MESNEVI

I

Mevlana Xhelaleddin
Rumi

Bashkia Metropoliane e Konjas, Botimet Kulturore, Nr. 115

Koordinatori i përgjithshëm
Ercan Uslu

Botues
Mehmet Birekul

Korrektore
Flora Hoxha

Kapakët
Sadrettin Özçimi

Shtypur në
Sebat Ofset
+90.332.342 01 53

Konja, Maj / 2007

ISBN
978-9944-913-75-1 (kompleti)
978-9944-913-76-8 (vëll.1)

Përgatitur nga
Realizim i Shoqërisë Anonime Konya Kültür
+90.332. 352 81 11

www.mkm.gov.tr
www.konyakultur.com.tr

Mevlana Xhelaleddin Rumi

MESNEVI
I

Përkthyes
Dr. Mithat Hoxha

Bashkia Metropoliane e Konjas

Prezantim

Mevlana Muhammed Xhelaleddin (1207-1273) i njohur në Perëndim si *Rumí, është një ndër poetët më të mëdhenj shpirtërorë e mistikë të të gjitha kohërave. Ai është si një luginë e gjerë e shtrirë në majat më të larta të njerëzimit. Sot, në botë, mesazhi i tij shpirtëror shpërndan dritë në zemrat e miliona njerëzve!*

Me një fjalë, Rumiu ka bashkuar dhe njësuar aspektin pasionant të fesë me sufizmin dhe artin e poezisë. Në traditën mevlevite të formuar në mënyrën e tij të jetesës dhe nën dritën e mësimeve të tij, përmbahen shumë theksime lidhur me shndërrimin e mesazhit shpirtëror të Islamit në mënyrë jetese. Vepra më e madhe e Rumiut, Mesnevia, nuk është një ritregim poetik i Kur'anit dhe një libër i shenjtë i Islamit, vetëm se, në gjuhën e sufive, *Mesnevia* është një libër mirëkuptimi dhe uniteti që e interpreton këngën e ashkut, dashurisë pasionante, në një mënyrë elegante e të thellë!

Para së gjithash, Rumiu është një njohës mjeshtëror i shpirtit. Ai ka shkruar poezi, por nuk mund të shihet vetëm si poet. Ai ka treguar historira të ndryshme, por nuk mund të shihet vetëm si tregimtar. Krejt ndryshe nga ç'mund të mendohet, ai s'është as themeluesi ose parapijësi i ndonjë feje! Ai është, sipas terminologjisë mistike, një *myrshit,* domethënë orientues i rrugës së drejtë, një *pir,*

domethënë një plak ose i mençur dhe një *ustad,* domethënë usta, mjeshtër i shpirtit njerëzor i cili ua kujton njerëzve se, duke u zhveshur nga të gjitha të këqijat, njeriu duhet të kthehet te qenia e tij e natyrshme, i cili, duke interpretuar parimet e fesë islame, i orienton njerëzit drejt delikatesave të shpirtit dhe drejt të vërtetave. Prandaj çdo njeri gjen tek ai ca gjëra për vete, ftesa e tij mundet të reflektohet në të gjithë botën. Prandaj *Mesnevia* është një diell që i jep dritë çdo shpirti dhe zemre! Ndërkaq, çdo njeri merr nga ky det aq sa ç'e ka kapacitetin, aq sa ç'e ka pjesën e caktuar për të marrë!

Gjendja e sotme e njerëzimit tregon për një krizë të thellë shpirtërore. Pazgjidhshmëria e çështjeve na qëndron para si një problem i madh. Prandaj jam i sigurt se këto probleme e vështirësi në dukje të pazgjidhshme mundemi t'i kapërcejmë me mesazhet e dashurisë pasionante të pafundme dhe të lirisë shpirtërore të Mevlanasë. Këto mesazhe i drejtohen kujtdo pa vënë kufizime fetare, gjuhësore, raciste e të ngjashme. Rumiu e shpreh këtë delikatisht kështu: "Po qe se në derë do t'ju vijnë vetëm të mirët, ku të shkojnë të këqinjtë?"

Me këtë rast u paraqes falenderimet e mia përkthyesit Dr. Mithat Hoxha dhe të gjithë atyre që kanë dhënë kontributin e tyre të çmuar për botimin e kësaj vepre në gjuhën shqipe. Për shpirtrat e etur, kjo vepër është një burim ku mund ta shuajnë etjen; për shpërndarjen e reve të injorancës, vetmisë dhe pasigurisë, është një dritë shprese; kurse për shokët dhe dashamirësit tanë të përhershëm, një udhërrëfyes!

Tahir AKYÜREK
Kryetar i Bashkisë
Konja - Turqi

Konja,
poeti mistik Mevlana
dhe poema e tij Mesnevi

Në prehistori dhe, pas saj, në periudha të ndryshme të epokës historike, qyteti që thirret sot me emrin Konja është emërtuar dhe thirrur me emra të ndryshëm. Emri më i njohur i qytetit në periudhën antike është "Ikonium". Në vitet e para të periudhës romake, qyteti është quajtur "Ikonium", kurse në kohën e perandorit Klaudius (41-54 e.r.) ka nisur të quhet "Claudiconium". Në periudhën bizantine njihet me emërtimin "Tokonion" dhe pastaj, duke filluar me selçukët, emërtimi i qytetit ka marrë trajtën përfundimtare "Konja" (sipas drejtshkrimit turqisht Konya).

Si kryeqendra historike e Anadollit, Konja është ura që lidh, nëpërmjet Anadollit, Azinë me Europën. Nga periudhat prehistorike e gjer në epokën tonë, Konja është bërë djepi i shumë kulturave dhe pragu i qytetërimeve. Konja ka qenë kryeqyteti i Shtetit Selçuk dhe një nga qytetet kryesore feudale e osmane.

Konja është "qyteti i Mevlanait" ("qyteti i zotërisë sonë të nderuar") dhe qendra e mevlevizmit. Ashtu siç nuk mund të mendohet pa Mevlanain mevlevizmi që është produkt i mendimit filozofiko-mistik dhe i ndjenjës mistike të poetit, ashtu dhe Konja nuk mund të mendohet pa Mevlanain. Por

Konja është edhe atdheu i Junus Emresë, poet i madh i kombit turk dhe gatuesi i ndjenjës kombëtare turke, edhe atdheu i të famshmit Nastradin Hoxha që njihet mirë në trojet shqiptare. Si rrjedhojë e këtyre meritave të larta, shkencëtari i shquar francez Prof. Eugéne Pittarel (Noelle Roger) me të shoqen e kanë cilësuar Konjën si "Qytet të Shenjtë".

Zotëria ynë (Mevlana) Xhelaleddin Rumi (1207-1273) lindi në qytetin Belh të Afganistanit në një zonë kufitare me Uzbekistanin. Mendimtar dhe mistik i shquar, themelues i tarikatit mevlevit. Kohën më të madhe të jetës e kaloi në Konja dhe aty vdiq. Ai erdhi në Konja me të atin në kohën e sundimit të sulltan Alaeddin Kejkubadit. Atëherë ai ishte katërmbëdhjetë vjeç. Siç tregojnë burimet biobibliografike, si emër të parë ka pasur emrin Muhammed. Por është bërë zakon të thirret përgjithësisht Xhelaleddin Rumi, nga studiuesit perëndimorë thjesht Rumi, kurse nga rrethet mistike e fetare, thjesht Mevlana, *Zotëria ynë*. Në përshtatje me frymën dhe tematikën e veprës që kemi në dorë, edhe ne po e thërresim vetëm Mevlana.

Siç thuhet, Mevlanai e mësoi mistikën nga dervishi shëtitës Shemseddin Muhammed Tebriziu, kurse dituritë e tjera fetare dhe shkencat, nga i ati Bahaeddin Muhammed. Pastaj, duke i bashkuar këto me kapacitetin e lartë mendor dhe talentin e tij të lindur artistik, Mevlanai krijoi vepra të mëdha fetare e shoqërore si tarikatin mevlevit, dhe shumë vepra letrare-artistike.

Mevlanai përdori në vargje persishten që ishte edhe gjuha e pallatit të selçukëve. Pavarësisht nga cilësitë dhe meritat e tjera, Mevlanai është, në kuptimin më të gjerë, një artist me strukturë artistike mistike. Mendimi i tij filozofik mund të përmblidhet në gjetjen e të gjithë të vërtetës në veten e vet. Metoda e tij është arritja tek forca hyjnore me anë të rrugës së zemrës. Këtë metodë afektive e përmbledh thënia e famshme e mistikëve se "tek Zoti arrihet jo me adhurim, por me dashuri (afeksion). Ndërkaq, duhet sqaruar se, si koncepti *muhabbet*, ashtu dhe koncepti *marifet* që janë koncepte bazë në metodën e rrugës mistike, mbështeten në ndjenjën, afeksionin e lartë dhe sublim që është krejt e ndryshme nga ndjenja shtazore e bazuar mbi epshin, dhe mohimi i saj.

Veprat kryesore të Mevlanait janë: 1) *Divani Shemsi Tebrizi* me shumë botime në lindje e Perëndim. 2) Rubairat. 3) Vepra më e madhe: Mesnevii Manevi me 25.700 bejite (bejte, dyvargshe ose kuplete). Kjo vepër është përkthyer në shumë gjuhë të botës.

Në konceptualitetin historik shqiptar të historisë botërore të letërsisë, Xhelaleddin Rumi është përmendur si poet persian krahas poetëve të shquar si Saadi, Xhami, etj. Në një aspekt, kjo është e drejtë, sepse, siç u tha, veprat e tij janë shkruar persisht. Por ai konsiderohet edhe poet turk sepse të gjithë veprimtarinë ideore e letrare e zhvilloi në Turqi dhe të gjitha veprat e tij janë përkthyer në turqishte. Gjithashtu, tërë trashëgimia shpirtërore e materiale e tij ndodhet në Konja, pra, në Turqi.

Origjinali i Mesnevisë është në vargje 11-rrokëshe, por të gjitha përkthimet e saj në gjuhë të tjera, përfshi edhe këtë përkthim shqip, janë bërë me një prozë poetike ose, më saktë, me një prozaizim të origjinalit.

Dr. Mithat Hoxha

Përmbajtja

24 Padishahu dashurohet pas një skllaveje dhe e blen. Skllavja sëmuret, kurse padishahu përpiqet ta shërojë.

26 E, kështu, padishahu e kuptoi se mjekët mbetën të paaftë për ta shëruar skllaven. Padishahu mendoi se duhej t'i falej Zotit. Ai sheh në ëndërr një njeri të shenjtë!

27 Lutja e suksesit nga Zoti që e jep suksesin; respektimi i etikës dhe edukatës në të gjitha gjendjet; dëmet shumë të mëdha të paturpësisë dhe mungesës së edukatës

28 Padishahu takohet me të urtin, veliun, që iu tregua në ëndërr

28 Padishahu e çon të urtin që ta vizitojë të sëmurën.

31 I urti i kërkon padishahut ta lërë vetëm për vetëm me të sëmurën për t'ia kuptuar sëmundjen.

33 I urti e kupton sëmundjen e skllaves dhe ia paraqet padishahut.

33 Padishahu dërgon në Samarkand njerëz të ngarkuar me detyrë për t'ia sjellë argjendarin.

35 Helmimi i argjendarit u bë me urdhrin e Zotit dhe jo me dashjen e padishahut.

37 Ngjarja e bakallit dhe papagallit, papagalli derdh vajin e trëndafilit në dyqan.

41 Historia e mbretit çifut.

42 Veziri i mëson mbretit hile.

43 Veziri u bën hile krishterëve.

43 Krishterët i besojnë hiles së vezirit.

44 Krishterët bëjnë siç u thotë veziri.

46 Kalifi e sheh Lejlanë.

48 Veziri bëhet ziliqar.

48 Krishterët e mençur e kuptojnë hilen e vezirit.

49 Mbreti i dërgon vezirit lajm fshehurazi.

49 Dymbëdhjetë pjesët e krishterëve.

49 Veziri i ngatërron urdhrat e ungjillit.

52 Mosmarrëveshja është në mënyrën e ecjes, jo në të vërtetën e rrugës.

53 Veziri pëson dëm nga hileja e tij.

54 Veziri thur një hile tjetër për t'i azdisur më tej krishterët.

55 Veziri i përzë myridët.

56 Myridët i luten prapë që t'i japë fund vetmisë dhe vetëmundimit.

57 Veziri përgjigjet se nuk do të dalë nga mbyllja në vetmi.

57 Myridët i luten vezirit.

60 Veziri i lë pa shpresë myridët në çështjen e braktisjes së vetizolimit.

60 Veziri e bën çdo emir zëvendësues në postin e vet.

61 Veziri vret veten në vetizolim.

61 Bashkësia e Isait i pyet emirët: "Kush është zëvendësi nga ju?"

62 Të gjithë pejgamberët janë të vërtetë. "Ne nuk i ndajmë pejgamberët e Zotit nga njëri-tjetri!"

63 Emirët nxorën shpatat dhe luftuan kundër njëri-tjetrit për prijësi dhe pushtet.

65 Lartësimi i vetive të mira të Mustafait (s.a.) të përmendura në Ungjill.

65 Historia e një mbreti tjetër çifut që përpiqet ta shkatërrojë fenë e Isait.

67 Mbreti çifut vë njerëz të ndezin zjarr dhe pranë zjarrit të vendosin një statujë së cilës, kush i falet, shpëton nga zjarri.

68 Mbreti çifut sjell një grua me një fëmijë të vogël dhe e hedh fëmijën në zjarr; fëmija i vogël që i vjen goja, e nxit popullin të hidhet në zjarr.

70 Personit që e përmendte emrin e Muhammedit (a.s.) për t'u dëfryer, i mbeti goja shtrembër!

71 Mbreti çifut i flet zjarrit.

72 Historia e erës e cila, në kohën e Hudit (a.s.), e shkatërroi fisin e Adit.

73 Mbreti çifut nuk u jep rëndësi këtyre fjalëve, i mohon dhe nuk i pranon këshillat e këshilltarëve.

75 Kafshët e gjahut i thonë luanit t'i dorëzohet Zotit e ta lërë punën.

76 Luani u përgjigjet kafshëve dhe u thotë se puna është e dobishme.

76 Kafshët e gjahut pëlqejnë dorëzimin në vend të punës dhe fitimit me punë.

76 Luani pëlqen punën dhe fitimin duke punuar, në vend të dorëzimit dhe nënshtrimit.
77 Kafshët e gjahut pëlqejnë dorëzimin ndaj punës dhe fitimit me punë.
77 Luani përsëri pëlqen punën ndaj dorëzimit.
78 Kafshët e gjahut prapë zgjedhin dorëzimin në vend të punës dhe fitimit me punë.
79 Azraeli sheh dikë që pastaj ikën në sarajin e Sulejmanit; dorëzimi është më i vlefshëm se puna; dobitë e punës janë më të pakta.
80 Përsëri, luani pëlqen punën në vend të dorëzimit dhe tregon dobitë e punës.
81 Pëlqimi i punës ndaj dorëzimit.
82 Kafshët e gjahut i kundërvihen lepurit pse vonoi të shkonte te luani.
82 Lepuri u përgjigjet kafshëve.
82 Lepuri u përgjigjet kafshëve të gjahut.
83 Dija e lepurit, virtytet dhe dobitë e dijes.
84 Kafshët e gjahut e shqyrtojnë sërish të fshehtën dhe mendimin e lepurit.
84 Lepuri e fsheh sekretin prej tyre.
85 Lepuri i punon një rreng luanit dhe del fitues mbi të
87 Pavlershmëria e shkujdesur e interpretimit të mizës.
88 Luani preket nga vonesa e lepurit.
89 Lepuri dredhon prapë dhe e vonon vajtjen.
91 Lepuri shkon te luani, Luani nxehet me lepurin.
92 Lepuri paraqet justifikim dhe e mashtron luanin.
93 Luani i përgjigjet lepurit dhe shkon së bashku me të.
94 Historia e Sulejmanit i cili na bën të ditur se, kur fati bëhet fakt, edhe sytë e ndriçëm s'shohin dot!
95 Sorra flet kundër zogut lajmëtar.
96 Zogu lajmëtar i jep përgjigje akuzës së sorrës.
96 Historia e profetit Adem; atij ia mbyll sytë fati dhe e zbaton urdhrin pa e menduar, pa bërë fjalë.
98 Kur u afruan te pusi, lepuri u tërhoq pas.

100 Luani e pyet seriozisht lepurin se cili ishte shkaku që e tërhoqi këmbën pas.
100 Luani vështron fundin e pusit dhe sheh atje reflektimin e vetes me lepurin.
102 Lepuri u çon kafshëve të gjahut sihariqin se luani ra në pus.
103 Kafshët e gjahut mblidhen rreth lepurit dhe e lavdërojnë!
104 Lepuri i porosit kafshët që të mos gëzohen shumë.
104 Kuptimi i fjalës "Po kthehemi nga lufta e vogël për në luftën e madhe!"
105 Ambasadori i perandorit të Bizantit shkon te kalifi Omer dhe sheh mrekullitë e tij.
107 Ambasadori e gjeti emirin e muslimanëve duke fjetur nën një pemë.
107 Omeri zgjohet nga gjumi dhe ambasadori i Bizantit e përshëndet.
109 Ambasadori bizantin e pyet Omerin, emirin e muslimanëve.
111 Ndërsa Ademi e mori gabimin mbi vete, Iblisi ia ngarkoi fajin Zotit.
113 Shpjegimi i ajetit "Kudo që të ndodheni, Ai është bashkë me ju!"
113 Ambasadori e pyet Omerin se pse shpirtrat janë të shtënë pas kësaj balte.
114 Kuptimi i fjalës "Kush kërkon të rrijë me Zotin, të rrijë me njerëzit e mistikës"
115 Një tregtar shkon në Indi dhe papagalli i burgosur u dërgon me të lajm papagallëve të Indisë.
117 Cilësitë e krahëve të zogjve të mendjes hyjnore.
117 Tregtari i takon papagajtë e Indisë dhe u jep të fala nga papagalli i tij.
118 Kuptimi i fjalës së Ferideddin Attarit, Zoti ia shenjtëroftë shpirtin!
119 Magjistarët e respektojnë Musain duke e vënë të zgjedhë se kush të hedhë i pari dhe Musai ua lë radhën atyre.
121 Tregtari i tregon papagallit të vet ç'pa tek papagallët e Indisë.

124 Pasi dëgjon se ç'i kishte ngjarë papagallit atje në Indi, papagalli i tregtarit vdes në kafaz, kurse tregtari qan për të.

128 Fjala e Hakim Senaiut, "Edhe sikur gjëja që të shmang ty nga rruga, të jetë fjalë mohimi, edhe sikur të jetë besim..., edhe sikur piktura që të lë larg ty nga miku, të jetë e shëmtuar, edhe sikur të jetë e bukur, njëlloj janë"; Hadithi i Pejgamberit (s.a.s.), "Sa'di është shumë ziliqar, unë jam më ziliqar se Sa'di, kurse Zoti është më ziliqar se unë; për shkak të zilisë, Ai i ka bërë haram të gjitha të këqijat e dukshme e të padukshme".

131 Kthimi te historia e tregtarit.

132 Tregtari e hedh papagallin e vdekur jashtë kafazit dhe, pastaj, papagalli fluturon.

133 Papagalli i lë lamtumirën tregtarit, fluturon e ikën.

133 Kur populli ngre lart dikë dhe e tregon me gisht, kjo ka pasoja të këqija.

135 Shpjegimi i shprehjes "Allahu ia mbrojttë prejardhjen!"

137 Historia e një muzikanti plak i cili, në kohën e Omerit - Zoti qoftë i kënaqur me të - në ditët e papasjes shkonte në varrezat dhe i binte lirës.

139 Shpjegimi i hadithit "Në ditët tona janë aromat e mira të Zotit tuaj. Ejani në vete dhe përpiquni t'i nuhatni ato aroma të mira!"

143 Aisheja - Zoti qoftë i kënaqur me të - e ka pyetur Mustafanë - paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të - "Sot ra shi. Megjithëse shkove në varrezat, rrobat nuk i ke të lagura! Pse?"

144 Shpjegimi i vargjeve të Gjykatësit Senai: "Në dorë të shpirtit ka qiej që ngarkojnë me punë qiejt e botës. Në rrugë të shpirtit ka shumë zbritje, shumë të përpjeta, shumë male dhe dete!"

145 Kuptimi i hadithit "Dijeni për pasuri freskinë e pranverës dhe përfitoni prej saj. Sepse ç'u bën ajo pemëve, u bën edhe trupave tuaj!"

146 Besnikja pyet: "Cila ishte e fshehta e shiut sot?"

147 Pjesa e mbetur nga historia e sazexhiut dhe shpëtimi i tij.

149 Në ëndërr, Hatifi i tha Omerit: "Merr kaq mall nga malli i shtetit dhe jepja atij njeriu që po fle në varrezë!"

150 Para se të ngrihej minberi nga predikonte Pejgamberi, ai mbështetej në trungun të quajtur Hannane. Kur u ngrit minberi dhe Pejgamberi u largua nga druri, ai nisi të rënkojë. Edhe sahabet e dëgjuan rënkimin, kurse Pejgamberi foli hapur me trungun.

152 Mrekullia e gurëve të fshehur në dorën e Ebu Xhehlit, që dëshmuan për drejtësinë e Muhammedit - paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të -!

153 Fundi i historisë së sazexhiut; Emiri i besimtarëve, Omeri, i çon në vend fjalët e Hatifit.

155 Omeri e ktheu vështrimin e sazexhiut plak nga vajtimi që është bota e ekzistencës, në dalldi që është bota e dehjes së përkushtimit shpirtëror.

156 Shpjegimi mbi lutjet e atyre dy engjëjve, nga të cilët njëri i lutej Zotit që t'i shpërblente ata që ushqenin të varfërit, kurse tjetri, që t'ua shkatërronte pasurinë atyre që e fshihnin atë dhe nuk jepnin; shpjegimi mbi atë person që jepte, i cili ishte luftëtar në rrugën e Zotit dhe jo shpërdorues në rrugën e dëshirave dhe pasioneve.

158 Historia e kalifit të pashoq, i cili në kohën e vet e kaloi Hatemi Taiun në bujari dhe mirësi.

158 Historia e beduinit arab të varfër dhe ndodhia mes tij dhe gruas për shkak të varfërisë.

159 Myridët nevojtarë gënjehen nga pretenduesit gënjeshtarë duke i pandehur ata si shenjtorë; myridët nuk e dallojnë dot paranë në dorë nga veresia, lulen artificiale, nga lulja e mbirë dhe e lulëzuar!

160 Disa herë, myridi i beson dhe i bindet me besnikëri shehut të rremë dhe pretendent. Dhe si rrjedhojë e kësaj besnikërie, arrin në një pozitë shpirtërore të tillë që shehu i tij s'e ka parë as në ëndërr. Atëherë, as uji dhe zjarri nuk i bëjnë dëm myridit, por për shehun janë të dëmshëm. Mirëpo kjo ndodh rrallë.

161 Beduini i thotë gruas të bëjë durim dhe i tregon asaj për virtytet e durimit dhe papasjes.

162 E shoqja i tha beduinit: "Lime tekulune ma la tef'alun", "mos fol më shumë se ç'të takon"! Megjithëse këto fjalë që the janë të drejta, kjo pozitë dorëzimi nuk është e jotja. Thënia e fjalëve më të larta se pozita jote dhe puna që bën, të dëmtojnë ty, atëherë shfaqet konkluzioni "Kebure makten indallah", "ndodhi ajo që urrehet në lartësinë e Allahut"!

164 Burri e këshillon gruan të mos i shohë të varfërit me përçmim, të mos i ngjisë mangësi punës së Zotit, të mos i qortojë të varfërit dhe varfërinë duke imagjinuar varfërinë e vet.

166 Vështrimi dhe veprimi i çdokujt varen nga pozita ku ndodhet. Çdokush e sheh botën nga dritarja e vështrimit të vet. Xhami blu e tregon diellin blu; xhami i kuq, të kuq. Xhami pa ngjyrë është i bardhë, pa ngjyrë. Xhami pa ngjyrë tregon më drejt se të gjithë xhamat e tjerë. Xhami pa ngjyrë është koka, është prijësi i të gjithëve!

167 Gruaja e beduinit vjen në rrugë dhe bën pendesë për fjalët që ka thënë.

170 Femrat e mundin njeriun e mençur, kurse njeriu injorant del fitues mbi to!

170 Beduini iu dorëzua gruas duke menduar se kundërshtimi dhe dëshira e gruas ishin urdhër i Zotit. Çdo njeri me arsye e di se është dikush apo diçka që e rrotullon gjënë që rrotullohet.

171 Ashtu siç janë të varur helmi me kundërhelmin dhe errësira me dritën ndaj dëshirës së Zotit, ashtu dhe Musai dhe Faraoni janë të varur ndaj dëshirës së Zotit. Faraoni i lutet Zotit në vetmi që t'ia ruajë nderin nga copëtimi!

173 Shkaku i privimit të njerëzve të këqinj nga të dy botët sipas konkluzionit "Pësuan disfatë në botë e në ahiret"!

175 Syri i ndjenjës i sheh me përbuzje pejgamberin Salih dhe devenë e tij. Po qe se Zoti dëshiron ta shkatërrojë një ushtri, ia tregon armikun të pakët e të dobët edhe sikur të jetë më i madh në numër e më i fortë. Dhe thotë: "Për ta bërë atë që duhej bërë, ju tregoi juve në sytë e tyre të pakët e të dobët!"

178 Shpjegimi i ajeteve "Zoti krijoi dy dete që, megjithëse takohen me njëri-tjetrin, nuk përzihen!"

180 Eshtë e papërshtatshme që myridi, duke vepruar me paturpësi, të bëjë të njëjtin veprim që bën edhe i urti. Sepse hallva nuk i bën dëm mjekut, por i bën dëm të sëmurit. Të ftohtit dhe bora nuk e dëmtojnë rrushin e pjekur, por aguridhen, sepse ajo është në rrugën e pjekjes... "Gjersa Allahu të t'i falë ty mëkatet e kaluara e të ardhshme!"

181 Fundi i historisë së beduinit me të shoqen.

183 Beduini ia plotëson kërkesën gruas dhe i betohet se në këtë nënshtrim ai nuk ka hile dhe nuk po e bën këtë për ta vënë në provë.

185 Gruaja i tregon të shoqit rrugën për të kërkuar të mira, dhe ai e pranon.

186 Duke pandehur se atje ka mungesë uji, Beduini kapërcen shkretëtirën për t'i çuar dhuratë kalifit një shtambë me ujë shiu!

187 Beduini e fut shtambën në një trastë lëkure, ia mbyll grykën shtambës dhe e qep.

189 Ashtu siç i varfëri është i shtënë pas bujarisë dhe bujarit, ashtu dhe bujari është i shtënë pas të varfërit. Po qe se durimi i të varfërit është i madh, njeriu bujar i shkon në portë atij. Po qe se durimi i njeriut bujar është i madh, i varfëri i shkon në portë atij. Ndërkaq, durimi i të varfërit është pjekuri e tij, kurse durimi i të pasurit është e meta e tij.

189 Ndryshimi mes personit të etur dhe nevojtar ndaj Zotit dhe personit i cili nuk zotëron diçka që i përket Zotit dhe është i etur ndaj dikujt tjetër veç Zotit.

191 Njerëzit e kalifit e takojnë beduinin për ta pritur me respekt dhe ia pranojnë dhuratën.

193 Personi i dashuruar pas kësaj bote është i dashuruar pas një muri që i ka rënë dielli. Ai i përngjet personit që nuk e ka lodhur fare mendjen për ta kuptuar se shkëlqimi i murit nuk është i vetë murit por i vjen nga dielli dhe që, për këtë arsye, e ka dhënë veten plotësisht pas murit. Dhe, kur drita e diellit kthehet te dielli, ai mbetet pa të. "Mes tyre dhe gjësë që e dëshirojnë, ka hyrë një ndarje!"

193 Proverbi i arabëve: Në rënç në mëkat, të paktën bjer me një grua të lirë (jo me një skllave); Në vjedhsh, të paktën vidh margaritar!

194 Beduini ua jep shtambën me ujë shërbyesve të kalifit.

195 Historia e dijetarit të sintaksës.

196 Ndërsa nuk kishte nevojë aspak për ujë, kalifi e pranoi dhuratën dhe ia ktheu beduinit të mbushur plot flori. Beduini u gëzua së tepërmi!

201 Kush është piri (plaku, prijësi)? Cilësitë e pirit.

202 Pejgamberi (s.a.s.) e ka porositur Aliun (r.a.) kështu: "Çdokush dëshiron t'i afrohet Zotit me një lloj adhurimi; ti përpiqu t'i afrohesh me anë të bisedës me robtë e mençur e të afërt të Zotit në mënyrë që të bëhesh i pari ndër të gjithë!"

204 Historia e kazvinasit që ka dashur të bëjë tatuazhin e një luani në trup, por që është penduar nga dhimbja e gjilpërës.

206 Luani, ujku dhe dhelpra që shkojnë për gjah.

207 Luani i tha ujkut për ta vënë në provë: "Eja pranë meje, o ujk dhe ndaje gjahun mes nesh!"

208 Dikush i tha kështu dikujt që i trokiti në portë dhe, kur e pyeti se kush ishte, iu përgjigj "unë": "Meqë je "unë" për vete, pra "ti" për mua, nuk po ta hap portën, sepse nuk njoh asnjë nga miqtë e mi që të jetë "unë" për vete, pra "ti" për mua!

210 Personi që tha "jam unë" pendohet, kalon një vit me përkorësi, pastaj kthehet te shtëpia e mikut dhe pyetjes së tij "kush troket" i përgjigjet "je ti".

211 Luani e ndëshkoi ujkun sepse në përpjesëtimin e gjahut nuk respektoi etikën.

212 Nuhu e kërcënoi popullin e vet: "Mos u merrni me mua sepse unë jam mbulesë e Zotit! O të poshtëruar e të dëmtuar, në të vërtetë, ju merreni me Zotin!"

214 Sundimtarët i ulin para vetes sufitë e pajisur me kulturën shpirtërore.

214 Te Jusufi shkon një mik dhe Jusufi kërkon prej tij një dhuratë.

215 Jusufi i kërkon dhuratë mikut.

217 Miku i tha Jusufit: "Të kam prurë si dhuratë një pasqyrë. Sa herë që të shihesh në të, do të vështrosh fytyrën tënde të bukur dhe do të më kujtosh mua!"

219 Shkruesi i vahjit, zbulesës hyjnore, i cili, nën dritën e zbulesës, i thoshte ajetet para Pejgamberit (a.s.) prandaj filloi të pretendonte se edhe atij i zbulohej fjala hyjnore dhe, kështu, doli nga feja.

223 Historia alegorike e Baurit.

224 Historia e Harutit dhe Marutit.

225 Fundi i historisë së Harutit dhe Marutit dhe ndëshkimi i tyre në Pusin e Babilonit.

226 Shurdhi shkon te komshiu i sëmurë për ta pyetur për shëndetin

229 Eshtë Iblisi i pari që, përballë fjalës së Zotit, pretendoi të bënte supozim.

230 Halli, gëzimi dhe dehja duhen fshehur prej injorantëve.

233 Rumët me kinezët vënë bast për aftësi pikturimi.

235 Pejgamberi Alejhisselam e pyeti Zejdin: "Si u gdhive sot, si je?" Dhe ai iu përgjigj: "Si besimtar, o i dërguari i Zotit!"

236 Zejdi i përgjigjet Pejgamberit (s.a.s.): "Sipas meje, gjendja e popullit s'është e fshehtë, por krejt e qartë!"

240 Skllevërit dhe shërbëtorët e të zot e akuzojnë Llukmanin se ka ngrënë frutat e mbledhura.

241 Përgjigjja e Zejdit për Pejgamberin (s.a.s.) dhe fundi i kësaj historie.

244 Pejgamberi (s.a.s.) i thotë Zejdit: "Mos e zbulo këtë të fshehtë, por ruaje!"

245 Kthim në historinë e Zejdit.

247 Në kohën e Omerit - Zoti qoftë i kënaqur me të - në qytet ra zjarr.

248 Armiku e pështyn në fytyrë Aliun - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - Emiri i muslimanëve, Aliu, e hedh shpatën nga dora.

251 Qafiri e pyeti Aliun - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - "Pse e hodhe shpatën prej dore kur më kishe vënë poshtë mua?"

252 Emiri i besimtarëve, Aliu - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - jep përgjigje dhe tregon se cili ishte shkaku që e hodhi shpatën.

255 Pejgamberi (a.s.) i thotë në vesh kujdestarit të kalit të emirit të muslimanëve, Aliut - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - "Po të lajmëroj se vrasja e Aliut do të jetë në dorën tënde!"

258 Ademi (a.s.) habitet me mbrapshtinë dhe mendjemadhësinë e Iblisit.

260 Kthim në historinë e Aliut - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - Aliu e sheh me sy të mirë vrasësin e vet.

261 Vrasësi i bie ndër këmbë Aliut - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - duke i thënë: "O emiri i besimtarëve, vramë dhe shpëtomë nga kjo ngjarje!

262 Dëshira e Mustafait (s.a.s.) për ta pushtuar Mekën dhe vende të tjera nuk ishte nga dashuria për pasurinë e kësaj bote, por me urdhër të Zotit, sepse ai pati thënë se "kjo botë është kufomë".

263 Emiri i besimtarëve, Aliu - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - i tha armikut: "Kur më pështyve në fytyrë, egoja m'u fry dhe në luftën time s'më mbeti më sinqeritet. Kjo ishte që më pengoi të të vrisja!

بسم الله الرحمن الرحيم

Me emrin e Allahut Mëshirues e Shpërblyes!

Ky është libër i Mesnevisë. Për sa i përket arritjes së të vërtetës dhe shtjellimit të të fshehtave evidente të saj, Mensevia është esenca e esencës së esencës së fesë. Është dija më e lartë e Zotit, rruga më e ndriçuar e Zotit, prova më e hapur e Zotit. Mesnevia i përngjet llambadarit brenda të cilit ndodhet kandili që llamburit më shumë se mëngjeset, që është parajsë për zemrat; ajo ka burimet e saj, degët e saj, filizat e saj. Njërit prej atyre burimeve, këta bij të rrugës i thonë Selsebil, çezmë për udhëtarë. Është stacioni më i mbarë dhe vendi më i mirë i pushimit për personat e pozitës së lartë shpirtërore dhe bujarë. Njerëzit e mirë e të dobishëm ftohen, hanë e pinë aty; njerëzit e lirë çlodhen e ripërtërihen. Mesnevia i përngjet Nilit në Egjipt: është ujë i pijshëm për të duruarit, është mall i pashuar për soj sorollopin e Faraonit dhe mohuesit, qafirët! Kështu, edhe Zoti ka thënë: "Me të, Zoti ua zgjat rrugën shumicës dhe ua drejton rrugën shumicës!" Nuk ka dyshim se Mesnevia është shërim për zemrat, i fshin dëshpërimet, e bën Kur'anin të kuptueshëm, bëhet shkak për begatimin e të mirave, i zbukuron shprehitë. Eshtë shkruar me duart e shkronjësve me famën të lartë e me thelbin të dobishëm, të cilët nuk lejojnë që ta prekin të tjerë persona përveç atyre të të pastërve! Mesnevia ka zbritur nga Zoti i Botëve: e shtrembra nuk i ngjitet dot as nga para, as nga pas, se e vëzhgon dhe e mbron Zoti që është mbrojtësi më i

mirë dhe më i mëshirshmi i të mëshirshmëve. Mesnevia ka edhe cilësime të tjera veç këtyre; edhe ato Zoti i ka dhënë! Por ne, duke i përmendur këto pak cilësime, e premë fjalën shkurt. E pakta është provë për të shumtën, një grusht ujë është provë për liqenin, një grusht kokrra drithi është provë për lëmin.

Robi i varfër e nevojtar për mëshirën e Zotit të Lartë, Muhammedi i biri i Muhammedit të birit të Hysejinit prej Belhi - Zoti ia pranoftë Mesnevinë - thotë: U përpoqa e u rropata për ta zgjatur dhe për ta zgjeruar nga të gjitha anët këtë Mesnevi në vargje e cila përmban në vetvete ndodhi të çuditshme e të thëna rrallë, fjalë të mëdha e të dobishme, margaritarë të argumentimit, rrugën e të të përkushtuarve të devotshëm, kopshtin e atyre që kryejnë adhurimet, si dhe e cila ka pak fjalë e shumë kuptime, më dëshirën e zotërisë tim, e personit tek i cili jam mbështetur e kam pasur besim, i cili sundon mbi trupin tim siç sundon shpirti im mbi të dhe në dorë të të cilit ndodhet buka ime e përditshme! Ai person është i madhi dhe prijësi i arifëve, domethënë, dijetarëve shpirtërorë, imami i njerëzve të orientuar e të njohur në mënyrë evidente me të vërtetën, është amaneti mes popullit i Zotit që u shkon në ndihmë britmave të popullit dhe që i mban fort zemrat dhe mendjet, është i zgjedhuri i Zotit mes krijesave, i zgjedhuri në porositë e profetit të vet dhe në të fshehtat pranë njerëzve të kulluar të tij. Eshtë Hasani i biri i Muhammedit të birit të Hasanit, shpatës së Zotit dhe të fesë, zotëruesit të virtyteve, i njohur si Ahityrkogllu, çelës i thesarëve të Arshit dhe kujdestar i thesareve të tokës. Ai është Bajazidi i kohës, Xhunejdi i së sotmes. Eshtë Besniku i biri i Besnikut. Zoti qoftë i kënaqur edhe prej tij, edhe prej të parëve të tij! Në origjinë është nga Urumu dhe nga soji i shehut vlerëlartë që thoshte "rashë të flija kurd dhe u ngrita arab", Zoti ia bekoftë shpirtin atij vetë dhe ua bekoftë shpirtrat atyre që rrjedhin nga soji i tij! Ç'paraardhës i mirë dhe ç'pasardhës i mirë!

Ka një soj të tillë
që dielli ka shtruar kaftanin mbi sojin e tij;
Ka një origjinë të tillë
që yjet kanë shtruar dritën përtokë përballë tij!

MESNEVI
I

Dëgjo se si ky fyell ankohet, si i përshkruan ndarjet:

Qysh kur më prenë nga kallamishtja, vajtimin tim gra e burra e dëgjuan dhe qanë e rënkuan.

Kërkoj një zemër të bërë copë-copë nga ndarja që t'ia tregoj se ç'hall kam e çfarë kërkoj.

Njeriu që bie larg nga rrënja, prapë truallin e bashkimit e kërkon.

Unë në çdo kuvend qava e rënkova, edhe me të vuajtur u bashkova, edhe me të kënaqur.

Çdo njeri m'u bë mik siç më kuptoi, por asnjeri s'kërkoi t'i mësonte të fshehtat e mia.

E fshehta ime s'është larg klithmës sime, por jo çdo sy sheh e çdo vesh dëgjon!

Trupi s'është i fshehtë për shpirtin e shpirti s'është i fshehtë për trupin, por askush s'ka leje për ta parë shpirtin.

Zëri i këtij fyelli është zjarr, jo erë; u shoftë ai që s'e ka këtë zjarr!

Ashku është zjarr që ka rënë brenda fyellit; ashku është vrull e hare që ka rënë brenda në verë!

Fyelli është shok i halleve të njeriut të ndarë nga miku. Perdet e tij i grisën perdet tona!

Kush ka parë si fyelli, edhe helm, edhe ëmbëlsirë; kush ka parë si fyelli, edhe shijim, edhe dëshirë?

Fyelli flet për rrugën e mbushur me gjak, tregon për ngjarjet e dashurisë së Mexhnunit.

Këtë mendje veç i pamençuri e kupton; edhe gjuha, veç veshit s'ka tjetër myshteri!

Nga vojtja jonë ditët dolën jashtë kohe, ditët u bënë shokë me gabimet!

Në kalofshin, ditët le të kalojnë, s'kemi frikë! O ti që s'ke shok në pastërti, ti mos ik, po rri!

Veç peshkut, çdo gjë u ngop me ujë; për të pafatin, ditët u zgjatën e shkuan!

Njeriu i patëkeq nuk kupton nga i rrahuri me jetën, prandaj fjala duhet prerë shkurt; të fala me shëndet!

O bir, zgjidhe litarin që të mban lidhur, bëhu i lirë! Gjer kur do të bëhesh skllav i arit dhe argjendit?

Po ta derdhësh detin në një shtambë, sa merr ajo? Sa kësmeti i një dite!

Shtamba e syrit të koprracëve nuk u mbush. Midhja e sedeftë, ngaqë kënaqej me pak, u mbush me margaritarë!

Ai që iu gris rroba për shkak të një dashurie, u pastrua mirë nga turpi, nga zilia!

O i dashuri ynë me dashurinë tënde të bukur, qofsh i gëzuar! O mjeku i të gjitha sëmundjeve tona!

O ilaçi i kreylartësisë dhe mendjemadhësisë sonë , o Platoni ynë, Galenusi ynë!

Nga ashku, trupi prej dheu u ngjit në qiej; mali nisi të lëvizë, u gjallërua!

O ashik! Ashku u bë shpirti i malit. Mali u deh, kurse Musait i ra të fikët e u rrëzua!

Po të flisja dot buzë më buzë me shokun që kalojmë kohën bashkë, edhe unë do të tregoja për gjërat që tregon fyelli!

Kush ndahet nga njeriu i afërt i zemrës, është i pagojë edhe nëse di njëqind lloje melodish!

Pasi të vyshket trëndafili e të ikë stina, s'mund të dëgjosh më aventura nga bilbili.

Çdo gjë është e dashuruara, ashiku është një perde. I dashuruari jeton, dashnori është i vdekur!

Kush s'ka dëshirë për dashuri, është si zogu pa krahë, mjerë ai!

Po s'e pata dritën e të dashurit para e pas, si mund ta dalloj unë ç'kam para e pas?

Ashku kërkon që kjo fjalë të shkruhet e të dalë jashtë; në mos qoftë pasqyra thashethemexhie, ç'është?

A e di pse pasqyra yte nuk bart fjalë? Sepse s'është fshirë nga pluhuri, nga papastërtitë!

TREGIM

Padishahu dashurohet pas një skllaveje dhe e blen. Skllavja sëmuret, kurse padishahu përpiqet ta shërojë.

O miq! Dëgjojeni këtë tregim! Në të vërtetë, kjo është gjendja jonë e sotme!

Në një kohë të hershme ishte një padishah. Ai sundonte edhe në pasuri, edhe në fe.

Një ditë me njerëzit e posaçëm të gjahut, ai i hipi kalit dhe u nis për gjah.

Duke shkuar nëpër rrugën kryesore, pa një skllave dhe e dashuroi si i marrë, aq sa u bë ai skllavi i saj.

Zogu i shpirtit nisi të përpëlitej në kafazin e trupit. Padishahu dha mall dhe e bleu skllaven.

E mori skllaven dhe e kënaqi dëshirën. Por ja që një ditë, skllavja u sëmur.

Njëri kishte gomar, por s'kishte shalë! Kur e gjeti shalën, gomarin ia rrëmbeu ujku!

Njëri kishte shtambë, por s'kishte ujë. Kur gjeti ujë dhe e mbushi, iu thye shtamba!

Padishahu mblodhi mjekë djathtas e majtas dhe u tha: "Jeta e të dy neve është në dorën tuaj!

Jeta ime s'është gjë; ajo është jeta e jetës sime! Unë jam i sëmurë e i vuajtur, shërimi im është ajo!

Kush i gjen derman jetës sime, merr thesarin tim, merr margaritarët dhe stolitë e mia!"

Të gjithë mjekët menjëherë i thanë: "Ta flijojmë jetën tonë! Të gjithë bashkë të mendohemi e të gjithë së bashku ta shërojmë!

Secili nga ne është një Mesih, një shpëtimtar i botës! Në dorë kemi ilaçe për çdo sëmundje!"

Nga mendjemadhësia, s'thanë "në dashtë Allahu!" Atëherë, Allahu u tregoi se sa të dobët janë njerëzit!

Ata s'e thanë fjalën "inshallah" jo se harruan, por nga zemërngushtësia e zemërngurtësia!

Hej, more, hej! Sa vetë ka që nuk thonë me gojë inshallah, por zemra u është zbutur ngaqë s'ndahet nga ajo!

Shumë lloje ilaçesh dhe shumë lloje shërimesh provuan mbi skllaven, por ajo u bë më keq!

Kur skllavja u dobësua e u bë si kashtë, lotët e përgjakur të padishahut u bënë lumë!

Vaji i bajames që i dhanë, i bëri më keq, e thau më shumë. Skllavja u dobësua më keq!

Gjërat që duhet ta lehtësonin, e rënduan më shumë, uji, si të ishte naftë, e ndihmoi zjarrin!

E, kështu, padishahu e kuptoi se mjekët mbetën të paaftë për ta shëruar skllaven. Padishahu mendoi se duhej t'i falej Zotit. Ai sheh në ëndërr një njeri të shenjtë!

Kur e pa se mjekët mbetën të paaftë, padishahu vrapoi zbathur për në faltore.

Pasi hyri në faltore, u drejtua te vendi i faljes. Vendi ku vuri kokën në sexhde, u qull në lot.

Pasi erdhi në vete, hapi gojën dhe, me një mënyrë të bukur, filloi ta lavdërojë Zotin:

"Zoti im që je në gjendje të dhurosh tërë pasuritë e botës! Ç'të them unë? Fundja, ti i njeh të fshehtat!

Zoti ynë që na i drejton dëshirat! Edhe kësaj radhe ne e ngatërruam rrugën!"

Ti po më thua se i di të fshehtat e mia, por, megjithatë, më kërkon ta derdh hallin e zemrës!

Dhe kur padishahu mori vrull në qarjen e tij, edhe deti i mirësive të Zotit u vrullua!

Duke qarë, padishahun e zuri gjumi. Ai pa në ëndërr një plak mjekërbardhë!

Dhe i tha: "O padishah, lajme të gëzuara ke! Dëshirat t'u pranuan. Ai që do të të vijë nesër, është prej nesh!

Mjeshtri që do të të vijë, është mjek. Dije se ai është njeri i drejtë! Ai është nga njerëzit e urtë e të besueshëm!

Në ilaçin e tij shih të fshehtën dhe në natyrën e tij vëzhgo fuqinë e Zotit!"

Kur u bë ditë dhe dielli u duk nga lindja e i dogji yjet,

Padishahu po priste në penxhere njeriun që të cilin iu tregua në ëndërr.

Dhe pa një njeri mjaft të virtytshëm, të ditur e të shquar, një diell mes hijes,

Që vezullonte që larg si hënë dhe që , kur s'shihej, dukej si një ëndërr!

Ne pothuaj s'kemi imagjinatë në shpirt. Ti shihe gjithë botën sikur të ecte mbi një përfytyrim!

Edhe kryet, edhe luftërat e tyre mbështeten në përfytyrim. Edhe lavdërimi, edhe turpërimi u vjen prej një përfytyrimi!

Ato përfytyrime që janë kurth për evlijatë, janë reflektime të fytyrëhënëve në bahçet e Zotit!

Edhe fantazma që pa padishahu në ëndërr, dukej pa u shuar në fytyrën e vizitorit plak.

Padishahu shkoi shpejt te përcjellësit dhe e priti mikun e ardhur nga bota e panjohur.

Pastaj që të dy u suallën si dy miq të vjetër, sikur e kishin njohur njëri-tjetrin prej kohësh!

Padishahu i tha se ai ishte në të vërtetë i dashuri i tij, mirëpo në këtë botë punët janë ngatërruar keq!

O i shtrenjtë, i tha padishahu, ti je për mua Mustafa, kurse unë jam për ty si Omeri! Për të të shërbyer ty, lidha në brez qemerin e durimit!

Lutja e suksesit nga Zoti që e jep suksesin; respektimi i etikës dhe edukatës në të gjitha gjendjet; dëmet shumë të mëdha të paturpësisë dhe mungesës së edukatës

Le t'i lutemi Zotit të na japë sukses! Por njeriu që s'di të sillet, mbetet pa mirësinë e Zotit!

Njeriu i paedukatë nuk i bën keq vetëm vetes. Ndoshta ia vë zjarrin gjithë botës!

Dhe zbriste sofra e Zotit nga qielli pa fjalë, pa kërkuar shpërblim për të!

Disa nga njerëzit e fisit të Musait pyetën me paturpësi: "Ku janë hudhrat, ku është supa me bishtaja?"

Pastaj sofra dhe buka e qiellit u ndërprenë; njerëzve iu desh të mbjellin, të prashisin, të korrin me drapër!

Pastaj, pasi ndërhyri Isai, Zoti dërgoi të mira me të shtruara buke, me tepsi dhe tabaka.

Prapë të paturpshmit, duke e lënë edukatën, e rrëmbyen vjedhurazi shtesën e ushqimit.

Isai iu lut atyre: Mos rrëmbeni se kjo është e vazhdueshme, nuk ndërpritet.

Dhe u tha: "Të pandehësh për keq dhe të tregohesh i pangopur ndaj të Zotit të kësaj sofre, është mohim, është faj i rëndë ndaj tij!"

Dhe ajo derë mëshire dhe bujarie iu mbyll syve atyre lipsarëve të paparë për shkak të ambicjes së tyre!

Po të mos jepet zeqat, retë e shiut nuk vijnë; nga kurvëria përhapet gjithandej murtaja!

Vuajtjet dhe mundimet i vijnë njeriut nga pafrikësia dhe paturpësia!

Kush tregohet i pamatur në rrugën e mikut, s'është burrë, është pirat!

Nga edukata, ky qiell është mbushur me dritë, nga edukata, engjëjt janë bërë të pafajshëm e të pastër.

Zënia e diellit vjen për shkak të paturpësisë. Edhe Azraeli, për shkak të paturpësisë është përzënë nga porta!

Padishahu takohet me të urtin, veliun, që iu tregua në ëndërr

Hapi krahët, e përqafoi, e mori në zemër si të ish vetë dashuria, e futi në shpirt!

Dhe nisi t'ia puthte dorën dhe ballin, dhe nisi ta pyeste se ku rrinte e nga ç'udhë kishte ardhur.

Pyet e pyet, e tërhoqi gjer në kryet e vendit të odës dhe i tha: "Më në fund, me durim, gjeta një thesar!"

O përgjigje e çdo pyetjeje, e bashkimit! Për shkak tënd, vështirësia kapërcehet pa thashetheme, pa folur!

Në zemrën tonë, ti je përkthyesi i tyre; ti je ai që e zë prej dore këdo që të jetë zhytur në baltë!

O i zgjedhur, o ti që ke fituar kënaqësinë e Zotit dhe je i kënaqur prej Tij, mirë se vjen!

Po u zhduke ti, vjen e keqja, hapësira ngushtohet!

Ti je i madhi i fisit! Kush nuk të do ty, kush nuk të kërkon ty, është zhvlerësuar. Dhe po s'hoqi dorë prej kësaj, ...

Pasi u pyetën e u përshëndoshën, e zuri njeriun prej dore dhe e çoi në dhomat e grave.

Padishahu e çon të urtin që ta vizitojë të sëmurën.

Padishahu ia tregoi të sëmurën dhe sëmundjen e saj, pastaj e çoi pranë saj.

I urti ia pa fytyrën, ia mati pulsin dhe ia kontrolloi urinën. Pastaj dëgjoi shenjat dhe shkaqet e sëmundjes.

Dhe tha: "Mjekimet e ndryshme të mjekëve të tjerë nuk e kanë përmirësuar, por e kanë shkatërruar më keq!

Ata nuk kuptojnë nga bota e brendshme e njeriut. Nga verbëria, të gjithë e kanë mendjen jashtë."

I urti i pa sëmundjen, e fshehta iu zbulua. Por e mbajti të fshehtë, nuk ia tha padishahut.

Sëmundjen s'e kishte te tëmthi apo te mëlçia. Aroma e drurit del jashtë me tymin!

Nga rënkimi, e pa se ajo ishte e sëmurë zemre. Trupin e kishte të shëndoshë, po zemra i vuante.

Dashuria dallohet nga rënkimi i zemrës; asnjë sëmundje s'është si sëmundja e zemrës!

Sëmundja e njeriut të dashuruar ndryshon nga të gjitha sëmundjet e tjera. Dashuria është astrolabi i të fshehtave të Zotit.

Le të jetë e tillë apo e atillë dashuria, më në fund, në atë anë na çon ne.

Çfarëdo që të them për ta treguar apo për ta shpjeguar dashurinë, kurse para dashurisë së vërtetë, mbetem i turpëruar.

Shpjegimi i gjuhës është mjaft sqarues, por dashuria që s'thuhet dot me fjalë, është më e qartë!

Sepse kalemi s'lodhet së shkruari, ai atë punë ka; por, kur vjen puna te dashuria, kriset, thyhet, s'shkruan dot.

Në shpjegimin e dashurisë, mendja u shtri si gomari i rënë në baltë. Dashurinë, prapë dashuria e shpjegoi!

Provë për ekzistencën e diellit është vetë dielli. Po t'u desh provë ty, mos i largo sytë nga dielli!

Ç'është e vërteta, edhe hija jep një shenjë për ekzistencën e diellit, por dielli i vërtetë çdo çast dhuron dritë jete!

Hija të sjell ty gjumë si përralla e natës, por kur lind dielli, hëna çahet (drita s'i shihet)!

Fundja, në botë s'ka gjë që t'i shembëllejë diellit. Por prapë, dielli i zemrës s'përëndon kurrë!

Vërtet, jashtë, dielli është një i vetëm, por është e mundur të përshkruhet i ngjashmi i tij.

Por dielli në eter është i tillë që s'mund t'i gjendet shembulli as në mendje, as jashtë.

E ku ka në imagjinatë një vend që ta nxërë atë, që të mundet të imagjinohet!

Me të ardhur fjalë për Shemseddinin, dielli i qiellit të shtresës së katërt e hoqi kryet mënjanë, u fsheh.

Dhe kur u përmend emri i tij, u bë e domosdoshme të tregojmë një simbol nga mirësitë e tij.

Këtë çast, shpirti po më tërheq për rrobe. Ka marrë erë nga këmisha e Jusufit!

Për hir të kuvendit që vazhdon prej vitesh, trego përsëri nga ato përjetime të bukura!

Që toka e qielli të qeshin, të gëzojnë. Që mendja, shpirti dhe syri të kridhen në gëzim e hare mbi njëqind gradë!

Mos më fut tani në mundim, se unë tani nuk jam në boshllëk. Mendja më ndaloi, jam i paaftë ta mësoj atë!

Çdo fjalë e thënë nga personi mendjekthjelltë, s'ka bukuri, sado që të mundohet, sado bukur të flasë!

E ç'mund të them unë për cilësinë e atij të dashuri kur asnjë damar, bile, s'e kam të kthjelltë!

Kaloje, tani, shpjegimin e kësaj ndarjeje, e këtij gjaku zemre, lëre për një kohë tjetër më vonë!

(Shpirti) tha: "Ushqemë mua se jam i uritur dhe nxito se koha është një shpatë e mprehtë!"

O udhëtar i përbashkët, o shok! Sufiu është i biri i kohës. Të thuash nesër, nuk është nga rregullat e rrugës!"

Apo mos ti nuk je nga sufitë? Nga veresia vjen varfëria!

Unë i thashë: "Eshtë më mirë të kalosh duke i mbajtur fshehur të fshehtat e të dashurit. Ti tani vëru veshin rrëfimeve dhe prej tyre mëso!

Eshtë më e pëlqyeshme që të fshehtat e dashnorëve të thuhen me fjalë për të tjerët (anasjelltas)."

Ai më tha: "Thuaje hapur se fenë është më mirë ta përmendësh hapur se mbyllur!

Ngrije perden dhe fol hapur se unë nuk bie me bukuroshen i veshur me këmishë!"

I thashë: "Po qe se ajo zhvishet lakuriq, as ti mbetesh, as prehri yt, as mesi yt!

Kërko, por sipas mundësisë; fija e barit ku ka fuqi ta tërheqë malin?

Edhe sikur pakëz fare të afrohet ky diell që ndriçon botën, çdo gjë digjet, përvëlohet e mbaron!

Mos e trazo intrigën, zënien dhe gjakderdhjen; mos trego tepër nga Shemsi Tebrizi për këtë!

Kjo s'ka fund! Prandaj ti fillo nga rrëfimi dhe përpiqu ta plotësosh!"

I urti i kërkon padishahut ta lërë vetëm për vetëm me të sëmurën për t'ia kuptuar sëmundjen.

I urti tha: "O padishah zbraze shtëpinë dhe të afërmit i largo!

Askush të mos vërë veshin nga qoshet e nga baxhat që unë të mund ta pyes këtë skllave të gjorë për disa gjëra!"

Oda u zbraz dhe brenda s'mbeti askush veç të urtit dhe të sëmurës.

Me një gjuhë të ëmbël, urtë e butë, i tha: "Kush është atdheu yt? Sepse ilaçi i popullsisë së çdo vendi është i ndryshëm.

Kush janë të afërmit e tu në atë vend? Me kë ke afërsi? Me kë ke lidhje?"

Me dorën në pulsin e vajzës, e pyeti një e për një për të gjitha ç'kishte hequr.

Kur njeriut i ngulet gjemb në këmbë, e vë këmbën mbi gjunjë,

Pastaj, me majë të gjilpërës, e kërkon gjembin dhe, po s'e gjeti, i njom vendin me buzë.

Po qe se qenka kaq e vështirë për ta gjetur gjembin e ngulur në këmbë, ç'bëhet me atë të ngulur në zemër? Thuaje ti!

Po qe se çdo njeri i trashë do të mund ta dallonte gjembin e zemrës, vuajtjet dhe mjerimet a do ta kapnin dot çdo njeri?

Dikush i vë gomarit ferra nën bisht dhe gomari që s'di si hiqen ferrat, hedh shkelma!

Dhe sa më shumë që të përpiqet e hidhet përpjetë, ferrat i ngulen më keq! Për t'i nxjerrë ato duhet njeri i mençur!

Por gomari vazhdon të hedhë shkelma për t'i hequr ferrat dhe plagos edhe fytyrën!

Kurse i urti që nxirrte gjemba, ishte mjeshtër. E vizitonte skllaven duke e prekur me dorë në të gjithë trupin.

Ndërkaq, i kërkonte t'i rrëfente për miqtë e saj. Dhe skllavja nisi t'i fliste hapur.

Ajo ia rrëfeu të gjitha të fshehtat: ku kishte qëndruar, kush kishin qenë të zotërit e saj, qyteti dhe vendet përreth qytetit.

I urti ia vinte veshin rrëfimit të vajzës, ia ndiqte me kujdes pulsin dhe të rrahurat e pulsit.

Ai e dinte se për kë të rrihte pulsi më fort, ai ishte njeriu më i dashur i zemrës dhe atë ia kërkonte zemra!

Ajo ia numëroi me radhë miqtë në atdhe. Pastaj përmendi një vend tjetër.

I urti e pyeti se nga ç'vend kishte dalë për herë të parë.

Vajza i përmendi shkarazi emrin e një vendi. Dhe as ngjyra e fytyrës, as pulsi nuk i ndryshuan.

Ajo ia numëroi një për një vendet ku kishte qenë dhe personat me të cilët ishte takuar, bukën me kripë që kishte ngrënë.

Qytet për qytet dhe shtëpi për shtëpi foli, por as pulsi iu shtua, as fytyra iu zverdh.

Gjersa i urti ia përmendi ëmbël Samarkandin, pulsi i rrahu rregullisht.

Por kur u përmend Samarkandi, pulsi i hodhi shpejt, fytyra iu skuq e pastaj iu zverdh. Sepse aty ishte ndarë nga një argjendar.

Pasi ia nxori të sëmurës këtë sekret dhe e kuptoi se cili ishte shkaku i sëmundjes dhe vuajtjes së saj, i urti i tha:

"Në ç'mëhallë banon ai?" Vajza iu përgjigj: "Në krye të urës, në mëhallën Gatfer!"

I urti i tha: "E kuptova menjëherë sëmundjen tënde dhe do të të tregoj të fshehtat e mjekimit të saj.

Gëzohu, mos u druaj dhe të jesh e sigurt se ç'u bën shiu barërave, edhe unë atë do të të bëj ty!

Unë po e heq vuajtjen tënde, ti mos vuaj; unë jam më i dhembshur për ty se njëqind baballarë!

Por kurrsesi mos i thuaj gjë padishahut! Sado që të të pyesë, prapë mbaje fshehtë!

Po të të mbeten të fshehtat fshehur në zemër, qëllimit do t'ia arrish shpejt!"

Pejgamberi ka thënë: "Kush e fsheh të fshehtën, ia arrin qëllimit shpejt!"

Pasi fara të fshihet në tokë dhe të mbetet ashtu, pas saj vjen blerimi i bahçes!

Po të mos qenë ari dhe argjendi të fshehtë, si do të bëheshin metale të çmuar? Si do të bëheshin ar dhe argjend?

Mirësitë dhe premtimet e mjekut të urtë ia hoqën frikën të sëmurës.

Premtimet e vërteta zemra i pranon, kurse premtimet që s'vijnë nga zemra, e fusin njeriun në vuajtje!

Premtimet e njerëzve bujarë janë thesare që rrjedhin, thesare që u duken vlerat. Kurse premtimet e njerëzve zemërngushtë janë vuajtje zemre!

I urti e kupton sëmundjen e skllaves dhe ia paraqet padishahut.

Pastaj mjeku i urtë u ngrit dhe shkoi te padishahu dhe e njoftoi pak për këtë çështje.

Dhe i tha: "Zgjidhja është kjo: për ta shëruar, duhet sjellë ai njeri këtu!

Thirre argjendarin nga ai qytet i largët duke e gënjyer me ar dhe rroba të çmuara!"

Padishahu e dëgjoi me vëmendje fjalën e të urtit dhe ia pranoi këshillën me gjithë zemër!

Dhe dërgoi në ato anë si përfaqësues një njeri të drejtë e të aftë për atë detyrë!

Padishahu dërgon në Samarkand njerëz të ngarkuar me detyrë për t'ia sjellë argjendarin.

Dy njerëz shkuan në Samarkand si lajmëtarë të lumtur të padishahut për argjendarin.

Dhe i thanë: "O mjeshtër i madh, o njeri që ke arritur përkryerjen në mjeshtërinë tënde!

Lavdërimet për ty janë përhapur qyteteve, prandaj padishahu të zgjodhi kryeargjendar.

Tani për tani merri këto rroba të bukura, këtë ar e argjend, se pastaj ke për t'u bërë ndihmës dhe njeri i afërt i padishahut!"

Argjendari e ndjeu veten krenar kur pa aq shumë mall, aq shumë para, dhe u largua nga qyteti, nga fëmijët dhe familja.

Dhe u nis për rrugë i gëzuar. Ai s'e dinte se padishahu e kishte dënuar me vdekje.

Hipi në kalin arab që e nisi me gëzim për ta dhënë gjakun për rrobat e bukura që kishte veshur!

O ti që nisesh për udhëtim qindra herë me pëlqim dhe shkon drejt ngjarjes së keqe me këmbët e tua!

Në përfytyrimin tënd ka pasuri, nder dhe madhështi, po Azraeli të thotë: Po, po, ke për t'ia arritur qëllimit.

Kur arriti argjendari i shkretë, mjeku i urtë e nxori para padishahut.

Për ta djegur në krye të qiririt të bukurisë, e shtyu te padishahu me dhurata dhe nderime!

Padishahu e nderoi shumë dhe ia dorëzoi thesarin e floririt.

Pastaj mjeku i urtë tha: "O mbret i madh, atë skllaven e shkretë jepja këtij tregtari

Që nga takimi me të të përmirësohet, që uji i takimit t'ia shuajë zjarrin!"

Dhe padishahu ia dhuroi argjendarit atë fytyrëhënë dhe i bashkoi ata dy njerëz të dashuruar.

Gjer më gjashtë muaj u kënaqën me njëri-tjetrin dhe, kështu, edhe vajza u përmirësua krejtësisht.

Pastaj i urti i bëri argjendarit një sherbet, argjendari e piu dhe nisi të tretej mu në sy të vajzës.

Dhe, kur, për shkak të sëmundjes, argjendarit s'i mbeti më bukuri, zemra e vajzës u çlirua nga dashuria për të.

Kur argjendari u sëmur e u shëmtua dhe kur fytyra iu zverdhua, edhe zemra e vajzës u ftoh prej tij dalngadalë.

Ja, kështu, dashuria për bukurinë e jashtme nuk është dashuri. Vjen një ditë që ajo merr fund.

Eh, sikur argjendari të ishte i shëmtuar që në krye e të mos i binte në kokë kjo e keqe!

Nga sytë e argjendarit rodhën lot të përgjakur, fytyra iu bë armike e zemrës!

Pendët i janë armik palloit. Sa mbretër ka që fuqia dhe madhështia u është bërë shkak për shkatërrim!

Argjendari tha: "Unë jam dreri që gjahtari ia derdh gjakun pse është dre!

Ah, unë jam dhelpra e shkretëtirës që, për t'ia marrë gëzofin, i ngrenë kurth, e kapin dhe ia presin kokën!

Ah, unë jam elefanti që e gjuajnë dhe e vrasin për t'ia marrë dhëmbin e fildishtë!

Por ai që më vret mua për një më të ulët se mua, që ma derdh gjakun, nuk e di se gjaku im nuk fle.

Sot e pësova unë, nesër e ka radhën ai! Si mund të shkojë humbur gjaku i një burri si unë?

Vërtet muri lëshon hije të gjatë (në mëngjes), por hija kthehet, pastaj, te ai që e ka krijuar!

Kjo botë është një mal, kurse bëmat'tona, zë. Jehona e zërave tanë në mal kthehet prapë tek ne."

Pasi tha këto fjalë, argjendari hyri në dhé. Kurse skllavja u çlirua nga dashuria dhe sëmundja dhe u bë krejt e pastër!

Sepse dashuria e vdekëtarëve nuk është e përhershme, sepse i vdekuri nuk kthehet prapë tek ne!

Dashuria e gjallë është te shpirti dhe syri. Çdo çast është më e freskët se gonxhja!

Zgjidhe dashurinë e Atij që është gjithmonë i gjallë dhe që të jep të pish nga vera që të jep jetë!

Zgjidhe dashurinë e Tij, se pejgamberët me dashurinë e Tij gjetën forcë e u bënë të aftë për punë të mëdha!

Mos thuaj se ne s'kemi leje për të dalë para atij padishahu. Për njerëzit bujarë, nuk ka punë të vështirë!

Helmimi i argjendarit u bë me urdhrin e Zotit dhe jo me dashjen e padishahut.

Vrasja e atij njeriu me dorën e mjekut të urtë nuk qe as për shpresë, as nga frika.

I urti nuk e vrau atë për t'ia bërë qejfin padishahut, pa ardhur urdhri dhe frymëzimi i Zotit.

Enigmën e therjes së atij djali nga Hizri populli i thjeshtë nuk e kupton dot.

Çfarëdo që të urdhërojë personi i cili meriton fjalën dhe përgjigjen e Zotit, është vetë drejtësia.

Personi që fal jetë e ka të lejuar edhe të marrë jetë. Ai është ndihmës, dora e tij është dora e Zotit.

Ashtu si Ismaili, vër kokën para tij. Jepe jetën me gëzim, duke qeshur, nën shpatën e tij!

Që siç mbetet i përjetshëm me Zotin shpirti i pastër i Ahmedit, edhe shpirti yt të mbetet përjetësisht i gëzuar dhe i qeshur!

Dashnorët e pijnë kupën e shpëtimit me duart e bukurosheve atë kohë kur do të vriten.

Padishahu nuk e derdhi atë gjak për epsh. Mos mendo keq! Lëre polemikën!

Ti fole keq për të duke thënë se bëri një punë të fëlliqur e të keqe. Pasi uji të kullohet, në të më s'mbetet llum e papastërti!

Këto thyerje të egos, këto vuajtje janë për ta nxjerrë argjendin nga minerali.

Prova e të mirës dhe e të keqes është për shkrirjen e arit dhe pastrimin e tij prej skorjes.

Po të mos ishte frymëzimi i Zotit, ai s'do të ishte padishah, por një qen i egër.

Por ai ishte i pastër edhe nga epshi, edhe nga ambicja, edhe nga dëshirat e vetvetes. Bëri një punë të mirë, por në dukje, të keqe.

Hizri e shpoi gjeminë në det, por në atë veprim të keq në dukje kishte njëqind të mira!

Bashkë me aq shumë bukuri dhe hijeshi, dëshira e Musait e la të turpëruar atë. Dhe ti, mos u nis të fluturosh pa krahë!

Ai është trëndafil i kuq, mos e quaj gjak. Ai është i dehur mendjeje, mos e quaj të marrë nga mendtë!

Po qe se qëllimi i tij do të ishte të derdhte gjak muslimani, mos qofsha musliman po t'ia zija emrin me gojë!

Arshi dridhet nga lavdërimi i njeriut të keq. Edhe njeriu që ruhet nga fajet dhe gjërat e dyshimta, po u lavdërua keq, mendon keq për lavdëruesin!

Ai ishte padishah dhe shumë i zgjuar! Ishte njeri i vërtetë, njeri i Zotit!

Njeriu i vrarë nga një padishah i tillë, është fatbardhë, lartësohet shpirtërisht!

Po qe se në vrasjen e tij nuk do të shihte dobi për të, ai njeri bujar si do ta dëshironte vrasjen e tij?

Fëmija dridhet nga thika e mjekut popullor, kurse nëna e tij që e mbron, gëzohet për vuajtjen e tij!

Merr gjysmë jetë dhe fal njëqind. Dhe të jep ty atë që s'të shkon ndërmend!

Ti po bën një krahasim sipas mendjes tënde, por kujdes se shumë larg po shkon!

Ngjarja e bakallit dhe papagallit, papagalli derdh vajin e trëndafilit në dyqan.

Ishte një bakall që kishte një papagall. Ishte një papagall jeshil, zëbukur dhe i gojës.

Bënte roje në dyqan, u thoshte fjalë të bukura të gjithë blerësve dhe bënte humor.

Kur u drejtohej njerëzve, fliste si njeri, por kishte aftësi të madhe edhe për të kënduar si papagall.

* Një ditë, bakalli kishte shkuar në shtëpi. Papagalli vëzhgonte me kujdes dyqanin.

* Papritmas, një mace hyri me vrik në dyqan për të zënë një mi. Papagalli u frikësua shumë.

Ai u hodh në skajin më të largët të dyqanit, derdhi edhe shishen me vaj trëndafili.

Pas pak erdhi dhe i zoti i dyqanit. Me zemër të kënaqur prej tregtari, u ul në vendin e tij.

Mirëpo pa se dyqani ishte bërë tërë vaj, ashtu dhe rrobat e tij. Atëherë i dha një të goditur kokës papagallit, të cilit iu zu goja dhe i ranë pendët.

U bënë disa ditë që papagalli e preu fjalën, kurse bakalli nisi të ofshante nga pendimi.

Bakalli fërkonte mjekrën dhe prapë ofshante duke thënë: Ah, sa keq, dielli i të mirave m'u zu nga retë!

Më mirë të më ishte thyer dora! Si u bë dhe i rashë në kokë këtij fjalëbukuri?

Bakalli nisi t'u jepte lëmoshë të varfërve me qëllim që papagalli të niste të fliste përsëri.

Tri ditë e tri net më pas, kur po rrinte në dyqan i hutuar e i pashpresë,

Dhe, i dëshpëruar e i vuajtur duke menduar se kur do të niste të fliste prapë ai zog,

Para dyqanit kaloi një dervish me kokën pa qime si fund legeni!

Aty për aty, papagallit i erdhi goja dhe, si njeri fort i mençur, i foli qerosit:

"O qeros, pse u bëre edhe ti qeros, apo mos edhe ti derdhe shishen me vaj trëndafili?"

Njerëzit që ndodheshin aty, nisën të qeshnin nga ky krahasim. Papagalli e kishte pandehur dervishin si veten!

Kur njeriu i mirë e pandeh gjithë botën të mirë, është si t'i thuash shapit sheqer!

Kështu, të gjithë botën e tërbuan! Pak vetë nga Abdallët u bënë dervishë të vërtetë!

Thanë se kishin ndenjur bashkë me pejgamberë dhe të urtët i pandehën si veten!

Dhe thanë: "Edhe ne jemi njerëz, edhe ata! Edhe ne s'bëjmë dot pa ngrënë e pa fjetur, edhe ata!"

Nga verbëria, nuk e kuptuan se mes tyre kishte ndryshim pa anë e pa fund!

Edhe bleta, edhe grerëza hanë në një vend, por bleta jep mjaltë, kurse grenza jep helm!

Dy lloje drerësh kullotën bar; nga njëri shpërtheu shurrë, nga tjetri, misk i vërtetë!

Dy lloje kallamash thithin ujë nga një pellg. Njëri është krejt bosh, tjetri plot sheqer!

Qindramijëra gjëra të tilla si këto të ngjashme ka, por ec e shih se mes tyre ka me mijëra vite rrugë largësi!

Kjo është tokë dhe nga kjo del pisllëk; edhe ajo është tokë, por prej saj del bukuri perëndie!

Kjo është tokë dhe nga kjo del smirë dhe zili; edhe ajo është tokë, por prej saj del mirësi perëndie!

Ky është vend i pastër, ai është vend shterp dhe i fëlliqur! Ky është engjëll i pastër, ai është djall dhe lugat!

Dy pamje mund t'i ngjajnë njëra-tjetrës: dy ujëra të kthjellta, njëra e ëmbël, tjetra e kripur!

Po kush mund t'i dallojë veç atij që ua di shijen? Atë gjeje! Ai e kupton dallimin mes ujit të ëmbël dhe ujit të kripur!

I padituri, duke e krahasuar magjinë me mrekullinë, pandeh se ato janë njëlloj.

Magjistarët që u matën me Musain, nga inati, morën në duar nga një shkop si shkopi i Musait!

Por mes atyre shkopinjve kishte ndryshim të madh, mes kësaj dhe asaj pune ka male!

Pas kësaj pune është mallkimi i Zotit, kurse pas asaj pune është mëshira e Tij!

Në inat, mohuesit, qafirët, kanë natyrë majmuni. Natyra është fatkeqësi brenda njeriut!

Ç'bën njeriu, bën edhe majmuni! Majmuni bën gjithmonë atë që sheh tek njeriu!

Dhe thotë: "Edhe unë bëra si ai!" Ajo qenie inatçore ku ta dijë ndryshimin mes qenieve?

Njëri bën se e urdhërojnë, kurse tjetri, për inat e për luftë! Hidhu dhé mbi krye njerëzve inatçinj!

Ai është hipokrit; qëndron në namaz për imitim dhe inat, jo për t'u lutur e falur!

Në namaz, agjërim, haxh dhe zeqat, besimtarët me hipokritët fitojnë e humbin.

Për besimtarët ka fitim përfundimtar, edhe për hipokritët, humbje në jetën tjetër!

Ndërsa janë secili në krye të një loje, mes tyre ka ndryshim të madh: njëri, këtu; tjetri, atje!

Secili shkon në vend të vet, secili ecën në përputhje me emrin e vet!

Atë e thërrasin besimtar dhe shpirti i kënaqet! Po t'i thonë hipokrit, ashpërsohet, ndizet, bëhet zjarr!

Emri i besimtarit është i dashur për shkak të bartësit. Emri i tjetrit është i padashur për shkak të bartësit të cilësuar si hipokrit!

Në tingujt e emrit të besimtarit nuk ka gjë të lartë. Kjo fjalë është vetëm për ta përshkruar atë.

Tjetrit i thërret hipokrit! Ai emër i poshtër ia copëton shpirtin si akrep!

Po qe se ky emër s'është shkëputur nga xhehennemi, pse të ketë shije xhehennemi?

Shëmtia e atij emri të keq nuk është nga shkronjat. Kripësia e ujit të detit nuk është nga "ena"!

Shkronja është enë, kuptimi te ajo është si uji. Kuptimi është personi që mban pranë Librit të Përgjithshëm edhe detin.

Në botë ka pranë e pranë detra të ëmbël e detra të kripur. Por mes tyre është një perde që nuk i lë të përzihen.

Por dije se të dy burojnë nga i njëjti burim. Lëri detrat dhe ec gjer te burimi!

Floriri kallp nga floriri i vërtetë dallohen nga karati. S'i dallon dot nga njëri-tjetri po s'ua mate karatin!

Vetëm ai, shpirtit të të cilit Zoti i jep karat, mund ta ndajë të vërtetën nga dyshimi!

Po qe se në gojë të një njeriu hyn një kashtë, ai qetësohet vetëm kur ta nxjerrë jashtë!

Po qe se njeriut të gjallë i hyn një copë e vogël kashte mes dhjetra kafshatave, ai e ndjen.

Ndjenja materiale është shkalla e kësaj bote, kurse ndjenja fetare është ndjenja e qiejve.

Shëndetin e kësaj ndjenje kërkojeni nga mjeku, shëndetin e asaj ndjenje, nga Profeti.

Shëndeti i kësaj ndjenje është nga shëndeti i trupit, shëndeti i asaj ndjenje arrihet me shkatërrimin e trupit.

Rruga e shpirtit patjetër e shkatërron trupin dhe, pasi ta shkatërrojë, e bën nga e para.

* Sa i lumtur e sa i bekuar është ai shpirt që, me dashurinë për kuptimin, e fal shtëpinë, mallin e pasurinë!

E ka shembur shtëpinë për ta nxjerrë thesarin e arit dhe, pasi e ka nxjerrë thesarin, e ka bërë shtëpinë më të bukur se më parë!

E pret ujin, e pastron rrugën nga kalon uji, pastaj ka lëshuar ujë të pijshëm.

E ka çarë lëkurën, e ka pastruar, pastaj prej saj ka bërë një lëkurë krejt të re!

E ka shembur kalanë, ia ka marrë qafirit, pastaj e ka rindërtuar me qindra bedena dhe e ka rrethuar me hendeqe!

Kush mund ta kuptojë punën e Zotit, urtësia e të cilit nuk pyetet? Kush arrin ta kuptojë urtësinë e punës së tij?

Herë e tregon kështu, herë të kundërtën. Feja nuk kuptohet, ajo vetëm admirohet!

Por admirues i vërtetë nuk është ai që ia kthen shpinën fesë, por ai që zhytet në të me dashuri, ai që dehet pas saj!

Fytyra e njërit drejtohet nga i dashuri, kurse e tjetrit, nga vetja e vet!

Shihua fytyrën të dyve dhe mbaji mend se nuk mund t'i njohësh nga shërbimi që bëjnë!

Sepse ka shumë shejtanë me fytyrë njeriu. Prandaj nuk është e drejtë t'i japësh dorë çdo dore!

Për të gjuajtur zogj, gjuetari i zogjve fishkëllen si zog, imiton zogjtë.

Dhe zogu, kur dëgjon zërin e vet, zbret poshtë e bie në lak.

Njeriu i poshtër i përsërit fjalët e dervishit për ta magjepsur njeriun me zemër të kulluar.

Shprehia e burrave është sinqeriteti dhe ngrohtësia, kurse e të poshtërve, dredhia dhe paturpësia!

Për t'ua marrë mendtë njerëzve, bëjnë luanë prej leshi, Ebu Musejlimit i japin llagapin Ahmed.

Por Ebu Musejlimit i mbeti llakapi gënjeshtar, kurse Muhammedit i thanë i zoti i të mençurve!

Ai është vula e verës së të Vërtetës, kapaku i shishes; është misk i vërtetë! Kurse vula e verës së keqe dhe kapaku i shishes së saj është era e keqe dhe ndëshkimi!

Historia e mbretit çifut.

Mes çifutëve ishte një mbret armik i Isait dhe që i kishte djegur dhe përvëluar krishterët!

Sundonte në kohën e Isait. Ai ishte shpirti i Musait dhe shpirti i Musait ishte ai!

Mbreti syvëngër i ndau nga njëri-tjetri ata dy shokë të rrugës së Zotit.

Ustai i tha çirakut syvëngër t'ia sillte shishen nga shtëpia.

Çiraku syvëngër i tha se ishin dy shishe, prandaj t'ia sqaronte mirë se kë të sillte.

Ustai i tha: "Nuk janë dy shishe, po mos e zgjat. Lëre mënjanë vëngërinë dhe mbathja për në shtëpi!"

Çiraku syvëngër i tha: "Usta, mos më shaj! Janë dy shishe!" Prandaj dhe ustai i tha: "Mirë, pra, njërën thyeje, kurse tjetrën sille!"

Kur çiraku e theu njërën shishe, i humbi nga sytë edhe tjetra! Anësia, zemërimi dhe epshi e bëjnë njeriun vëngër!

Shishja ishte një, por atij i dukej dy. Dhe, kur e theu, as njëra mbeti, as tjetra!

Zemërimi dhe epshi ia turbullojnë njeriut sytë, e largojnë shpirtin nga e drejta!

Kur vjen zemërimi, aftësia mbulohet. Nga zemra bien mbi sy qindra perde!

Pasi të vendosë me zemër për të marrë rushfet, kadiu si mund ta ndajë mizorin nga viktima që qan e rënkon?

Nga urrejtja e tij prej çifuti, mbreti u vëngërrua aq shumë, sa aman, o Zot, aman!

Duke thënë se ishte mbrojtës i fesë së Musait, vazhdues i tij, vrau qindramijëra besimtarë të pafajshëm!

Veziri i mëson mbretit hile.

Mbreti kishte një vezir aq pirat, aq dredharak, sa edhe ujit i bënte magji!

Veziri i tha mbretit: "Krishterët e mbrojnë jetën e vet dhe e fshehin fenë e tyre nga mbreti.

Por ti mos vrit shumë prej tyre sepse nga vrasja nuk ke dobi. Me vrasje nuk i del aroma fesë se nuk është gjë aromatike!

Është një e fshehtë e fshehur brenda njëqind këllëfësh. Nga jashtë e njeh, por nga brenda, jo!"

Mbreti i tha: "Mirë, na thuaj, ç'të bëjmë? Ç'dredhi të përdorim në këtë punë?

Ç'të bëjmë që në botë të mos mbetet as fetar i hapur, as krishter që e ndjek fenë fshehtazi?"

Veziri i tha: "Urdhëro të m'i presin veshët e duart, të m'i çajnë hundë e buzë!

Dhe pastaj më ço në trekëmbësh. Aty të ndërhyjë dikush pranë teje e të të kërkojë të ma falësh fajin!

Dhe bëje këtë punë ku të kryqëzohen katër rrugë, bëje në pazarin e tellallit

Dhe pastaj më syrgjynos në një qytet larg teje që të mos më njohin, kurse unë të lëshoj mes njerëzve njëqind lloje nënvleftësimi të fesë."

Veziri u bën hile krishterëve.

Atëherë, le të themi se unë jam krishter i fshehtë. O Zot që e di të fshehtën, ti ma di zemrën time!

Mbreti ma kuptoi besimin dhe për shkak të fanatizmit, më vrau!

Desha ta fsheh fenë nga mbreti, të dukesha si i fesë së tij!

Mbreti ma ndjeu të fshehtën, fjalët e mia para tij u dukën të meta.

Më tha: "Fjalët e tua janë si buka që ka brenda një gjilpërë. Në zemrën time është një dritare që sheh në zemrën tënde.

Unë ta pashë gjendjen nga ajo dritare, prandaj nuk mund të ta dëgjoj më fjalën!"

Po të mos më kishte ardhur në ndihmë shpirti i Isait, ai do të më kishte bërë copa-copa çifutërisht!

Për Isain luaj me kokën, e jap shpirtin dhe duke ndjerë qindramijëra herë mirënjohje për këtë!

Nuk e kursej jetën për Isain, por i njoh mirë njohuritë mbi fenë e tij!

Mua më prek shumë që ajo fe e pastër u shkatërrua mes injorantëve!

Lëvduar qoftë Zoti, falenderuar qoftë Isai që ne u bëmë udhërrëfyes të kësaj feje të vërtetë!

Qysh kur lidhëm mesit brez, shpëtuam nga çifutët dhe çifutëria!

O njerëz, kjo kohë është koha e Isait. Dëgjojini me shpirt të fshehtat e fesë së tij!

* Me t'ia derdhur mbretit këtë hile, e hoqi krejtësisht dyshimin nga zemra e tij.

Dhe mbreti i bëri vezirit çdo gjë që i tha ai! Populli mbeti i habitur nga kjo hile e fshehtë.

Dhe e dërgoi atë nga ato anë ku rronin krishterët. Atje veziri nisi ta ftonte popullin.

Krishterët i besojnë hiles së vezirit.

Qindramijëra krishterë u mblodhën pak nga pak rreth tij.

Ai u tregonte atyre fshehurazi të fshehtat e ungjillit, brezit kishëtar dhe faljes.

Në dukje, ai u tregonte urdhrat e fesë, por, në të vërtetë, kjo ishte kurth për t'i shtënë ata në dorë.

Prandaj, pse është e vështirë për ta kuptuar hilen e fshehtë, disa sahabe e pyesnin Pejgamberin për hilen e nefsit azgan dhe hileqar.

Dhe i thoshin: "Ç'u përzjen nefsi nga zemërimet e fshehta adhurimeve dhe sinqeritetit që vjen nga zemra?"

Nuk e pyesnin Pejgamberin për virtytin dhe mirësitë e adhurimit, por veset e këqija: "Cili është turpi i hapur?"

I njihnin hilet e nefsit fije për fije, kokërr për kokërr, siç dallonin trëndafilin nga selinoja!

Sahabet gjithmonë mbeteshin të mahnitur nga ai predikues dhe fjalët e tij!

Krishterët bëjnë siç u thotë veziri.

Krishterët ia dhanë plotësisht zemrën vezirit. Fundja sa mund të jetë fuqia e imitimit të popullit të thjeshtë?

Dashurinë për të e mbollën në zemra, e pandehën atë si zëvendës të Isait.

Kurse në të vërtetë ai ishte Dexhali i mallkuar me një sy! O Zot, vrapo në ndihmë të thirrjeve tona, ç'ndihmës i mirë je ti!

O Zot, qindramijëra kurthe me ushqim ka, kurse ne jemi si zogj të uritur të mbetur pa ushqim!

Çdo çast kapemi në një kurth të ri, kurse ne, po të duam, mund të bëhemi skifterë, feniksë!

Ti na shpëton çdo herë ne nga kurthi. O Zoti ynë i pasur që s'ke nevojë për asgjë! Ne përsëri jemi duke shkuar drejt një kurthi të ri!

Ne po mbledhim grurë në këtë hambar, por grurin e mbledhur jemi duke e humbur prapë!

Dhe ne, shoqëri prej njerëzish primitivë, nuk e kuptojmë se pakësimi i grurit vjen nga hileja e minjve!

Minjtë kanë hapur vrima dhe na e kanë prishur hambarin.

O shpirt, më parë largoje të keqen e minjve, pastaj përpiqu të mbledhësh grurë!

Dhe dëgjoje një fjalë nga fjalët e atij lajmëtarit të lajmëtarëve: "Pa zemër të qetë, namazi nuk bëhet i plotë!"

Po qe se në hambarin tonë të adhurimeve nuk ka minj, ku është gruri i adhurimeve dyzetvjeçare?

Pse nuk na mblidhen pak nga pak në hambar kokrrat e adhurimeve tona të drejta?

Nga guri i çakmakut shpërthyen shumë yje zjarri dhe zemra e djegur i pranoi dhe i tërhoqi.

Por në errësirë një hajdut u vë gisht fshehurazi shkëndijave.

Dhe i shuan një nga një ata që në qiell të mos shkëlqejë një pishtar!

* Kur mund të na frikësojë ai hajdut me të mirat e tua?

Edhe sikur të ketë mijëra kurthe në një hap, ne s'na gjen gjë sa të jesh ti me ne!

Çdo natë je duke i shpëtuar shpirtrat nga kurthi i trupit, je duke i shkulur dërrasat.

Çdo natë shpirtrat shpëtojnë nga ky kafaz dhe arrijnë flijimin pa qenë as sunduesi, as i burgosuri i dikujt!

Natën, ata që ndodhen në errësirë, nuk dinë gjë për errësirën; të ftuarit e mbretit nuk dinë gjë për shtetin!

As ankth, as mendim fitimi apo humbjeje. As përfytyrimi i kësaj gruaje, as iluzioni i atij burri!

Gjendja e arifit është po kjo edhe zgjuar: Zoti tha se "ata janë në gjumë", këtë mos e moho!

Ditë e natë ata janë në gjumë për hallet e kësaj bote; janë si kalem në dorë të Zotit të tyre që i kthen nga të dojë!

Personi, dora e të cilit gjatë shkrimit nuk sheh, lëvizjen e kalemit e pandeh se është nga vetë kalemi!

Zoti i tregoi popullit shumë pak nga gjendja e arifit, kurse popullin e kapi gjumi i ndjenjave dhe nuk e kuptoi arifin.

Shpirti i tyre shkoi në shkretëtirë, të fshehtën e të cilës mendja s'e rrok dot. Edhe shpirtrat në pushim, edhe trupat, po!

Pastaj, me një fërshëllimë, i tërheq ata në kurth dhe që të gjithë i tërheq pas propozimit tënd!

* Kur drita e mëngjesit të ngrejë krye dhe ngjyra e kuqërremtë e qiellit të përplasë krahët,

Ai që e bën mëngjesin, si Israfili, e sjell këdo nga ai vend në botën e figurës;

Shpirtrat e përhapur i bën trupa dhe çdo trup e lë sërish me barrë.

Kuajt e shpirtit i vë pa shalë dhe kjo është e fshehta "gjumi është vëllai i vdekjes".

Por për të ardhur prapë dita, i lidhin këmbët me një litar të gjatë

Gjersa ta tërheqin mbrapsht atë nga ai livadh dhe ta sjellin nga kullota me ngarkesë.

Eh, sikur ta ruante këtë frymë si shokët e shpellës ose varka e Noes

Dhe ky mendim, ky sy dhe ky vesh të shpëtonin nga kjo gjendje zgjimi dhe tufani të mendjes!

Në botë ka shumë shokë të shpellës që në këtë kohë ndodhen pranë teje ose para teje.

Edhe shpella, edhe miku këndojnë bashkë me të. Po ç'dobi? Sytë dhe veshët e tu janë të vulosur!

Kalifi e sheh Lejlanë.

Kalifi i tha Lejlasë: "A ti je ajo pas së cilës Mexhnuni e humbi veten dhe u shkatërrua?

Ti s'je më e bukur se të bukurat e tjera!" Lejlaja i tha: "Hesht, sepse ti nuk je Mexhnuni!"

I zgjuari është më i fjetur se ai në gjumë! Zgjimi i tij është më i keq se gjumi!

Po qe se shpirti ynë s'është i zgjuar me të Vërtetën, zgjimi për ne është si lugina e ngushtë mes dy maleve.

Po qe se shpirti yt nuk ha çdo ditë shkelmin e imagjinatës, nga frika e dëmit, dobisë dhe humbjes,

S'i mbetet as pastërtia, as tejdukshmëria, as fuqia, as rruga për t'u ngjitur në qiej!

Dhe atëherë i thonë shpirt i fjetur i cili mban shpresë te iluzionet, me ato bisedon,

Në gjumë, shejtanin e sheh si hyri, pastaj, nga epshi për shejtanin, bëhet për ujë.

Dhe me ta derdhur farën e brezit në djerrinë, vjen në vete, atëherë, edhe iluzioni ikën prej tij!

Nga ëndrra fitoi vetëm dhimbje koke, hutim dhe papastërti të trupit. Ah, ai iluzion i pavërtetë që na mashtron në dukje!

Zogu është në ajër, hija në tokë duket sikur fluturon si zog!

Kokëtrashi niset ta gjuajë hijen dhe vrapon pas saj gjersa ta lënë fuqitë!

Meqë hija është në drejtim e kundërta e zogut në ajër, ai s'e di se ku ndodhet zogu i vërtetë.

Dhe hedh një shigjetë drejt hijes, pastaj një tjetër. Kështu, shigjetorja i mbetet bosh!

Shigjetorja e jetës u boshatis, jeta shkoi, mbaroi. Ai mori fund nga vrapimi pas hijes!

Po qe se dadoja e dikujt është hija e Zotit, e shpëton atë nga iluzioni dhe hija.

Kush i bëhet rob Zotit, në të vërtetë është hija e Zotit. Ai ka vdekur në këtë botë dhe është ringjallur me Zotin.

Kapu pas Tij pa e humbur rastin dhe pa bërë dyshim, që të shpëtosh nga ngatërresat e fundit të kohës së mbrame!

E dinë të urtët (evlijatë) se si e zgjati Zoti hijen. Sepse i urti është drita e diellit të Zotit.

Mos ec në këtë rrugë pa këtë provë dhe, si Halili, thuaj: "Unë nuk i dua ata që perëndojnë!"

Ec dhe, nga hija, gjej një diell. Dhe kapu pas Shah Shemsi Tebrizit!

Po s'e dite dot rrugën për në vendin ku ndodhen kjo dasmë dhe nusja e saj, pyete Husameddinin që është drita e të Vërtetës!

Po qe se gjatë rrugës zilia të kap për fyti, dije se simboli i djallit është zilia!

Sepse për shkak të asaj zilie ai u veçua nga Ademi, luftoi kundër bekimit!

Nuk ka kalim më të vështirë në rrugë. Sa i lumtur është ai që nuk ka shok rruge zilinë!

Ky trup ka qenë qysh në fillim shtëpi e zilisë. Për shkak të zilisë, soji e farefisi bëhen si enë të palara!

Trupi është shtëpia e zilisë, por Zoti e ka pastruar atë, e ka bërë krejt të pastër!

Ajeti "pastromani shtëpinë" flet për pastrimin e trupit. Edhe pse talismani i trupit i takon tokës, në të vërtetë është thesar drite!

Nëse ti i bëhesh ziliqar atij që, në të vërtetë, nuk ka trup, zemra nxihet nga ajo zili.

Bëhu dhé nën këmbët e njerëzve të Zotit. Si ne, edhe ti hidhi dhé kokës zilisë!

Veziri bëhet ziliqar.

Ashtu ishte krijuar veziri i shkretë, të ishte ziliqar, prandaj fuste hundët dhe hapte veshët kudo!

Me atë shpresë që, me helmin që i rridhte nga maja e gjilpërës së zilisë, t'i helmonte të dëshpëruarit mu në shpirt!

Personi që i këputet hunda ngaqë e zgjat tepër nga zilia, mbetet pa hundë e pa veshë.

Hunda duhet për të nuhatur një aromë dhe për ta kthyer kokën në atë anë ku ndodhet fytyra që e lëshon atë aromë.

Kush nuk merr dot aromë, është pa hundë, kurse aromë është vetëm aroma e fesë!

Personi që nuhat një aromë të këndshme dhe nuk falenderon për të, kërkon mohimin dhe e prish hundën e vet!

Edhe falendero, edhe bëju rob atyre që falenderojnë dhe, duke vdekur në prani të tyre, fito jetë të përhershme!

Mos e vër pasurinë me piratëri si veziri, mos i pengo robtë e Zotit nga namazi!

Ai veziri qafir, duke e hequr veten si këshillues fetar, duke bërë hile, i kishte futur hallvës hudhra!

Krishterët e mençur e kuptojnë hilen e vezirit.

Ata që e dinin se ç'është shija e kënaqësia, në fjalën e tij ndjenë se ishte përzjerë një hidhësi.

Ai thoshte fjalë të bukura por me maraz, në sherbetin me lëng trëndafili derdhte helm.

Fytyra e jashtme e fjalës këshillonte syçeltësinë dhe shkathtësinë në rrugë, kurse shpirtit i thoshte që të ishte i shkujdesur!

Edhe pse e jashtmja e argjendit është e bardhë dhe e kulluar, duart dhe rrobat t'i nxin si katran!

Edhe nëse zjarri me shkëndijat duket fytyrë alle, shih se ç'nxirje lë pas djegies që bën!

Në pamje, vetëtima duket se përbëhet prej një drite të thjeshtë, por ta vjedh dritën e syve!

Fjalët e vezirit, për të tjerët veç atyre që ishin të zgjuar dhe e njihnin kënaqësinë, ishin qafore skllavërie!

Veziri qëndroi gjashtë muaj larg mbretit dhe, gjatë kësaj kohe, u bë mbështetje për ndjekësit e Isait.

Shumica e popullit ia la atij në dorë edhe zemrën, edhe fenë. Para mendimeve dhe urdhrave të tij, çdo njeri ishte gati ta flijonte veten!

Mbreti i dërgon vezirit lajm fshehurazi.

Mes tij dhe mbretit shkonin e vinin lajme. Mbreti e kërcënonte fshehurazi.

* Më në fund, me qëllim që krishterët ta linin tokën që ai t'ia arrinte qëllimit, i shkroi një letër vezirit, ku i thoshte:

"O veziri im i fuqishëm, erdhi koha, shpëtoma zemrën shpejt nga ankthi!*

Dhe veziri iu përgjigj: "Mbreti im, ja, tani po merrem me lëshimin e intrigave në fenë e Isait!"

Dymbëdhjetë pjesët e krishterëve.

Në atë vend, populli i Isait kishte dymbëdhjetë emirë ose prijësa që urdhëronin mbi ta.

Çdo pjesë varej nga një emir; nga pangopësia, ata i qenë bërë rob beut të tyre.

Fiset e dymbëdhjetë emirëve u lidhën pas atij veziri të keq.

Të gjithë i bindeshin fjalës së tij, të gjithë ishin vënë në rrugën e tij.

Sapo të thoshte ai "vdis", çdo emir vdiste në atë çast.

Veziri i ngatërron urdhrat e ungjillit.

Veziri përgatiti nga një rul në emër të çdo emiri. Shkrimi i çdo ruli ishte një ngjarje e veçantë.

Urdhri i secilit ishte i një lloji të veçantë. Kjo binte kryekëput në kundërshtim me rregullin.

Në njërin, rrugën e përkorësisë dhe urisë e kishte bërë shtyllë të pendesës, kusht të kthimit te Zoti.

Në një tjetër, shkruante se përkorësia është e kotë; në këtë rrugë nuk ka shpëtim tjetër veç bujarisë!

Në një tjetër kishte thënë: "Vetëmundimi yt me uri dhe dhënia e pasurisë janë herezi ndaj Zotit tënd!

Në kohë vuajtjeje apo rehatie, çdo gjë tjetër veç mbështetjes te Zoti dhe dorëzimit të plotë tek Ai, është hile dhe kurth!"

Në një tjetër kishte thënë: "I domosdoshëm është shërbimi, kurse mendimi i dorëzimit është faj!"

Në njërin kishte thënë: "Urdhrat dhe ndalimet e fesë nuk janë për t'i zbatuar, por për të na e treguar dobësinë tonë."

Gjersa ta shohim prej tyre se jemi të dobët dhe ta mësojmë e ta kuptojmë fuqinë e Zotit!

Në tjetrin kishte thënë: "Mos shih dobësinë tënde, zgjohu dhe eja në vete se shikimi i dobësisë është mohim i të mirës!

Fuqinë tënde shih, se kjo fuqi është prej Tij! Fuqinë tënde dije si mirësi të Tij, se kjo është fuqi!"

Në njërin kishte thënë: "Lëri edhe këto të dyja, ç'të të zërë shikimi, bëhet idhull!"

Në tjetrin: "Këtë qiri mos e shuaj se ky shikim është si qiriri në kuvend!

Po qe se kalon nga shikimi dhe përfytyrimi, e shuan qiririn e bashkimit në mes të natës!"

Në njërin kishte thënë: "Shuaje mos ki frikë hiç, se sheh qindramijëra shpërblime!

Sepse duke e shuar qiririn e shikimit, qiriri i shpirtit shtohet, gjen fuqi. Nga durimi yt, Lejlaja të bëhet Mexhnun!

Kush e braktis këtë botë për përkorësi, para tij bota shtohet, bëhet më e madhe!"

Në një tjetër: "Ç'të të ketë dhënë Zoti ty, duke e krijuar atë, e ka bërë të ëmbël për ty.

E ka bërë të lehtë. Merre mirë e bukur atë dhe mos e mundo veten!"

Në njërin kishte thënë: "Braktise atë që të përket ty, sepse ajo që e ka pranuar natyra jote, është e fëlliqur, e keqe.

Rrugët e kundërta janë të lehta për vetveten, një fe për çdo njeri është bërë jetë!

Po qe se lehtësimi i punëve të fesë nga Zoti do të ishte një rrugë e drejtë, çdo çifut dhe adhurues i zjarrit do ta dëgjonte e do ta kuptonte Zotin!"

Në tjetrin kishte thënë: "E lehtë është ajo që bëhet ushqimi i zemrës, jetës dhe shpirtit.

Çdo gjë që i pëlqen natyrës, pasi t'i kalojë koha, nuk jep më gjë siç nuk mbin fara e mbjellë në tokë të thatë e shterpë.

Prodhimi i saj s'bëhet gjë tjetër veç pendimit; fitimi i saj s'i sjell të zotit gjë tjetër veç humbjes.

Ajo kënaqësi, edhe në fund, ashtu si në krye, nuk duket e lehtë dhe e këndshme; në përfundim, emri i saj bëhet vështirësi, ajo bëhet një gjë e vështirë!

Ti ndaji nga njëra-tjetra të vështirën me të lehtën; edhe njërën shihe si ta ketë fundin, edhe tjetrën."

Kurse në një rokelë tjetër kishte thënë: "Kërko një mësues. Ndjeshmërinë për ta parë përfundimin nuk mund ta gjesh te prejardhja, te ai që krenohet me prejardhjen!

Ndjekësit e çdo lloj feje i kanë parë përfundimet e punëve pa kërkuar mësues, pa ndjekur pejgamberët, bënë arsyetime mbi përfundimet sipas mendjeve të veta, prandaj ranë në gabim dhe prapësi.

Fundi nuk është i thurur, i endur me dorë. Po të ishte kështu, si do të ndodhte ndarja në fe?"

Në njërin kishte thënë kështu: "Ti je edhe mjeshtër, sepse ti e njeh edhe mjeshtrin.

Bëhu burrë, jo maskara i burrave; dili për zot kokës tënde, mos u huto!"

Në një tjetër: "Të gjitha janë e njëjta gjë. Ai që sheh dy është i vëngër!"

Në një rokelë kishte thënë: "Si mund të bëhet qindi një? Kush mund ta mendojë këtë veçse në qoftë i marrë?

Secila gjë është e kundërta e tjetrës. Si mund të jenë e njëjta gjë helmi me sheqerin?

Pa hequr dorë edhe nga helmi, edhe nga sheqeri, si mund të nuhatësh aromë të këndshme nga lulishtja e njësisë së Zotit?"

Veziri armik i fesë së Isait shkroi, në këtë formë dymbëdhjetë letra me mesazhe të mbështjella rokelë dhe i dërgoi.

Mosmarrëveshja është në mënyrën e ecjes, jo në të vërtetën e rrugës.

Ai nuk kishte marrë dot aromë nga njëngjyrëshmëria e Isait. Ai nuk kishte kuptuar dot gjë nga ena e bojatisjes e Isait.

Rroba me njëqind ngjyra bëheshin, nga ena e thjeshtë e Isait, të holla e të lehta si era e mëngjesit, merrnin një ngjyrë.

Kjo njëngjyrshmëri në bashkim nuk është e tillë që t'i japë njeriut mërzitje e shqetësim. Ndoshta ajo ngjyrë e vetme është si deti: ata që kridhen në të, ashtu si dhe peshqit, e ndjejnë veten krejt gjallëri dhe hare.

Në tokë, ç'është e vërteta, ka mijëra ngjyra, mirëpo peshqit janë në armiqësi me thatësirën.

Po ç'është peshku dhe ç'është deti që po i marrim si shembuj, që mbreti i lartë të ketë përngjasim me ta?

Qindramijëra dete dhe peshq në botën e ekzistencës bien me ballin në tokë para Atij bujarit dhe mirëbërësit!

Sa shira mirësie ranë dhe deti u bë që të shpërndajë margaritarë!

Sa dritëra dielli bujarie shpërthyen që reja dhe deti ta mësonin ç'është bujaria!

Në tokë dhe në ujë ra drita e Tij dhe për atë shkak, faqja e tokës u bë që ta pranojë farën!

Toka është e sigurt dhe bestare: ç'të mbjellësh, do të korrësh!

Këtë siguri dhe besëtari, toka e ka gjetur nga siguria dhe besëtaria e Tij, sepse mbi të ka rënë dielli i drejtësisë!

Po s'e pruri pranvera fermanin e Zotit, si e nxjerr në shesh toka të fshehtën e saj?

Ai është aq bujar dhe dhurues, saqë këtë siguri dhe drejtësi ia ka dhënë tokës së thatë në një trup pa jetë!

Vlera dhe mirësia e Tij e bën tokën të informuar e të ditur; ashpërsia dhe persekutimi i Tij njerëzit e mençur i verbojnë!

Ai nuk ka fuqi të vrapojë në shpirt, në zemër, po kujt t'ia them? Në botë nuk ka një vesh të vetëm!

Ku pati një vesh, për shkak të tij u bë sy. Ku pati një gur, me favorin e tij, u blerua.

Ai është që e ka krijuar kiminë, kimia ç'mund të jetë? Eshtë mrekullidhuruese; po alkimia?

Kjo përkëdhelja ime është vetë braktisje e përkëdheljes, sepse kjo përkëdhelje është provë ekzistence, kurse ekzistenca është e metë!

Përballë ekzistencës së Tij duhet asgjësuar; ç'është ekzistenca para tij? Një gjë pa kuptim!

Po të mos ishte e verbër, ekzistenca do të shkrihej prej Tij, do ta njihte dhe kuptonte nxehtësinë e diellit!

Mosnjohja e faktit se ky trup i dukshëm ekziston me ekzistencën e Allahut, është provë e verbërisë!

Veziri pëson dëm nga hileja e tij.

Si mbreti, edhe veziri ishte injorant dhe i shkujdesur. Ai i dilte kundër Zotit të Amshuar, qenia e të cilit është e domosdoshme.

Ai i tregonte forcën një Zoti me fuqi të tillë që në një çast të vetëm krijon nga hiçi njëqind gjithësi si kjo.

Duke i dhënë syrit tënd aftësinë për ta parë veten, në shikimin e tij krijon qindra botë si kjo botë.

Dije se, siç është bota, në krahasim me ty, madhështore dhe e pafundme, para fuqisë së Tij s'është as sa një thërrime.

Fundja, kjo botë është burgu i shpirtrave tuaj, pra, zgjohuni dhe ikni në anën tjetër! Sepse ana tjetër është fusha ku ju jeni të lirë, është vendshëtitja juaj!

Kjo botë ka kufij, kurse ajo botë është në bazë e pakufi. Forma dhe trajta janë mbulesë për atë kuptim, janë pengesë.

Qindramijëra heshta të Faraonit i theu me një heshtë të vetme të një Musai të vetëm!

Qindramijëra Galenus kishin qindramijëra mjeshtëri mjekësore; pranë Isait dhe frymës së tij dolën gënjeshtra!

Ishin qindramijëra libra poezish; përballë Librit të Përgjithshëm mbetën kokulur e të turpëruar!

Personi që s'është i poshtër, pse të mos vdesë në prani të një Zoti të tillë ngadhnjyes?

Shumë zemra si male këputi. Zogun dredharak e lidhi me shkop nga të dyja këmbët.

Zoti s'arrihet me përsosmëri mendjeje dhe mençurie. Virtyti dhe mirësia e mbretit s'pranon tjetërkënd veç personit që njeh dobësinë e vet!

Hej, more, hej! Shumë gërrmues qoshesh e buxhakësh e mbushës thesaresh u poshtëruar prej atij personi që rrinte pa bërë gjë, prej atij bualli (veziri).

Kush është bualli që ti të bëhesh maskarai i tij? Ç'është dheu që ti të bëhesh bari i tij?

Pasi një gruaje iu zverdh fytyra nga puna e keqe që kishte bërë, pasi u turpërua, Zoti e goditi dhe e bëri yllin Venus.

Një grua u bëka Venus me të qëlluar; po kthimi i njeriut në baltë, a s'është goditje, o inatçi?

Ndërsa shpirti po të ngjiste në qiejt më të lartë, ti zbrite poshtë e më poshtë, drejt ujit dhe baltës!

Dhe një qenie të tillë që ia patën zilinë edhe mendjet, për shkak të kësaj balte e ndërrove!

Tani shih, kjo vetëgoditja jote si të duket? Pranë asaj goditjeje, kjo mjaft e ulët!

Kalin e përpjekjes e kalërove në drejtim të yjeve, u more me diturinë e yjeve, por nuk e njohe Ademin para të cilit kishin rënë në gjunjë!

O bir i pahajrit! Fundi i fundit, ti je biri i Ademit; gjer kur do ta quash poshtërimin, nder?

Gjer kur do të thuash se do ta pushtosh këtë botë dhe do ta mbushësh njerëzimin me qenien tënde?

Edhe sikur ta mbulojë dëbora botën krye e fund, nxehtësia e diellit e shkrin atë me ta parë!

Edhe fajin e atij veziri, si dhe fajin e qindramijërave si ai, Zoti e asgjëson me një shkëndijë të vetme!

Iluzionet e pabazë Ai i bën krejtësisht urtësi; Ai e kthen ujin e helmët në sherbet!

Fjalët që lindin pandehmë e dyshim, Ai i kthen në vërtetësi dhe fakt. Nga shkaqet e urrejtjes dhe armiqësisë shfaq miqësi e dashuri!

Ibrahimin e ushqen mes zjarrit; frikën e bën siguri dhe paqe të zemrës!

Jam admirues i djegies së shkaqeve prej Tij. Në imagjinatat për Të jam si sofist!

Veziri thur një hile tjetër për t'i azdisur më tej krishterët.

Veziri thuri një hile tjetër sipas mendjes së vet. I la predikimin dhe këshillën dhe u mbyll në vetmi.

Myridët i dogji. Plot dyzet ditë qëndroi i mbyllur në vetmi.

Njerëzit u bënë si të marrë nga dëshira për ta parë, nga kjo sjellje e tij, ngaqë mbetën pa të!

Ata i luteshin e ngashëreheshin, kurse veziri ishte mbledhur shuk nga të pangrënët.

Të gjithë së bashku i çuan fjalë: "Ne pa ty e kemi keq punën! Ç'mund të bëjë i verbëri po s'pati shkopin që t'ia tregojë udhën?

Për hir të Zotit, ki mirësinë dhe mos na lër më tepër të vetëm pa ty!

Ne jemi si fëmijë, kurse ti je dado për ne; eja e na mblidh nën hijen tënde!"

Veziri u çoi fjalë: "Shpirti s'më ndahet nga miqtë, por nuk kam leje të dal jashtë!"

Emirët filluan ta lusin e t'i përgjërohen, kurse myridët, ta zgjasin gjuhën!

O bujar i madh! Ç'fat i keq që pa ty mbetëm jetimë edhe nga zemra, edhe nga feja!

Ti nxjerr pretekste, kurse ne ofshajmë pa pushim nga zemra që na digjet për ty!

Ne jemi mësuar me kuvendin tënd të bukur, ne jemi ushqyer me qumështin e urtësive të tua!

Për dashuri të Zotit, mos na e bëj këtë të keqe; ki mirësinë, të sotmen mos e lër për nesër!

A mund të ta pranojë zemra që të dashurit e tu të mbeten pafundësisht pa përfituar prej teje?

Që të gjithë përpëliten si peshku në tokë të thatë! Shembe pritën e lumit dhe lëshoje ujin!

O njeri që nuk ke zëvendës sot! Për dashuri të Zotit, shkoji popullit në ndihmë!

Veziri i përzë myridët.

Veziri u çoi fjalë: "Bëni kujdes, o të shtënë pas thashethemeve! O ju që kërkoni predikimet formale që dalin nga gjuha dhe dëgjohen me veshë!

Zëreni me pambuk veshin e kësaj ndjenje të ulët, zgjidheni lidhësen e ndjenjës nga syri i ballit!

Pambuku i atij veshit të fshehtë është veshi që keni në kokë; pa u shurdhuar ky, veshi i shpirtit nuk nis të dëgjojë!

Bëhuni pa ndjenja, pa veshë, pa mendim që ta dëgjoni thirrjen "kthehu te Zoti yt!"

Për sa kohë të jesh në thashethemet e gjendjes së zgjuar, si mund të ndjesh diçka nga biseda e gjendjes në gjumë?

Fjala jonë, puna jonë ecin në botën e jashtme, në dukje, kurse ecja e brendshme bëhet mbi qiej.

Trupi pa thatësirën (këtë botë) se në thatësirë lindi, kurse Isai i shpirtit e hodhi këmbën në det!

Ecja e trupit të thatë ra në vend të thatë; sa për ecjen e shpirtit, ai e hodhi hapin mu në mes të detit!

Jeta, drejt thatësirës: pasi të kapërcesh male, detra, fusha...

Ku do ta gjesh ujin jetëdhënës, dallgët e detit ku do t'i çash?

Dallgët tokësore janë fantazitë tona, mendësia jonë dhe mendimi ynë. Kurse dallgët e detit janë dalldisja, dehja dhe asgjësimi.

Në këtë dehje ku ndodhesh, ti je mjaft larg asaj dehjeje. Sa të jesh i dehur me këtë dehje, atë gotë vazhdon ta urresh!

Thashethemet e botës së dukshme janë si pluhur. Bëjeni zakon të dëgjoni pak siç dëgjon veshi!"

Myridët i luten prapë që t'i japë fund vetmisë dhe vetëmundimit.

Të gjithë së bashku i thanë: "O i urtë që kërkon shkak, mos e shih me vend këtë mundim për ne!

Ngarkoji kafshës atë barrë që mund ta mbajë! Njerëzve të dobët jepu punë sa e kanë fuqinë!

Çdo zog ha kafshatën që i përshtatet. Si mund të ndodhë që një zog ta gëlltisë menjëherë një kokërr fiku?

Po i dhe bukë fëmijës së gjirit, dije të vdekur atë foshnjë të shkretë!

Kur t'i dalin dhëmbët, ai kërkon vetë tul buke!

Po qe se zogu që s'i kanë dalë pendët, ngrihet të fluturojë, bëhet kafshatë për macen.

Por kur t'i dalin pendët, ai fluturon vetvetiu, pa i propozuar kush, pa i fishkëllyer kush.

Fjala jote e bën djallin të heshtë, mirësia dhe bujaria jote na i japin veshit mendim dhe frymëzim!

Nëse je ti që na flet, veshi ynë bëhet krejtësisht mendja jonë. Meqë deti je ti, edhe toka jonë është det!

O ti që u ke dhënë dritë e bukuri çdo gjëje, nga qielli më i lartë gjer te peshku në fund të detit!

Kur të jemi me ty, toka është për ne më e mirë se qielli! Pa ty ne jemi në errësirë edhe në majë të qiellit! O hënë! O ti që s'mund të krahasohet qielli me ty!

Qiejt janë të lartë në dukje. Por lartësia në kuptim është tek shpirti!

Lartësia në dukje është e trupave, por si kuptim, trupat përfaqësohen prej emrash."

Veziri përgjigjet se nuk do të dalë nga mbyllja në vetmi.

Veziri u tha: "Arsyetimet prijini shkurt; këshillat m'i dëgjoni me gjithë zemër!

Nëse jam i besueshëm, njeriu i besueshëm nuk vihet në dyshim edhe sikur të thotë se u ngjit në qiell!

Nëse jam krejt i përkryer, ç'është ky mohim i përkryerjes? Nëse s'jam, ç'është kjo vojtje, ky mundim?

Unë nuk do të dal nga mbyllja në vetmi, sepse jam duke u marrë me punët e zemrës!"

Myridët i luten vezirit.

Të gjithë me një zë i thanë: "O vezir, nuk mohojmë, fjala jonë nuk është si fjala e të tjerëve.

Lotë na rrjedhin nga ndarja prej teje, ofshamat na dalin nga thellësitë e shpirtit!"

Fëmija nuk grindet me dadon e vet. Në të vërtetë, as ç'është e keqe di, as ç'është e mirë, por qan pa pushim!

Ne jemi si lufta, heshtat i hedh ti; nuk rënkojmë ne, por rënkon ti!

Ne jemi si fyelli, tingulli ynë është prej teje. Ne jemi si mali; jehona që lëshojmë ne është prej teje!

Jemi si loja shah që fitohet ose humbet. O ti me ëndrra të bukura: fitorja apo humbja jonë është tek ti!

O ti që na je jetë për jetët tona! Kush jemi ne që të ndodhemi, të dukemi bashkë me ty!

Ne s'jemi. Ekzistenca jonë je ti, ai që tregon me trajta të përkohshme!

Ne jemi luanë, por luanë të vizatuar mbi flamurë! Lëvizjet dhe hedhjet e tyre janë prej erës!

Edhe lëvizja jonë, edhe ekzistenca jonë janë e dhëna jote. Qenia jonë është shpikja jote!

Ndryshe, e tregove shijen e ekzistencës! Atë që s'ekzistonte, e bëre të pasionuar ndaj teje!

Mos e kurse shijen e asaj dhuntie dhe të asaj të mire; mos e kurse mezen dhe gotën me verë!

Po na e kurseve, kush mund ta kërkojë dhe gjejë? Si mund të luftojnë me njëri-tjetrin qëndistari me qëndismën?

Mos na shih ne, punët tona; shih dhuratat e tua, bujarinë tënde!

Ne s'ishim, as përpjekja dhe lufta jonë s'ishte. Favori yt i dëgjonte edhe të fshehta tona të pathëna!

Para piktorit dhe lapsit, piktura është duarlidhur dhe e dobët si fëmija në barkun e nënës!

Krijesat e të gjitha botëve janë para fuqisë së Zotit të pafuqishme si gjergjefi para gjilpërës!

Fuqia punon mbi gjergjef, disa herë, fytyrë njeriu, disa herë, fytyrë djalli; herë gëzim, herë hidhërim punon!

Gjergjefi nuk ka dorë që ta lëvizë për def, nuk ka gjuhë që të nxjerrë zë për të folur për dobinë ose dëmin!

Ti këndoje në Kur'an kuptimin e këtyre vargjeve. Zoti tha: "Kur qëllove, nuk qëllove ti!"

Nëse ne hedhim shigjetën, nuk qëllojmë ne. Ne jemi hark me të cilin Zoti qëllon!

Ky nuk është determinim, është kuptimi i determinimit. Përmendja e determinimit është vetëm për lutje dhe përgjërim ndaj Zotit!

Qarja jonë është provë e nevojtarisë dhe pafuqisë sonë. Edhe turpërimi nga kjo që bëjmë është provë se s'e kemi në dorë.

Po ta kemi në dorë, pse të turpërohemi? Ç'të jetë ky hidhërim, ky turpërim?

Pse mësuesit i edukojnë nxënësit? Pse kthehet mendimi nga masat parandaluese tek të tjerat?

Po qe se ti thua se "ai s'di gjë për determinimin", se "hëna që i përket të Vërtetës, e fsheh fytyrën në re",

Për këtë ka një përgjigje të këndshme; po ta dëgjosh, kalon nga mohimi, e miraton fenë dhe bashkohesh me mua:

Malli dhe qarja janë në kohën e sëmundjes. Koha e sëmundjes është krejtësisht kohë zgjimi.

Kur je i sëmurë, bën pendesë për mëkatin.

Ty të bëhet e dukshme shëmtia e mëkatit; kur shërohesh, vë për qëllim të hysh në rrugë të drejtë!

Dhe betohesh që prej aty e tutje të mos zgjedhësh ndonjë punë tjetër.

Në këto kushte, u kuptua dukshëm se sëmundja të dhuron ty mençuri!

O ti që kërkon të vërtetën! Dije këtë të vërtetë se tek kush të ketë vuajtje, ai ka nuhatur aromë, ka arritur shpëtim!

Kush të jetë më shumë i zgjuar, ai është më shumë i vuajtur. Kush ta ketë kuptuar punën më mirë, fytyra e tij është më e zverdhur!

Nëse e njeh shtrëngimin e së Vërtetës, pse s'bërtet? Ti sikur e shihje zinxhirin e shtrëngimit, apo jo!

Si ndodh që të gëzohet i lidhuri në zinxhirë? I burgosuri si mund të ndjejë liri?

Nëse sheh se t'i kanë lidhur këmbët, se mbi kokë të janë ngulur çaushët e mbretit,

As ti mos u shërbe si çaush të dobtëve! Sepse kjo detyrë s'është shprehi dhe natyrë e të dobtëve!

Meqë s'e sheh, mos fol për shtrëngimin e Zotit! Nëse e sheh, ku është shenja që e sheh?

Në çfarëdo pune që priresh për ta kryer, e sheh hapur fuqinë tënde,

Kurse kur s'dëshiron vetë ta bësh, e quan veten të shtrënguar nga Zoti që të mos e bësh!

Pejgamberët janë të shtrënguar në punët e kësaj bote, kurse qafirët, në punët e botës tjetër!

Pejgamberët zgjedhin punët e botës tjetër, kurse injorantët, punët e kësaj bote!

Sepse çdo zog shkon në atë vend ku ndodhet lloji i vet; trupi i mbetet pas, kurse shpirti, më i shpejtë, ecën para!

Meqë mohuesit, qafirët, janë nga lloji i errësirës, kanë ardhur qetë e qetë në burgun e kësaj bote!

Meqë pejgamberët janë nga lloji i qiellit më të lartë të parajsës, kanë shkuar drejt dritës së zemrës dhe shpirtit!

Kjo fjalë s'ka fund, por ne prapë të kthehemi e ta plotësojmë *tregimin.*

Veziri i lë pa shpresë myridët në çështjen e braktisjes së vetizolimit.

Veziri u bëri zë nga brenda: "O myridë, ta merrni vesh prej meje se Isai më tha mua:

"Ndahu prej të afërmve, prej shokëve, rri vetëm,

Ktheje kokën nga muri dhe ulu vetëm, duke pëlqyer ndarjen edhe nga vetvetja jote!"

Pas kësaj, nuk kam më leje të flas, nuk kam punë me thashetheme!

Lamtumirë, o miq! Unë vdiqa, barrën ia përcolla qiellit të katërt!

Në këtë mënyrë, të mos digjemi mes mundimesh e vështirësish nën qiellin e zjarrit!

Këtej e tutje do të ulem mbi qiellin e katit të katërt, pranë Isait!"

Veziri e bën çdo emir zëvendësues në postin e vet.

Por pastaj i thirri emirët veç e veç e një nga një dhe secilit i tha një gjë.

Secilit i tha: "Ti je zëvendës i Zotit në fenë e Isait dhe pasardhësi im,

Emirët e tjerë janë të varur prej teje dhe në urdhrin tënd. Isai i bëri të gjithë përkrahës dhe ndihmës të tu!

Cili emir të ngrejë krye, të mos të bindet, kape dhe o vrite, o mbaje rob dhe hidhe në burg!

Vetëm se, sa të jem unë gjallë, askujt mos ia thuaj këtë; pa vdekur unë, mos e kërko këtë pozitë!

Pa vdekur unë, mos e nxirr në shesh këtë, mos u ngri të kërkosh salltanet dhe sundim!

Ja, Kjo rokelë letre dhe urdhrat e Mesihut aty... Këndoja bashkësisë tënde në mënyrë të qartë që ta kuptojnë!"

Ai i tha çdo emiri veçmas këtë gjë: "Në fenë e Isait nuk ka zëvendës tjetër veç teje!"

Çdonjërin e priti veç e veç. Ç'i tha njërit, ia tha edhe tjetrit!

Çdonjërit i dha një letër të mbështjellë rrotull si rokelë; çdo rokelë shprehte të kundërtën.

Tekstet e letrave ishin të kundërtat e njëra-tjetrës siç janë nata me ditën.

Urdhrat e letrave ishin të kundërtat e njëra-tjetrës, gjë që e bëmë të qartë gjer tani.

Veziri vret veten në vetizolim.

Pastaj veziri e mbylli derën për dyzet ditë me radhë. E vrau veten dhe shpëtoi nga qenia e vet!

Kur e mori vesh vdekjen e tij, populli u shemb mbi varrin e tij si të ishte shembur bota!

Një mori njerëzish u grumbullua pranë varrit të tij duke shkulur flokët e duke shqyer rrobat.

Vetëm Zoti e di numrin dhe kombësinë e njerëzve që u mblodhën aty!

I hodhën kokës dheun e varrit të tij; mjerimin e tij e panë si shpëtim të tyre!

Një muaj me radhë, populli lëshoi lot të përgjakur mbi varrin e tij. Nga mjerimi prej ndarjes së tij, edhe mbretërit, edhe të mëdhenjtë, edhe të vegjëlit klithnin e bërtisnin!

Bashkësia e Isait i pyet emirët: "Kush është zëvendësi nga ju?"

Një muaj më pas, populli i pyeti emirët: "O ju të mëdhenjtë tanë! Kush nga ju do të ulet në pozitën e vezirit?

Që ne ta njohim atë person si imam dhe si model për ta ndjekur, që t'ia dorëzojmë çdo gjë atij!

Meqë dielli perëndoi dhe na e ngushtoi zemrën, s'kemi ç'të bëjmë tjetër veçse të ndezim pishë në vend të tij!

Meqë i dashuri na humbi nga sytë, meqë mbetëm pa të, dikush duhet ta zëvendësojë, dikush duhet të na bëhet kujtimi i tij!

Tani që stina e trëndafilave iku dhe trëndafilishtja u tha, nga ç'gjë ta marrim aromën e trëndafilit? Nga uji i trëndafilit!

Meqë Zoti nuk është në shesh, pejgamberët janë zëvendësit e Tij.

Jo, fola gabim! Nëse pandeh se zëvendësi dhe ai që e cakton zëvendësin janë dy, kjo është gabim, s'është gjë e mirë!

Gjersa ti kapesh nga pamja, janë dy, kurse për atë që shpëton nga pamja, janë një.

Në pamje, sytë janë dy, por shih se drita e tyre është një!

Nëse njeriu sheh dritën e syve, drita e tyre s'ndahet nga njëra-tjetra!"

Të gjithë pejgamberët janë të vërtetë.
"Ne nuk i ndajmë pejgamberët e Zotit nga njëri-tjetri!"

Nëse në një vend ndodhen njëqind copë pisha, në pamje, secila është më vete.

Por nëse sheh flakën e tyre, pa dyshim, është e pamundur të dallosh ndryshim mes tyre!

Merr njëqind mollë e njëqind ftonj, secili janë veç e veç, por po t'i shtrydhësh, të gjithë bëhen një!

Në kuptime nuk ka përpjesëtim dhe numërim, nuk mund të bëhet ndarje e bashkim.

Bashkimi me mikun, me miqtë është i këndshëm. Mbahu pas kuptimit se pamja është e pabindur.

Shtype dhe shtrydhe pamjen inatçore që nën të ta shohësh si thesar njësinë (e Zotit).

Po s'e shtrydhe, mirësitë e Tij (Zotit) e shtrydhin atë. O Zot, që zemra më është robëruar ndaj Tij!

Ai edhe ua tregon veten zemrave, edhe e qep hirkën e dervishit!

Të gjithë qemë përhapur dhe ishim një element. Atje ishim pa kokë e pa këmbë;

Ishim element si dielli, pa nyje dhe të thjeshtë... si uji.

Kur ajo dritë e bukur dhe e tejdukshme mori trajtë, doli në shesh numri siç del në shesh hija e bedenave të kalasë.

Shembini bedenat me katapultë që të zhduket ndarja mes këtyre dy anëve.

Unë patjetër mund ta shtjelloja këtë, por druhem të mos rrëshqas qoftë edhe në një ide!

Mendimet dhe idetë janë si një shpatë çeliku e mprehtë. Po s'pate mburojë, ik sa më larg që të jetë e mundur!

Mos dil para këtij elmazi pa mburojë! Sepse shpata nuk ka turp të të presë!

Për këtë shkak e futa unë shpatën në mill: Ai që lexon përsëprapi, të mos i japë kuptim të kundërt.

Erdhëm në fund të tregimit, në diskutimin mbi besnikërinë e bashkësisë së gjërave të drejta e të vërteta!

Pas vdekjes së prijësit u ngritën dhe kërkuan zëvendësin e tij.

Emirët nxorën shpatat dhe luftuan kundër njëri-tjetrit për prijësi dhe pushtet.

Njëri prej emirëve doli para dhe shkoi te ai populli besnik.

Dhe u tha: "Ja zëvendësuesi i atij njeriu; unë jam zëvendësi i Isait në këtë kohë!

Ja, kjo letër e mbështjellë është prova ime se posti i prijësit më përket mua!"

Pastaj doli nga pusia emiri i dytë. Davaja e tij për çështjen e zëvendësit të postit ishte si e të parit.

Edhe ai nxori nga nënsqetulla një letër të mbështjellë në rokelë dhe e tregoi. Tek të dy nisi zemërimi çifut.

Pasi edhe emirët e tjerë u ngritën për të njëjtën çështje, nxorën shpatat e mprehta.

Në dorë të secilit kishte një letër të mbështjellë si rokelë dhe një shpatë. Ata u sulën kundër njëri-tjetrit si elefantë të dehur.

Qindramijëra krishterë vdiqën, kokat e prera u bënë sa një kodër!

Fara e intrigës e mbjellë nga veziri u kthye në fatkeqësi që ra mbi kokën e tyre!

Arrat u thyen; ai me thelbin të shëndoshë, pas thyerjes u bë zotërues i një shpirti të pastër e të tejdukshëm.

Por vrasja dhe vdekja që i përkasin trajtës së trupit, janë si prerja apo çarja e shegës dhe e mollës.

Fruti i ëmbël bëhet shurup, kurse nga fruti i kalbur s'mbetet gjë!

Në fakt, gjëja që ka kuptim del në shesh; e kalbura shpërbëhet dhe humbet.

O ti që i falesh trajtës, pamjes! Përpiqu të kapësh llojin, kuptimin, sepse kuptimi është flatër për trupin e trajtës.

Bjer e ngrihu me njerëzit e kuptimit që edhe të përfitosh mirësi, edhe të mbetesh i ri!

Shpirti pa kuptim në këtë trup është si shpata e drunjtë brenda në këllëf!

Brenda në këllëf ka vlerë, por, me të dalë nga këllëfi, bëhet gjë për të ndezur zjarr me të!

Shpatën prej druri mos e ço në luftë; për të mos rënë në vajtim, në fillim kontrolloje!

Po qe prej druri, ik, kërko tjetrën; po qe prej elmazi, ec para me gëzim!

Shpata prej elmazi është në depon e të urtëve. Shikimi i tyre është për ju një gjë e rrallë!

Të gjithë të diturit vetëm e vetëm kështu kanë thënë: Ai që di, është mëshirë për botët!

Në marrç shegë, merr shegë që qesh (të plasur nga e bëra), në mënyrë që e qeshura e saj të të tregojë ty se është e bërë!

Ç'e qeshur e bekuar është ajo që, si margaritari në kutinë e shpirtit, nga goja të tregon zemrën!

E qeshura e pabekuar është e qeshura e mallkimit: me ta hapur gojën, tregon të nxirën e zemrës.

Shega e qeshur e bën kopshtin të qeshur. Edhe kuvendi i burrave të bën ty burrë!

Edhe sikur të jesh gur i fortë apo mermer, po sose te njeriu i zemrës bëhesh margaritar!

Dashurinë e njerëzve të pastër mbille mu në zemër! Mos ia jep zemrën një dashurie tjetër veç asaj të atyre me zemër të këndshme!

Mos shko te vendi ku s'ka shpresë, se shpresë ka; mos shko në errësirë, se diell ka!

Zemra të tërheq ty te vendi i njerëzve të zemrës, kurse trupi, në burgun e ujit dhe baltës!

Bëhu i kuptueshëm: ushqimin e zemrës merre nga njeriu i zemrës. Ec dhe mësoje kënaqësinë nga ai që e njeh kënaqësinë!

Lartësimi i vetive të mira të Mustafait (s.a.) të përmendura në Ungjill.

Në Ungjill ishte emri i Mustafait, i atij kreut të pejgamberëve, i atij detit të kënaqësisë;

Ishin përmendur cilësitë, pamja, lufta, agjërimi dhe mënyra si hante.

Krishterët, kur flisnin për të, për të fituar mirësi,

E puthnin atë emër të lartë dhe e vinin në ballë!

Gjatë intrigës për të cilën folëm, ata ishin të mbrojtur nga intriga dhe rrëmuja.

Të mbrojtur nga të këqijat e emirëve dhe vezirit, ishin strehuar nën emrin e Ahmedit.

Edhe brezi i tyre u shtua. Drita e Ahmedit u ndihmoi atyre, u bë i dashuri i tyre.

Grupi tjetër që e përbuzte emrin e Ahmedit, u zhvlerësua dhe u poshtërua

Për shkak të intrigave dhe për shkak të vezirit intrigant.

Për shkak se bënë sipas letrave me fjalë dhe kuptime të kundërta, edhe feja e tyre u trazua, edhe rregullat.

Po qe se emri i Ahmedit ndihmoka kaq shumë, po drita e tij, si mbron?

Kur emri i Ahmedit bëhet një kala e fortë, ç'bëhet personi i atij shpirti të besueshëm?

Pas atij mbretit që s'pranonte këshillë, që kishte dalë nga rruga për shkak të belasë së vezirit,

Historia e një mbreti tjetër çifut që përpiqet ta shkatërrojë fenë e Isait.

Për shkatërrimin e fesë së popullit të Isait, nga i njëjti brez çifut doli në shesh një mbret i ri.

Po deshe të marrësh vesh për daljen në shesh të një mbreti tjetër, këndo suren mbi konstelacionet.

Edhe ky mbret iu përshtat zakonit të keq të lindur nga mbreti i parë.

* Ndërkaq, dije se Zoti e kërkon një më një llogarinë e mëkatit të dhunës dhe padrejtësive nga fajtori i parë.

Kush vë një zakon të keq, mallkohet pastaj për çdo çast dhe vazhdimisht.

Të mirët ikën dhe prej tyre zakonet e mira mbetën, kurse nga njerëzit e këqinj, padrejtësitë, mizoritë dhe mallkimet e tyre!

Gjer në kiamet, çfarëdo i keq që të krijohet, e ka fytyrën në drejtim të asaj të keqeje!

Uji i ëmbël me ujin e kripur nuk përzihen. Dhe nuk do të përzihen gjersa të fryjë briri!

Të mirëve u mbeti trashëgim uji i ëmbël. Ç'trashëgim është ai? "Libri Universal"

Po të bësh kujdes, e sheh dhe e kupton se dëshira e kërkuesve janë rrezet e margaritarit profetik, ato rreze dëshirojnë.

Rrezet shkëlqejnë dhe kthehen në vartësi të margaritarëve. Rrezet shkojnë aty nga kanë dalë, ku ta kenë burimin.

Meqë dielli lëviz nga një konstelacion në tjetrin, drita e tij që bie në penxhere, rrotullohet nëpër gjithë shtëpinë.

Kush të ketë lidhje dhe marrëdhënie me një yll, ai lëviz dhe rrotullohet bashkë me atë yll, ndodhet nën ndikimin e tij.

Venusi fatmirë dëshiron kënaqësinë, bërtitjen dhe ftesën dhe dashurinë, është i dhënë tepër pas tyre.

Kurse kush është i lidhur pas Marsit gjakderdhës, kërkon luftë, shpifje dhe armiqësi.

Pas yjeve ka yje të tjerë tek të cilët nuk ka djegie dhe thatësirë.

Ata lëvizin dhe udhëtojnë në qiej të tjerë veç këtyre shtatë kat qiejsh.

Këta yje të pandarë nga njëri-tjetri, qëndrojnë nën ndriçimin e dritërave të Zotit.

Kush e pastë fatin si të tyre, ai i godet dhe i djeg qafirët.

Zemërimi i tij nuk i përngjet zemërimit të Marsit që herë shtohet e herë pakësohet dhe i cili ecën kështu duke u ndërruar.

Drita mbizotëruese s'pakësohet e s'shuhet. Ajo ndodhet mes dy gishtave të dritës së Zotit.

Atë dritë Zoti ua shpërndau shpirtrave. Fatmirët e kanë mbushur prehrin me to.

Ai që e ka gjetur atë shpërndarje drite, e ka hequr fytyrën nga tjetërkush veç Zotit.

Kush nuk ka prehër dashurie, ka mbetur pa pjesë nga ajo shpërndarje drite.

Fytyra e gjërave të pjesshme është drejt plotësimit. Fytyra e bilbilit është drejt ushqimit dhe trëndafilit.

Ngjyrën e peshkut kërkoje nga jashtë, kurse ngjyrën e njeriut, çfarëdo që të jetë, e vërdhë a e kuqe, kërkoje nga brenda!

Ngjyrat e mira formohen nga pastërtia, kurse ngjyra e shëmtive del në shesh nga uji i fëlliqur.

Emri i asaj ngjyre të bukur është "ngjyra e Zotit", kurse kundërmimi i ngjyrës së fëlliqur është mallkimi i Zotit.

Ç'gjë të ketë dalë nga deti, shkon në det, ngado që të ketë ardhur, atje kthehet dhe arrin.

Ujërat që rrjedhin me rrëmbim nga majë e malit dhe shpirti që pikon e ikën nga trupi ynë përzier me dashuri, shkojnë në origjinë!

Mbreti çifut vë njerëz të ndezin zjarr dhe pranë zjarrit të vendosin një statujë së cilës, kush i falet, shpëton nga zjarri.

Pa shihe ç'masa mori ai qen çifut! Pranë zjarrit ngriti një idhull-statujë.

Kush i falet këtij idhulli, shpëton. Kush nuk i falet, futet mu në mes të zjarrit!

Pasi ai s'e vuajti ndëshkimin e idhullit të vetvetes, nga idhulli i vetvetes lindi një idhull tjetër.

Nëna e idhujve është idhulli i vetvetes (egos) tuaj, sepse ai idhull është gjarpër, ky idhull është kuçedër!

Vetvetja është çakmak i përbërë prej hekuri dhe guri, kurse idhulli është shkëndija. Shkëndija shuhet me ujë.

Po hekuri dhe guri, a shuhen me ujë? Sa të ndodhen këta të dy te njeriu, si dhe kur mund të jetë njeriu i sigurt?

* Guri dhe hekuri e kanë zjarrin brenda, uji nuk arrin dot gjer te zjarri i tyre, nuk vepron dot mbi të.

* Zjarri i jashtëm shuhet prej ujit të lumit. Por si mund të hyjë brenda hekurit dhe gurit?

* Uji i kupës dhe shtambës është i përkohshëm, i mbarueshëm, kurse uji i burimit është gjithmonë i freskët dhe i përhershëm.

* Origjina e zjarrit dhe tymit është hekuri dhe guri. Herezia krishtere dhe çifute është produkt i të dyjave.

Idhulli është uji i zi i fshehur në shtambë. Vetveten dije pa dyshim si burim të atij uji të zi.

Ai idhulli i gdhendur si statujë është si rrebesh i zi. Vetvetja (egoja) që bën idhull (statujë) është një burim (pus) në rrugën kryesore.

Një copë gur e thyen shtambën, por uji i burimit (pusit) zjen (bulëzon) pa pushuar.

Të thyesh një statujë (idhull) është e lehtë, mjaft e lehtë! Por ta shohësh vetveten (egon) si gjë të lehtë, është injorancë.

O bir, po e deshe shembëllimin dhe trajtën e vetvetes (egos), lexo rrëfimin mbi xhehennemin me shtatë porta!

Në çdo çast, vetvetja sajon një hile dhe në çdo hile është faraoni i mbytur së bashku me ndjekësit e vet!

Ik te Zoti i Musait dhe te Musai; mos e derdh ujin e besimit duke vepruar, kështu, si faraon!

Kapu pas Atij që është një dhe Ahmedit, o vëlla, dhe shpëto nga Ebuxhehli që është trupi yt!

Mbreti çifut sjell një grua me një fëmijë të vogël dhe e hedh fëmijën në zjarr;
fëmija i vogël që i vjen goja,
e nxit popullin të hidhet në zjarr.

Çifuti solli para statujës një grua bashkë me fëmijën e saj të vogël. Zjarri qe ndezur mirë.

Ia mori fëmijën nënës dhe e hodhi në zjarr. Gruaja u frikësua dhe e shkëputi zemrën nga besimi.

Sapo gruaja deshi t'i falej statujës (idhullit), të vinte ballin në tokë para tij, fëmija thirri nga mesi i zjarrit: "Unë s'kam vdekur!"

Dhe vazhdoi t'i flasë: "Eja, nënë! Vërtet, në dukje jam brenda në zjarr, por këtu jam mirë, jam këndshëm.

Ky zjarr në dukje është si një copë me të cilën na janë lidhur sytë. Por, në të vërtetë, është mëshirë e shfaqur nga kuptimi!

Nënë, eja dhe shihe provën e Zotit që, në këtë mënyrë, të shohësh edhe shenjën dhe kënaqësinë e të sëmurëve të së Vërtetës!

Nënë, dil nga një botë që në të vërtetë është zjarr, por i përngjet ujit, dhe hyr në këtë zjarr dhe shihe ujin që i përngjet zjarrit!

Hyr në zjarr dhe shih të fshehtat e Ibrahimit i cili gjeti në zjarr trëndafila dhe jaseminë!

Duke lindur prej teje, shihja vdekjen dhe frikësohesha shumë nga ndarja prej teje!

Mirëpo, me të lindur prej teje, hyra në një botë të gjerë me ajër të këndshëm e me ngjyrë të bukur duke shpëtuar nga ajo qeli e ngushtë dhe e errët ku ndodhesha!

Tani, pasi gjeta brenda këtij zjarri qetësi dhe prehje, nisa ta shoh botën si mitrën e nënës!

Brenda këtij zjarri pashë një botë, në çdo thërrime të së cilës është fryma e Isait!

Një botë e vetëqenë, pa trajtë. Kurse ajo botë e qenë në dukje, përbëhet prej një trajte të paqëndrueshme!

Nënë, për hir të së drejtës së amësisë, eja! Eja dhe hyr! Ky zjarr nuk djeg!

Nënë, eja, hyr, se është pikërisht koha e fatmirësisë dhe lumturisë. Nënë, eja dhe hyr, mos të të shpëtojë nga dora lumturia!

Fuqinë e atij qenit e pe! Eja dhe shih edhe mirësinë dhe fuqinë e Zotit!

Unë po të tërheq prej këmbe se më dhimbsesh, jo se dua të ta rrëshqes këmbën nga kënaqësia!

Eja brenda dhe thirri edhe të tjerët se mbreti ka shtruar këtu një sofër.

O muslimanë, hidhuni që të gjithë në zjarr, se, veç shijes së besimit, çdo gjë tjetër është mundim!"

Dhe thirri: "O njerëz! Të gjithë së bashku ejani e hidhuni si fluturat në zjarr në këtë botë me qindra pranvera!"

Kështu thërriste ai nga mesi i zjarrit, kurse populli kishte shtangur i tmerruar nga zëri i tij!

Atëherë, burra e gra nisën ta hidhnin pa lëkundje veten në zjarr!

Dhe pa iua ngarkuar kush këtë detyrë, pa i shtrënguar kush! Vetëm me dashurinë për mikun, sepse i dashuri dhe miku i japin shije çdo dhimbjeje!

Më në fund, ashtu u bë që shërbëtori nisi ta pengonte popullin duke i bërë thirrje që të mos hidhej në zjarr.

Çifutit iu nxi fytyra e u turpërua. Për këtë shkak, iu ndrydh zemra, u pendua!

Sepse populli u lidh më tepër se më parë ndaj besimit, u bë më i vendosur për ta sakrifikuar veten!

Falenderuar qoftë që hileja e vet iu lidh shejtanit për këmbësh! Falenderuar qoftë që shejtani e pa veten fytyrënxirë!

Poshtërimi që ia lëshoi popullit fytyrës, nga burrëria e popullit, iu kthye e iu ngjit mbretit në fytyrë!

Ai ua griste rrobat njerëzve pa u drojtur, kurse, më në fund, rroba e tij u gris e ai doli lakuriq, kurse rroba e popullit mbeti e pacënuar!

Personit që e përmendte emrin e Muhammedit (a.s.) për t'u dëfryer, i mbeti goja shtrembër!

Dikush, duke e shtrembëruar gojën, e përmendi me tallje emrin e Ahmedit, goja iu shtrembërua dhe i mbeti ashtu!

I penduar, iu lut Profetit ta falte duke ia përmendur meritën si njohës i dijes së fshehtë.

Unë u talla me ty nga injoranca, kurse tani u bëra që të tallen të tjerët me mua!

Po qe se Zoti dëshiron t'ia grisë perden dikujt, i shtyn njerëzit e pastër ta shajnë e ta turpërojnë.

Po qe se Zoti dëshiron t'ia mbulojë të metat e gabimet dikujt, e bën atë të mos flasë për të metat e njerëzve të tjerë.

Po qe se Zoti dëshiron të na ndihmojë, na jep prirjen për t'iu lutur dhe përgjëruar Atij.

Prandaj, sa i bekuar është syri që qan! Sa e shenjtë është zemra që digjet e përvëlohet me dashurinë për Zotin!

Fundi i çdo qarjeje është buzëqeshja. Njeriu që e sheh fundin e vet, është një rob i bekuar i Zotit.

Ku rrjedh ujë, vendi gjelbëron; ku rrjedh lot, atje shfaqet mëshirë!

Bëhu sypërlotur që në sheshin e shpirtit të mbijë blerim!

Në daç të qash, ndjej dhimbje për ata që derdhin lot... Në daç të meritosh mëshirë, mëshiroji të dobëtit!

Mbreti çifut i flet zjarrit.

Mbreti çifut e ktheu fytyrën nga zjarri dhe i foli kështu: "O ti me shprehi të ashpra! Ku e ke cilësinë e djegies në natyrën tënde?

Pse nuk po djeg? Ç'u bë kjo cilësia jote? Apo mos e ndryshove qëllimin për fatin tonë?

Ti nuk po i bën të mirë as atij që e adhuron zjarrin! Si shpëtoi ai që s'të falet ty?

O zjarr! Ti nuk ishe aspak durimtar! Pse nuk po djeg? Ku është shkaku? Apo s'ke fuqi?

Kjo mos është pengesë për syrin apo pengesë për mendjen? Si të mos djegin këto flakë të ngritura lart?

A mos të bëri kush magji, apo kjo është alkimi? Apo është fati ynë që t'u ndërrua natyra?"

Dhe zjarri i tha: "O Shaman! Unë jam po ai zjarr! Pa eja brenda dhe ma sheh nxehtësinë!

As natyra s'm'u ndryshua, as elementi im. Unë jam shpata e Zotit, pres me lejen e Tij!"

Qentë e stanit rrinë të shtrirë qetë në hyrje të çadrës së stanarit.

Por po të afrohet ndonjë i huaj, i vërsulen si luanë!

Në bindje, unë s'jam më poshtë se qentë. Unë i bindem urdhrit të Zotit!

Po qe se të frikëson ty zjarri i natyrës, djegia e tij është me urdhër të Zotit të fesë.

Po qe se zjarri i natyrës të jep gëzim, atë gëzim ta jep mbreti i fesë!

Po të ndjesh ankth e dhimbje, bëj pendesë, sepse dhimbja shkaktohet me urdhër të Krijuesit.

Po deshi Zoti, zjarri bëhet vetë dhimbja, apo vetë hareja, apo vetë laku i këmbëve apo vetë liria!

Era, dheu, ajri, zjarri janë skllevër. Me mua e me ty janë të vdekur, kurse me Zotin, janë të gjallë, mbajnë vetëm emrin e Tij.

Zjarri qëndron i gatshëm para Zotit për të zbatuar urdhrat e Tij; si dashnori, përpëlitet natë e ditë!

Po t'i biesh gurit me një copë hekuri, shpërthejnë shkëndija. Por shkëndijat dalin jashtë jo nga goditja, por me ferman të Zotit!

Mos i përplas me njëri-tjetrin hekurin e dhunës me gurin, sepse këta të dy, si gruaja me burrin, nxjerrin në shesh fëmijë!

Hekuri dhe guri janë shkaqe, kurse ti, si burrë i mirë, shih para!

Sepse këtë shkak e ka nxjerrë në shesh ky shkak. Si mund të dalë në shesh vetvetiu shkaku i jashtëm pa qenë shkaku i vërtetë?

Shkaqet që u kanë shërbyer profetëve si udhërrëfyes, janë më të lartë se këto shkaqe!

Eshtë ai shkak që e bën të efektshëm këtë shkak. Por disa herë ndodh që ta bëjë të kotë e pa rezultat, ta lërë pa fuqi.

Mendja e kupton këtë shkak. Edhe të afërtit e atyre shkaqeve janë profetët.

Ç'është shqipja e kësaj fjalës "shkak"? Litar! Litari për të nxjerrë ujë nga pusi!

Rrotullimi i çikrikut bëhet shkak që litari të lëshohet në pus ose të mblidhet. Por është gabim të mos e shohësh atë që e rrotullon çikrikun!

Pra, këtë zinxhir shkaqesh mos ia lër fatit

Në mënyrë që të mos mbetesh kokëbosh dhe i trullosur si fati, që të mos digjesh si pisha ngaqë s'ke mend!

Era bëhet zjarr me urdhër të Zotit; që të dy janë bërë sarhoshë me verën e Zotit!

O bir! Po t'i hapësh sytë, do ta shohësh se edhe uji i butësisë, edhe zjarri i zemërimit janë prej Zotit!

Po të mos e njihte shpirti i erës Zotin, si do ta dallonte fisin e Adit nga besimtarët?

Historia e erës e cila, në kohën e Hudit (a.s.), e shkatërroi fisin e Adit.

Hudi hoqi një vijë përreth vendit ku ndodheshin besimtarët. Kur era futej në atë rreth, frynte e lehtë dhe e këndshme.

Kurse të gjithë ata që ndodheshin jashtë vijës, i copëtonte dhe i ngrinte lart copë-copë.

Edhe Shejban Rai, po kështu, hiqte një vijë përreth tufës që kulloste.

Kështu bënte edhe ditën e xhuma kur do të shkonte për t'u falur, me qëllim që ujqit të mos ia sulmonin dhe grabisnin tufën.

Dhe asnjë dele nuk mund të dilte jashtë vijës dhe asnjë ujk nuk mund të hynte brenda vijës.

Rrethi i njeriut të Zotit i qe bërë pritë dhe pengesë edhe ambicjes së ujkut, edhe ambicjes së deles.

Kështu, edhe era e vdekjes është për arifët e lehtë dhe e këndshme si era që vjen nga trëndafilishtet.

Zjarri nuk e kafshoi dot Ibrahimin. Sepse ai ishte i zgjedhur i Zotit, si mund ta kafshonte?

As njerëzit e fesë nuk digjen nga zjarri i epshit, kurse të tjerët, ky zjarr i ka futur në fund të dheut!

Duke vrapuar me ferman të Zotit, dallga e detit e veçoi fisin e Musait nga kiptinjtë.

Kur arriti fermani i Zotit, e tërhoqi Karunin gjer në fund të dheut së bashku me fronin dhe florinjtë e tij!

Kur uji dhe dheu u ushqyen me frymën e Isait, u bënë me krahë, u bënë zogj dhe fluturuan!

Madhërimi që i bën ti Zotit përbëhet prej një avulli, prej një fryme të dalë nga një kufomë e formuar prej uji dhe dheu. Ndërkaq, si rrjedhojë e drejtësisë së zemrës, është bërë zog xhenneti që ka fluturuar dhe ka shkuar atje.

Mali Sina nisi të hedhë valle nga drita e Musait, u bë një sufi i vërtetë, shpëtoi nga mangësitë.

Ç'ka për t'u çuditur nëse mali bëhet një sufi i shenjtë? Edhe trupi i Musait përbëhej prej një cope të prerë!

Mbreti çifut nuk u jep rëndësi këtyre fjalëve, i mohon dhe nuk i pranon këshillat e këshilltarëve.

Ai mbreti çifut i pa mrekullitë e çuditshme me zjarrin, megjithatë, i mohoi.

Këshilltarët i thanë: "Mos e tepro, mos e zgjat kaq shumë kryeneçësinë prej kafshe!"

Kurse ai ua lidhi duart këshilltarëve dhe i burgosi. Dhe bëri padrejtësi pas padrejtësish.

Atëherë erdhi një zë: "Meqë puna arriti gjer në këtë gradë, duro, o qen, se të erdhi goditja jonë!"

Pastaj flakët e zjarrit u ngjitën dyzet arshin, formuan një hallkë dhe i dogjën çifutët.

Origjina e tyre ishte prej zjarri, kështu që, më në fund, u kthyen në origjinë!

Fundja ai grup kishte lindur prej zjarri. Pjesët nisen në drejtim të hirit. Andej shkojnë.

Ata ishin një zjarr që mund të digjte vetëm besimtarët. Kurse zjarri që ndezën i dogji dhe përvëloi ata vetë.

Vendi i personit që e ka origjinën Havije, është vetëm Havije!

Nëna e fëmijës kërkon fëmijën; origjinat ndjekin patjetër ato që kanë dalë prej tyre!

Uji brenda në hauz është si i burgosuri në burg, por e tërheq ajri. Sepse uji është një nga katër elementët bazë: ajri, zjarri, uji dhe dheu.

Ajri e shpëton nga hauzi pak nga pak (me anë të avullimit) dhe e çon gjer në origjinë. Meqë e ndodh pak nga pak, ti s'e vë re dot.

Kështu e vjedhin edhe frymëmarrjet shpirtin tonë pak nga pak nga burgu i kësaj bote.

Fjalët e pastra dalin nga ne dhe ngjiten gjer te Ai dhe arrijnë gjer atje ku e di vetëm Ai.

Frymët tona, për shkak të pastërtisë, ngjiten si dhuratë nga ne në vendin e përjetësisë.

Pastaj, shpërblimi për fjalët tona na kthehet neve dyfish nga Zoti i lartë vetëm si mëshirë.

Pastaj na rikthen neve te ato fjalë të bukura dhe na bën të shprehim përsëri fjalë të atij lloji në mënyrë që të meritojmë sërish mirësi.

Ja, kështu, pasi të thuash fjalët më të bukura, mëshira e Zotit zbret dhe kjo gjendje tek ti është e vazhdueshme.

Le ta themi persisht: "Kjo tërheqje dhe kënaqësi vjen nga ana nga vjen kënaqësia!"

Syri i çdo populli ka mbetur në atë anë ku shijoi kënaqësi njëditore.

Në fakt, kënaqësia e çdo lloji është nga lloji i vet. Shih: "kënaqësia e pjesës është nga e tëra e vet!"

Ose ajo gjë ka aftësi për të marrë pjesë në një lloj tjetër dhe, kur e arrin atë, bëhet prej atij lloji.

Si uji dhe buka që, duke mos qenë të llojit tonë, u bënë nga lloji i ynë dhe na e ushqyen trupin dhe na e shtuan fuqinë.

Uji dhe buka nuk janë në pamje nga lloji ynë, por, për sa i përket përfundimit, dije si llojin tonë!

Po qe se marrim kënaqësi nga një gjë tjetër veç gjërave që janë të llojit tonë, ajo është një gjë që i përngjet gjësë që është e llojit tonë.

Kënaqësia që merret nga gjëja që i ngjet llojit, nuk është e përhershme. Ajo kënaqësi është e rastit dhe gjëja e rastit nuk mbetet e tillë përjetësisht.

Edhe sikur zogu të ndjejë kënaqësi nga fishkëllimi, po të mos e gjejë llojin e vet, fluturon e ikën si shigjetë.

I eturi ndjen kënaqësi nga mirazhi i ujit në shkretëtirë dhe vazhdon ta ndjekë atë edhe kur e sheh se s'e arrin dot!

Edhe pse të falimentuarit kënaqen me floririn kallp, në punishten e monedhave ai flori hidhet si metal pa vlerë.

Kujdes! Larja me ujë floriri mos të të nxjerrë nga rruga! Kujdes! Përfytyrimi i rremë mos të të rrëzojë në pus!

Lexoje këtë histori nga Kelile dhe përpiqu të përfitosh nga ajo rrëfenjë!

Kafshët e gjahut i thonë luanit t'i dorëzohet Zotit e ta lërë punën.

Në një përrua të bukur, kafshët e gjahut vuanin nga frika e luanit.

Sepse luani vazhdimisht dilte nga pusia dhe e kapte ndonjërën. Prandaj ajo kullotë të gjithave u dukej e vështirë.

Dhe menduan t'i bënin një hile dhe shkuan te luani. Dhe i thanë: "Ne të të japim ushqim ditor e të të ngopim,

Kurse ti mos na ndiq asnjërën prej nesh që kjo kullotë të mos na bëhet helm!"

Luani u përgjigjet kafshëve dhe u thotë se puna është e dobishme.

Luani u tha: "Po të mos pësoj hile, po të më rrini besnikë, e keni me vend. Mirëpo unë kam parë shumë hile prej këtij e atij!

Jam dëmtuar shumë nga bëmat dhe hilet e njerëzve, jam kafshuar shumë nga ata gjarprinj, nga ata akrepë!

Kurse nefsi që ka ngritur pusi brenda, është më i keq se të gjithë njerëzit në mendjemadhësi dhe urrejtje!

Veshi më dëgjoi se "besimtari nuk gënjehet dy herë nga vrima e një kafshe helmuese!". Veshi ma pranoi me gjithë zemër fjalën e Pejgamberit!"

Kafshët e gjahut pëlqejnë dorëzimin në vend të punës dhe fitimit me punë.

Të gjitha kafshët thanë: "O i urtë që e di si është çështja! Lëre druajtjen! Druajtja s'e shpëton dot njeriun nga vendimet e kaderit.

Druajtja nga kaderi sjell të këqija dhe shkatërrim, pra, ec para, dorëzohu, se dorëzimi është më e mira!

O njeri zemërak! Mos u përfyt me kazanë që as kazaja të mos përfytet me ty!

Për të mos ardhur ndonjë e keqe nga Zoti që zbardh dritën, robi duhet të sillet si i vdekur ndaj urdhrit të Zotit!"

Luani pëlqen punën dhe fitimin duke punuar, në vend të dorëzimit dhe nënshtrimit.

Luani tha: "Po, edhe nëse dorëzimi është udhërrëfyes, iniciativa është sunnet i Pejgamberit!

Pejgamberi ka thënë me zë të lartë: "Dorëzohu, por edhe devenë lidhe!"

Dëgjoje thënien "Personi që punon, është i dashuri i Zotit"! Mos u trego dembel në iniciativë për shkak të dorëzimit!"

Kafshët e gjahut pëlqejnë dorëzimin ndaj punës dhe fitimit me punë.

Kafshët i thanë luanit: "Dije se, për shkak të dobësisë së populllit në besim, puna dhe fitimi me punë janë një kafshatë hipokrizie sa ç'është numri i gurmazeve të të pangopurve!

Nuk ka fitim më të bukur se dorëzimi! Në fakt, ç'gjë më të dashur ka se nënshtrimi ndaj Zotit?

Shumica hidhen nga belaja në bela, nga gjarpri te kuçedra;

Njeriu bëri hile, por hileja iu bë kurth atij vetë; kë pandehu të dashur, iu bë armik gjakpirës!

E mbylli derën, por armiku ishte brenda shtëpisë. Edhe hileja dhe masat mbrojtëse të Faraonit ishin përralla të ngjashme me këtë!

Ai urrejtës vrau qindramijëra fëmijë, kurse fëmija që kërkonte ndodhej brenda shtëpisë!

Meqë në syrin tonë ka shumë pengesa, ec dhe pikëpamjen tënde asgjësoje në pikëpamjen e mikut!

Ç'shpërblim i bukur është pikëpamja e tij në vend të pikëpamjes sonë! Të gjitha qëllimet, në pikëpamjen e tij i gjen!

Fëmija kur ende s'ecën dot vetë, hipën në supe të të atit!

Por kur fuqizohet dhe bëhet i paturpshëm, kur lëviz këmbë e duar, bie menjëherë në vuajtje e mundime!

Shpirtrat e njerëzve, para se të pajiseshin me këmbë e duar, pa rënë në vartësi të trupit, fluturonin sipas qejfit të vet!

Por, kur u burgosën me urdhrin "zbrisni!", ranë në kufizimet furi, ambicje, ngopje me pak dhe nevojë.

Ne jemi për Zotin si familja që kërkon kujdes dhe foshnja që kërkon sisë. Pejgamberi ka thënë se populli është si familje për Zotin."

Ata thanë: "Ai që jep shi nga qielli, është i aftë që, me mëshirën e tij, të japë edhe jetë!"

Luani përsëri pëlqen punën ndaj dorëzimit.

Luani tha: "Mirë, po Zoti na vuri para këmbëve një shkallë.

Duhet të ngjitemi shkallare pas shkallareje në çati! Ta ndjesh veten nën shtrëngim, në këtë rast, është pangopësi!

Këmbë ke, pse e bën veten topall? Duar ke, pse i fsheh pëllëmbët?

Kur zotëria t'ia vërë skllavit belin në dorë, ia bën të qartë qëllimin pa ia thënë me fjalë!

Edhe dora është shenjë e Zotit, si beli. Ndjeshmëria për ta menduar fundin është nga treguesit e tij.

Po qe se jep shpirt pasi t'i kesh ngulitur shenjat e Zotit në shpirt dhe t'u kesh mbetur besnik atyre shenjave,

Të fal ty shumë shenja sekretesh, e heq barrën prej teje dhe të bën të aftë për punë e për fitim!

Tani ti je nën barrë; Zoti të vë barrë, të ngarkon. Tani ti e pranon urdhrin e tij, pastaj ai të bën të kënaqur.

Tani e ke pranuar urdhrin e tij, pastaj ato urdhra i thua. Tani kërkon bashkim, pastaj bëhesh i bashkuar.

Përpjekja për të falenderuar për të mirat e Zotit, është aftësi dhe fuqi. Kurse shtrëngimi për të cilin flet ti, është mohim i atyre të mirave!

Falenderimi për fuqinë që të ka dhënë ai, ta shton fuqinë. Kurse shtrëngimi ta nxjerr nga dora të mirën!

Shtrëngimi yt është të flesh në rrugë; mos fli! Pa e parë atë portë, atë seli, mos bjer në gjumë!

O determinist i pavëmendshëm! Kujdes, mos fli në vend tjetër veçse nën atë pemë me kokrra!

Që era të fryjë dhe në çdo çast të të hedhë mbi krye fruta!

Besimi në determinizmin (shtrëngesën) është i njëllojtë me fjetjen mes piratëve! Si ndodh që të shpëtojë zogu që këndon pa kohë?

Po ia ule hundën shenjave të tij, a mos e pandeh veten burrë? Po ta vësh re, e kupton se je grua!

Edhe kaq pak mendje tek ti humbet, kurse koka e mbetur bosh, bëhet urdhëruese!

Sepse mosfalenderimi është gjë e turpshme dhe keqndjellëse, e tërheq dhe e çon mosfalenderuesin gjer në fund të zjarrit!

N'u dorëzofsh, dorëzohu për të punuar; fito dhe pastaj mbështetu te Zoti!"

Kafshët e gjahut prapë zgjedhin dorëzimin në vend të punës dhe fitimit me punë.

Të gjitha kafshët i thanë duke bërtitur: "Ata të pangopurit që mbollën farën e iniciativës,

Gra e burra, qindramijëra vetë, ç'ndodhi që mbetën të privuar nga interesat e kohës së vet?

Qysh prej fillimit të botës, qindramijëra fise kanë hapur gojën si kuçedra,

Kanë sajuar dredhi dhe kanë marrë masa që mund t'i lëvizin malet nga vendi.

Dhe Zoti i ka lavdëruar dredhitë dhe masat e tyre.

Por, megjithatë, me gjithë përpjekjet e mëdha, ata s'kanë marrë dot tjetër veç kësmetit të parashkruar...

Të gjithë mbetën të pafuqishëm nga masat dhe përpjekjet, kurse zotëruan puna dhe vendimet e Zotit!

O ti me emër të shquar! Mos e quaj fitimin tjetër gjë veçse një fjalë! O njeri hileqar! Mos e pandeh punën gjë tjetër veç një iluzioni!"

Azraeli sheh dikë që pastaj ikën në sarajin e Sulejmanit; dorëzimi është më i vlefshëm se puna; dobitë e punës janë më të pakta.

Një njeri i thjeshtë, në kohë të drekës, arriti duke vrapuar në sarajin e drejtësisë së Sulejmanit.

Fytyra i qe zverdhur nga ankthi, buzët i qenë nxirë. Sulejmani e pyeti: "Ç'ka ndodhur, zotëri?"

Ai i tha: "Azraeli më pa me aq tërbim, me aq urrejtje, sa..."

Sulejmani e pyeti: "Mirë, po pa të shohim, ç'kërkon tani?" Njeriu i tha: "O ti që i mbron shpirtrat! Urdhëroje erën

Të më çojë gjer në Indi, ndoshta e shpëtoj jetën!"

Ja, kështu frikësohet populli nga varfëria! Prandaj njerëzit bëhen kafshatë e ambicjeve dhe e qëllimeve!

Frikësimi nga varfëria i ngjet frikësimit të atij njeriu nga vdekja. Kurse ambicjen, punën, pandehi Indistan.

Sulejmani urdhëroi erën dhe era e çoi menjëherë në një ishull andej nga India.

Të nesërmen, gjatë takimit me popullin, Sulejmani i tha Azraelit:

"O i dërguari i Zotit, tregomë, pse e pe me urrejtje atë musliman?

Mos vallë e bëre këtë punë për ta larguar atë njeri e për ta lënë pa familje e pa shtëpi?"

* Azraeli iu përgjigj: O mbreti i pahumbje i botës! Ai më kuptoi mbrapsht, atij ashtu iu bë!

Kur e pashë unë atë me armiqësi? U habita që ishte nisur për rrugë!"

Sepse Zoti më tha: "Shko e merrja shpirtin atij në Indistan!"

I turpëruar, i thashë: "Edhe sikur njëqind flatra të ketë, prapë është larg!"

Ja, pra, me këtë përngjasoji ti punët e kësaj bote, hapi sytë e shih!

Nga kush ikim, nga vetja jonë? Gjë e pamundur! Nga kush duam të shpëtojmë? Nga Zoti? Ç'mundim i kotë!

Përsëri, luani pëlqen punën në vend të dorëzimit dhe tregon dobitë e punës.

Luani tha: "Drejt, por shih edhe punët dhe përpjekjet e pejgamberëve dhe të besimtarëve!

Ata u shpërblyen për të gjitha vuajtjet dhe mundimet, Zoti nuk e çoi kot luftën e tyre!

Zgjidhjet që përdorën ata u bënë të qarta në çdo çështje. Sepse nga qartësia vjen qartësi.

I vunë kurth fatit dhe e kapën, të metat u rrafshuan dhe u plotësuan.

O njeri i madh! Puno e përpiqu në rrugën e pejgamberëve dhe të të urtëve!

Përleshja me kaderin dhe kazanë nuk quhet përpjekje. Sepse janë kaderi dhe kazaja që na vënë të përleshemi e të luftojmë!

Qofsha qafir nëse dikush ka ecur në rrugën e besimit dhe të bindjes dhe ka humbur qoftë për një çast!

S'të është çarë koka, pra, mos e lidh! Puno disa ditë dhe pastaj qesh!

Personi që kërkon këtë botë, kërkon një gjë të paqenë e të keqe. Kurse ai që kërkon përjetësinë, ka kërkuar një gjë të mirë për vete!

Përdorimi i rrugëzgjidhjeve për fitim material është një gjë e ftohtë. Kurse përdorimi i rrugëzgjidhjeve për ta braktisur këtë botë, është i lejueshëm, është urdhëruar!

Dredhi dhe rrugëzgjidhje do të thotë ta shposh burgun e të dalësh. Kurse, po qe se dikush e mbyll vrimën e hapur, kjo është një punë e prapë dhe e ftohtë.

Kjo botë është burg dhe ne jemi të burgosurit e saj. Shpoje burgun dhe shpëtoje veten!

Ç'është bota? Të jesh indiferent ndaj Zotit! Bota s'është tregti me matje stofrash e numërim parash, s'është femër!

Mallit që fitove për ta shpenzuar në rrugën e fesë, Pejgamberi i ka thënë "ç'mall i mirë!".

Uji brenda në gjemi do të thotë fundosje e gjemisë, kurse uji nën të e ndihmon gjeminë të vozitë!

Ngaqë e nxori dhe e hodhi tej nga zemra dashurinë për mall e pasuri, Sulejmani mbajti një emër të varfër.

Shtamba boshe me grykë të mbyllur voziti mbi ujë në largësi të pakufi sepse kishte brenda ajër!

Ja, pra, kur të jetë i rrethuar nga ajri i varfërisë, njeriu nuk fundoset në detin e kësaj bote, por qëndron mbi të!

Sikur ta ketë pronë të gjithë këtë botë, ajo s'është asgjë para syve të tij!

Atëherë, mbushe zemrën me ajrin e madhështisë së diturisë hyjnore dhe mbylle gojën, vulose!

E drejtë është edhe puna, e drejtë është edhe gëzimi, e drejtë është edhe dëshpërimi. Mohuesi ngul këmbë në mohimin e punës për këdo!"

Pëlqimi i punës ndaj dorëzimit.

Në arsyetimin e kësaj, luani solli shumë prova. Deterministët u bindën nga përgjigjja e luanit.

Dhelpra, dreri, lepuri dhe çakalli e lanë besimin në shtrëngimin (determinizmin) dhe në thashethemet.

Për të mos u dëmtuar në këtë besëlidhje, bënë betime bashkë me luanin e kreshpëruar!

Çdo ditë atij do t'i shkonte kësmeti dhe, kështu, luani nuk do të kishte nevojë për ndonjë iniciativë tjetër.

Pastaj, kush e kishte radhën, vraponte për tek luani pa bërë fjalë.

Mirëpo, sapo i erdhi radha lepurit, ai bërtiti: "Pse kjo padrejtësi kaq e madhe?"

Kafshët e gjahut i kundërvihen lepurit pse vonoi të shkonte te luani.

Kafshët thanë: "Ka shumë kohë që, duke i qëndruar fjalës së dhënë, flijuam jetën!

O inatçi, mos u bëj shkak që të përmendemi me një emër të keq, edhe luani të mos zemërohet! Ec, ec, shpejt, shpejt!"

Lepuri u përgjigjet kafshëve.

Lepuri u tha kafshëve: "O miq, jepmëni afat dhe, me dredhinë time, edhe ju shpëtoni!

Me dredhinë time të na shpëtojë jeta, kjo dredhi t'u mbetet trashëgim fëmijëve!

Çdo pejgamber e ftoi bashkësinë e vet në një shpëtim të tillë në këtë botë.

Në sytë e popullit, pejgamberët dukeshin të vegjël si bebja e syrit, por ata e kishin parë rrugën e shpëtimit!

Populli i pa pejgamberët të vegjël si beben e syrit, askush s'e kuptoi dot madhështinë kuptimore të bebes së syrit!"

Kafshët i thanë lepurit: "Or gomar, vër vesh! Mbaje veten me aq sa ç'e ke fuqinë, mos e tepro!"

Ç'është kjo fjala jote që edhe më të mirët se ti në këtë botë as që e çuan ndërmend!

Ose u bëre krenar, ose e keqja na ndjek pas. Ndryshe, ç'do t'i vlejë kjo fjalë dikujt si ti?"

Lepuri u përgjigjet kafshëve të gjahut.

Lepuri u tha: "O miq, Zoti ma frymëzoi! Me të vërtetë, një i dobët meritoi një mendim dhe veprim të fuqishëm!

Atë që ia ka mësuar Zoti bletës, s'e dinë as luani, as kuçedra!

Bleta i mbush hojet me mjaltë taze. Zoti i hapi derë atij në atë dije!

A ka elefant që ta dijë se ç'i ka mësuar Zoti krimbit të mëndafshit?

Njeriu prej dheu mësoi dije nga Zoti dhe me atë dije e ndriçoi botën gjer në qiellin e shtatë!

Dhe kështu, megjithëse është aq i verbër sa të dyshojë mbi Zotin, njeriu bëri që engjëjve t'u harrohej emri dhe fama!

Lidhi gojën e adhuruesit gjashtëqindmijëvjeçar, e atij viçi;

Në këtë mënyrë, u bë pengesë që të thithë qumështin e dijes së fesë, që të përsillet rreth atij pallati të lartë e të fortë.

Dijet e njerëzve të ndjenjës, e atyre që i japin vlerë vetëm dukjes, janë lidhëse goje për ata që thithin qumësht nga ajo dije e lartë!

Mbi një centimetërkub të zemrës ra një margaritar i tillë që nuk u është dhënë as detrave, as qiejve!

O ti që i falesh trajtës! Pse ky shqetësim? Shpirti yt i pakuptimtë nuk shpëtoi dot nga trajta!

Po qe se njeriu do të ishte njeri nga trajta, Ahmedi me Ebu Xhehlin do të ishin njëlloj.

Edhe portreti mbi mur i ngjet njeriut. Shih, ç'ka të mangët nga trajta?

Por ajo pikturë e shkëlqyer ka mangët shpirtin. Ec dhe gjeje atë element që gjendet rrallë!

Me t'iu dhënë dorë qenit të shokëve të shpellës, të gjithë luanët në botë e ulën kokën.

Ç'dëm ka trajta e keqe dhe e shëmtuar pasi shpirti t'i jetë zhytur në detin e dritës?

Kalemat nuk e lavdërojnë trajtën. Edhe në librat nuk shkruhen vetitë e trajtës së autorit, por vetitë e personit të tij, si "dijetar, i drejtë", etj.

Zotërues i diturisë dhe drejtësisë... Këto janë vetëm kuptime, nuk mund t'i gjesh diku rrotull teje!

Atributet e Individualitetit (hyjnor) i lëshojnë rreze shpirtit nga dora e Atij që s'është i kufizuar në hapësirë; diellin e shpirtit nuk e nxënë qiejt!"

Dija e lepurit, virtytet dhe dobitë e dijes.

Kjo fjalë nuk ka fund, pra, vër veshin e dëgjoje historinë e lepurit!

Shite veshin e gomarit dhe blij një vesh tjetër, se veshi i gomarit nuk e kupton dot këtë fjalë!

Ec, shih dredhinë e lepurit si të dhelprës, shih se ç'kishte menduar ai dhe si e vu poshtë luanin.

Dija është vula e mbretërimit të Sulejmanit; tërë gjithësia është kufomë, kurse dija, shpirt.

Për shkak të kësaj aftësie, qeniet e detrave, maleve dhe fushave kanë mbetur të dobëta e të paafta ndaj njeriut.

Prandaj luani dhe tigri frikësohen si miu. Prandaj të gjitha kafshët e egra në fushë e në mal rrinë fshehur.

Prandaj peritë dhe djajtë kanë zënë qoshet, secili e ka bërë vendqëndrimin në një vend të fshehtë.

Armiqtë e fshehtë të njeriut janë të shumtë; personi që respekton maturinë, është i mençur.

Janë shumë krijesa të fshehta prej nesh, të bukura e të shëmtuara, që trokasin pandërprerë në portën e zemrës.

Kur të hysh në përrua apo lumë për t'u larë, gjembi në fund të shkakton dëm.

Ç'është e vërteta, gjembi ndodhet i fshehur në fund të ujit, por kur të të ngulet, e kupton se është.

Vuajtjet e frymëzimeve dhe lëkundjeve vijnë nga mijëra vetë, jo nga një vetë.

Nëse dyshon, duro; me t'u ndërruar ndjenjat, i sheh, vështirësia zgjidhet.

Dhe atëherë e sheh se fjalët e kujt ke hedhur poshtë dhe kë e ke marrë për të madh për veten tënde!

Kafshët e gjahut e shqyrtojnë sërish të fshehtën dhe mendimin e lepurit.

Pastaj thanë: "O lepur i shkathët! Nxirre sheshit ç'ke në mendje!

O ti që përfytesh me një luan, që ia hyn zënies, thuaje gjënë që mendon!

Këshillimi i jep njeriut kuptim dhe mendje, mendjet u japin ndihmë mendjeve.

Pejgamberi ka thënë: "O njeri i matur, këshillohu se këshilltari është njeri i besueshëm!"

Lepuri e fsheh sekretin prej tyre.

Lepuri u tha: "Çdo sekret nuk thuhet sepse, thua çift, del tek, thua tek, del çift!"

Po qe se e lavdëron pasqyrën ndër sy, ajo zë menjëherë avull dhe turbullohet dhe tregon turbull.

Mos i lëviz buzët për tri gjëra: për rrugën nga do të kalosh, për paratë që ke dhe për bindjen që ndjek.

Sepse edhe këto tre gjëra kanë shumë armiq. Po të t'i marrë vesh armiku, të ngre pusi.

Po ua the nja dy vetëve, jepu lamtumirën atyre sekreteve! Çdo sekret që i kapërcen dy vetë dhe shkon te i treti, përhapet.

Nëse i lidh dy zogj me njëri-tjetrin, mbeten aty ku ndodhen, mes dhimbjesh.

Fshehtazi bisedojnë se si të shpëtojnë. Mënyra se si këshillohen, i gënjen të tjerët.

Pejgamberi këshillohej johaptazi. Shokët i përgjigjeshin, kurse armiku nuk kuptonte gjë!

Që armiku të mos e marrë vesh punën fund e krye, që të mos ndjejë gjë, mendimin e thoshte me shembuj me nënkuptim.

Dhe ashtu e tregonte ku e kish qëllimin. I huaji nuk nuhaste asgjë nga pyetja e tij, nuk kuptonte asgjë!

Lepuri i punon një rreng luanit dhe del fitues mbi të.

Lepuri e shtyu pak vajtjen te luani, por, më në fund, i shkoi pranë atij me kthetra të fuqishme!

I zemëruar nga vonesa e lepurit, luani gërryente dheun me kthetra dhe bulëronte:

"Unë pata thënë që besa e atyre të poshtërve është boshe, betimet e tyre, të kota; ata nuk qëndrojnë në fjalë!

Zhurma e tyre më la këmbëzbathur. Gjer kur do të më gënjejë ky fat mua? Gjer kur?

Emiri i pamatur mbetet krejt i dobët, sepse, për shkak të kokëtrashësisë, as ç'ka përpara sheh, as prapa."

Rruga, e sheshtë, por në të ka kurthe. Forma e shkrimit, e këndshme, por kuptimi që ka brenda është shterp.

Fjalët dhe shkrimet u përngjajnë kurtheve. Fjalët e ëmbla janë rëra e jetëgjatësisë sonë.

Rëra brenda së cilës bulëzon ujë, gjendet shumë pak; ec atë kërkoje!

* O bir, ajo rërë është njeriu i Zotit. Ai njeri është ndarë nga vetja dhe ka arritur te Zoti.

* Prej tij, uji i ëmbël i fesë bulëzon pa pushim. Të dëshiruarit gjejnë jetë nga ai ujë, zhvillohen, rriten.

* Tjetrën veç atij njeriut të Zotit, dije si ranishte të thatë që vazhdimisht pi ujin e jetëgjatësisë tënde, e shkatërron.

* Kërko urtësi nga njeriu i urtë, me qëllim që me të të bëhesh i aftë për të parë e për të kuptuar.

Kush kërkon urtësi, bëhet burim urtësie, shpëton nga kërkimi dhe inicimi.

Tabela që ruan njohuritë, bëhet një Tabelë e Kujtesës; mendja e tij përfiton nga shpirti, merr frymëzim prej tij.

Ndërsa në fillim mendja është mësues, më pas bëhet nxënës i tij.

Mendja thotë si Xhebraili: O Ahmed, edhe sikur një hap të hedh, digjem!

Ti lërmë mua dhe më tutje ec vetë! O mbret zemre, kufiri im është gjer këtu!"

Ai që mbetet i privuar nga falenderimi dhe durimi për shkak të dembelizmit, di vetëm të thotë se ia ka kapur këmbën shtrëngimi, determinizmi. Ai thotë se aq i ka dhënë Zoti!

Kush pretendon se ndodhet nën shtrëngim, e tregon veten të sëmurë pa qenë i sëmurë. Më në fund, sëmundja e ka ndarë atë nga shëndeti.

Pejgamberi ka thënë: "Sëmurja me shaka sjell me të vërtetë sëmundje dhe, më në fund, ai njeri shuhet si qiri!"

Ç'do të thotë shtrëngim, determinim? Ta lidhësh thyerjen ose ta lidhësh damarin e këputur.

Meqë këmbën s'e theve në këtë rrugë, me kë po tallesh, ku e lidhe këmbën?

Atij që e ka thyer këmbën në rrugën e përpjekjes, i erdhi menjëherë Buraku dhe ai ia hipi.

Kishte ngarkuar urdhrat e fesë, tani hipi vetë... Ishte pranues fermani, u bë i pranuar!

Gjer tani pranonte fermanin e mbretit, e zbatonte, pas kësaj, u jep ferman ushtarëve!

Ndërsa gjer tani ylli i fatit ndikoi mbi të, pas kësaj, ai person u bë urdhërues mbi yllin.

Po qe se ke dyshim për këtë, domethënë se ke dyshim edhe për Ndarjen e Hënës!

O njeri që i përsërit fshehurazi dëshirat dhe iluzionet! Përsërite besimin, vetëm të mos jetë vetëm me gojë!

Për sa kohë që dëshirat dhe iluzionet përsëriten e freskohen, besimi nuk është i freskët. Sepse iluzioni është dryni i portës së besimit!

Ke interpretuar fjalën e virgjër; ti interpreto veten, jo Kur'anin!

E interpreton Kur'anin siç do vetë. Kuptimi i lartë u poshtërua për shkak të interpretimit tënd, hyri në një trajtë kontradiktore.

Pavlershmëria e shkujdesur e interpretimit të mizës.

* Gjendja jote i përngjet asaj mizës së çuditshme, e cila e pandehte veten se diç ishte.

* Qe dehur vetvetiu, pa pirë, thërrmija i qe dukur diell.

* Kishte dëgjuar skifterët të lavdëroheshin dhe kishte thënë: "S'ka dyshim se unë jam feniksi i kohës!"

Duke ngritur kokën si kapiten gjemie mbi një fije kashte të ngulur mes pellgut me shurrë gomari, kishte thënë:

"Unë e kam lexuar historinë e detit dhe gjemisë dhe pata menduar dikur për këtë.

Dhe ja, tani, deti, anija dhe unë, kapiteni i sprovuar i saj!"

Dhe vazhdonte ta ngiste sandallin mbi sipërfaqen e detit! Aq pak ujë asaj i dukej det!

Për mizën, ai pellg shurre ishte pa breg e pa anë, sepse ku e kishte miza atë sy që ta shihte siç ishte?

Bota e saj ishte sa ç'e kishte shikimin. Aq i shihte syri, aq i dukej edhe deti!

Interpretuesi i keq është si miza. Përfytyrimi i saj, shurra e gomarit, kurse interpretimi, fija e kashtës!

Po qe se miza heq dorë nga interpretimi sipas mendjes së vet, fati e bën atë zog parajse.

Kush ka një sy të tillë që nxjerr mësim, nuk mund të jetë mizë, por një person me shpirt të lartë sa të mos jetë i denjë për trajtën!

Luani preket nga vonesa e lepurit.

Si lepuri që përfytet me luanin. Si mund të jetë i denjë shpirti i tij për atë trupin e vogël të tij?

Luani thoshte me zemërim: "Armiku m'i mbylli sytë me fjalë mashtruese.

Hilet e deterministëve më lidhën, shpatat e tyre të drunjta ma lodhën trupin.

Pas kësaj, unë s'ia vë veshin më asaj zhurme. Ato janë vetëm zëra të djajve, të demonëve.

O zemër, mos rri, copëtoji ata, rripjau lëkurën! Se mos janë gjë tjetër ata veç lëkurës!"

Ç'kërkohet të thuhet me lëkurën? Llafe ngjyra-ngjyra si pafta metalike që s'mund të rrinë mbi ujë!

Kjo fjalë është si lëkurë, kuptimi është brendia e saj; kjo fjalë është si kufomë, kurse kuptimi, shpirti.

Lëkura mbulon turpin e brendisë së keqe, kurse bota e fshehtë mbulon brendinë e mirë si pasojë e përpjekjeve të saj.

Po qe se lapsi përbëhet prej ere, kurse letra prej uji, çfarëdo që të shkruash, asgjësohet në vend!

Fjala pa kuptim është është shkrim i bërë mbi ujë. Po shpresove besë prej saj, kthehesh duke kafshuar gishtin nga pendimi.

Era është dëshira dhe pasioni tek njeriu. Po të heqësh dorë nga dëshirat dhe pasionet, të mbetet lajmi nga Zoti, merr lajm prej Tij!

Lajmet e Zotit janë shumë të këndshme, sepse nga kreu në fund janë të përjetshme.

Me përjashtim të madhërisë dhe ligjëratave të pejgamberëve, ligjëratat, madhëritë, emrat, fama e mbretërve ndërron nuk mbetet e përhershme.

Sepse fuqia e mbretërve është nga dëshira dhe pasioni, kurse diploma e pejgamberëve është nga Zoti i lartë e madhështor!

Emrat e mbretërve gërryhen dhe fshihen nga paratë, kurse emri i Ahmedit do të përmendet gjer në kiamet!

Emri i Ahmedit është emri i të gjithë pegamberëve. Kur të kemi njëqind në dorë, do të thotë se edhe nëntëdhjeta është në dorën tonë!

Lepuri dredhon prapë dhe e vonon vajtjen.

Lepuri u vonua shumë për të shkuar te luani. Dredhinë që do t'i punonte, e vendosi vetë.

Pasi u vonua për një kohë të gjatë, u nis për rrugë për t'i thënë luanit nja dy të fshehta në vesh.

Atje ku ndodhet mendja, ka shumë dijetarë. Sa i gjerë është ky det mendjeje!

Kjo trajta jonë vozit në këtë det të ëmbël si enë druri mbi ujë.

Për sa kohë që është bosh, ena ndodhet mbi ujë; me t'u mbushur, fundoset në det.

Mendja është e fshehtë, kurse në shesh duket dhe qëndron një botë. Trajta jonë përbëhet prej dallgës së atij deti ose lagështirës së tij.

Çfarëdo që të përdorë trajta si pretekst për ta arritur atë det, për shkak të atij preteksti, deti e shtyn trajtën më tej.

Për sa kohë që zemra s'e sheh atë që i ka dhënë sekret dhe shigjeta, atë që e ka hedhur larg,

Kujton se e ka humbur kalin, ndërsa kalin që i ka hipur e nget me inat, zemërim dhe nxitim.

Trimi e pandeh kalin të humbur. Kurse kali i ka shpënë para me vrap si era!

Ai i hutuari bërtet, kërkon, portë më portë shkon, shkon në çdo anë dhe pyet:

"Kush dhe ku është ai që ma ka vjedhur kalin?" E pyesin: "Or zot, kjo qenie që ke nën të ndenjura, ç'është?"

Ai thotë: "Vërtet, ky kalë është, po ku, në ç'vend?" I thonë: "O kalorës trim që kërkon kalin, eja në vete!"

Ngaqë ndodhet krejt hapur dhe shumë pranë, shpirti nuk duket. Njeriu është si ena e thatë nga jashtë por e mbushur plot ujë brenda!

E kuqe, jeshile dhe e verdhë... Po të mos e shohësh dritën para se t'i shohësh këto, si mund t'i shohësh këto tri ngjyra?

Por ngaqë mendja jote është humbur brenda ngjyrave, ngjyrat t'u bënë perde që të pengojnë ta shohësh dritën.

Kur u bë natë, ngjyrat u mbuluan dhe atëherë e pe dhe e kuptove se shikimi i ngjyrave bëhet në sajë të dritës.

Po s'pati dritë të jashtme, shikimi i ngjyrave është i pamundur. Kështu është puna edhe me ngjyrën e brendshme të imagjinuar.

Ngjyrat e jashtme shihen me anë të dritës së diellit dhe yllit Arusha, kurse ngjyrat e brendshme, me anë të reflektimit të dritërave sublime.

Edhe drita e dritës së syrit është drita e zemrës. Drita e syrit formohet nga drita e zemrave.

Edhe drita e dritës së zemrës është drita e Zotit që nuk është nga drita e mendjes dhe ndjenjës, që është veç prej tyre.

Natën dritë s'kishte, prandaj ngjyrat nuk i pe. Me të kundërtën e dritës ty t'u bë e qartë përfundimisht se

Në fillim duket drita, pastaj ngjyra. Edhe këtë e di pa lëkundje me anë të të kundërtës së dritës.

Zoti krijoi sëmundjen dhe dëshpërimin me qëllim që, me anë të kësaj kundërvënieje, të formohet kënaqësia e zemrës, që çdo gjë të kuptohet mirë.

Në këto kushte, gjërat e fshehta dalin në shesh me anë të të kundërtave të tyre. Zoti është i fshehtë sepse nuk ka të kundërt.

Në fillim shihet drita, pastaj ngjyra. Sepse e bardha dhe e zeza shfaqen ngaqë janë të kundërta.

Ti e njohe dritën me anë të të kundërtës. E kundërta nxjerr në shesh dhe e tregon të kundërtën.

Në botën e ekzistencës nuk ka të kundërt të dritës së Zotit që të mund të duket hapur.

Shkurt, sytë nuk e shohin dot Zotin, por ai na sheh dhe na njeh ne. Ti shihe këtë në rrëfimin mbi Musain dhe malin Sina.

Trajtën me kuptimin diji si luanin me pyllin, si mendimin me fjalën dhe zërin.

Kjo fjalë, ky zë u formua nga mendimi. Po deti i mendimit ku është? Këtë s'mund ta dish!

Por me të parë një dallgë fjale të bukur, e kupton se ajo është një det me vlerë të lartë!

Kur nga dija shfaqet dallga e mendimit, formohet një trajtë prej kuptimit, fjalës dhe zërit.

Nga fjala lindi një formë që prapë vdiq. Dallga e përçoi veten përsëri në det.

Trajta doli nga mungesa e trajtës dhe u kthye përsëri në mungesë të trajtës. Sepse ne prapë te Zoti do të kthehemi.

Prandaj ti, sa herë që të hapësh e mbyllësh sytë, ringjallesh dhe vdes. Mustafai tha: "Kjo botë përbëhet nga një çast."

Mendimi ynë është një shigjetë në ajër. Si qëndron në ajër? Vjen te Zoti.

Në çdo frymëmarrje, bota rinohet. Por meqë ne e shohim botën sikur mbetet ashtu siç është, jemi të painformuar për këtë rinim.

Jeta rrjedh si ujë nga e reja tek e reja, por duke treguar një vazhdimësi tek kufoma.

Nëse shkopi me majë të zjarrtë që ti e lëviz shpejt në ajër, tregon një vijë zjarri të pandërprerë, edhe jeta duket si vazhdimësi ngaqë kalon shpejt.

Po vazhdove ta lëvizësh shkopin me zjarr, duket shumë i gjatë në syrin tënd. Edhe gjatësia e jetës duket nga krijimi i shpejtë i Zotit.

Krijimi që bën Zoti nga e para dhe me shpejtësi e tregon jetën të gjatë e të vazhdueshme.

Kush dëshiron ta dijë këtë të fshehtë, edhe sikur të jetë një dijetar i madh dhe i thellë, nuk mund ta dijë nga e vetja. Thuaji atij: Ja, këtu është Husameddini! Nga ai mësoje se ai është një libër i lartë!

Lepuri shkon te luani, Luani nxehet me lepurin.

Luani u nxeh keq, u ashpërsua. Por pa nga larg se lepuri po vinte.

Me një qëndrim të pafrikë dhe mendjemadh, po vraponte i zemëruar, i ashpër, i nxehur, me fytyrë të varur.

Nga mënyra e ardhjes si i prekur dhe i ndjeshëm, kuptohej një ndjenjë faji, por guximi e fshihte çdo lloj dyshimi.

Kur iu afrua luanit, ai i bërtiti: "O barktharë!

Unë që i kam bërë elefantët copë-copë, unë që ua kam hequr veshin luanëve burra!

Si ndodh që një copë lepur të marrë nëpër këmbë urdhrin tim?

Lëri përgjumjen dhe shkujdesjen prej lepuri! Or gomar, dëgjoje bulërimën e luanit!"

Lepuri paraqet justifikim dhe e mashtron luanin.

Lepuri tha: "Po qe se zotëria ynë na fal, do të kërkoj mëshirë se kam justifikim!"

Luani i tha: "O i fundmi i kokëtrashëve! Ç'justifikim është ky? A në këtë kohë vihet në audiencë te mbreti?

Ti je gjel që këndon pa kohë, duhet të të pritet koka! Justifikimi i kokëtrashit nuk dëgjohet!

Justifikimi i kokëtrashit është më i keq se faji i tij. Justifikimi i injorantit është helmi i çdo dijeje!

O lepur! Në justifikimin tënd nuk ka dije. Unë nuk jam lepur që të më flasësh në vesh!"

Lepuri i tha: "Imzot, çmoje si burrë edhe atë që s'është burrë! Vërja veshin justifikimit të viktimës së dhunës dhe padrejtësisë!

Sidomos si lëmoshë të pozitës tënde, atë që e ka humbur rrugën mos e përze nga rruga jote!

Edhe deti që u jep ujë të gjithë lumenjve, çdo mbeturinë e bart mbi krye!

Eshtë kjo bujari për shkak të së cilës deti nuk pakësohet; për shkak të mirësisë, nuk qortohet!"

Luani i tha: "Unë bëj mirësi ku duhet dhe për atë që e meriton; secilit ia pres rrobën sipas trupit!

Lepuri i tha: Po qe se s'e meritoj favorin, ja tek vura kokën para kuçedrës dërrmuese! Bëj ç'të duash!

Unë dola në rrugë paradite; po vija këtu, te mbreti im, bashkë me shokun tim!

Lepujt më kishin dhënë një shok rruge për të ta sjellë ty!

Një luan mashkull na ra në qafë të dyve tek po ecnim në rrugën tonë!

Unë i thashë: "Ne jemi robtë e mbretit të mbretërve! Ne jemi dy të përkushtuar të portës së tij!"

Kurse ai na tha: "Turp të kesh, or ti! Kush na qenka ky mbreti i mbretërve? Mos e përmend para meje emrin e një njeriu të tillë të paqenë!

Po qe se bën edhe dy hapa më tej, edhe ty, edhe atë mbretin tënd do t'ju bëj copë-copë!"

"Lërmë mua t'ia shoh edhe një herë fytyrën mbretit tim e t'i them për ty!"

Ai më tha: "Shokun lëre peng këtu se ti, sipas ligjeve të mia, je kurban!"

E lutëm shumë, por pa dobi. Ma rrëmbeu shokun e më la vetëm!

Shoku im ishte sa tri herë unë edhe si shëndet, edhe si bukuri!

Këtej e tutje, kjo rrugë është mbyllur nga ai luan; për shkak të një armiku të tillë, imzot, rruga është e zënë!

Pas kësaj, preje shpresën nga pagesat. Unë po të flas drejt, fjala e drejtë është e hidhur!

Po deshe pagesa, pastroje rrugën! Eja, zhduke prej aty atë të pamarrëvesh!"

Luani i përgjigjet lepurit dhe shkon së bashku me të.

Luani i tha: "Bismil'lah, pa eja, të shohim, ku është ai? Nëse flet drejt, më prij!

Edhe atë ta ndëshkoj, edhe njëqind të tjerë si ai! Por po qe se kjo fjala jote është gënjeshtër, do të të ndëshkoj ty!"

Për ta lëshuar luanin në kurthin që i kishte ngritur, lepuri doli para si kallauz!

Dhe dolën në rrugë drejt një pusi që lepuri i kishte vënë nishan. Ishte një pus shumë i thellë!

Që të dy iu afruan vendit ku ndodhej pusi. Ja, pra, një lepur dhelparak që ta fut ujin nën rrogoz!

Uji e çon fijen e kashtës në fushë, por malin, si e rrokullis, vallë?

Dredhia e lepurit ia hodhi lakun luanit! Sa e çuditshme që lepuri gjuan luanin!

Një Musa e vret duke e mbytur në lumin Nil Faraonin me gjithë ushtri!

Një mushkonjë me gjysmë krahu e pickon trurin mu brenda në kokë!

Kështu e pëson ai që ia dëgjon fjalën armikut! Shihe gjobën e mikut të smirëziut!

Kështu e ka pësuar Faraoni që dëgjoi Hamanin, Nemrudi që dëgjoi Djallin!

Sado miqësisht të të flasë armiku, sado që të të bëjë fjalë për dhurata, dije se po të ngrë kurth!

Po të dha sheqer, dije se është helm; po të bëri një të mirë, dije se është e keqe!

Kur të ndodhë e keqja, s'sheh dot gjë tjetër veç lëkurës, s'i ndan dot miqtë nga armiqtë!

Meqë puna qëndron kështu, fillo të lutesh, të qashë e të rënkosh; vazhdo ta madhërosh Zotin e të agjërosh!

Zoti ynë, ti e di të fshehtën! Mos merr shpagim prej nesh për shkak të mëkateve tona!

O ti që i ke krijuar luanët! Po qe se ne kemi bërë qenëri, mos i lësho nga kjo pusí luanët kundër nesh!

Mos i jep ujit të mirë formën e zjarrit dhe zjarrit mos i jep freskinë e ujit!

Zoti ynë! Nëse ti e deh njeriun me verën e persekutimit, gjërave të paqena u jep trajtë të qene duke i treguar sikur ekzistojnë!

Ç'është dehja? Lidhja e syve, verbimi sa për t'u dukur guri xhevahir, leshi mëndafsh!

Ç'është dehja? Ndërrimi i ndijimeve aq sa të duket dushku plep!

Historia e Sulejmanit
i cili na bën të ditur se, kur fati bëhet fakt, edhe sytë e ndriçëm s'shohin dot!

Sapo u ngrit çadra e madhe mbretërore e Sulejmanit, të gjithë zogjtë iu paraqitën.

E gjetën atë një person që ua kuptonte gjuhën, që ua dinte sekretin, prandaj vrapuan me gjithë zemër për tek ai!

Të gjithë zogjtë e lanë këngën dhe nisën të bisedonin me Sulejmanin me një gjuhë më të qartë se ajo me të cilën bisedon ti me tët vëlla!

Folja e të njëjtës gjuhë është afërsi, është lidhje shpirtërore. Kur njeriu mbetet me të huaj, i ngjet të burgosurit!

Sa indianë e sa turq folën të njëjtën gjuhë! Dhe sa e sa turq mbetën të huaj për njëri-tjetrin!

Prandaj gjuha e intimitetit është gjuhë krejt tjetër. Përbashkësia e zemrës është më e mirë se përbashkësia e gjuhës.

Nga zemra shfaqen qindramijëra përkthyes pa fjalë, pa shenja, pa shkrim!

Të gjithë zogjtë ia thoshin krejt hapur Sulejmanit të gjitha sekretet, të gjitha gjërat mbi aftësitë, njohuritë dhe punët e tyre

Dhe lavdëroheshin për t'ia bërë të njohur veten.

Ky lavdërim nuk ishte nga mendjemadhësia, nga qenia e tyre. Çdo zog lavdërohej me qëllim që të arrinte pranë tij, që të ishte ndër të afërmit e tij!

Po qe se një skllav dëshiron t'i bëhet skllav një zotërie, ia paraqet atij një pjesë të aftësive,

Kurse po të mos dëshirojë që ai ta blejë, e tregon veten të sëmurë, shurdh, cung dhe topall.

I erdhi radha zogut lajmëtar të paraqiste mjeshtërinë e vet, t'i bënte të ditura artin dhe mendimet e veta.

Dhe tha: "O padishah, të ta parashtroj shkurt një mjeshtërinë time më të vogël! E thëna shkurt është më e mirë!"

Sulejmani i tha: "Thuaje, ta marrim vesh, ç'mjeshtëri është kjo?" Zogu lajmëtar i tha: "Kur fluturoj në lartësi,

Prej në ajër e shoh ujin mu në fund të dheut.

Dhe i marr vesh të gjitha: Ku është ai ujë, sa i thellë është, ç'ngjyrë ka, a buron nga dheu apo nga guri?

O Sulejman! Merrmë me vete kur ke për të shkuar për të caktuar vendin se ku do të ngresh fushim për ushtrinë!"

Dhe Sulejmani i tha: "O bashkudhëtar i mirë! Bënau shok në shkretëtirat pa ujë e pa fund, gjena ujë dhe, kështu, nëpër fushata, u bëhesh shokëve saka!"

Sorra flet kundër zogut lajmëtar.

Kur i dëgjoi këto fjalë, sorrën e kapi një zili e marrë dhe i tha Sulejmanit: "Ky zog foli të kundërtën dhe bëri keq!"

Të flasësh në prani të padishahut është kundër edukatës. Pa le sikur të gënjesh e të thuash gjëra që s'bëhen!

Sorra vazhdoi: "Po qe se ky do të kishte një shikim të tillë, si s'do ta kishte parë kurthin një pëllëmbë nën dhé, si do të kishte rënë në kurth?"

Si do ta lejonte ta kapnin e të mbyllej i pashpresë në kafaz?

Atëherë, Sulejmani tha: "O zogu lajmëtar! A është e drejtë kjo? A ta pranon mendja këtë?

O ti që pi dhallë! Si ndodh që e tregon veten sarhosh dhe thua para meje fjalë që do të dalë gënjeshtër?"

Zogu lajmëtar i jep përgjigje akuzës së sorrës.

Zogu lajmëtar i tha: "Padishahu im! Për dashuri të Allahut, mos e dëgjo fjalën e armikut për këtë të varfër e të zhveshur!"

Po qe se paskam thënë gënjeshtër, ja ku ta vura kokën, prema! Sorra që e mohon vendimin e fatit, sikur një mijë mendje të ketë, prapë është mohuese, qafir!

Po qe se te njeriu ndodhet qoftë edhe një shkronjë nga fjala mohues, qoftë edhe një shenjë epshi nga femrat e fëlliqura, vjen erë të keqe, bëhet i fëlliqur!

Po qe se fati s'ma mbyll syrin dhe mendjen, kurthin e shoh që në ajër.

Por kur vjen çasti që të bëhet ajo që është shkruar, mendja bie në gjumë, hëna nxihet, dielli zihet!

A mos është e rrallë kjo lojë e fatit? Edhe ata që e mohojnë fatin e shkruar dhe zbatimin e tij, mohimin e kanë për fat!

Historia e profetit Adem; atij ia mbyll sytë fati dhe e zbaton urdhrin pa e menduar, pa bërë fjalë.

Zotëruesi i "emrave të gjithësisë", ati i njerëzimit i cili kishte qindramijëra dije në çdo damar të tij,

Dinte emrin e çdo gjëje siç e kishte dhe ishte bërë i njohur me çfarë do të ndodhte gjer në fund.

Ç'cilësi t'i ketë dhënë materies ai, ashtu ka dalë; kë ka quajtur të shkathët, nuk ka dalë dembel!

E pa që në fillim personin që në fund do të bëhej besimtar; iu bë i qartë edhe personi që në fund do të bëhej mohues, qafir!

Emran e çdo gjëje dëgjoje nga ai që e di; dëgjoje të fshehtën e simbolit "emrat e gjithësisë".

Sipas nesh, emri i çdo gjëje i përshtatet pamjes; si të duket gjëja, ashtu e emërtojmë ne. Por sipas Zotit, i përshtatet përmbajtjes, të vërtetës së saj.

Sipas Musait, emri i shkopit të tij ishte "shkop", kurse për Krijuesin, "kuçedër"!

Në këtë botë, dikur, emri i Omerit ishte "idhujtar", mirëpo qysh në "Elest", ai ka qenë emërtuar "besimtar"!

Gjëja që ne e quajmë spermë, te Zoti ka qenë një vete me trajtën e saj të caktuar.

Kjo spermë ka ekzistuar në botën e mosqenies; ajo ekzistonte në dijen e Zotit identikisht as më pak e as më shumë.

Shkurt, ne kemi marrë në të vërtetë atë emër që ka emërtuar fundin tonë sipas dijes së Zotit!

Zoti i vë njeriut një emër sipas fundit të tij, jo sipas emrit të përkohshëm që i vë populli.

Meqë syri i Ademit shihte me anë të dritës së pastër të Zotit, atij iu bënë të qarta e vërteta dhe përmbajtja e emrave.

Kur engjëjt panë tek ai dritën e Zotit, që të gjithë ranë me ballin në tokë para tij!

Edhe sikur ta lavdëroj gjer në kiamet këtë Ademin që po ia përmend emrin, sikur t'ia numëroj vetitë, prapë mbetem i paaftë për ta bërë këtë gjë.

Ademi i diti të gjitha këto. Por kur i erdhi e shkruara, ra në gabim ngaqë e dinte të ndaluarën.

Vallë, ky ndalim, pse është haram (i pabekuar), apo për të frikësuar?

Me t'i dhënë përparësi interpretimit sipas zemrës, natyra e shtyu të vraponte pas grurit.

Me t'i hyrë kopshtarit gjemb në këmbë, vjedhësi gjeti rast, mori atë që i takonte dhe iku!

Kur Ademi shpëtoi nga habia dhe hyri sërish në udhë, pa se vjedhësi e kishte marrë gjënë nga vendi dhe kishte ikur!

Dhe nisi të ofshajë duke thënë "Rabbena inna dhalemna", "Zoti ynë mos na bëj të padrejtë". Pra, tha: "Ra errësira, udha u humb!"

Kjo e shkruar është një re që mbulon diellin. Edhe luani dhe kuçedra, bile, ankohen dhe klithin prej saj!

Po qe se shfaqet dhe hyn në veprim e shkruara dhe unë nuk shoh dot as edhe një kurth, unë s'jam i vetmi injorant në këtë rrugë!

Ç'njeri i bekuar është ai që, duke lënë shtrëngesën, vihet të klithë e të vajtojë! Ai është kapur pas një pune të mirë!

Po qe se e shkruara të rrethon si nata, fundi i fundit është prapë ajo që ka për të të kapur dore!

Edhe sikur njëqind herë të të vrasë, prapë është e shkruara është ajo që të jep jetë dhe shërim!

Edhe sikur njëqind herë të ta presë rrugën, prapë ta ngre çadrën mu sipër qiejve!

Për të të çuar ty te vendi i sigurisë, këtë frikësim dije mirësi!

Kjo fjalë s'ka fund; e, pra, dhe mjaft u zgjat! Dëgjoje, tani vazhdimin e historisë së lepurit me luanin!

Kur u afruan te pusi, lepuri u tërhoq pas.

Kur arritën te pusi, luani pa se lepuri kishte mbetur pas.

Dhe i tha: "Pse e hoqe këmbën pas? Mos u praps, po ec para!"

Lepuri ia ktheu: "Ku e kam këmbën? Duar e këmbë m'u prenë, shpirti më dridhet si ndër ethe, zemra më ka luajtur vendit!"

A s'po ma sheh ngjyrën e fytyrës? Si e verdhë ari! Ngjyra e saj tregon se në ç'gjendje ndodhem!

Zoti e ka quajtur fytyrën "treguese". Prandaj syri i arifëve është kredhur në fytyrë e ka mbetur!

Ngjyra dhe era njoftojnë si këmbana; hingëllima e kalit njofton për praninë e kalit.

Që ta dallosh zërin e gomarit nga zëri i derës, zërat janë të ndryshëm dhe tregojnë për gjënë që i përkasin.

Në lidhje me dallimin e njerëzve, Pejgamberi ka thënë se "njeriu është i fshehur te fjala e vet"!

Në ngjyrën e fytyrës ka shenjë për gjendjen e zemrës. Të të vijë keq për mua, mbaje dashurinë time në zemër!

Fytyra e kuqe tregon për mirëqenien dhe lumturinë e të zot; fytyra e verdhë tregon se i zoti ndodhet në vështirësi e vuajtje.

Arrita te ai që më mori duar e këmbë, që ma fluturoi ngjyrën e fytyrës, që më la pa fuqi, që ma prishi çehren!

U përplasa me atë që e pret kë t'i dalë para, që i shkul pemët me rrënjë.

Hasa në atë që i mposht njerëzit, kafshët, gurët e drurët!

Këto janë pjesë të së përgjithshmes, por edhe e përgjithshmja është zverdhur dhe prishur për shkak të tij!

Kur bota këtu duron e atje falenderon, kopshtet e vreshtat këtu vishen, atje mbeten lakuriq!

Dielli lind në ngjyrë zjarri dhe pastaj, më vonë, perëndon.

Yjet që shkëlqejnë në qiell, herë pas here digjen.

Edhe hëna që shkëlqen në bukuri më shumë se yjet, kapet nga sëmundja e veremit dhe mbetet si një drapër i hollë!

Edhe këtë vend shumë të qetë e me edukatë, tronditja e lëshon në ethe.

Sa e sa male, si pasojë e kësaj fatkeqësie të papritur, janë shpërndarë mbi dhé si rërë!

Edhe ajri që i ngjet shpirtit, kur i vjen e shkruara, bëhet si i sëmurë kolere, prishet.

Uji i kulluar që është motër e shpirtit, në një liqenth zverdhet, hidhërohet dhe turbullohet.

Edhe zjarrin tërë madhështi e mendjemadhësi, madje, një fllad e shuan!

Edhe gjendjen e detit, nga ankthi, nga vrulli kuptoja dhe dije se mendja ndryshon, se hyn nga kallëpi në kallëp!

Edhe gjendja e qiellit që i merren mendtë duke kërkuar pëlqimin e Zotit, është si gjendja e bijve:

Sa më poshtë fare, sa në mes, sa më në majë! Edhe në të ka turra-turra kohë të bekuara e keqndjellëse!

O ti që je përzjerë te e përgjithshmja, te shumica, o njeri! Edhe gjendjen e trupave të thjeshtë krahasoje me veten tënde!

Kur e përgjithshmja ka sëmundje dhe vuajtje të tilla, fytyra e pjesëve si nuk zverdhet?

Pa le pjesa e formuar nga gjërat që janë të kundërta me njëra-tjetrën: uji, dheu, zjarri dhe ajri...

Nuk është çudi pse delja ikën nga ujku; është çudi po t'ia japë delja zemrën ujkut!

Shëndeti është paqja e të kundërtave. Dije se fillimi i luftës mes tyre është vdekje!

Favori i Zotit ka dhënë afërsi bese mes luanit dhe gomarit të egër, mes këtyre dy të kundërtave.

Kur bota të jetë e sëmurë dhe e burgosur, a bëhet çudi që i sëmuri është i vdekshëm?

Duke i dhënë këshilla të tilla luanit, lepuri i tha: "Për këto shkaqe mbeta unë pas!"

Luani e pyet seriozisht lepurin se cili ishte shkaku që e tërhoqi këmbën pas.

Luani i tha: "Ti lëri këto shkaqe dhe më thuaj shkakun pse e tërhoqe këmbën pas. Këtu e kam hallin unë!"

Lepuri i tha: "Ja, te ky pusi rri ai luani; i sigurt nga të gjitha fatkeqësitë brenda kësaj kështjelle!"

Njeriu me mend në kokë zgjedh fundin e gropës për të ndenjur, pasi në vetmi e gjen kënaqësinë e zemrës!

Errësira e pusit është më e mirë se errësirat ku të fusin njerëzit. Kush zë këmbën e popullit, kush përzihet e takohet me njerëzit, s'e ka shpëtuar dot kokën, s'e ka arritur dot paqen.

Luani i tha: "Ec para! Plaga që do t'i hap unë, ka për të qenë fundi i tij! Pa shihe, ai luani a është atje?"

Lepuri i tha: "Unë jam djegur një herë nga ai zjarr!

Por po të më marrësh në prehër, o minierë bujarie, vetëm atëherë më hapen sytë dhe mund të shoh në fund të pusit!"

Luani vështron fundin e pusit dhe sheh atje reflektimin e vetes me lepurin.

Luani e mori lepurin në prehër dhe shkuan së bashku gjer te pusi.

Sapo luani vështroi fundin e pusit, atje shndërritën figurat e tij dhe të lepurit.

Luani pa në ujë një luan me një lepur të ngjallmë në prehër.

Sapo e pa armikun në ujë, e lëshoi lepurin dhe u hodh brenda.

Dhe ra në gropën që kishte përgatitur vetë! Padrejtësia dhe dhuna që kish bërë gjer atëherë, i ranë mbi krye!

Padrejtësia dhe mizoria e mizorëve është një gropë e errët. Të gjithë dijetarët kanë thënë kështu:

Gropa e më mizorit është më e frikshmja. Drejtësia është t'i jepet më të keqit dënimi më i rëndë!

O ti që me mizorinë tënde ke hapur një gropë! Ti po përgatit një kurth për vete!

Mos e thur veten nga të gjitha anët siç bën krimbi i mëndafshit! Po qe se gërryen një gropë për vete, bëje këtë punë i vendosur!

Mos i pandeh të dobëtit pa njeri, pa ndihmë! Këndo nga Kur'ani pjesën "Kur erdhi ndihma e Allahut dhe..."!

Po qe se ti je elefanti dhe armiku është frikësuar prej teje, ja tek të vijnë zogjtë Ebabil për të të ndëshkuar!

Po qe se mbi tokë një i dobët kërkon ndihmë, ushtarët e qiellit nxitohen duke u ngatërruar me njëri-tjetrin.

Po qe se ti e kafshon dikë me dhëmbë dhe e përgjak, po të të zërë dhimbja e dhëmbit çfarë bën?

Kur e pa luani veten në pus, nga zemërimi, në atë çast, nuk e ndau dot veten nga armiku!

Pasqyrimin e vet në ujë e pandehu për armik, shkurt, ia nguli shpatën vetes!

O njeri! Shumë padrejtësi dhe mizori që sheh te njerëzit, janë vesi yt; ti e sheh vesin tënd tek të tjerët!

Qenia jote, dyfytyrësia jote, mizoria jote, moskokëçarja jote është reflektuar tek ta.

Ti je tek ata, ti je duke plagosur veten! Në atë çast je duke e thurur vetë për veten tënde gjalmën e mallkimit!

Ti nuk e sheh hapur te vetja jote atë të keqe. Po ta shihje, do të bëheshe me gjithë zemër armik i vetvetes!

O kokëtrashë! Si ai luani që u hodh kundër vetvetes, edhe ti po e sulmon vetveten!

Po qe se arrin ta shohësh simbolin e moralit të kësaj dhe ta kuptosh të vërtetën e kësaj, e merr vesh se të keqen e ke prej vetes!

Në fund të pusit e kuptoi luani se luani në ujë ishte ai vetë!

Ai që i shkul dhëmbin të dobëtit, bën po atë gjë që bëri luani që s'pa qartë!

O ti që sheh një nishan të keq në fytyrën e tjetrit! Gjëja që sheh është reflektim i nishanit tënd, mos u neverit prej tij!

"Besimtarët janë pasqyrë e njëri-tjetrit". A s'e kanë përcjellë këtë fjalë prej Pejgamberit?

Para syve ke vënë një xham ngjyrë qielli, prandaj bota të duket qiell!

Nëse s'je qorr, këtë verbëri dije prej vetes! I keq thuaji vetes, jo tjetrit!

Po qe se besimtari nuk do të kishte parë me dritën e Zotit, si do t'i bëhej e dukshme e fshehta besimtarit në tërë lakuriqësinë e saj?

Por, ngaqë ti sheh jo me dritën e Zotit, por me zjarrin e Tij, mbete te e keqja, mbete indiferent ndaj së mirës!

Nuk e ndave dot të mirën nga e keqja dhe mbete indiferent edhe ndaj së mirës, edhe ndaj së keqes!

O njeri i kredhur në vuajtje e mjerim! Spërkat pak nga pak dritë në zjarr që zjarri të të kthehet në dritë!

O Zot, spërkate dhe ti atë ujë të pastër që ky zjarr që e ka përfshirë botën të bëhet krejtësisht dritë!

Uji i detit është vazhdimisht nën urdhër; o Zot, edhe uji i yti është, edhe zjarri!

Po deshe ti, zjarri bëhet ujë i kulluar; po deshe, uji, madje, kthehet në zjarr!

Edhe këtë lutjen tonë ti je duke na e frymëzuar. Shpëtimi ynë nga padrejtësia dhe dhuna është mirësia jote!

Ç'na ke dhënë, na i ke dhënë pa t'i kërkuar; na ke bërë të mira pa masë e pa numërim!

Lepuri u çon kafshëve të gjahut sihariqin se luani ra në pus.

Duke u gëzuar që shpëtoi, lepuri vrapoi në fushë te kafshët.

Pasi e pa që luani ngordhi në pus, lepuri shkonte drejt livadheve duke hedhur valle.

Ngaqë shpëtoi nga kthetrat e vdekjes, nuk i zinte këmba dhé, qeshte, këndonte e lodronte!

Pasi mbijnë duke shpëtuar nga burgu i tokës, kërcenjtë dhe gjethet e bimëve ngrenë kokën lart dhe bëhen shokë me erën.

Pasi e çajnë sythin dhe dalin jashtë, gjethet rriten me shpejtësi dhe e mbushin pemën gjer në majë!

Çdo gjethe e çdo frut, me gjuhën e sythit shqiptojnë falenderimet e tyre për Zotin.

Dhe thonë: Zoti mirëbërës e zhvilloi farën tonë, pastaj filizin, trungu i pemës sonë u trash dhe u rrit përpjetë.

Edhe gjallesat që ndodhen mes ujit dhe baltës, kur shpëtojnë prej llucës, me zemrën plot gëzim,

Vallëzojnë në atmosferën e dashurisë për Zotin, të bukura si hëna pesëmbëdhjetë!

Trupat u lodrojnë, po shpirtrat? Mos pyet se s'tregohet dot!

Lepuri e futi luanin në burg. Ç'turp për luanin! U tregua më i dobët se një lepur!

Ndërsa u turpërua në këtë mënyrë, e çuditshme është se kërkon ta thërresin Fahreddin, krenari e fesë!

Or ti! Ti je një luan i burgosur në fund të pusit të kësaj bote. Si të shkatërroi nefsi yt si lepur?

Nefsi yt lepur tani po ha e pi e po bën qejf në fushë, kurse ti ndodhesh në fund të pusit të thashethemeve, polemikave dhe grindjeve!

Lepuri gjahtar luanësh vrapoi te vendi ku ndodheshin kafshët e gjahut dhe u tha: Përgëzojeni njëri-tjetrin! Ju erdhi lajmi i mirë!

Sihariq, o ju të kredhurit në dëfrime! Sihariq se ai qen xhehennemi shkoi në xhehennemin nga erdhi!

Sihariq! Zoti ia shkuli dhëmbët atij armiku të shpirtit! Armikun që pati shtypur aq koka me kthetrat e tij, fshesa e vdekjes e fshiu si plehër!

Kafshët e gjahut mblidhen rreth lepurit dhe e lavdërojnë!

Atëherë, të gjitha kafshët, të gëzuara, duke qeshur e luajtur, e puthën lepurin mu në ballë!

Dhe u bënë rreth përqark tij. Ai ndodhej mes tyre si pishtar. Të gjitha kafshët që ndodheshin në fushë, ranë në gjunjë para lepurit.

Dhe i thanë: A mos je engjëll i zbritur nga qielli, apo perí? Jo, s'je as engjëll, as peri! Ti je Azraeli që u rrëmben shpirtrat luanëve burra!

Po kushdo që të jesh, t'u bëfshim kurban! A fitove mbi të? Të lumshin duar e këmbë!

Zoti e lëshoi këtë ujë nga harku yt. Të lumshin duar e këmbë!

Na thuaj edhe një herë! Si e binde atë ta hajë hilen tënde? Si e shkatërrove atë mizor në kurthin që i ngrite?

Thuaje edhe një herë që rrëfimi yt të bëhet shërim për hallet, mëshirë për shpirtrat!

Thuaje edhe një herë se na dhembin qindramijëra plagë që na ka hapur ai mizor!

Lepuri u tha: "Zotërinj! Zoti më ndihmoi, ndryshe ç'mund të bëjë një lepur në këtë botë?

M'i dha fuqi krahut, m'i dha qëndresë zemrës, m'i hodhi në prehër hyrì e xhennet!

Epërsia vjen prej Zotit, edhe ndryshimet e gjendjeve prej Tij janë!"

Lepuri i porosit kafshët që të mos gëzohen shumë.

Zoti ua tregon fuqinë, forcën dhe epërsinë me radhë atyre që kanë dyshim dhe atyre që janë të vendosur në besim!

O ti, që të ka ardhur radha për të mirë! Eja në vete, mos u gëzo! Ti je i lidhur pas radhës, mos pretendo për liri!

Ata që e kanë mbretërimin jashtë radhe, që e kanë suksesin të përjetshëm, i bien daulles së radhës në një vend mbi shtatë yje!

Ata që qëndrojnë jashtë radhës, janë mbretër të përhershëm; ata u japin ujë shpirtrave vazhdimisht.

Nja dy ditë po e le pirjen e ujit, e fut gojën në verën e përjetësisë, pi atë verë të së vërtetës!

Kuptimi i fjalës "Po kthehemi nga lufta e vogël për në luftën e madhe!"

O sundimtarë! E vramë armikun e jashtëm, kurse brenda vetes kemi një armik shumë më të keq se ai!

Vrasja e tij s'është punë me mend! Luani brenda nuk është i tillë që të mund të tallet një lepur me të!

Xhehennemi është vetvetja jonë. Xhehennemi është një kuçedër që furinë nuk ia pakësojnë dot as detet!

Pi shtatë dete dhe prapë, furia dhe entuziazmi i nefsit (vetvetes) që i përngjet një shtrige plakë, nuk pakësohen.

Gurët, mohuesit zemërgurë hyjnë në xhehennem të turpëruar duke qarë e rënkuar.

Megjithëkëtë, pa i ardhur ky zë nga Zoti, s'ngopet as me kaq mundim!

E pyesin: "A u ngope?" Si ujk dhe çakall, ai përgjigjet: "Jo, nuk u ngopa!" Ja, pra, ç'zjarr, ja, pra, ç'nxehtësi!

Edhe sikur ta gëlltisë tërë gjithësinë si një kafshatë, stomaku i bërtet: "A s'ka edhe më?"

Më në fund, Zoti vë mbi të këmbën nga bota e pakufizuar në hapësirë dhe atëherë ai menjëherë qetësohet!

Edhe nefsi. vetvetja jonë është një copë e xhehennemit. Prandaj, pjesët kanë gjithmonë natyrën e së tërës!

Edhe këmba që mund ta vrasë nefsin është vetëm këmba e Zotit. Fundja, kush mund ta tërheqë harkun kundër nefsit përveç Zotit?

Harkut i vënë shigjetë të drejtë. Kurse ky hark ka edhe shigjeta të shtrembra.

Bëhu i drejtë si shigjeta dhe shpëto nga harku, sepse nuk ka dyshim se çdo shigjetë e drejtë fluturon nga harku!

Pasi shpëtova nga lufta e jashtme, ia nisa luftës së brendshme.

Ne tani u kthyem nga lufta e vogël; së bashku me Pejgamberin, ndodhemi në luftën e madhe!

Nga Zoti kërkoj një fuqi që të çajë detet, në mënyrë që me një gjilpërë ta shkul nga vendi këtë mal përrallash e ta hedh tutje!

Dije se është e lehtë të luftohet me luanin që i prish dhe i shpërndan radhët; luan i vërtetë është ai që e mund vetveten!

Tani dëgjo një histori për këtë çështje dhe nxirr mësim nga fjala ime!

Ambasadori i perandorit të Bizantit shkon te kalifi Omer dhe sheh mrekullitë e tij.

Pas një rruge të gjatë, një ambasador i perandorit të Bizantit arriti te kalifi Omer në Medine.

Dhe i pyeti banorët e Medines: "Ku është pallati i kalifit që t'i lë atje kalin dhe plaçkat?"

Njerëzit i thanë: "Ai s'ka pallat. Pallati i tij është vetëm shpirti i tij i ndritshëm!"

Vërtet, atij i është dëgjuar emri si emiri i muslimanëve ose kalif, por ai ka vetëm një kasolle si të të varfërve!

Vëlla, si mund ta shohësh pallatin e tij? Ty të ka mbirë lesh në syrin e zemrës!

Pastroje syrin e zemrës nga qimet dhe sëmundjet, pastaj vëzhgo ta shohësh pallatin e tij.

Kush ta ketë pastruar shpirtin nga pasionet dhe iluzionet, e sheh menjëherë selinë e pastër të Zotit!

Meqë Muhammedi ishte pastruar nga ky zjarr e nga ky tym, ngado që ta kthente fytyrën, shihte bukurinë e Zotit!

Po qe se ti bëhesh shok me dyshimet dhe lëkundjet që të shtyjnë në të këqija, si mund ta njohësh fytyrën hyjnore?

Tek zemra e kujt të hapet një portë, në qiellin e zemrës së vet ai sheh qindra diej.

Ashtu siç duket hëna mes yjeve, edhe Zoti duket mes të tjerëve!

Por vëri dy gishtat mbi dy sytë: a mund të shohësh gjë? Mjaft më!

Edhe pse s'sheh ti, s'do të thotë se bota s'ekziston! E meta është vetëm te gishti i nefsit që mbyll syrin!

Pra, eja në vete, hiqe gishtin nga syri dhe shih ç'të duash!

Fisi i Nuhut e pyetën Nuhun: "Ku është mirësia?" Nuhu u tha: "Atje ku jeni fshehur të mbuluar me rroba me qëllim që të mos shihni e të mos dëgjoni!

Keni mbuluar kokën, prandaj, megjithëse keni sy, nuk shihni!"

Njeriu është sy. Ç'mbetet tjetër prej tij është lëkurë. Ndërkaq, sy i thonë syut që sheh mikun!

Po qe se s'e sheh dot mikun, njeriu më mirë të qorrohet! Një njeri i tillë, edhe sikur të jetë Sulejman, vlen më pak se një milingonë!

Këto fjalë të reja e të padëgjuara, e entuziazmuan të dërguarin e Bizantit; atij iu shtua dëshira për ta parë Omerin!

Syrin e nguli te kërkimi i atij mbreti, kështu, e humbi edhe plaçkën, edhe kalin!

Dhe u vu pas tij duke vrapuar nga të gjitha anët si i marrë duke e kërkuar atë njeri të punës!

Dhe thoshte me vete: "A mund të ketë njeri të tillë në botë që të fshihet nga njerëzit si të ishte shpirt?"

E kërkoi për t'iu bërë rob nga zemra. Pa dyshim, ai që kërkon, gjen!

Gruaja e një beduini e pa se ai ishte i huaj dhe, kur e kuptoi se ai kërkonte Omerin, i tha: "Ja ku është, ja, mu nën këtë drurin e hurmës!"

Ambasadori e gjeti emirin e muslimanëve duke fjetur nën një pemë.

Shihe hijen e Zotit që po fle nën hije nën drurin e hurmës, i vetëm, i veçuar nga njerëzit!

Ambasadori arriti aty, por qëndroi larg. Me ta parë Omerin, nisi të dridhej.

Nga njeriu që po flinte, ambasadori u druajt, u frikësua, por dhe ndjeu një kënaqësi të thellë!

Dhe pa se, ndërsa janë e kundërta e njëra-tjetrës, dashuria dhe frika u bashkuan në zemrën e tij.

Dhe tha me vete: "Unë pashë sa e sa mbretër e sundimtarë dhe u pranova prej tyre!

Unë s'druhesha, s'tronditesha prej tyre. Tronditja që më shkakton ky njeri, m'i nxori mendtë prej kreje!

U kredha në pyje me luanë e tigra, por s'më ndërroi as ngjyra e fytyrës!

Mora pjesë në shumë beteja, mora plagë dhe plagosa e vrava shumë armiq, por zemra kurrë s'm'u ligështua!

Ky njeri shtrihet këtu i paarmatosur, kurse unë dridhem para tij si purtekë! Ç'është kjo?

Kjo tronditje vjen nga Zoti, jo nga njerëzit; kjo tronditje s'vjen nga ky njeri i varfër që fle këtu!"

Sapo që një njeri të frikësohet nga Zoti e të zërë rrugën e devocionit, qoftë xhind e qoftë njeri, kushdo që ta shohë, trembet prej tij!

Dhe, me këto mendime, lidhi duart me respekt. Pas pak, Omeri u zgjua nga gjumi!

Omeri zgjohet nga gjumi dhe ambasadori i Bizantit e përshëndet.

Ambasadori e përshëndeti Omerin me respekt të thellë. Pejgamberi ka thënë "në fillim përshëndetja, pastaj fjala!"

Omeri e pranoi përshëndetjen, e ftoi pranë vetes, e uli para vetes dhe e qetësoi.

Të frikësuarin e qetësojnë, i japin siguri dhe zemrën ia shtrojnë.

Fjala "mos ki frikë" është gjellë e gatshme që u serviret atyre që frikësohen. Dhe kjo gjellë është krejt si për ta!

Si mund t'i thuhet "mos ki frikë" atij që s'ka frikë? Pse t'i japësh mësim atij? Ai s'ka nevojë për atë mësim!

Omeri e gëzoi atë njeri që i kishte lëvizur zemra, ia ngriti prapë zemrën e shembur.

Pastaj u kredh në biseda të holla mbi atributet e pastra të Zotit i cili është bashkudhëtari më i mirë.

I tregoi ambasadorit se ç'është pozita shpirtërore, gjendja shpirtërore. I përcolli favoret dhe mirësitë e treguara nga Zoti për abdallët, që t'i dinte e t'i kuptonte.

Gjendja shpirtërore është pamja e një nuseje, kurse pozita shpirtërore, mbyllja me atë nuse dhe bashkimi me të.

Pamjen e nuses e sheh edhe mbreti, e shohin edhe të tjerët, por bashkimi me të është i posaçëm vetëm për mbretin e vyer.

Nusja nusëron edhe për elitën, edhe për popullin e thjeshtë, por është vetëm mbreti që mbyllet me të.

Mes sufive ka shumë me këtë gjendje shpirtërore, por janë të rrallë ata që ia kanë arritur pozitës shpirtërore.

Omeri i tha ambasadorit etapat e shpirtit, ia tregoi udhëtimet e shpirtit.

I foli për atë që ndodhet jashtë kohe, për kohën që s'e nxë koha, për pozitën e shenjtërisë së madhështisë,

Për feniksin e shpirtit, për fluturimet e tij para se të vinte në këtë botë!

Një fluturim i shpirtit në atë botë i kapërcente horizontet, shkonte më tej se edhe shpresat e të dëshiruarve, se edhe ambicjet e tyre!

Omeri e kuptoi se ai njeri me çehre jabanxhiu ishte mik i vërtetë, se shpirti ia donte sekretet e Zotit.

Shehu ishte i përkryer, edhe nxënësi ishte plotësisht i dëshiruar. Udhëtari ishte i shkathët dhe kali e priste te porta.

Mësuesi dhe prijësi Omer pa se ai kishte mundësi të drejtohej; atëherë, farën e pastër e mbolli në dhé të pastër!

Ambasadori bizantin e pyet Omerin, emirin e muslimanëve.

Ambasadori e pyeti: "O emiri i muslimanëve! Si zbriti shpirti nga lartësitë?

Si hyri në kafaz zogu shpirt që nuk ishte i kushtëzuar me asgjë?" Omeri i tha se Zoti i këndoi magji, i tregoi histori.

Kur Zoti u këndon magji mosqenieve pa sy e pa veshë, ato nisin të entuziazmohen dhe ulen në botën e qenies.

Me magjepsjen e Tij, mosqeniet kapërcejnë për në vendin e qenies dhe vijnë këtu.

Pastaj, duke i kënduar magji atij që është i qenë, Zoti e shtyn me shpejtësi për në mosqenie.

I tha një fjalë trëndafilit në vesh dhe e bëri të qeshë. I tha një fjalë gurit në vesh dhe e ktheu në mineral.

I këndoi trupit të pajetë një të vërtetë dhe ai mori jetë. I tha një gjë diellit dhe dielli shkëlqeu!

Pastaj, kur i fryn diellit në vesh një gjë të frikshme, mbi fytyrën e diellit zbresin qindra perde.

Zoti i cili zotëron fjalën, i këndon resë një gjë në vesh dhe bën që nga syri i resë të pikojnë e rrjedhin lot si parfum!

Ç'i tha veshit të tokës që toka u mblodh në vetvete dhe mbeti ashtu, e përhumbur?

Edhe në vesh të personit të mbetur në lëkundje e mahnitje, Zoti ka thënë një gjë të pakuptueshme!

Në këtë mënyrë, atë e burgos mes dy dyshimeve. Dhe ai thotë: "O Zot, të cilit i kërkohet ndihmë, këtë ta bëj, apo atë?"

Dhe nëse njeriu njërën prej të dyjave e mban për më të mirë dhe atë bën, prapë, prej Zotit e ka!

Nëse s'do që mendja e shpirtit të mos rropatet mes lëkundjeve, mos e zër veshin e shpirtit me pambuk

Në mënyrë që t'i kuptosh ato thëniet e pakuptueshme të Zotit, që t'i marrësh vesh fjalët e thëna haptazi ose fshehtazi!

Po veprove kështu, veshi i zemrës bëhet vendi i zbulesës hyjnore. Ç'është zbulesa hyjnore? Fjalë e fshehtë nga ndjenjë e jashtme!

Veshi dhe syri i shpirtit janë të huaj për ndjenjën e jashtme. Ajo ndjenjë është e ndryshme nga kjo ndjenjë. Këtu, veshi i mendjes dhe ndjenjës mbetet i pafuqishëm!

Çështja e determinizmit ma bëri dashurinë të pazgjedhur, durimin ma mori dore. Kurse i padashuruari e burgosi determinizmin, e mohoi ose e kushtëzoi.

Mirëpo kjo është të jesh bashkë me Zotin, nuk është determinizëm, detyrim. Kjo është shfaqje e hënës, s'është re!

Edhe sikur të jetë determinizëm, nuk është detyrimi që njeh çdo njeri, nuk është detyrimi i egos detyrues që ndjek vetëm interesin e vet!

O bir! Këtë detyrim e kuptojnë ata që Zoti ua ka hapur sytë e zemrës.

E fshehta dhe e ardhmja atyre u duket krejt hapur. Për ta, përmendja e të shkuarës është gjë pa vlerë!

Edhe zgjedhja e tyre është tjetër gjë, edhe detyrimi bëhet për ta margaritar brenda sedefeve të pikave të shiut!

Jashtë sedefit ka pika të vogla e të mëdha, kurse brenda sedefit ka margaritarë të vegjël e të mëdhenj.

Tek to është kapaciteti i barkut të kaprolles. Pikat e gjakut jashtë janë misk brenda këtyre.

Mos thuaj se si gjaku jashtë bëhet misk brenda barkut!

Mos thuaj se si ky bakër që jashtë është një gjë e zakonshme dhe e rëndomtë, brenda eliksirit kthehet në flori!

Zgjedhja dhe detyrimi janë tek ti iluzione. Kurse tek ata është kthyer në dritë të madhështisë së Zotit.

Për sa kohë që qëndron në sofër, buka është e pajetë. Kurse në trupin e njeriut bëhet jetë e shpirt!

Eshtë e pamundur që buka në mes të sofrës të jetë e gjallë. Por shpirti mundet ta bëjë atë si të gjallë!

O ti që lexon drejt e kupton drejt! Kjo është fuqi jetësore! Pa mendo, si mund të jetë fuqia e atij shpirtit të shpirtrave?

Vetëm njëri krah i njeriut, me fuqinë që i vjen prej shpirtit, çan detra, male, miniera!

Fuqia e shpirtit të njeriut çan shkëmbenjtë, kurse fuqia e shpirtit të shpirtrave çan hënën mespërmes.

Po qe se zemra hap torbën e të fshehtave të Zotit, shpirti vrapon me vrap drejt arshit.

Ndërsa Ademi e mori gabimin mbi vete, Iblisi ia ngarkoi fajin Zotit.

Edhe bëmat e Zotit shihi, edhe tonat! Shihi të dyja dhe dije se ka edhe punë që bëjmë ne, të cilat, fundja, janë sheshit!

Po qe se në shesh nuk ka punë të bëra nga njerëzit dhe po qe se çdo punë e bën Zoti, atëherë askujt mos i thuaj "pse e bëre këtë!"

Akti krijues i Zotit është realizimi i punëve që bëjmë ne. Punët tona janë vepër e punës së Zotit!

Personi që flet, sheh ose shkronjat, ose kuptimin. Si mund t'i shohë që të dyja në një çast?

Duke folur, njeriu mendon kuptimin dhe jo shkronjat. Asnjë sy nuk mundet të shohë në të njëjtin çast edhe të parmen, edhe të prapmen e një gjëje!

Dhe dije mirë këtë! Kur të shohësh para, si mund të shohësh pas?

Meqë shpirti nuk mundet t'i përfshijë edhe shkronjën edhe kuptimin në një çast, si mund të ndodhë që edhe punë të bëjë, edhe fuqinë për atë punë ta krijojë?

O bir! Zoti e përfshin çdo gjë! Kryerja e një pune nuk e pengon që, në të njëjtin çast, të kryejë edhe një punë tjetër!

Shejtani e fshehu punën e vet duke thënë se ai vetëm këshilloi.

Kurse Ademi tha për veten e tyre, "ne i bëmë padrejtësi vetes sonë", se ai nuk ishte i painformuar si ne për aktin e Zotit!

Megjithëse bëri mëkat, duke respektuar etikën, nuk ia ngarkoi Zotit, e fshehu aktin krijues të Zotit dhe, pse e mori fajin mbi vete, meritoi mirësi.

Pasi Ademi bëri pendesë, Zoti i tha: "O Adem, a s'e krijova unë fajin tek ti?

A s'ishte ai vlerësimi im, ekzekutimi im? Pse i fshehe këto duke u justifikuar?"

Ademi i tha: "U frikësova, nuk e lashë edukatën." Dhe Zoti i tha: "Ja, prandaj dhe unë të çlirova nga ndëshkimi!"

Kush respekton, respektohet. Kush sjell sheqer, ha sheqerka!

Gjërat e pastra janë për të pastërtit. Trajtoje të dashurin me të mirë, të të trajtojë mirë; ngacmoje, të të ngacmojë!

O zemër! Sill një shembull për t'i ndarë detyrimin nga zgjedhja, që t'i kuptosh të dyja!

Dora që dridhet nga sëmundja e dridhjes dhe dora që ti e bëre të dridhet...

Dije se që të dyja veprimet Zoti i ka krijuar, mirëpo është e pamundur të krahasohet akti yt me aktin e Tij!

Me anë të aftësisë tënde zgjedhëse, mund të pendohesh para se ta dridhësh dorën; por a ke parë të sëmurë nga ajo sëmundje që të pendohet dhe të mos ta lëvizë më dorën?

Kjo fjalë që thamë me qëllim që mendjengushti ta kuptojë këtë çështjen e detyrimit dhe zgjedhjes, është fjalë arsyeje, edhe kjo çështje, është çështje arsyeje. Fundja, kjo mendje hileqare nuk është arsye!

Edhe sikur çështja e arsyeshme të jetë margaritar, çështja e shpirtit është tjetër.

Çështja e shpirtit është një pozitë tjetër, vera e shpirtit ka një përbërje tjetër.

Në kohën kur çështjet e mendjes mbisundonin, Omeri dhe Ebulhakemi ishin të një radhe.

Por kur Omeri kaloi nga bota e mendjes, në botën e shpirtit, Ebulhakemi, në çështjen e shpirtit u bë Ebuxhehl.

Ebuxhehli, ndërsa ishte injorant mbi shpirtin, ishte i formuar mbi mendjen dhe ndjenjën.

Mendja dhe çështja e saj dije se është vepër ose shkak (me të kuptohen autori dhe shkaku). Kurse çështja e shpirtit është diçka që të lë gojëhapur!

O ti që kërkon dritë! Drita e shpirtit shkëlqeu: s'mbeti më nevojë dhe nevojtar, dobi dhe domosdoshmëri!

Eshtë sheshit se, po qe se dikush që sheh, është në kulmin e shkëlqimit, ka për të hequr dorë nga një provë sa një hu gardhi!

Prapë u kthyem te historia jonë. Por kur jemi larguar prej saj?

Shpjegimi i ajetit "Kudo që të ndodheni, Ai është bashkë me ju!"

Po folëm për Xhehlin (injorancën), ai është errësira e Zotit; po folëm për dijen, ajo është litari dhe streha e Zotit.

Po të flemë, jemi sarhoshët e tij; po të jemi zgjuar, flasim për historinë e tij.

Po të qajmë, jemi re plot dhunti; po të qeshim, jemi vetëtimë!

Po të zemërohemi e luftojmë, kjo është e kundërta e shkatërrimit, është paqe; po të paraqesim justifikim, është e kundërta e afërsisë dhe dashurisë.

Kush jemi ne në këtë botë të ngatërruar e të shumëllojshme? Jemi si shkronja elif. Në fakt, elifi nuk ka asgjë, asgjë!

Ambasadori e pyet Omerin se pse shpirtrat janë të shtënë pas kësaj balte.

* Kur dëgjoi këto fjalë prej Omerit, në zemrën e ambasadorit u duk një shkëlqim.

* Edhe pyetja u shkatërrua, edhe përgjigjja. Shpëtoi edhe nga gabimi, edhe nga e drejta.

* E kuptoi thelbin, kaloi nga dytësitë. Filloi të pyesë vetëm për një të vërtetë për të përfituar prej saj.

E pyeti Omerin: "Cila është urtësia e mbylljes së atij uji të kulluar në vend të turbullt? Ç'urtësi ka këtu?"

Dhe i tha: "Uji i kthjelltë është fshehur në ujë; shpirti i kulluar është lidhur pas trupave; cili është shkaku i kësaj?"

Omeri i tha: "Ti po zhytesh në një temë të thellë. Për shembull, kuptimin e vesh me fjalë (thua një fjalë).

E burgose kuptimin që është i lirë, frymën e kushtëzove me një fjalë.

Ndërsa je i drojtur nga dobia, ndërsa nuk e di dobinë e ardhjes së shpirtit në trup, këtë e bën për të arritur një dobi, apo jo!

Dobia, Zoti që shfaqet vetvetiu, si nuk e sheh këtë që shohim ne?

Në thënien e kuptimit me anë të fjalëve ka qindramijëra dobi. Secila prej tyre është shumë e pavlerë ndaj dobisë së hyrjes së shpirtit në trup.

Nëse kjo fryma jote që është pjesë e pjesëve, kjo thënia fjalë siguron një dobi të përgjithshme, pse e tëra që formohet me hyrjen e shpirtit në trup, të jetë pa dobi?

Ndërsa je pjesë, ti sheh dobi. Atëherë, pse e qorton të tërën?

Nëse fjala s'ka dobi, mos e thuaj; po pati, lëre kundërshtimin dhe shih të falenderosh!

Falenderimi i Zotit është detyrë për çdokënd. Zënia, thartimi i fytyrës nuk janë falenderim.

Po qe se falenderimi është thartim fytyre, nuk ka njeri që të falenderojë si uthull!

Po qe se uthulla kërkon rrugë të shkojë në mëlçi, thuaji "përzjeu me sheqer" dhe bëhu "uthull si mjaltë".

Përpjekja për ta shtrënguar kuptimin në poezi është e barabartë me mbylljen e gojës, s'është tjetër gjë! Kuptimi në poezi është si hobe. S'ka mundësi të shkojë në vendin që kërkohet."

Kuptimi i fjalës "Kush kërkon të rrijë me Zotin, të rrijë me njerëzit e mistikës"

Me këto një a dy gota, ambasadori e humbi veten; në kujtesë s'i mbeti as detyra, as lajmi që solli!

Ai shtangu i mahnitur nga fuqia e Zotit; u ngjit në pozitë shpirtërore, u bë mbret!

Rrebeshi u bashkua me detin, u bë det. Kokrra arriti te ara e të lashtave, u bë e lashtë!

Buka u përzje me trupin e Adem Babait; n'sa ishte i vdekur, ai u ngjall, u informua.

Kur qiriu dhe druri i dhanë jetë zjarrit dhe u ndezën, trupat e tyre të padritë u ndriçuan.

Kur guri i syrmesë leu sytë, u bë shkak që sytë të shohin më mirë, që njeriu të bëhet vëzhgues.

Ç'lumturi për atë njeri që ka shpëtuar nga vetja dhe ka arritur ringjalljen!

Sa keq për atë të gjallë që është ulur me një të vdekur dhe ka vdekur, e ka humbur jetën!

Po qe se ikën te Kur'ani i Zotit dhe strehohesh atje, bashkohesh me shpirtrat e pejgamberëve!

Kur'ani është gjendja e peshqve në detin e lartësisë së pastër të Zotit, të pejgamberëve!

Por po ta lexosh e të mos i bësh ato që thuhen, zëre se vetëm sa i ke parë pejgamberët, të urtët!

Po qe se i zbaton urdhrat e Kur'anit dhe merr mësim nga rrëfimet e tij, zogut të shpirtit i vjen ngushtë kafazi i trupit!

Fakti që zogu i burgosur në kafaz nuk do që të shpëtojë, vjen nga injoranca e tij.

Shpirtrat që kanë shpëtuar nga kafazet, janë pejgamberët, të denjë për Zotin dhe udhërrëfyes për popullin.

Zërat e tyre vijnë nga jashtë kafazeve dhe nga posti i fesë: "Kjo është e vetmja rrugë e shpëtimit tënd!

Me këtë shpëtuam ne nga ky kafaz i ngushtë. Nuk ka zgjidhje veç kësaj për të shpëtuar nga ky kafaz!

Për të shpëtuar nga popullariteti që ke fituar, bëhu si i sëmurë që rënkon pa pushim!

Fundja, të jesh i njohur ndër njerëz, është një litar i shëndoshë. Pse, a mos është ky litar në këtë rrugë më poshtë se një litar hekuri?"

Një tregtar shkon në Indi dhe papagalli i burgosur u dërgon me të lajm papagallëve të Indisë.

Një tregtar kishte një papagall; ishte një papagall i bukur i mbyllur në kafaz.

Tregtari nisi të përgatitej për rrugë për të shkuar në Indi.

Si bujar që ishte, i pyeste skllavet, robëreshat dhe shërbëtoret se ç'kërkonin t'u sillte nga India.

Secila i kërkoi një gjë dhe ai njeri i mirë u premtoi se do t'ua sillte.

Edhe papagallit i tha: "Ç'dhuratë kërkon ti, ç'të të sjell nga India?"

Papagalli i tha: "Kur t'i shohësh papagallët e atjeshëm, ua trego hallin tim!"

Dhe thuaju: "Filan papagall që e doni ju, me dëshirë të Zotit është i burgosuri ynë!

Ju bën të fala, ju kërkon ndihmë, kërkon një zgjidhje, një rrugë shpëtimi prej jush!"

Tha: "A është me vend që, me dëshirën tuaj, unë të jap shpirt në dhe të huaj?

Unë të jem brenda një burgu të shtrënguar, kurse ju të bëni qejf në pemë e gjelbërim?

A e tillë është besa e miqve? Unë ndodhem në burg, ju, në bahçe trëndafilash!

Zotërinj! Në kuvendin me verë të një mëngjesi të hershëm, kujtojeni dhe këtë të shkretë që rënkon!

Ç'lumturi për njeriun e dashur kur e kujtojnë të dashurit! Sidomos po qe se njëri është Lejlaja e tjetri, Mexhnuni!

O të afërmit e njeriut të dashur me pamje të bukur! A është me vend t'i pi gotat e mëdha të verës që i mbusha me gjakun tim!

E dashur, po deshe të më japësh edhe mua, pije një gotë duke më kujtuar mua!

Dhe, duke e kujtuar njeriun e dashur të shtrirë në këto dhera, hidh një gllënjkë verë mbi tokë!

Çudi! Ku është fjala e dhënë, ku është ai betim? Ku janë premtimet e dhëna nga ato buzë si sheqer?

Po qe se mbeta i ndarë nga sjellja e keqe dhe po qe se i përgjigjesh sjelljes së keqe me sjellje të keqe, ç'ndryshim ka midis nesh?

Megjithëkëtë, e keqja e ardhur prej teje me zemërim e tërbim, është më e këndshme, më dëfryese se qielli, se melodité tingëlluese!

O i dashur me mundimin më të mirë se shpërblimin, me shpagimin më të dashur se jetën!

Zjarri yt është ky..., po drita, vallë? Nëse zija jote është e tillë, dasmën si duhet ta kesh?

Në mundimin tënd ka ëmbëlsi të tilla, që, për shkak të hijeshisë që ke, askush s'të kupton dot siç duhet!

Edhe rënkoj, edhe kam frikë se mos më beson dhe, me bujarinë tënde, ma pakëson mundimin!

Jam i pasionuar edhe pas ndëshkimit, edhe pas favorit tënd! Ç'gjë e çuditshme që unë ua kam dhënë zemrën këtyre dy gjërave të kundërta!

Për Zotin, po shpëtova nga ky gjemb dhe hyj në bahçen e trëndafilave, kam për të ligjëruar si bilbil!

Ç'bilbil i çuditshëm që, kur e hap gojën, i duken një edhe gjembi, edhe trëndafili, dhe i gëlltit që të dy!

Ky nuk është bilbil, por lugat zjarri! Me dashurinë për Të, të gjitha gjërat e këqija i vijnë të këndshme!

I dashuruar pas trëndafilit, por vetë është trëndafil, i dashuruar pas vetes, dashurinë e vet kërkon!"

Cilësitë e krahëve të zogjve të mendjes hyjnore.

E tillë është edhe historia e papagallit të shpirtit. Por ku është personi i afërt me zogjtë?

Ku ka një zog të dobët e të pafajshëm që brenda tij Sulejmani të ketë ngritur ushtri me ushtarët e vet!

Që, kur të bërtasë me falenderim ose ankim, në qiell të bien tërmete!

Që në çdo kohë t'i arrijnë nga Zoti njëqind letra, njëqind lajmëtarë; që kur të thotë ai një herë "o Zot", nga Zoti t'i vijë gjashtëdhjetë herë zëri "Lebbejk, urdhëro!"

Që, para Zotit, gabimi i tij të jetë më i mirë se adhurimi, që, në krahasim me herezinë e tij, besimi i të gjithë njerëzve të mbetet pa vlerë!

Për njeriun e tillë ka në çdo frymëmarrje nga një miraxh të posaçëm. Zoti vë mbi kurorën e tij qindra kurora të posaçme!

Trupin e ka dhé, shpirtin, në Botën e Pakufi. Ajo Botë e Pakufishme është përtej imagjinatës së udhëtarëve!

Ajo Botë e Pakufi as imagjinohet, as kuptohet!

Ashtu siç lumi në xhennet është nën urdhrat e atyre të xhennetit, edhe bota e kufishme me Botën e Pakufishme janë nën urdhrat e atyre të xhennetit!

Por preje diskutimin mbi zogjtë e mendjes hyjnore dhe hesht! Zoti e di se ç'është e drejtë dhe e vërtetë!

O miq, le të kthehemi ne në historinë e zogut, tregtarit dhe Indisë:

Tregtari pranoi t'u çojë të fala nga papagalli i vet papagajve të Indisë.

Tregtari i takon papagajtë e Indisë dhe u jep të fala nga papagalli i tij.

Kur arriti në kufi të Indisë, në një rrafshinë me drurë, pa disa papagaj.

E ndaloi kalin dhe u bëri zë, u dha të falat e papagallit të vet dhe fjalët që ia kishte lënë amanet.

Njëri nga papagajtë u dridh shumë, iu pre fryma, ra nga pema dhe vdiq.

Tregtari u pendua që ua çoi fjalën dhe tha: "Vrava një jetë!

Ky papagall duhet të jetë farefis me atë papagallin tim; ndoshta trupat i kanë dy, por shpirtin, një!

Pse e bëra këtë punë, pse e dhashë atë lajm? Me këtë fjalë pa vend e dogja të shkretin, e përvëlova!"

Kjo gjuhë është si guri i çakmakut me hekurin e çakmakut dhe ajo që del prej goje, i ngjan zjarrit.

Prandaj mos i bjer vend e pa vend gurit me hekur!

Sepse mjedisi është errësirë, nga të gjitha anët mbushur me pambuk. Si mund të qëndrojë shkëndija në pambuk?

Mizorë janë ata që i kanë mbyllur sytë, që e kanë djegur gjithë botën me fjalët që kanë thënë!

Një fjalë e vetme djeg një botë, dhelprat e ngordhura i bën luanë!

Në thelb, shpirtrat janë me frymë Isai; nga njëra anë bëhen plagë, nga ana tjetër, melhem!

Po të ngrihej perdja nga shpirtrat, fjala e çdo shpirti do të ndikonte si fjalë e Mesihut.

Po deshe të thuash fjalë si sheqer, duro, mos u bëj i babëzitur, mos e ha këtë hallvë!

Oreksi i njerëzve largpamës është për durim, dëshira e tyre është durimi. Kurse dëshira e fëmijëve është hallva!

Kush duron, ngjitet mbi qiej, kurse kush ha hallvë, mbetet pas.

Kuptimi i fjalës së Farideddin Attarit, Zoti ia shenjtëroftë shpirtin!

"O i shkujdesur! Ti je i frymës, ha gjak brenda në tokë. Kurse njeriu me zemër, edhe sikur të hajë helm, i bëhet mjaltë!"

Njeriu që ka zemër, edhe sikur të hajë një helm qartësisht vdekjeprurës, nuk pëson dëm.

Sepse ai ka gjetur shërim, e ka shpëtuar pehrizi. Por udhëtari i shkretë (udhëtari i ri i udhës mistike) është ende i sëmurë me nxehtësi!

Pejgamberi ka thënë: "O nxënës guximtar! Kujdes, për asnjë përfitim mos lufto!"

Tek ti ka Nemrud, mos u hidh në zjarr; në u hedhsh, më parë bëhu Ibrahim!

Meqë s'je as zhytës, as detar, mos e hidh veten në det duke bërë siç ta thotë mendja!

Zhytësi dhe detari nxjerrin margaritarë nga deti, nxjerrin dobi edhe nga dëmet!

Të aftit edhe po t'i zërë dora dhé, i bëhet flori, kurse të paaftit, edhe po t'i zërë dora flori, i bëhet pluhur!

Njeriu i vërtetë është bërë i pranueshëm nga Zoti; në të gjitha punët, dora e tij është dora e Zotit!

Kurse dora e të paaftit është dora e Shejtanit, sepse është kapur nga kurthi i propozimit dhe dredhisë së Shejtanit!

Sipas të aftit, edhe mosdija bëhet dije, kurse gjëja që di i paafti kthehet në mosdije.

Çdo gjë që të prekë njeriu i sëmurë, bëhet e sëmurë. Edhe sikur i afti të jetë mohues, mohimi i tij kthehet në fe dhe sheriat!

O ti këmbësor që hyn në garë me kalorësin! Ti s'ke për ta fituar dot këtë garë, s'ke për ta kaluar dot atë. Atëherë, më e mira është të qëndrosh!

Magjistarët e respektojnë Musain duke e vënë të zgjedhë se kush të hedhë i pari dhe Musai ua lë radhën atyre.

Në kohën e Faraonit të mallkuar, magjistarët, nga urrejtja, hynë në luftë me Musain.

Megjithëkëtë, e mbajtën për të madh, e vunë para, e respektuan.

Dhe i thanë: "Vendimi është yti. Po deshe, hidhe ti i pari shkopin tënd!"

Kurse Musai u tha: "Jo, o magjistarë, në fillim ju vërini në shesh magjitë tuaja!"

Aq respekt që treguan para Musait u bë shkak që të besonin; si ndëshkim këmbë e duar iu prenë!

Ngaqë e kuptuan se Musai kishte të drejtë, magjistarët në fillim, si ndëshkim për fajin që bënë, sakrifikuan duart dhe këmbët.

Ngrënia dhe fjala janë të lejuara e të bekuara për njeriun e aftë e të formuar. Meqë ti s'je i aftë e i formuar, mos ha e mos fol, por hesht!

Sepse ti je vesh, ai është gjuhë, ai s'është nga lloji yt; Zoti u çoi veshëve urdhrin: "Heshtni!"

Fëmija lind me aftësinë për të thithur gjirin, prandaj, gjatë një kohe pas lindjes, nuk flet, por i hap veshët mirë të dëgjojë!

Gjer në mësimin e të folurit, duhet që buzët të mbyllen, që të mos thuhet gjë!

Po të mos vërë veshin, thotë fjalë pa kuptim dhe e bën veten memec.

Kurse ai që lind i shurdhër nëne, meqë nuk ka dëgjuar asgjë, bëhet memec; si mund të flasë?

Sepse të flasësh, është kusht që në fillim të dëgjosh. Hyr në fjalë nga rruga e dëgjimit!

Nëpër shtëpi hyni nga dyert; të mirat kërkojini duke inicuar shkaqet.

Fjala që kuptohet pa pasur nevojë për dëgjim, është vetëm fjala e Allahut i cili nuk është i pangopur e nevojtar.

Zoti krijon pa shembull e pa model, pa qenë i varur nga ndonjë mësues apo mjeshtër. Çdokush mbështetet tek Ai ndërsa nuk ka qenie ku të mbështetet Ai!

Të gjitha qeniet veç Tij varen nga mësuesi apo mjeshtri, kanë nevojë për model edhe në fjalë, edhe në art.

Po qe se s'je i huaj për këtë fjalë, futu nën një hirkë, tërhiqu në një gërmadhë dhe derdh lot!

Sepse Ademi me të qarë shpëtoi nga qortimi i Zotit; fryma e pendimtarit janë lotët e lagur!

Ademi ka ardhur mbi tokë për të qarë, vazhdimisht për të klithur, për të rënkuar dhe për të qenë i dëshpëruar.

Për të kërkuar falje, Ademi zbriti nga Firdeusi, nga sipër shtatë kat qiejsh, duke iu përdredhur këmbët, gjer në vendin më të ulët, në fund të derës!

Po qe se edhe ti je biri i Ademit, kërko falje si ai, ec në rrugën e tij!

Me zjarrin e zemrës, shtroi lotët përdhe si fruta për t'u tharë. Në sajë të diellit dhe reve, bahçeja u jeshilua, u mbush plot me fruta!

Ku e di ti kënaqësinë e lotit? Ti je i pasionuari i bukës si ata që s'shohin.

Po e zbraze bukën nga torba e barkut, e mbush me margaritarë lartësie shpirtërore.

Në fillim preje fëmijën shpirt nga qumështi i Shejtanit, pastaj bashkoje atë me engjëjt!

Sa të jesh në errësirë, i vuajtur dhe i turbulluar, dije se je vëlla qumështi me Shejtanin!

Kafshata që e shton dritën dhe përkryerjen, është kafshatë e shtënë në dorë me fitim hallall.

Mos i thuaj vaj vajit që, kur i futet kandilit, e shuan; vajit që e shuan kandilin, thuaji ujë!

Dituria dhe urtësia lindin nga kafshata hallall; ashku dhe hijeshia formohen nga kafshata hallall.

Po qe se nga një kafshatë shkakton zili dhe bie në kurth, po qe se nga një kafshatë formohet padituri dhe moskokëçarje, dije se ajo kafshatë është haram!

A të ka ndodhur të mbjellësh elb e të dalë grurë? A ke parë të lindë kërriç nga kali?

Kafshata është farë, prodhimi i saj, mendimet; kafshata është det, margaritarët e saj janë mendimet.

Vendosmëria për të shërbyer dhe për të shkuar në atë anë, lind nga kafshata hallall e futur në gojë!

Tregtari i tregon papagallit të vet ç'pa tek papagallët e Indisë.

Tregtari e mbaroi shitblerjen dhe, i kënaqur që ia kishte arritur qëllimit, u kthye në shtëpinë e vet.

Çdo skllavi i solli dhurata, çdo shërbëtoreje i bëri të mira.

Papagalli i tha: Po dhurata e këtij robit tënd? Thuaj ç'pe e ç'dëgjove!

Tregtari iu përgjigj: "S'them! Sepse, duke ndrydhur duart e duke kafshuar gishtërinjtë,

Ende pendohem pse e dërgova atë lajm të marrë për shkak të injorancës dhe marrëzisë sime!"

Papagalli i tha: "Imzot, pse ky pendim, ç'u bë shkak për këtë zemërim, për këtë ankth?"

Tregtari i tha: "Ankesat e tua ua thashë papagajve që të ngjanin ty.

Njëri prej tyre që e kuptoi hallin tënd, nuk duroi dot, u drodh dhe vdiq.

Unë u pendova që e thashë atë fjalë, mirëpo e kisha thënë një herë! Ç'dobi mund të më bënte pendimi?"

Dije se fjala që del një herë nga goja, është si shigjeta e hedhur nga harku.

O bir, ajo shigjetë nuk kthehet më prej aty ku bie; uji i rrëmbyer duhet ndaluar që në krye!

Pasi uji i rrëmbyer të lëshohet tatëpjetë, s'është çudi që ta përmbytë gjithçka, ta shkatërrojë botën!

Në Botën e Fshehtë lindin veprat e punës së bërë këtu; ato vepra nuk varen nga vendimi i njerëzve.

Po të kenë lidhje me ne, që të gjitha krijohen vetëm nga Zoti i vetëm!

Për shembull, Zejdi i hedh Amrit një shigjetë; ajo shigjetë e plagos Amrin si të plagoste një luan.

Plaga punon gjer një vit në trupin e Amrit, shkakton dhimbje. Ato vuajtje Zoti i ka krijuar, jo njeriu!

Po qe se Amri i qëlluar nga shigjeta vdes atë çast nga frika, ose në trupin e tij formohen plagë që i shkaktojnë vdekjen

Dhe Amri vdes nga ato plagë e nga ato vuajtje, Zejdit thuaji katil sepse ai e hodhi shigjetën, ai u bë shkaku i parë!

Edhe pse të gjitha ngjarjet janë krijim i Zotit, dhimbjet Zejdit ia ngarko!

Kështu është edhe të mbjellësh, të marrësh frymë, të ngresh kurth, të çiftohesh. Por është Zoti që mbjell, merr frymë, ngre kurth, çifton, shkakton mbirjen, mban gjallë, fut në kurth, shkakton lindjen ose të kundërtën e këtyre.

Tek të urtët dhe shenjtorët ka një fuqi të marrë nga Zoti, që shigjetën e hedhur e kthejnë nga rruga.

I urti i Zotit, po të pendohet, ua mbyll dyert shkaqeve (i lë aktet pa rezultat). Por këtë e bën me dorën e Zotit.

Me fuqinë e Zotit, fjalën e thënë e bëjnë të pathënë, e bëjnë të tillë që as helli digjet, as mishi!

Të gjitha fjalët e zemrave i dëgjojnë dhe ato fjalë i asgjësojnë.

O zotëri! Po të të duhet argument dhe provë, lexo ajetin "min ajetin ev nunsiha"!

Lexoje edhe ajetin "ensevkum dhikri" dhe kuptoje harresën që vendosin të urtët ndër zemra.

Të urtët janë të aftë për të shkaktuar kujtesën dhe harresën, prandaj sundojnë në zemrën e çdokujt.

Sapo që i urti, me fuqinë e tij për të shkaktuar harresë, ia zë dikujt rrugën e arsyetimit, ai person nuk bën dot punë edhe sikur të jetë mjeshtër i asaj pune!

Ju i vutë në lojë personat e lartë dhe pandehët se prej kësaj s'ka për të dalë gjë, por pa këndojeni ajetin "ensevkum" në Kur'an!

Kush i zotëron qytetet dhe fshatrat, është mbreti i trupave. Kush i zotëron zemrat, është mbreti i zemrave tuaja!

Nuk ka aspak dyshim se punët janë produkte të vështrimeve. Prandaj njeriu përbëhet vetëm prej syrit!

Unë këtë nuk e them plotësisht, sepse zotëruesit e qendrës (pejgamberët) e ndalojnë.

Meqë kujtesa dhe harresa e njerëzve është në duart e tij, është ai që u shkon në ndihmë.

Ai personi i veshur me shprehi të bukura, çdo natë fshin nga zemrat mijëra kujtime të mira e të këqija.

Po me ato kujtime i mbush zemrat e ditës; ato sedefe i bën të mbushura plot me margaritarë!

Të gjitha mendimet e mëparshme, me mirësinë e Zotit, i njohin të zotët e tyre.

Kur zgjohesh, arti dhe mjeshtëria të kthehen prapë me qëllim për ta hapur portën e shkaqeve.

Mjeshtëria e argjendarit nuk shkon te kovaçi; shprehia e bukur e njeriut me shprehi të bukura nuk shkon te njeriu me shprehi a vese të këqija!

Ditën e kiametit, mjeshtëritë dhe shprehitë i vijnë të zot si pajë.

Mjeshtëritë dhe shprehitë edhe pas gjumit kthehen me vrap për tek i zoti!

Të bukura apo të shëmtuara, të gjitha mjeshtëritë dhe shprehitë shkojnë te i zoti që me mëngjes.

Edhe pëllumbat e postës i kthejnë letrat me përgjigje në qytetin nga janë nisur!

Pasi dëgjon se ç'i kishte ngjarë papagallit atje në Indi, papagalli i tregtarit vdes në kafaz, kurse tregtari qan për të.

Kur dëgjoi ç'i kishte ngjarë papagallit në Indi, papagalli i tregtarit u drodh, ra dhe mbeti ashtu, i shtangur!

Me ta parë që ra, tregtari u hodh përpjetë dhe e përplasi qylafin përdhe.

Me ta parë zogun në atë gjendje, nisi të çjerrë rrobat nga hidhërimi!

Dhe tha: "O papagall zëbukur! Ç'të ndodhi kështu, pse erdhe në këtë gjendje?

Mjerë për mua, o zogu im i bukur! Mjerë për mua, o shoku im, o mik i zemrës sime!

Mjerë për mua, o zëbukuri im, o hareja e shpirtit, o lulja ime, o kopshti im!"

Po të kishte Sulejmani një zog të tillë, a do të merrej me zogj të tjerë!

Sa keq që u ndava kaq shpejt nga zogu që e pata gjetur lirë!

O gjuhë, ti po më jep shumë dëm! Por meqë ti je folësi, ç'të të them unë ty?

O gjuhë, ti je edhe zjarr, edhe kashtë! Gjer kur do t'i vësh kashtës zjarr?

Megjithëse shpirti bën atë që thua ti, fshehurazi bërtet për shkakun tënd!

O gjuhë, ti je edhe një thesar i pashtershëm, edhe një vuajtje pa derman!

Edhe vërshëllimë dhe hile për zogjtë je, edhe nisja e kohës së ndarjes dhe vetmisë.

O e pashpirt, s'ke fare mëshirë për mua! Ti e ke ngritur harkun për të më vrarë mua!

Ja, tek ma fluturove zogun tim! Kullotsh pak në kullotën e dhunës dhe padrejtësisë!

Ose përgjigjmu, ose bëhu e matur, ose kujtomë njërin nga shkaqet e gëzimit dhe haresë!

Ah, drita ime që ma shemb e ma shkatërron errësirën time! Ah, mëngjesi im që ma ndriçon ditën time!

Ah, fluturuesi im i bukur, zogu im që fluturon e vjen nga mbarimi në fillim!

Njeriu injorant është përjetësisht i dashuruar pas mirënjohjes! Ngrihu dhe lexoje "Ia uksimu" gjer te "fi kebed"!

Fytyrën tënde pashë dhe shpëtova nga mirënjohja; në lumin tënd u pastrova nga shkumba, nga zhuli!

Këto ankime e këto mjerime janë me imagjinatën për ta parë atë, për t'u prerë prej qenies tënde të tashme që e ke në dorë!

Shkaku i vdekjes së këtij zogu është zelli (zilia) i Zotit. Vendimit të Zotit s'i gjindet çare. Ku ka zemër që të mos jetë bërë njëqind copash nga vendimi i Zotit?

Zelli (zilia) është përpjekja e Zotit, e ndryshme nga çdo gjë tjetër, cilësia e të cilës nuk futet dot në zë dhe fjalë! (Zoti ka zili çdo gjë tjetër veç vetes)

Ah, sikur lotët e mi të ishin det dhe të hyja në rrugën e atij dilberit tim të bukur!

Papagalli im, zogu im i mençur, interpretuesi i mendimeve dhe i sekreteve të mia!

T'ia jap ç'i takon a të mos ia jap... e kisha mik. E kujtoj që me fjalët e para; ishte shoku im i ngushtë gjer në vdekje!

Ishte një papagall që zëri i vinte nga qielli, që ekzistonte para se të krijohej ekzistenca!

Ai papagall ndodhet i fshehtë brenda teje. Ti ke parë në këtë apo atë, të kundërtën e tij!

Ai zog ta rrëmbente gëzimin, por prapë ti prej tij merr gëzim. Padrejtësinë e bërë prej tij e pranon si drejtësi!

O ti që ma djeg shpirtin për trupin! Shpirtin e dogje, trupin e ndriçove!

Unë u dogja; ai që kërkon t'i vërë flakë eshkës së vet, të vijë tek unë, të marrë flakë prej meje dhe pastaj t'u japë flakën barit e kashtës e të djegë gjithçka!

Eshka është kapaciteti për të marrë zjarr, prandaj merre eshkën që tërheq zjarrin!

Ah, sa keq, sa keq! Një hënë e tillë hyri nën re!

Si të them? Zjarri i zemrës mori flakë me vrull, ndarja e tërboi luanin, e bëri gjakderdhës!

Ai që, duke qenë mendjekulluar, bile, është i dehur e i rreptë, ç'bëhet kur merr kupën në dorë?

Luani i dehur sa nuk tregohet, kur vjen në livadh, merr hare nga blerimi i përhapur aty dhe bëhet më i dehur se më parë!

Unë mendoj për rimën, kurse e dashura më thotë "mos mendo tjetër gjë veç fytyrës sime!"

O ti për të cilën unë mendoj rimën! Rri e qetë se pranë meje ti je rimë bukurie!

Ç'është shkronja që të mendosh ti për të? Ç'është shkronja? Muri prej gardhi i vreshtës!

T'i përplasim me njëri-tjetrin e t'i copëtojmë shkronjën, tingullin dhe fjalën dhe të bisedoj me ty pa këto të tria!

Sekretin që e fsheha edhe prej Ademit, madje, o e dashur që je enigma e gjithësisë, të ta them ty.

Enigmën që nuk ia kam thënë as Halilit, vuajtjen që nuk ma di as Xhebraili,

Enigmën për të cilën nuk foli as Mesihu, enigmën që as Zoti, duke na pasur zili ne, nuk ia hapi askujt pa qenë ne, të ta hap ty!

Fjala "ne", ç'fjalë është në fjalor? Një fjalë që provon vërtetimin dhe mohimin. Mirëpo unë nuk jam vërtetim; nuk kam individualitet dhe ekzistencë që të mund të vërtetohet! Nuk jam as mohim!

Unë e gjeta ekzistencën në mosqenie, prandaj e flijova ekzistencën për mosqenien!

Të gjithë mbretërit dhe sundimtarët përulen para atij që përulet para tyre. Gjithë populli është i dehuri i atij që është i dehur ndaj tij.

Sundimtarët i bëhen rob atij që u bëhet rob atyre. Përgjithësisht, populli vdes në rrugën e atij që vdes për të!

Për t'i gjuajtur befasisht, gjahtari u bëhet gjah zogjve.

Dilberët i kërkojnë të dashurat me gjithë zemër. Të gjithë të dashuruarit janë gjuajtur prej të dashuruarve!

Kë të shohësh se e ka zënë dashuria, dije se është i dashuruar. Sepse, krahas që e ka zënë dashuria, është i dashuruar në atë mënyrë që duhet nga e dashura.

Të eturit kërkojnë ujë, por edhe uji kërkon të eturit!

Meqë ai është i dashuruar, ti hesht! Meqë ai tërheq veshin, ti hapi veshët plotësisht!

Sapo të nisë të rrjedhë uji i rrebeshit, ti zërja shtegun, preja rrugën! Ndryshe, e shkatërron botën, të gjitha anët i shemb.

Por pse të shqetësohem nga rrënimi? Nën rrënoja janë thesaret e mbretit!

Personi që zhytet te Zoti, më shumë dëshiron të zhytet, të bëhet dallga e përmbysur e detit të shpirtit.

Fundi i detit është më i këndshëm, apo sipërfaqja e tij? Shigjeta e tij është më tërheqëse dhe e bukur, apo mbajtja e mburojës para asaj shigjete?

Në këto kushte, o zemër, po i ndave harenë dhe dëfrimin nga mundimi dhe belaja, bëhesh rob i pasigurisë!

Le ta zëmë se në dëshirën tënde ka shije sheqeri. A s'është dëshira e të dashurit mungesë dëshire, braktisje e qëllimit dhe synimit?

Çdo yll i tij është shpagimi i gjakut të qindra hënëve të reja! Ai e ka të lejueshme të derdhë gjakun e gjithësisë.

Ne e gjetëm edhe vlerën, edhe shpagimin e gjakut! Dhe prandaj vrapuam të japim jetën!

O i dashuruar! Jeta e të dashuruarve është në vdekje. Jetën s'mund ta gjesh në mënyrë tjetër veç dhënies së zemrës.

Desha t'ia marr zemrën me qindra naze e lojra, por i dashuri më tregoi fytyrën e tij indiferente, zuri pretekste.

I thashë: "Kjo mendje, ky shpirt a s'i janë kushtuar dashurisë tënde?" Më tha: "Shko, shko! Mos ma këndo këtë magji mua!"

A s'e di unë se ç'mendon ti? O ti që sheh dy! Si mund ta kesh parë të dashurin ti?

O ti njeri i rëndë! Ti e pe atë me nënvleftësim sepse e bleve lirë!

Kush merr lirë, jep lirë! Fëmija e shkëmben një margaritar me një bukë!

Unë jam mbytur në një dashuri të tillë që edhe dashuria e të parëve është fundosur në dashurinë time, edhe e të pasmëve!

Unë atë dashuri e thashë shkurt, nuk e tregova dot plotësisht. Po ta tregoj, edhe buzët më digjen, edhe gjuha!

Po thashë "buzë", e kam fjalën për "bregun e detit"; po thashë "jo", dua të them "vetëm se"!

Për shkak të ëmbëlsisë, po rri me turinj të thartuar; po hesht nga fjalët e tepërta!

Dëshiroj që, në këtë mënyrë, ëmbëlsia me thartinë e fytyrës të na mbeten të fshehta nga të dy botët,

Që kjo fjalë të mos hyjë në çdo vesh. Prandaj, nga njëqind enigma hyjnore, po them vetëm njërën!

Fjala e Hakim Senaiut, "Edhe sikur gjëja që të shmang ty nga rruga, të jetë fjalë mohimi, edhe sikur të jetë besim..., edhe sikur piktura që të lë larg ty nga miku, të jetë e shëmtuar, edhe sikur të jetë e bukur, njëlloj janë"; Hadithi i Pejgamberit (s.a.s.), "Sa'di është shumë ziliqar, unë jam më ziliqar se Sa'di, kurse Zoti është më ziliqar se unë; për shkak të zilisë, Ai i ka bërë haram të gjitha të këqijat e dukshme e të padukshme".

Ngaqë Zoti ia kaloi gjithë botës në zili, gjithë bota u bë ziliqare.

Ai është si shpirti, kurse bota, si trupi. Trupi e pranon të mirën e të keqen nën ndikimin e shpirtit.

Dije se, nëse dikush ka në namaz Hënën (individualitetin dhe bukurinë e Zotit) për mihrab dhe kible dhe, pastaj, kthehet përsëri nga ana e besimit (iman), kjo për të është turp dhe e metë.

Nëse personi që shërben si garderobist te mbreti, i futet tregtisë për hesap të mbretit, kjo është dëm dhe humbje.

Nëse personi që rri bashkë me mbretin, ulet në portën e tij, ky është veprim i keq dhe vetëmashtrim.

Nëse dikujt i bie rasti t'ia puthë dorën mbretit, kurse ai ia puth këmbën, kjo është faj.

Sado që vënia e kokën nën këmbët e tjetrit është afërsi, në krahasim me afërsinë e puthjes së dorës është gabim, është poshtërim.

Mbreti bëhet ziliqar nëse dikush, pasi ia ka parë një herë fytyrën, kthehet nga dikush tjetër.

Zelli i Zotit i përngjet grurit, kurse kashta në duaj është zilia e njerëzve.

Dijeni se origjina e zilive është nga Zoti. S'ka dyshim se zilitë e njerëzve vijnë pas zilisë së Zotit.

Ta lë shpjegimin e kësaj e të ankohem për mundimin e së dashurës së lëkundshme me vullnetin e vet.

Të klith, sepse vajtimet e klithjet i shkojnë pas shtati. Edhe nga të dyja botët, asaj i duhen klithje e vajtime.

Si të mos klith me hidhërim nga aventura e saj, se nuk përfshihem në rrethin e sarhoshëve.

Si të mos nxihem si nata kur ndodhem larg syve të saj, i ndarë nga fytyra gjithmonë e më e bukur e saj, nga prania e saj?

Edhe gjëja e pakëndshme e saj m'i vjen zemrës e këndshme. Jeta m'iu bëftë fli të dashurës sime që i prek dhe i ngacmon zemrat!

Që mbreti im i cili s'ka shok, të jetë i kënaqur, unë e dashuroj edhe sëmundjen time, edhe vuajtjen time!

Që dy sytë e mi të cilët janë si dy detra, të mbushen me margaritarë, po vuaj sikur t'ia fërkoja fytyrës dheun e dhimbjes!

Lotët që njerëzit derdhën për të, janë margaritarë; njerëzit i pandehin për lot!

Unë nuk jam ankestar për shpirtin e shpirtrave, unë po tregoj.

Kur zemra më thotë se "është prekur prej saj", unë qesh me këtë dyfytyrësi të pabazë e të parëndësishme të zemrës.

O ti, burim krenarie i drejtësisë! I dretë ji! O qoshja e kreut! Në portën tënde, unë jam pragu i saj! Ku është, në botën e kuptimit, qoshja e kreut dhe ku, pragu? Në vendin ku ndodhet i dashuri ynë, ku jemi unë dhe ne?

O ti, shpirti i të cilit ka shpëtuar nga kushtëzimi unë dhe ne! O shpirt që te mashkulli dhe femra nuk të nxënë fjala dhe cilësia!

Kur zhduket dallimi mashkull-femër dhe mbetet një, ai njëshi je ti! Kur zhduken edhe njëshat, ai që mbetet në shesh, je vetëm ti!

Për të luajtur tavllën e kënaqësisë me vetveten, formove këtë "unë" dhe këtë "ne".

Në këtë mënyrë, të gjithë un-ët dhe ne-të shndërrohen në një shpirt dhe, më në fund, shkrihen dhe humbasin në qenien e të dashurit.

Unë, ne, imi dhe yni, qenia dhe mosqenia e qenieve, të gjitha ç'po them, janë, ndodhin. O urdhri "bëhu", o Zot që je i pastër nga thënia "eja" dhe nga thënia fjalë, ti eja!

A mund të të shohë ty, syri i trupit? A mund të imagjinohet që unë të të mërzis ty apo të të zbavis dhe të të bëj të qeshësh?

Mos i thuaj zemrës të lidhur pas vuajtjes dhe haresë se është e denjë për ta parë atë!

Kush është i lidhur pas dëshpërimit dhe gëzimit, me këto dy cilësi të shtuara e të përkohshme jeton.

Mirëpo kopshti i blertë i dashurisë nuk ka fund, nuk ka anë e kënd. Ç'fruta të tjera ka atje veç vuajtjes dhe haresë!

Përjetimi i dashurisë është më i lartë se këto dy gjendje: krejt e njomë dhe e freskët, pa pranverë dhe vjeshtë!

O fytyrëbukur! Jepe zeqatin e fytyrës tënde të bukur; gjithashtu shpjegoje shpirtin që e ke pjesë-pjesë dhe tregoje atë!

Ngadhnjimtari më pa një herë me cep të syrit dhe me naze dhe zemrës m'i ra një mal i ri!

Ia bëra hallall edhe sikur të ma derdhte gjakun. Kur i thosha fjalën "hallall", ai ikte.

Meqë ikën nga klithmat e banorëve të tokës, pse i hedh dhimbje zemrës së të dëshpëruarve?

Çdo mëngjes, me të shkëlqyer nga lindja, të gjeti ty duke u shfaqur, duke u entuziazmuar si burimi i lindjes, dielli!

O bukuroshe që buzëve të tua të ëmbla s'mund t'u vihet çmim! Ç'pretekste i gjen ekzaltimit tënd?

O ti që je shpirt i ri për botën e vjetër! Dëgjoje klithmën dhe vajtimin që dalin prej trupit të mbetur pa zemër e pa shpirt!

Për dashuri të Zotit, lëre, tashmë, tregimin për trëndafilin dhe trego hallin e bilbilit të ndarë nga trëndafili!

Entuziazmi ynë s'është nga dhimbja apo nga gëzimi, nuk ka ardhur nga mendja, kultura, imagjinata dhe fantazia jonë!

Eshtë prej një situate të gjendur rrallë; mos e moho që fuqia e Zotit është shumë e madhe!

Mos e krahaso ti këtë situatë me gjendjen e njerëzve, mos qëndro te padrejtësia dhe mirësia!

Padrejtësia, mirësia, mirënjohja dhe gëzimi janë kalimtarë. Kalimtarët vdesin; Zoti është trashëgimtar për ta!

U bë mëngjes, o Zot, streha e mëngjesit! Unë nuk parashtroj dot justifikim! Ti kërko falje nga Husameddini i cili na shërben neve!

Ti je ai që kërkon falje për Arsyen e Përgjithshme dhe shpirtin; ti je shpirti i shpirtrave, shkëlqimi i perlave!

Drita e mëngjesit shkëlqeu dhe ne, në kohën e këtij mëngjesi jemi duke pirë verën tënde Mansur!

Por nëse frymëzimi yt na deh ne kështu, ç'është vera që të na japë hare?

Vera është varfëria jonë në entuziazëm; fati është, në kthim, i varfëri i mendjes sonë!

Vera u deh prej nesh, jo ne prej saj! Trupi u bë i qenë prej nesh, jo ne prej tij!

Ne jemi si bleta, kurse trupat, si dylli. Zoti i ka bërë trupat si prej dylli: forma-forma, trajta-trajta!

Kjo temë është shumë e gjatë; tregoje historinë e tregtarit që të kuptohet se në ç'gjendje erdhi ai njeri i mirë, ç'u bë!

Kthimi te historia e tregtarit.

Të tilla qindra fjalë të ngatërruara thoshte tregtari në zjarrmi, vuajtje e vajtime!

Aty thoshte fjalë që nuk përputheshin me njëra-tjetrën, aty bënte naze, aty lutej, aty shprehte dashurinë për të vërtetën, aty, dashurinë e figurshme!

Njeriu që bie në ujë, rropatet tepër, kapet pas fijes së barit që i bie në dorë.

Në atë çast rreziku, nga frika se kush do t'ia japë dorën, tund duart sa andej-këtej dhe përpiqet të notojë!

I dashuri e do këtë marrëzi, këtë rrënim. Eshtë më mirë se puna dhe përpjekja kot më kot, se gjumi.

Kush është mbret, s'është i pafuqishëm! Klithja dhe vajtimi i atij që s'është i sëmurë, është gjë për t'u çuditur!

Zoti, o bir, ka thënë për të: "Në të gjitha ditët ai është në punë!"

Kjo është rruga jote, ngjitu, mos rri kot asnjë çast gjer në frymën e fundit!

Ka mundësi që, në frymën e fundit, të arrish mirësinë. Ajo mirësi të bën ty të afërm.

Veshi dhe syri i mbretit janë në penxhere; qoftë shpirti i mashkullit, qoftë i femrës, për kë të përpiqet shpirti, atë sheh, atë dëgjon!

Tregtari e hedh papagallin e vdekur jashtë kafazit dhe, pastaj, papagalli fluturon.

Tregtari e hodhi jashtë papagallin e vdekur i cili, sapo e ndjeu veten të lirë, fluturoi dhe u ul në degën e një peme të lartë.

Siç lind dielli me shpejtësi nga horizonti, ashtu fluturoi papagalli!

Tregtari që s'dinte asgjë, kur e pa enigmën e papagallit, mbeti i habitur.

Ngriti fytyrën lart dhe tha: "O bilbil! Na thuaj ç'po ndodh, ç'është kjo punë!

Ç'bëri papagalli në Indi dhe ti e mësove, na luajte një rreng dhe na e dogje zemrën!"

Papagalli i tha: "Me veprimin e vet, ai më dha një këshillë: "Lëre bukurinë, thënien e fjalëve dhe harenë

Sepse të folurit të futi ty në burg!" Për të ma dhënë këtë këshillë, e tregoi veten të vdekur!

Ai deshi të më thoshte: "O ti që flet dhe këndon edhe para popullit, edhe para parësisë! Vdis si unë që të shpëtosh!"

Po të bëhesh farë, të mbledhin zogjtë e të hanë; po të bëhesh gonxhe, të këpusin fëmijët e vegjël!

Fshihe farën dhe rri plotësisht në pritë! Fshihe gonxhen dhe bëhu bar në çati!

Kush e nxjerr bukurinë sheshit, i ndodhin qindra fatkeqësi!

Syri i keq i armiqve, urrejtja dhe mëria e tyre, smira e tyre i zbrazen në krye si uji nga kova.

Armiqtë e bëjnë copë-copë nga zilia, kurse miqtë ia shpenzojnë jetën me fantazira dhe iluzione!

Ku ta dijë njeriu që s'merr vesh nga mbjelljet, vlerën e pranverës si kohë mbjelljesh?

Duhet të strehohesh nën mbrojtjen e favorit të Zotit, sepse Zoti u derdhi shpirtrave qindra favore!

Duhet të mbështetesh në favorin e Zotit që të gjesh strehim. Por ç'strehim? Uji dhe zjarri, bile, bëhen ushtarët e tu!

A s'iu bë deti mik Nuhut dhe Musait? Dhe a nuk ua shkatërroi armiqtë me urrejtjen e vet?

A nuk iu bë zjarri kala Ibrahimit dhe nxori tym nga zemra e Nemrudit?

A nuk e thirri mali Jahjanë për ta strehuar dhe pastaj i qëlloi me gurë dhe i copëtoi ata që e kishin sulmuar?

O Jahja! Ik, eja tek unë që të të shpëtoj nga shpatat e mprehta?

Papagalli i lë lamtumirën tregtarit, fluturon e ikën.

Papagalli i dha tregtarit disa këshilla që i pëlqyen dhe pastaj i tha: "Të paça lënë në dorë të Zotit! Erdhi koha të ndahemi!"

I zoti i tha: "Zoti të dhëntë paqe, shko! Ti më tregove mua një rrugë të re!"

Tregtari tha me vete: "Kjo ishte mend për mua! Të zë rrugën e tij se kjo është një rrugë e ndritshme!

Pse shpirti im të jetë më poshtë se i papagallit? Shpirti që është shpirt, duhet të ndjekë një gjurmë të tillë!"

Kur populli ngre lart dikë dhe e tregon me gisht, kjo ka pasoja të këqija.

Trupi i ngjan kafazit. Me mashtrimin e atyre që hyjnë e dalin, që bëjnë miqësi me njeriun, shpirti është gjemb në trup.

Njëri i thotë që të bëhet shok i ngushtë i sekreteve, kurse tjetri i thotë se është moshatari i tij, i ngjashmi i tij!

Njëri i thotë se në botë s'ka si ai në virtyt, bukuri, mirësi dhe bujari!

Kurse tjetri i thotë se që të dyja botët janë të tij, se të gjitha shpirtrat e tyre janë lidhur pas shpirtit të tij.

Atëherë, njeriu, kur e sheh se populli është dehur pas tij, fryhet, krenohet dhe nis të dalë nga kontrolli.

Mijëra si ai ka hedhur Shejtani në det!

Favoret dhe dallkaukllëqet e botës janë një kafshatë e këndshme, por ti ha pak sepse janë një kafshatë prej zjarri!

Zjarri është i fshehtë, kurse kënaqësia e tij, sheshit. Tymi i del pas!

Mos thuaj se ti s'i gëlltit ato lajka, mos thuaj se ai të lavdëron nga pangopësia dhe se ti e kupton atë!

Po qe se ai që të lavdëron dhe lajkaton, vepron kundër teje mes njerëzve, të digjet zemra ditë me rrahë!

Edhe sikur ta dish se, meqë ai nuk e arriti dot atë që shpresonte nga afërsia me ty, po vepron kundër teje,

Fjalët lavdëruese e lajkatare të prekin në zemër, të mbajnë nën vete. Edhe nga lavdërimi vjen një mbajtje më të madh, provoje dhe shih!

Mbetesh për ditë të tëra edhe nën ndikimin e lavdërimit. Ai lavdërim bëhet shkak që shpirti të të mbahet më të madh, të vetëmashtrohet!

Por ky ndikim nuk duket hapur, sepse të lavdërohesh është gjë e ëmbël. Meqë qortimi është i hidhur, duket menjëherë i keq.

Qortimi është si ilaçi i zjerë dhe hapjet; po t'i pish a t'i gëlltitësh, për një kohë pak a shumë të gjatë ndjen ankth e dhimbje.

Po të hash ëmbëlsirë, kënaqësia e saj është e çastit, ndikimi i saj nuk zgjat si i tyre.

Ndikimi që vazhdon gjatë, është i fshehtë. Çdo gjë kuptoje me të kundërtën e saj.

Ndikimi i lavdërimit i ngjan ndikimit të sheqerit; ndikon fshehtazi dhe, pas një kohe, në trup del një çiban që duhet shpuar.

Nefsi, egoja u faraonizua pikërisht pse u lavdërua gjatë! Bëhu i thjeshtë, kokulur, mos u mbaj më të madh!

Me sa të të vijë dore, bëhu rob, jo mbret! Bëhu mundimheqës si top, mos u bëj shkop!

Ndryshe, kur mos të të mbetet kjo bukuri e kjo hijeshi, ata që ulen e ngrihen me ty do të mërziten prej teje!

Atëherë, ata që të patën gënjyer në fillim, me të të parë do të ta ngjisin emrin Shejtan!

Kur të të shohin në fund të derës, të gjithë së bashku do të thonë "lugat i ngritur nga varri"!

Si djalit të ri. Në fillim e mbiquajnë Zot dhe, me këtë dallkaukllëk, kërkojnë ta rrëzojnë në pusí.

Por kur t'i dalë emri për të keq dhe, pasi të kalojë koha, t'i dalë mjekra në një të keqe, atëherë, nga afrimi me të turpërohet dhe Shejtani!

Shejtani shkon pranë njeriut për një të keqe, nuk vjen tek ti, sepse ti tashmë je më i keq se Shejtani!

Sa kohë që ti ishe njeri, Shejtani të ndiqte gjurmët, vraponte pas teje, të jepte të pish verë!

O ti njeri që s'vlen për gjë! Pasi të kesh ngulur këmbë në veset e shejtanit dhe të jesh bërë shejtan, edhe Shejtani ikën prej teje!

Edhe personi që ka qenë i lidhur fort pas teje, kur të bëhesh i tillë, ikën prej teje!

Shpjegimi i shprehjes "Allahu ia mbrojttë prejardhjen!"

Të gjitha këto i thamë, por, po të mos jenë mirësitë e Zotit, në rrugën e Allahut ne jemi hiç, asgjë!

Po të mos jenë mirësitë e Zotit dhe njerëzve të Zotit, tjetri, edhe sikur të jetë engjëll, e ka librin e llogarive sterrë të zi!

O Zot, o ti që mirësitë e tua janë provë! Përballë teje nuk është e denjë të përmendet emri i askujt!

Ja, tek na e fale kaq fuqi orientimi, sa e sa të meta na i mbulove gjer tani!

Pikën e kulturës shpirtërore që na e fale në pafillimshmëri, çojua detrave!

Ç'kam në shpirt, përbëhet prej një pike diturie; shpëtoje atë nga fryma e trupit, nga dheu i trupit!

Çliroje atë para se ta mbulojnë këto dhera, para se ta thajnë këto erëra!

Ç'është e vërteta, ti je i aftë për ta marrë dhe çliruar përsëri edhe pasi ta kenë tharë dhe prishur erërat!

Pika e ngritur në ajër apo e derdhur përtokë si mund të ikë nga thesari i fuqisë tënde?

Edhe sikur të asgjësohet, edhe sikur të hyjë njëqind kat nën asgjësimin, kur ta thërresësh, vrapon me të katra për tek ti!

Qindramijëra të kundërta e shkatërrojnë kundërshtinë mes tyre, pastaj, urdhri yt i sjell ato përsëri në botën e ekzistencës.

Aman, o Zot! Për çdo çast, qindramijëra karvanë vijnë me radhë nga bota e mosqenies në botën e qenies!

Sidomos, çdo natë, të gjithë shpirtrat, të gjitha mendjet fundosen në atë det pa anë e pa fund dhe asgjësohen!

Prapë, në kohën e mëngjesit, shpirtrat dhe mendjet që i përkasin atij Zoti, nxjerrin kokën si peshqit në det.

Në stinën e vjeshtës, ato qindramijëra degë dhe gjethe bien, thahen dhe shkojnë në detin e vdekjes.

Korbat e zeza, duke veshur rroba të zeza si ata që mbajnë zi, nëpër kopshte e vreshta mbajnë zi për blerimin e vdekur.

Nga pronari i fshatit të ekzistencës del përsëri fermani për mosekzistencën: Ktheji mbrapsht ato që ke ngrënë!

Jepet urdhri: "O vdekje e zezë! Ktheji mbrapsht ato që ke ngrënë nga barërat, rrënjët dhe gjethet që kanë për t'u bërë ilaç!"

Vëlla, mblidh mendtë! Edhe tek ti në çdo çast ka vjeshtë dhe pranverë!

Shih se si trëndafilishtja është plot me gonxhe, trëndafila, selvi dhe jaseminë të bleruar e të njomë!

Degët janë fshehur nga numri i madh i gjetheve; fushat dhe pallatet nuk duken nga numri i madh i trëndafilave!

Edhe këto fjalë që vijnë nga Arsyeja e Përgjithshme, është aroma e asaj trëndafilishteje, e atyre selvive dhe zymbylave!

A ke parë që nga vendi ku s'ka trëndafila, të vijë erë trëndafili, që, atje ku s'ka verë, të zjejë e të valojë verë?

Aroma është udhërrëfyese për ty. Ajo të çon ty gjer në xhennetin e përjetshëm dhe lumin parajsor!

Aroma është ilaç për syrin, ia shton dritën. Sytë e Jakupit u hapën nga një aromë.

Kurdërmimi i keq e nxin syrin. Kurse kundërmimi i Jusufit i jep dritë syrit.

Në s'je Jusuf, të paktën bëhu Jakup; si ai, qaj për t'u takuar me atë që kërkon!

Dëgjoje këtë porosi të Hakim Gazneviut dhe gjeji një risí trupit tënd të vjetër:

Për të bërë naze, duhet një fytyrë si trëndafili; po s'pate një fytyrë të tillë, mos u vërtit përreth huqeve të tua të këqija, mos bëj naze!

Edhe nazja e një fytyre të shëmtuar e të verdhë është e shëmtuar. Syri edhe qorr, edhe i sëmurë është gjë e vështirë!

Para Jusufit mos bëj naze, mos pretendo për bukuri! Mos bëj gjë tjetër veçse të lutesh dhe të mjerohesh si Jakupi!

Kuptimi i vdekjes së papagallit ishte lutje. Edhe ti bëje veten të vdekur në lutje dhe papasje!

Që fryma e Isait të të ringjallë, që të të bëjë të bukur dhe të lumtur siç është vetë!

A bleron guri nën efektin e pranverës? Bëhu dhé që të mbijnë prej teje lule ngjyra-ngjyra!

Për vite të tëra u bëre gur që gris zemra, që u jep zemrave dhimbje; provoje dhe bëhu një herë edhe dhé!

Historia e një muzikanti plak i cili, në kohën e Omerit - Zoti qoftë i kënaqur me të - në ditët e papasjes shkonte në varrezat dhe i binte lirës.

S'e di, a e dëgjove? Në kohën e Omerit ishte një muzikant që i binte lirës shumë hijshëm e shumë bukur!

Nga tingujt e saj, bilbili e humbte veten, një tingull i saj ua shkonte dëgjuesve kënaqësinë njëqind herë!

Tingujt e saj zbukuronin mbledhjet dhe kuvendet; nga zëri i saj shpërthente kiameti.

Zëri i saj tregonte mrekullira si Israfili, u falte jetë trupave të të vdekurve!

Ose i jepte ndihmë Israfilit; edhe elefanti që i dëgjonte këngët e saj, bëhej me krahë!

Një ditë Israfili do t'ia thotë melodisë së tij dhe do t'u japë jetë të vdekurve të kalbur prej qindra vitesh.

Edhe ndër pejgamberët ka që dinë melodi me të cilat atyre që duan u japin një jetë të paçmueshme.

Por ato melodi veshi i zakonshëm nuk i dëgjon sepse, për shkak të këqijave, është në gjendje të fëlliqur.

Njeriu nuk e dëgjon dot zërin e perive sepse është i huaj ndaj të fshehtave të perive.

Ç'është e vërteta, edhe zëri i perive është në këtë botë, por zëri i zemrës është më i lartë edhe se zëri i veshit, edhe se i perive.

Sepse edhe peria, edhe njeriu janë të burgosur; që të dy ndodhen në këtë burg mosdijeje dhe indiferentizmi.

Këndoje në suren Rahman ajetin ku Zoti u drejtohet xhindve dhe njerëzve dhe kuptoje mirë atë!

Meloditë e brendshme të të urtëve në fillim thonë: "O pjesë (copëra) të botës së varfërisë!

Ejani në vete! Këtë iluzion që nxjerr kokë nga varfëria e nefsit, hidheni mënjanë!

O jetë të kalbur krejtësisht në botën e bërje-prishjes! Shpirtrat tuaj të përjetshëm as u trupëzuan, as lindën!

Po të them vetëm pak nga ato melodi, shpirtrat ngrenë kokën nga varret!"

Vëri veshin! Ato tinguj nuk janë larg, por ti s'ke leje t'i thuash!

Dije se të urtët janë Israfilët e kohës. Të vdekurit gjejnë jetë prej tyre, zhvillohen.

Shpirtrat e vdekur ndërsa shtrihen në varrezën e trupit mbështjellë me qefin, nga zëri i tyre hidhen përpjetë e ngrihen.

Dhe thonë: Ky zë është krejt i ndryshëm nga zërat e tjerë, sepse ringjallja është puna e zërit të Zotit.

Ne vdiqëm, u kalbëm krejt, u shkatërruam, por kur erdhi zëri i Zotit, që të gjithë u ringjallëm, u ngritëm!

Le të vijë zëri i Zotit nga pas një pengese ose pa pengesë. Ç't'i ketë dhënë Xhebraili Merjemes duke i fryrë, edhe Zoti atë i jep njeriut!

O njerëz nën lëkurë të kalbur e të shkatërruar nga mosqenia! Kthehuni nga mosqenia me zërin e të Dashurit dhe bëhuni prapë të qenë!

Ai zë, edhe sikur të dalë nga fyti i robit të Zotit, në fakt dhe absolutisht vjen nga Mbreti!

Zoti i tha atij: "Unë jam gjuha, ti je trupi. Unë jam ndjenjat e tua, kënaqësia dhe vuajtja jote!

Ec! Ti je ai që dëgjon me mua, që sheh me mua. Ç'do të thotë të jesh zotërues i të fshehtës? E fshehta vetë je ti!

Meqë në botën e çudirave ti u njohe me të fshehtën "lil'lah", edhe unë u bëra i yti. Sepse "kush bëhet i Zotit, edhe Zoti bëhet i tiji"!

Ty, disa herë të them ti je ti, disa herë, ti je unë. Çfarëdo që të them, unë jam një diell i ndritshëm.

Në çfarëdo vend të ndriçuar me pishtarë të marrësh dritë, në atë vend të gjitha vështirësitë e kësaj bote zgjidhen.

Edhe errësira që nuk e ndriçon dhe nuk e heq dot dielli, nga nefsi ynë ndriçohet si paraditja."

Ademi ua tregoi të bijve emrat personalisht. Nga Ademi u përhapën emrat në qeniet e tjera.

N'daç merre dritën nga Ademi, n'daç nga Ai. N'daç merre verën nga kupa, n'daç nga shtamba!

Sepse këtë shtambë e ka njësuar tejet bukur me kupën. Ajo shtambë fatmiroshe është si ti (e mbushur me hare jo me kënaqësi formale, por të vërteta)!

Mustafai tha: "Ç'lumturi për atë që më ka parë mua dhe që e ka parë atë që ma ka parë fytyrën mua!"

Ai që e sheh pishtarin e ndezur nga një qiri, në fakt ka parë qiriun.

Në këtë mënyrë, po qe se nga qiriu i parë ndizet një pishtar dhe nga ky një pishtar i dytë dhe pastaj një qiri tjetër dhe të vazhdojë ndezja e qirinjve të tjerë me radhë gjer te i njëqindti, ta shohësh qiriun e fundit do të thotë ta shohësh qiriun e parë që është origjina e të gjithë qirinjve.

N'daç merre dritën nga qiriu i fundit, n'daç nga i pari, s'ka asnjë ndryshim!

N'daç shihe dritën nga qiriu i atyre të fundit, n'daç nga qiriu i të shkuarve!

Shpjegimi i hadithit "Në ditët tona janë aromat e mira të Zotit tuaj. Ejani në vete dhe përpiquni t'i nuhatni ato aroma të mira!"

Pejgamberi tha: "Këto ditë do të fryjnë aromat e mira e të pastra të Zotit;

Veruni veshin atyre kohëve, mendja t'u rrijë në ato kohë që t'i nuhatni këto lloj aromash të mira! Mos e humbni këtë rast."

Erdhi aroma e mirë dhe fryu e iku pa e marrë vesh ju... Iku duke i falur jetë kujt deshi.

Arriti një aromë tjetër. Rri zgjuar, rri zgjuar, o shok, që të mos mbetesh edhe pa këtë!

Shpirti me karakter zjarri fitoi prej saj aftësinë për ta shuar zjarrin. Shpirti i pakëndshëm me favorin e saj u bë i këndshëm.

* Shpirti i zjarrtë u shua për shkak të saj. I vdekuri veshi kaftan nga ndriçimi i saj.

Kjo njomështi është njomështia e drurit të Tubas; kjo lëvizje është lëvizja e pemës së Tubas. Kjo nuk u ngjet lëvizjeve të njerëzve.

Po qe se kjo frymë e përjetshme do të zbriste në qiell, mushkëritë e banorëve të qiellit e të tokës do të bëheshin ujë.

Në fakt, nga frika e kësaj fryme të amshuar, qiejt, toka dhe malet u druajtën ta marrin përsipër atë amanet. Këndoje ajetin "U druajtën për ta marrë përsipër atë" dhe shihe!

Po të mos e kishte mali zemrën me gjak nga frika, a thoshte "Nuk e marr dot?"

Kjo aromë e Zotit na u shfaq neve mbrëmë në një formë tjetër, mirëpo vetëm disa kafshata erdhën dhe e mbyllën derën.

Një Llokman u bë peng për një llokmë. Tani është radha e Llokmanit; o llokmë, ti hiqu këtej!

Nxirreni gjembin që i ka hyrë në këmbë Llokmanit për shkak të kësaj llokme vuajtjeje e vështirësie!

Në këmbën e tij nuk ka as gjemb, as hije të gjembit, madje, por ju, për shkak të ambicjes, nuk e dalloni dot!

Ajo që ti e sheh për hurmë, dije se është gjemb, sepse ti je shumë mosmirënjohës, shumë i pasjellshëm!

Kur shpirti i Llokmanit është një trëndafilishte e Zotit, pse këmba e shpirtit t'i preket nga një gjemb?

Ky trup që ha gjemba, është deve. Edhe kush ka lindur nga Mustafai, mbi këtë deve ka hipur!

O deve! Mbi kurrizin tënd ka një deng të tillë trëndafilash që, nga aroma e tyre tek ti janë formuar qindra bahçe trëndafilash!

Mirëpo ti ende priresh kah akacia dhe ranishtja. Si do ta mbledhësh trëndafilin e ngecur nëpër gjembishte?

O ti që, për shkak të këtij kërkimi, vjen rrotull vazhdimisht anë për anë e skutë më skutë! Gjer kur do të thuash "ku është kjo bahçe trëndafilash?"

Gjersa të mos e nxjerrësh gjembin që të ka hyrë në këmbë, syri s'ka për të të parë! Si mund të kthehesh e të vish vërdallë?

Ç'gjë e çuditshme! Biri i Ademit (njeriu) që s'e nxë bota, vërtitet fshehurazi mbi krye të një gjembi!

Mustafai erdhi për të gjetur një bashkëkohës dhe tha: "Fol me mua, Humejra!"

O Humejra, vëre nallanen në zjarr që ky mal të bëhet petale!

Fjala Humejra është femërore. Edhe shpirti është qiellor femëror. Arabët e quajnë shpirtin të gjinisë femërore.

Por shpirti nuk ndalet dot nga femërorja! Sepse shpirti s'ka të bëjë as me femër e as me mashkull!

Edhe nga femërorja lartësohet, edhe nga mashkullorja! Ky nuk është shpirt shtazor që formohet nga lagështira!

Ky shpirt nuk është shpirt që fuqizohet nga buka ose formohet kështu apo ashtu!

Ky shpirt jep kënaqësi, është i këndshëm, është vetë kënaqësia! O ti që përdor pretekste për të arritur synimin! E pakëndshmja nuk e bën njeriun të këndshëm!

Edhe sikur ti të vish në gjendje të ëmbël me anë të sheqerit, mundet që, ndonjëherë, ajo shije të ikë prej teje!

Por kjo s'ka mundësi nëse bëhesh krejtësisht sheqer për shkak besnikërie. A ka mundësi të ndahet shija e ëmbël nga sheqeri?

O shok i këndshëm! Po qe se ashiku e gjen verën e vërtetë e të kulluar në vetvete dhe ushqehet prej saj, domethënë se ai ka arritur një gradë shpirtërore ku mendja humbet (nuk punon më)!

Mendja e pjesshme e mohon ashkun edhe nëse duket se e zotëron të fshehtën!

Eshtë e zgjuar, di, por nuk është asgjësuar. Edhe engjëlli, gjersa të mos jetë bërë i paqenë, është shejtan!

Në fjalë dhe veprim, mendja e pjesshme është shoku ynë. Por kur vjen puna tek përmbajtja, bëhet asgjë!

Meqë nuk e ka kapërcyer qenien, është asgjë. Po s'u bë asgjë me dëshirën e vet, më në fund do të asgjësohet me shtrëngim, pa dashje. Dhe kjo i mjafton asaj.

Shpirti është përkryerje, edhe thirrja e tij, edhe zëri i tij janë përkryerje. Prandaj Mustafai i thoshte Bilalit: "O Bilal, na bëj të qetësohemi, të prehemi;

O Bilal, ngrije lart zërin nga ajo frymë që e fryn nga gjoksi yt, nga ai burim!

Ngrije lart zërin me atë frymë që e pati dehur edhe Ademin, që ua pati marrë mendtë edhe banorëve të qiellit!"

Mustafai ra në dalldi nga ai zë i bukur! Në mbrëmjen e kënaqësisë dhe prehjes, i kaloi koha e namazit!

Dhe nuk e ngriti kokën nga ai gjumë i bekuar; kaloi dhe koha e namazit të mëngjesit dhe erdhi koha e sillës.

Në atë natë prehjeje, shpirti i pastër i tyre para asaj nuseje arriti fatmirësinë e puthjes së dorës.

Ashku dhe shpirti... që të dy janë të fshehtë e të mbuluar. Mos më bëj me turp pse i them Zotit nuse!

I dashur, po të më zemërohej për fjalën, heshtja; pak kohë të më jepte, pushoja!

Por më thotë: "Fol! Kjo fjalë s'është turp! Fjala jote s'është gjë tjetër veç shfaqjes së kazasë dhe kaderit të botës së fshehtë!"

Eshtë turp për atë që s'sheh gjë tjetër veç turpit. Mirëpo shpirti i pastër i botës së fshehtë a sheh turp?

Turpi është i tillë për krijesën injorante, jo për Zotin.

Edhe mohimi, madje, është një kuptim për Krijuesin, kurse po të lidhet me ne, është mënxyrë, është fatkeqësi!

Po qe se tek ne, krahas qindra virtyteve, ndodhet edhe turp, ai turp është për ne siç është kërcelli apo dega për bimën.

Në kandar i peshojnë së bashku, sepse kërcelli apo degët janë pjesë të bimës të lidhura me të si trupi me shpirtin.

Prandaj, të mëdhenjtë nuk kanë thënë kot: Edhe trupat e njerëzve të pastër janë të thjeshtë si shpirtrat e tyre!

Edhe fjalët e tyre janë bërë shpirt pa shenjë dhe të pavarur nga ndonjë kusht, edhe frymët e tyre, edhe trajtat e tyre.

Kurse shpirtrat e armiqve të tyre janë thjesht trup fizik. Ai armik është i padobishëm porsi zari i thyer i lojës së tavllës, përbëhet vetëm nga një emër.

Pasi armiku të futet në dhé, bëhet krejtësisht dhé. Kurse ky hyri në kripë dhe u pastrua plotësisht.

Ajo kripë është një kripë e tillë që Muhammedi fitoi shije dhe bukuri me të, prandaj në ligjëratë është futur fjala "i kripur, i shijshëm"!

Kjo kripë, kjo bukuri dhe shije kanë mbetur trashëgim prej tij; trashëgimtarët janë bashkë me ty, kërkoji dhe gjeji!

Trashëgimtarët janë tek rrinë në praninë tënde, para teje; po ku është prania jote? Janë para teje, po ku është shpirti që mendon fillimin dhe mbarimin?

Po qe se ti pandeh se tek ti ka para dhe pas, do të thotë se je i lidhur pas trupit, je i mangët nga shpirti.

Sipër, poshtë, para, pas janë veti të trupit fizik. Kurse shpirti që është dritësor, s'ka të bëjë me këto veti dhe s'ka anë.

Për të mos rënë në pandehma si dritëshkurtësia, hapi sytë me dritën e atij mbreti të pastër!

Meqë ti i mendon kreun dhe fundin e dukshëm, ndodhesh vetëm e vetëm në këtë botë ankthi dhe hareje. O ti që, në të vërtetë, nuk ekziston! Ku është kreu që s'ekziston, fundi që s'ekziston?

Eshtë ditë me shi; ec gjer në epokën e natës! Ky shi nuk është si shiu që dimë ne; është nga shirat e Zotit!

Aisheja - Zoti qoftë i kënaqur me të - e ka pyetur Mustafanë - paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të - "Sot ra shi. Megjithëse shkove në varrezat, rrobat nuk i ke të lagura! Pse?"

Një ditë, Mustafai shkoi në varrezat bashkë me miqtë për të përcjellë një mikun e tyre të vdekur.

I hodhi dhé në varr, ia ringjalli farën nën dhé.

Këto pemë u ngjajnë njerëzve nën dhé. Nxjerrin duart nga dheu

Dhe u bëjnë njerëzve qindra shenja, u thonë fjalë.

Me gjuhët jeshile, me duart e gjata tregojnë të fshehtat e dheut brenda.

Kanë futur kokët në ujë si rosat. Duke qenë si sorra, janë kthyer në pallonj.

Edhe pse i burgos në kohë të dimrit, Zoti në pranverë i bën sorrat si pallonj.

Edhe në u dhëntë vdekje në dimër, në pranverë i ringjall, i mbush me gjethe, i gjelbëron.

Mohuesit thonë: "Një gjë, kjo, e bërë zakon që në krye të herës. Pse t'ia ngarkojmë Zotit bujar?"

Pavarësisht nga verbëria e tyre, Zoti ka formuar në zemrat e miqve kopshte e vreshta.

Çdo trëndafil që kundërmon në zemër, tregon për të fshehtat e hirit.

Për t'ua ulur hundën mohuesve, aromat e tyre i grisin perdet dhe shëtisin rreth botës.

Përballë asaj arome të zemrës, mohuesit janë si kandrra të zeza, nuk durojnë dot. Ose u përngjasin njerëzve me tru të dobët që s'e durojnë dot zërin e daulles.

E tregojnë veten të zënë e të dalldisur. I mbyllin sytë nga shkëlqimi i vetëtimës.

I mbyllin sytë, por sytë e nivelit të tyre nuk janë sy! Sy është ai që mundet të shohë një strehim.

Pas kthimit nga varrezat, Pejgamberi shkoi pranë Besnikes dhe nisi të bisedojë me të.

Me t'u kapur syri i Besnikes në fytyrën e Pejgamberit, iu afrua, vuri dorën mbi dorën e tij

Dhe, pastaj, e fërkoi pas çalmës, fytyrës, flokëve, rrobave, gjoksit dhe krahëve të tij.

Pejgamberi e pyeti: "Ç'kërkon kështu me nxitim?" Aisheja i tha: "Sot moti ishte me re, ra shi!

Po kërkoj shenjat e shiut në rrobat e tua. Eshtë e çuditshme që po shoh se nuk je lagur nga shiu!"

Pejgamberi e pyeti: "Me se e kishe mbuluar kokën? Cila ishte mbulesa e kokës tënde?" Aisheja i tha: "Rrobën tënde e kisha hedhur si mbulesë mbi kokë."

Pejgamberi tha: "O zonjë me rrobën krejt të pastër! Prandaj Zoti i tregoi syrit tënd të pastër shiun e fshehtë!

Ai shi nuk është nga këto re, por nga një re tjetër, nga një qiell tjetër!"

Shpjegimi i vargjeve të Gjykatësit Senai: "Në dorë të shpirtit ka qiej që ngarkojnë me punë qiejt e botës. Në rrugë të shpirtit ka shumë zbritje, shumë të përpjeta, shumë male dhe dete!"

Bota e fshehtë ka tjetër re, tjetër shi, tjetër qiell, tjetër diell!

Por ai bëhet i dukshëm vetëm për parinë shpirtërore. Njerëzit e tjerë, ngaqë do të ringjallen pas vdekjes, dyshojnë.

Shiu ekziston dhe bie për ta ushqyer botën. Shiu ekziston dhe bie për ta shkatërruar botën.

Dobia e shirave të pranverës është e habitshme, kurse shiu i vjeshtës është si sëmundja e vreshtave.

Shiu i pranverës e ushqen dhe e rrit vreshtën, kurse shiu i vjeshtës e zverdhon, e prish.

Kështu janë edhe dimri, era dhe dielli. Edhe ndikimet e tyre janë të ndryshme dhe sipas kohës. Kështu dije këtë dhe kape fillin e mendimit!

Kjo shumëllojshmëri është edhe në botën e fshehtë. Disa gjëra janë të dobishme, disa, të dëmshme. Disa shira janë bereqet, disa, dëm.

Edhe kjo frymë e Abdallit nga ajo pranverë është. Nga ajo frymë, në zemër dhe shpirt mbijnë gjëra të bukura.

Frymërat e tyre veprojnë mbi njerëzit fatmirë siç veprojnë shirat e pranverës mbi vreshtën.

Por nëse diku ndodhet ndonjë pemë e thatë, mos e shaj erën që i shton jetës jetë!

Era e bëri punën e saj, fryu. Edhe jeta e pranoi nga jeta ndikimin e erës!

Kuptimi i hadithit "Dijeni për pasuri freskinë e pranverës dhe përfitoni prej saj. Sepse ç'u bën ajo pemëve, u bën edhe trupave tuaj!"

Pejgamberi tha: "O miq, mos e mbuloni trupin nga freskia e pranverës

Sepse era e pranverës, siç vepron mbi pemët, ashtu vepron edhe mbi jetën tuaj!

Por ruhuni nga freskia e vjeshtës, sepse atë që u bën ajo vreshtave dhe bistakëve, u bën edhe trupave tuaj."

Ata që e kanë përcjellë këtë hadith, e kanë dhënë kuptimin e jashtëm të tij dhe janë mjaftuar vetëm me kuptimin e tij të jashtëm.

Ata s'dinë gjë për përmbajtjen, për të brendshmen. E kanë parë malin, por nuk e kanë parë dot mineralin!

Sipas Zotit, vjeshta është nefs dhe iluzion. Kurse mendja dhe shpirti janë vetë pranvera dhe përjetësia.

Po qe se ti ke një mendje të fshehtë e të pjesshme, kërko në botë një njeri me mendje të plotë.

Prej tij, mendja jote e pjesshme bëhet e plotë, sepse Mendja e Përgjithshme është për nefsin (frymën, egon, veten) si një zinxhir.

Për rrjedhojë, kuptimi i hadithit me interpretim bëhet kështu: Frymët e pastra janë si pranvera, janë jeta e gjetheve dhe e filizave.

Mos e mbulo veten nga fjalët e të urtëve edhe në qofshin të buta, edhe në qofshin të ashpra, sepse ato fjalë janë ana e dukshme e fesë.

Edhe në të foltë ngrohtë, edhe në të foltë ftohtë, shihe me sy të mirë që të shpëtosh nga të nxehtët e të ftohtët (nga ngjarjet e jetës) dhe nga zjarri i xhehennemit.

Ngrohtësia e tij është pranvera e jetës. Eshtë kapitali i drejtësisë, ndershmërisë, faktit dhe adhurimit.

Sepse bahçet e shpirtit ringjallen me fjalën e tij. Deti i zemrës me këta margaritarë është i mbushur plot.

Po qe se nga bahçja e zemrës pakësohet ndonjë kënaqësi dhe përmbajtje e pjesshme, zemrën e personit me mend në kokë e mbulojnë mijëra ankthe.

Besnikja pyet: "Cila ishte e fshehta e shiut sot?"

* Dashuria e Besnikes mori hov dhe ajo e pyeti Pejgamberin me edukatë:

"O ti, përmbledhja e kësaj ekzistence, cila ishte urtësia e shiut sot?

A ishte ky, ndër shirat e mëshirës, apo ra për kërcënim? Apo mos ishte prej drejtësisë së Zotit të Lartë?

Ky shi, a mos ishte nga favoret e pranverës, apo shi vjeshte plot fatkeqësi?"

Pejgamberi tha: "Ky shi binte për të qetësuar ankthin e rënë mbi zemrën e njerëzve për shkak të fatkeqësive!"

Po qe se njeriu do të mbetej brenda atij zjarri ankthi, do të rrënohej me të tepërt, do të dobësohej dhe s'do të ishte në gjendje të bënte asgjë!

Atë çast, kjo botë do të bëhej gërmadhë, në brendësi të njerëzve s'do të mbetej ambicje.

O shpirt, shtylla e kësaj bote është shkujdesja. Mençuria, syçeltësia janë fatkeqësi për këtë botë!

Mençuria është në atë botë; po të dalë eprore, kjo botë ulet, poshtërohet.

Mençuria është diell, kurse ambicja është akull. Mençuria është ujë, kjo botë është zhul.

Mençuria rrjedh nga ajo botë për në këtë botë vetëm që në këtë botë ambicja dhe smira të mos tërbohen.

Por po qe se rrjedh shumë, në këtë botë s'mbetet as aftësi, as turp!

Kjo temë s'ka fund. Kthehu te fjala që fillove dhe vazhdoje historinë e atij që i binte lirës!

Pjesa e mbetur nga historia e sazexhiut dhe shpëtimi i tij.

Ai ishte një sazexhi i tillë që, prej tij, bota ishte mbushur plot me hare. Nga zëri i tij, dëgjuesit zhyteshin në përfytyrime të çuditshme, binin në gjendje për t'u habitur.

Zogu i zemrës fluturonte me melodinë e tij, mendja admironte zërin e tij!

Por, me kalimin e kohës dhe me plakjen, zemra e tij e fortë si e skifterit, nga dobësia filloi të gjuajë miza!

Shpina iu kërrus, vetullat iu trashën e i u bënë si bisht gomari!

Zëri i tij i këndshëm që i shtonte jetës jetë, u prish, u shëmtua e u bë që t'i gërryente zorrët!

Zëri i tij i bukur që ia kishte zili edhe Venusi, iu bë i ngjashëm me pëllitjen e gomarit.

Fundja ç'gjë e këndshme s'është bërë e pakëndshme? Ose cili tavan nuk është shembur, nuk është shtrirë përtokë?

Vetëm se fryrja e Bririt, zërat e shënjtorëve të lartë që janë reflektime të frymëve, përjashtohen nga kjo; zërat e tyre janë të të amshuar.

Zemrat e tyre janë të të tilla që zemrat dehen prej tyre. Mosqenia e tyre është e tillë që qenia jonë është bërë e qenë nga ajo mosqenie.

Ajo zemër është qelibari (shufra e qelibartë) tërheqëse e çdo mendimi, e çdo zëri. Frymëzimi, revelacioni dhe shija e enigmës prej asaj zemre përbëhen.

Kur sazexhiu u mplak dhe u dobësua shumë, meqë nuk fitonte gjë, u bë nevojtar edhe për një fetë të hollë buke!

Dhe tha: "Zoti im, më dhe jetë të gjatë dhe afat, i bëre favore një personi të ulët.

Shtatëdhjetë vjet të kundërshtova, por ti s'm'i preve të mirat asnjë ditë!

Sot do t'i bie pa shpërblim, do t'i bie për ty. Jam miku yt dhe gjithçka imja është e jotja!"

E vuri lirën në sup dhe doli në rrugë për ta kërkuar Zotin. Duke ofsharë, u drejtua për në varrezën e Medines.

Dhe tha: "Nga Zoti do të kërkoj para për harkun, sepse ai u bën të mira zemrave që janë të sinqerta ndaj Tij."

I ra gjatë lirës dhe qau; e vuri kokën përtokë, pastaj e bëri lirën jastëk dhe u mbështet te një varr.

Sazexhiun e zuri gjumi, zogu i shpirtit shpëtoi nga kafazi i trupit; i la edhe lirën, edhe sazexhiun, u ngrit fluturim e iku.

Duke arritur në një botë të pastër, në hapësirën e shpirtit, shpëtoi nga trupi dhe mundimi i kësaj bote.

Atje, shpirti e këndonte kështu aventurën e vet: Sikur të më linin këtu...

Në këtë bahçe, në këtë kohë pranvere, shpirti do të më bëhej i këndshëm, do të bëhej i dehuri i kësaj fushe, i tulipanëve të kësaj lulishteje të fshehtë.

Dë të bëja udhëtime pa kokë e pa këmbë; do të haja sheqerka pa dhëmbë, pa buzë.

Me banorët e qiellit, do të zhytesha pa lodhje e pa mundim në zikër, pa kokë në mendim, do të thosha fjalë të bukura me ta.

Do të shihja symbyllur një botë, do të mblidhja trëndafila pa duar, pa pëllëmbë.

Sazexhiu ishte një shpend uji, kurse kjo botë, një det mjalti; ky mjaltë ishte burimi ku pati pirë e ku qe larë pejgamberi Ejub.

Duke u larë në atë burim, Ejubi u pastrua nga koka te këmbët nga të gjitha sëmundjet, u bë si drita e lindjes.

Edhe sikur Mesnevija të ishte si vëllim sa qiejt, prapëseprapë nuk do ta përfshinte dot as edhe një pjesë të vogël të kësaj bote.

Mirëpo ato vende qiellore shumë të gjera ma bënë copa-copa zemrën ngaqë ishte e ngushtë.

Kjo është një botë që m'u shfaq në ëndërr dhe, me gjerësinë e saj, m'i hapi krahët.

Po qe se rruga mes këtyre dy botëve do të ishte sheshit, në këtë botë shumë pak vetë do të mbeteshin, vetëm për një çast.

Sazexhiut plak po i vinte urdhri: "Mos bëj pangopësi për të mbetur këtu; meqë gjembi të ka dalë prej këmbe, shko!"

Kurse shpirti i thoshte: "Prit në sheshin e mëshirës dhe mirësisë së Zotit!"

Në ëndërr, Hatifi i tha Omerit: "Merr kaq mall nga malli i shtetit dhe jepja atij njeriu që po fle në varrezë!"

Në atë mes, Zoti i dha Omerit një gjumë që s'e përballoi dot.

I drojtur, Omeri mendoi: "Kjo s'ishte një gjë e zakonshme. Ky gjumë më erdhi nga bota e fshehtë, s'mund të jetë pa shkak!"

E mbështeti kokën dhe fjeti. Në ëndërr, nga Zoti i erdhi një zë që ia dëgjoi shpirti.

Ai zë ishte një zë i tillë që është origjina e tingullit të çdo zëri. Zë i vërtetë ai është, kurse të tjerët janë reflektime të tij.

Të gjithë popujt ngado që janë, e kanë njohur këtë zë pa qenë nevoja e veshit dhe e buzëve.

Jo vetëm njerëzit, të bardhë e të zinj, të kuq e të verdhë, por edhe malet dhe gurët e kanë dëgjuar atë zë.

Në çdo kohë, nga Zoti vjen zëri "A s'jam unë Zoti juaj?" dhe elementet bashkë me simptomat bëhen të qena prej atij zëri.

Ndërkaq, edhe sikur në dukje prej tyre të mos dëgjohet përgjigjja "Po, ti je Zoti ynë!", vetë ardhja e tyre nga mosqenia, krijimi i tyre është përgjigjja "Po, ti je Zoti ynë!"

Thashë për kuptimin e drurit dhe gurit. Dëgjoje menjëherë tani historinë që flet për këtë!

Para se të ngrihej minberi nga predikonte Pejgamberi, ai mbështetej në trungun të quajtur Hannane. Kur u ngrit minberi dhe Pejgamberi u largua nga druri, ai nisi të rënkojë. Edhe sahabet e dëgjuan rënkimin, kurse Pejgamberi foli hapur me trungun.

Për shkak të ndarjes prej Pejgamberit, trungu Hannane nisi të qajë e të rënkojë si të ishte njeri.

Pejgamberi e pyeti: "Ç'kërkon, o trung druri?" Dhe ai iu përgjigj: "Zemra më pikon gjak nga ndarja prej teje!

Mbështeteshe tek unë, kurse tani më le, u ngjite në minber!"

* Pas këtyre fjalëve, Pejgamberi i tha: "O dru i mirë, o ti që je bashkudhëtar i të fshehtës dhe fatit!

Thuaj, çfarë do? Po deshe të të bëj një fidan hurmaje mbushur plot me fruta që të hanë nga lindja e nga perëndimi!

Ose Zoti të të bëjë një selvi në atë botë që të mbetesh përjetësisht i blertë e i njomë!"

Hannane i tha: "Dua të mbetem i përjetshëm!" O njeri i paditur e i shkujdesur, dëgjo dhe mos mbet më poshtë se një dru!

Dhe Pejgamberi e groposi atë trung në dhé që të ringjallet bashkë me njerëzit ditën e kiametit!

Dëgjoje dhe dije edhe këtë që kë ta ftojë Zoti, ai njeri ka hequr dorë nga të gjitha punët e kësaj bote!

Kush meriton ndihmën e Zotit, ka gjetur rrugë për në atë botë, ka dalë nga punët e kësaj bote.

Po qe se dikush nuk ka pjesë nga të fshehtat hyjnore, si mund ta vërtetojë rënkimin e trupave të ngurtë e të pajetë?

E vërteton, por jo nga zemra. Që të mos i thonë hipokrit, bën si ata që e vërtetojnë, e vërteton në dukje.

Po qe se trupat e ngurtë nuk do ta njihnin urdhrin e Zotit "Bëhu" e nuk do të kishin ardhur në këtë botë, atëherë kjo fjalë do të kundërshtohej dhe hidhej poshtë në këtë botë!

Qindramijëra njerëz që imitojnë ose deduktojnë, një imagjinatë mjaft e pjesshme i rrëzon në dyshim.

Sepse të gjitha imitimet dhe deduksionet, madje, të gjitha krahët dhe flatrat u qëndrojnë me anë të pandehmës.

Ai Shejtani i poshtër formon një dyshim dhe të gjithë këta të verbër bien përmbys.

Këmbët e atyre që merren me arsyetime e deduktime, janë prej dërrase dhe këmba prej dërrase është shumë e pafuqishme, shumë e paqëndrueshme.

Kurse kulmi i kohës i cili, me qëndrueshmërinë e vet i lë të mahnitur edhe malet, dhe i cili është tejpamës, s'është i tillë (s'i jep vlerë arsyetimit dhe deduktimit).

Që të mos bjerë me kokë mbi çakëll, këmba e qorrit është shkopi, shkopi!

Kush është ai kalorës që bëhet shkak për epërsinë e ushtarit, domethënë, njeriut të fesë? Mbreti që sheh!

Sado që qorrat e kanë gjetur rrugën me anë të shkopit, prapë në sajë të vëzhguesve.

Po qe se në këtë botë nuk do të ishin vëzhguesit dhe mbretërit, të gjithë qorrat do të kishin vdekur!

Qorrave s'u vjen dore as të mbjellin, as të korrin, as të shesin e të blejnë, as të bëjnë qar e të fitojnë!

Po qe se Zoti nuk do të bënte mëshirë e mirësi për ta, shkopinjtë e tyre të arsyetimit dhe deduksionit do të thuheshin aty për aty!

Ç'është ky shkop? Analogjitë, provat. Kush ua dha atë shkop atyre? Zoti që sheh!

Meqë shkopi është mjet lufte dhe grindjeje, o qorr, thyeje atë shkop, bëje copë-copë!

Ai ju dha shkopinj dhe ashtu dolët në shesh. Pastaj, me zemërim i ratë atij me atë shkop!

O grupi i qorrave! Ç'po bëni, ç'po punoni? merrni mes jush dikë që sheh!

Dhe ti kape për prehri atë që të ka dhënë shkop dhe shih se ç'hoqi pejgamberi Adem nga arsyetimi dhe kundërshtimi!

Vëru veshin mrekullive të Musait dhe Muhammedit! Si u shndërrua shkopi në gjarpër dhe si u bë trungu i mençur!

Shkopi i Musait mori trajtë gjarpri, kurse nga trungu u dëgjuan rënkime. Këto mrekulli i shpallin pesë herë në ditë për ta sqaruar fenë.

Po qe se kënaqësia fetare nuk do të ishte në kundërshtim me arsyen, ç'do të ishte nevoja për kaq prova?

Mendja e pranon çdo gjë që përputhet me arsyen, pa pasur nevojë për mrekullira!

Shihe se kjo rrugë e virgjër është në kundërshtim me mendjen (arsyen) dhe vër re se ky vështrim pranohet nga çdo njeri me fat.

Ashtu siç shejtanët dhe lugetërit rrëqethen nga frika dhe smira e njerëzve dhe ikin nëpër ishuj dhe vende të shkreta,

Edhe mohuesit janë frikësuar nga mrekullitë e pejgamberëve dhe e kanë futur kokën brenda barërave.

Në këtë mënyrë, kanë dashur të jetojnë duke u përmendur si muslimanë por pa dashur të të tregojnë ty se kush janë dhe çfarë besimi kanë!

Ashtu siç i lyejnë kallpazanët paratë kallpe me argjend dhe gdhendin mbi to emrin e mbretit,

Edhe fytyra e jashtme e fjalëve të tyre është tevhid dhe sheriat, por fytyra e brendshme u ngjan farës së egjrës të përzjerë në bukë!

Filozofi nuk ka fuqi ta mohojë fenë ose të hyjë në polemikë me kompetentin e fesë. Po qe se ia hyn kësaj, feja e vërtetë e shkatërron atë!

Duart dhe këmbët e tij janë pa zemër. Ato bëjnë ç't'u kërkojë e urdhërojë zemra e tij.

Edhe nëse filozofët e mohojnë me gojë lëvizjen dhe foljen e gjërave të pajetë, duart dhe këmbët e tyre dëshmojnë paprerë mbi mundësinë e kësaj!

Mrekullia e gurëve të fshehur në dorën e Ebu Xhehlit, që dëshmuan për drejtësinë e Muhammedit - paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të -!

Në duart e Ebuxhehlit kishte copa gurësh. I tha: "O Ahmed, thuaj shpejt, ç'kam në grusht?

Meqë i njeh të fshehtat e qiejve e nëse je pejgamber, ç'fsheh unë në pëllëmbë?"

Pejgamberi i tha: "A unë të them se ç'janë ato, apo ato të thonë se unë jam i drejtë, të më vërtetojnë mua? Cilën do?"

Ebuxhehli tha: "Kjo e dyta është më e çuditshme!" Pejgamberi tha: "Zoti është i aftë për më tej se kaq!"

Menjëherë, secili nga gurët në duar të Ebuxhehlit filluan të dëshmojnë:

"Nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe Muhammedi është i dërguari i Tij!"

Kur i dëgjoi këto fjalë nga gurët, Ebuxhehli i përplasi gurët në tokë me zemërim!

Fundi i historisë së sazexhiut; Emiri i besimtarëve, Omeri, i çon në vend fjalët e Hatifit.

Lëre këtë dhe vëri veshin prapë historisë së sazexhiut që i binte lirës. Pasi sazexhiu u mërzit së prituri,

Omerit i erdhi prapë një zë: "O Omer, shpëtoje robin tonë nga nevojtaria!

E kemi një rob të nderuar; bëj mundim e shko gjer në varrezat!

O Omer, ngrihu, merr shtatëqind dinarë nga malli i shtetit dhe numëroja atij në grusht një e nga një!"

Shko te ai dhe thuaji: "O i nderuar! Tani për tani merr vetëm kaq dhe na shih të justifikuar!

Kaq pak para janë vetëm për harkun! Shpenzoji dhe, kur të të mbarohen, eja prapë këtu!"

Pas kësaj, Omeri brofi në këmbë dhe u përgatit për ta kryer këtë shërbim.

Me qesen e parave nën sqetull, vrapoi drejt varrezave për ta kërkuar dhe gjetur sazexhiun.

Dhe i erdhi rrotull varrezës nga të gjitha anët por nuk pa asnjeri tjetër veç një plaku.

Duke menduar se ai duhet të ishte, i erdhi rrotull edhe një herë; më në fund, u lodh, por prapë nuk pa njeri tjetër veç plakut.

Me vete kujtoi ç'i kishte thënë Zoti për njeriun te varrezat: "Eshtë një robi ynë i vërtetë dhe i nderuar"!

Si mund të ndodhë që një sazexhi i moshuar të jetë nga robtë e vërtetë të Zotit? O enigmë e fshehtë, sa e këndshme je dhe sa e çuditshme!

Ashtu siç vjen rrotull luani që ka dalë për gjah, i ra rrotull edhe një herë varrezës.

Kur e kuptoi mirë se atje nuk ndodhej tjetërkush veç plakut, tha me vete: "Ka shumë zemra që shndërrisin mes errësirës!"

U afrua dhe, duke respektuar me të tepërt rregullat e edukatës, u ul. Omeri teshtiti, kurse plaku u zgjua duke brofur përpjetë.

Kur e pa Omerin, plaku mbeti i habitur. Deshi të ikte, por filloi të dridhej.

Me vete tha: "O Zot! Në dorën tënde! Ja ku më erdhi tani edhe nëpunësi i bashkisë!"

Omeri vështroi plakun dhe kur pa se ishte zverdhur në fytyrë, i tha:

Mos ki frikë nga unë sepse të kam sjellë lajme të mira nga Zoti!

Zoti i lavdëroi aq shumë shprehitë e tua, sa, më në fund, e bëri Omerin ashik të bukurisë sate!

Ulu kështu para meje dhe mos mendo të largohesh. Të të them në vesh disa të fshehta nga bota e fatit të mirë dhe mbarësisë.

Zoti të bën të fala, të pyet për shëndetin dhe për hallet. Si po ja çon me mundimet dhe vuajtjet e panumërta?

Tani për tani merri kaq para si pagesë për harkun dhe, kur të të mbarohen, eja prapë këtu!

Kur i dëgjoi këto fjalë, plaku nisi të përplaset përtokë, t'i kafshojë gishtat, t'i shqyejë rrobat.

Dhe nisi të bërtasë: "O Zot që s'ke të dytë! U tret ky plak i mjerë nga turpi i madh ndaj Teje!"

Pastaj qau për një kohë të gjatë! Më në fund, e përplasi lirën përtokë dhe e bëri copë-copë!

Dhe filloi t'i thotë lirës: "O ti që më je bërë perde mes meje dhe Zotit tim, o ti që më ke nxjerrë nga rruga kryesore e ma ke humbur drejtimin!

O ti që ke shtatëdhjetë vjet që po ma pi gjakun, që po ma nxin fytyrën para zotëruesit të përsosmërisë!

Zoti ynë mirëbërës e besnik! Të të dhimbset jeta ime që më shkoi me faje, mëkate e gabime!

Zoti më dha një jetë të tillë, vlerën e një dite të vetme të së cilës askush në këtë botë s'e di!

Kurse unë e shpenzova jetën në erë duke ia kushtuar tingujve të asaj vegle!

Ah, e kisha harruar kohën e ndarjes së hidhur duke u marrë me melodité arabe e persiane, duke u rënë shkallëve irakiane!

Mjerë për mua që për shkak të melodive të ëmbla, m'u thanë të mbjellat e ndjenjave, zemra më vdiq!

Mjerë për mua që, për shkak të zërit të këtyre njëzet e katër melodive, karvani më iku, dita u mbarua!

O Zot, dëgjoje klithmën e këtij njeriu që vetëm klith e që nuk kërkon ndihmë prej askujt! Ankesa ime është vetëm ndaj vetes time!

Askush nuk më mëshiron, askush s'më jep ndihmë përveç atij që është ndaj meje më i afërt se vetja ime!

Sepse prej tij më vjen çdo çast kjo ekzistencë. Dhe kur më shkatërrohet ekzistenca, vetëm atë shoh, jo tjetërkënd!"

Po qe se dikush të jep para ty, t'i numëron florinjtë në dorë, ti nga ai sheh, jo nga vetja jote! Kësaj i ngjet puna ime!

Omeri e ktheu vështrimin e sazexhiut plak nga vajtimi që është bota e ekzistencës, në dalldi që është bota e dehjes së përkushtimit shpirtëror.

Atëherë, Omeri i tha kështu sazexhiut: "Vajtimi yt është provë që ti i ke mendtë në vend!

Rruga e atij që s'është, është rrugë tjetër, sepse edhe t'i kesh mendtë në kokë është një mëkat tjetër!

Mendtë në kokë shkaktohen nga kujtimi i së kaluarës. Edhe e kaluara, edhe e ardhmja janë perde që e fshehin Zotin.

Hidhi që të dyja në zjarr! Gjer kur do të bëhesh nyje-nyje si fyelli për shkak të këtyre dy perdeve?

Kudo që të ketë nyje, atje s'ka njëtrajtësi; buza nuk mund të jetë e huaj për zërin.

Nëse ti bën tavaf, rrotullohesh rreth vetes tënde, si mund të jesh duke bërë tavaf rreth Qabes? Kur të jesh te vetja jote, si mund të quhesh se ke shkuar në Qabe?

Lajmet nuk dinë gjë për lajmëtarin; Zoti na ruajttë! Janë më keq se mëkati i tij!

O ti që dëshiron të bësh pendesë për të shkuarën! Thuaj se kur do të pendohesh për këtë dëshirë për të bërë vazhdimisht pendesë? Aty i bën kible tingujt e veglës, aty qan e rënkon!"

Kur Faruku u bë pasqyrë e fshehtësive, edhe shpirti i muzikantit plak u zgjua te trupi i tij.

Tashmë, si shpirti, shpëtoi nga të qarët e të qeshurit. Shpirti i iku, u ringjall me një shpirt krejt tjetër!

Atëherë, në zemër i erdhi një mahnitje e tillë që e bëri atë të mbetej edhe jashtë tokës, edhe jashtë qiellit, tërë botën e harroi!

I ra në kokë një dëshirë kërkimi përtej kufirit të kërkimit të zakonshëm, e tillë që unë s'e njoh; në e ditsh ti, thuaje!

Arriti në një gjendje të tillë përtej përjetimit dhe fjalëve, që u kredh dhe mbeti në vështrimin e bukurisë së Zotit!

Por e tillë që të ketë një mundësi shpëtimi ose të jetë dikush që e njeh ose e dallon atë nga deti. Jo, kjo s'ishte një kredhje e tillë!

Po qe se këto fjalë nuk do të shfaqeshin, po qe se shfaqja e vazhdueshme nuk do të bëhej shkak për thënien e këtyre fjalëve, po qe se mendja e pjesshme nuk do të thoshte fjalë që i përkasin mendjes së përgjithshme!

Por shfaqeshin pa pushim njëra pas tjetrës. Prandaj dallgët e detit vinin gjer këtu.

Kur historia e muzikantit plak erdhi gjer këtu, edhe vetë plaku e ktheu fytyrën pas perdes, edhe përjetimi i tij.

Plaku e shkundi pëqirin nga thashethemet; për të, nga goja jonë vetëm një gjysmë fjale mbeti.

E vlen nëse për të vrapuar për këtë të ngrënë e të pirë flijohen qindramijëra shpirtra.

Bëhu i tillë që lind në gjuetinë e pyllit të jetës; bëhu diell i botës dhe luaj me jetën!

Dielli i lartë ka ardhur gjer më sot duke dhënë jetë; duke u zbrazur në çdo frymëmarrje, mbush me dritë.

O diell shpirtëror, jep jetë dhe rinoje botën e vjetër!

Trupit të njeriut i vjen mendja dhe shpirti si ujvarë nga bota e fshehtë.

Shpjegimi mbi lutjet e atyre dy engjëjve, nga të cilët njëri i lutej Zotit që t'i shpërblente ata që ushqenin të varfërit, kurse tjetri, që t'ua shkatërronte pasurinë atyre që e fshihnin atë dhe nuk jepnin; shpjegimi mbi atë person që jepte, i cili ishte luftëtar në rrugën e Zotit dhe jo shpërdorues në rrugën e dëshirave dhe pasioneve.

Pejgamberi tha: "Me qëllim këshille, dy engjëj luten me një zë të këndshëm:

O Zot, ushqeji ata që ushqejnë nevojtarët dhe për çdo dërhem që japin, jepu njëqind mijë të mira!

O Zot, kurse atyre që e kursejnë mallin dhe nuk japin, mos u jep gjë tjetër veçse humbje!"

Mirëpo ka shumë e shumë raste kur kursimi dhe mosdhënia janë më të mira se dhënia. Mos e jep mallin e Zotit përveç se në atë vend që ka urdhëruar Zoti,

Në mënyrë që të fusësh në dorë thesare të panumërta dhe, kështu, të mos hysh në radhët e mohuesve (qafirëve), atyre që e bëjnë mohimin dhunti.

Qafirët bënin kurban deve me qëllim që shpatat e tyre të dilnin mbi Mustafanë.

Për urdhrin e Zotit pyet dikë që ka arritur te Zoti. Çdo zemër nuk e kupton dot urdhrin e Zotit.

Mirësia e pavend i ngjan rastit kur një shërbëtor i ulët u shpërndan njerëzve të ulët mallin e mbretit me pretendimin se po zbaton drejtësinë, se po bën mirësi.

Në Kur'an është një ajet që i frikëson indiferentët, të padituri, duke thënë: "Të gjitha mirësitë e tyre përbëhen nga ndjenja e mallit!"

Drejtësia dhe mirësia e atij njeriu të ulët e largon më shumë atë nga mbreti, ia ul vlerën në sytë e mbretit dhe e bën faqezi.

Edhe parësia e Mekës, kur therte kurban ndërsa luftonte kundër Pejgamberit, kishte shpresë se Zoti do ta pranonte kurbanin.

Pikërisht për këtë, nga frika e mospranimit të Zotit, besimtari thotë vazhdimisht në namaz "ihdinas-siratal-mustakim", "drejtona në rrugën e drejtë"!

Dhënia e parave është e denjë për njeriun bujar. Kurse dhënia e shpirtit është, në thelb, e dhënë e ashikut.

Po qe se, për hir të Zotit, jep bukë, bukë të japin; po qe se, për hir të Zotit, jep shpirt, të dhurojnë shpirt e jetë!

Po u derdhën gjethet e këtij lisi, Zoti i dhuron atij ushqim që t'i dalin gjethet.

Po s'të mbeti mall në dorë për shkak të shpërndarjes së tij, a lejon mirësia e Zotit të të shkelin ty me këmbë?

Kur dikush mbjell, hambari i zbrazet, por e mira e kësaj pune kuptohet në arë!

Por po ta lërë e ta grumbullojë farën në hambar, me kalimin e kohës, e hanë dhe e mbarojnë minjtë!

Kjo botë është krejtësisht e përkohshme dhe e vdekshme; atë që kërkon, kërkoje në botën e qëndrueshme! Forma është e barabartë me zero; atë që kërkon, kërkoje në botën e kuptimit!

Shpirtin e hidhur e të kripur vëre para shpatës, flijoje dhe merre shpirtin që është si një det i ëmbël!

Po s'pate fuqi për ta marrë këtë nga kjo portë, të paktën dëgjoje këtë histori nga unë!

Historia e kalifit të pashoq, i cili në kohën e vet e kaloi Hatemi Taiun në bujari dhe mirësi.

Në kohët e vjetra ishte një kalif që e kishte bërë Hatemiun skllav të bujarisë së tij.

Kishte ngritur lart flamurin e mirësisë dhe drejtësisë, kishte zhdukur nga bota varfërinë dhe nevojtarinë!

Deti dhe margaritarët kishin mbetur pa rëndësi në krahasim me të dhënën e tij, favoret dhe mirësitë e tij ishin përhapur skaj më skaj!

Ai mbret ishte reja dhe shiu mbi këtë tokë. Ishte i merituar i dhuntisë së Zotit mirëbërës dhe shpërblyes.

Deti dhe minierat ishin tronditur përballë mirësisë së tij, ato shkonin me karvane drejt bujarisë së tij.

Dera e tij ishte kibleja e nevojtarisë. Me anë të bujarisë, popullariteti i tij ishte përhapur në tërë botën.

Nga bujaria e tij kishin mbetur të habitur edhe iranianët, edhe grekët; kishin mbetur të mahnitur edhe turqit, edhe arabët!

Lëngu i jetës ishte deti i bujarisë. Prej tij ishte rilindur edhe arabi, edhe iraniani!

Historia e beduinit arab të varfër dhe ndodhia mes tij dhe gruas për shkak të varfërisë.

Një natë, gruaja e një beduini, duke e kapërcyer masën e të folurit dhe të thashethemeve, i tha të shoqit:

"Ne po e heqim tërë këtë varfëri, këtë mundim. Jeta e të tjerëve kalon me kënaqësi. Vetëm ne jemi në gjendje të keqe!

Bukë s'kemi; për djathë kemi vuajtje dhe zili... Shtambë s'kemi, kurse uji janë lotët tanë.

Veshja jonë e ditës është drita e diellit; dysheku dhe jorgani janë natën, drita e hënës!

Nga uria, duke e pandehur drapërin e hënës si simite njëokëshe, e sulmojmë qiellin me duar!

Të varfërit turpërohen nga varfëria jonë dhe ngaqë ne ditë e natë mendojmë për të ngrënë.

Si Samiriu që ikën nga njerëzit, farefis e të huaj, të gjithë ikin prej nesh!

Po të kërkoj një grusht thjerrëzash prej dikujt, më thotë: "Hesht, ngordhç për të ngrënë!"

Krenaria e arabit është lufta dhe mirëbërësia. Kurse, mes arabëve, ti i ngjan një shkrimi të gabuar që duhet fshirë!

Ç'luftë? Fundja ne jemi vrarë e kemi marrë fund edhe pa luftë; me shpatën e papasjes na është prerë koka e fluturuar tutje!

Mirëbërësia ku është? Ne po thurim rrjetë duke u përsjellë rreth papasjes, po zëmë miza e po thithim gjak prej tyre!

Pa le sikur të na vijë ndonjë mik! Mos më thënçin njeri po s'e zhvesha e t'ia grabis rrobat pasi ta zërë gjumi!"

Myridët nevojtarë gënjehen nga pretenduesit gënjeshtarë duke i pandehur ata si shenjtorë; myridët nuk e dallojnë dot paranë në dorë nga veresia, lulen artificiale, nga lulja e mbirë dhe e lulëzuar!

Prandaj, të diturit thanë me urtësi: U duhet shkuar si mik njerëzve mirëbërës e bujarë!

Mirëpo ti je myrid i një njeriu të tillë i cili qëndron më poshtë se ti; atëherë, si ka për të të bërë ty të lartë?

Jo vetëm s'ka për të të dhënë dritë, përkundrazi, do të të nxijë për dreq!

Kur vetë s'është i nurshëm, si do të bëhen të nurshëm ata që takohen e bisedojnë me të?

Ky lloj shehu i ngjet njeriut që i kullojnë sytë e nuk sheh. Sytë i lyen me ilaç, por s'ka mundësi t'i lyejë me gjë tjetër veç ilaçit të dëmshëm!

Në këtë gjendje jemi edhe ne në varfëri dhe vështirësi! Asnjë mik nuk gënjehet të vijë tek ne!

Po s'e pate parë formën e dhjetë viteve ngushticë, hapi sytë e shih nga ne!

Pamja jonë e jashtme si e pretenduesve: zemra e zezë, por gjuha e shkëlqyer!

Te ai s'ka as aromë nga Zoti, as shenjë. Por pretendimi i tij më i madh se i Shitit, më i madh se i Ademit!

Madje atij as Shejtani s'i shfaqet. Megjithëkëtë, ai thotë paprerë: "Ne jemi nga abdallët, madje, më tej!"

Që ta pandehin për dervish, ka vjedhur dhe përshtatur shumë fjalë e shprehje nga gjuha e dervishëve!

Kur flet, e peshon fjalën më shumë se Bajaziti, madje e sheh atë të metë. Kurse nga fytyra e tij e brendshme edhe Jezidi turpërohet!

Ai s'ka pjesë nga buka dhe sofra e qiellit. Zoti s'i ka hedhur para asnjë kockë, madje!

Kurse ai vazhdon të bërtasë: "Unë e kam shtruar sofrën, unë jam veqili i Zotit, jam biri i kalifit!"

Dhe vazhdon: "O njerëz naivë e të poshtër! Ejani, ejani e hani nga sofra e mirësisë dhe bujarisë pa iu penguar kush!"

Dhe ata i mblidhen përreth dhe, sapo i kërkojnë mirësi e bujari, shehu i gënjeshtërt thotë: "Nesër!" Mirëpo e nesërmja s'vjen kurrë!

Për t'i dalë në shesh sekreti i njeriut, duhet pak a shumë kohë e gjatë!

Nën murin tek, a ka thesar, apo çerdhe gjarpri, çerdhe milingonash?

Por gjer kur të dalë në shesh se ai shehu s'është asgjë, edhe nxënësit i mbarohet jeta: ç'kuptim ka se e kuptoi dhe e njohu?

Disa herë, myridi i beson dhe i bindet me besnikëri shehut të rremë dhe pretendent.
Dhe si rrjedhojë e kësaj besnikërie,
arrin në një pozitë shpirtërore të tillë që shehu i tij s'e ka parë as në ëndërr.
Atëherë, as uji dhe zjarri nuk i bëjnë dëm myridit, por për shehun janë të dëmshëm.
Mirëpo kjo ndodh rrallë.

Por ndodh rrallë që, për shkak të shkëlqimit të besimit të nxënësit, gënjeshtra e shehut t'i sjellë dobi atij.

Shehun e pandeh për shpirt, kurse ai i del kufomë, mirëpo për shkak të qëllimit të mirë, nxënësi arrin një pozitë shpirtërore të tillë, që...

Dhe gjendja e tij i përngjet atij që kërkon kiblen në mes të natës. Edhe sikur të mos gjendet kiblja, namazi i tij është i vlefshëm!

Ngushtica shpirtërore e shehut pretendues e gënjeshtar është e fshehtë. Kurse ngushtica e bukës tek ne është sheshit.

Pse ta fshehim këtë si shehu pretendues? Pse të ndjejmë turp e ankth kur kjo s'ka ndonjë dobi?

Beduini i thotë gruas të bëjë durim dhe i tregon asaj për virtytet e durimit dhe papasjes.

Beduini i tha gruas: "Gjer kur do të vazhdosh të kërkosh bukë? Fundja, ç'na mbeti për të jetuar? E shumta iku e shkoi!"

Personi i mençur nuk sheh për pak e për shumë, sepse që të dyja ikin e shkojnë si ujë i rrëmbyer.

N'daç i kulluar, n'daç i turbulluar të jetë uji i rrebeshit, meqë nuk është i vazhdueshëm, mos fol për të!

Në këtë botë, mijëra gjallesa përshkohen e jetojnë pa shqetësime, të kënaqura.

Guguçja e falenderon Zotin që natën mbi pemë, kur ushqimin s'e ka ende gati.

Bilbili e lavdëron Zotin duke i thënë: "O Zot që i përgjigjesh lutjes! Tek ti e kemi sigurinë për ushqim!"

Meqë skifteri e shpreson ushqimin nga dora e mbretit, e ka prerë shpresën nga të gjitha gjërat e pista!

Kështu, zëre nga mushkonja e gjer te elefanti, të gjitha krijesat janë familja e Zotit dhe Zoti është një kryetar familjeje shumë i mirë!

Të gjitha ankthet e zemrës na vijnë nga tymi dhe pluhuri i dëshirave dhe pasioneve tona, i vetë qenies sonë!

Ankthet që na i shkulin rrënjët, i ngjajnë draprit të jetës. Edhe fiksimet se pse kjo kështu e pse ajo ashtu, janë lëkundjet tona!

Dije se sëmundja është një copë nga vdekja. Po të ketë shpëtim, përzeje nga vetja një copë të vdekjes!

Kur nuk ikën dot nga një copë e vdekjes, dije mirë se çdo gjë do të ta derdhin nga koka te këmbët!

Po qe se sëmundja që është pjesë e vdekjes tënde, të duket e ëmbël, dije se Zoti ta bën të ëmbël edhe të tërën, domethënë, vdekjen!

Sëmundjet vijnë si ambasadorë të vdekjes; o ti grykës, mos e largo fytyrën nga ambasadori i vdekjes!

Ai që jetoi ëmbël, në fund vdiq hidhur. Ai s'e shpëtoi dot shpirtin e lidhur pas trupit!

Delet i sjellin nga stani dhe cila të jetë më e ushqyera e më e majmja, atë e therin!

Kaloi nata dhe u bë mëngjes. Gjer kur do të vazhdosh ta tregosh këtë përrallë të artë duke e përsëritur nga e para?

Kur ishe e re, ishe më e kënaqur, kurse tani kërkon flori, mirëpo ti ke qenë flori që më parë!

Ishe një pjergull plot rrush, si u prishe, si mbete pa rrush?

Fruti yt duhet të ishte më i mirë; s'duhet bërë si ata që ia heqin shkëmbin vetes!

Ti je bashkëshortja ime; që punët të shkojnë mirë, duhet që bashkëshortët të jenë në një mendim!

Bashkëshortët duhet t'i përngjasin njëri-tjetrit. Pa shihi çiftet e këpucëve dhe mesteve!

Sikur njëra këpucë t'i vijë këmbës ngushtë, që të dyja s'vlejnë.

A mund të ndodhë që njëri kanat i derës të jetë i madh e tjetri, i vogël? A mos ke parë në pyll një çift prej luani dhe ujku?

Dy thasë, njëri plot e tjetri bosh nuk mund të bëhen barrë e qëndrueshme për devenë.

Unë shkoj në rrugën e kënaqjes me një zemër të shëndoshë; ti pse zë udhën e sharjes dhe qortimit?

E shoqja i tha beduinit: "Lime tekulune ma la tef'alun", "mos fol më shumë se ç'të takon"! Megjithëse këto fjalë që the janë të drejta, kjo pozitë dorëzimi nuk është e jotja. Thënia e fjalëve më të larta se pozita jote dhe puna që bën, të dëmtojnë ty, atëherë shfaqet konkluzioni "Kebure makten indallah", "ndodhi ajo që urrehet në lartësinë e Allahut"!

Burri i matur i foli fjalë të tilla të shoqes me sinqeritet, duke iu djegur zemra, gjer në mëngjes.

Kurse gruaja i bërtiti: "O ti që s'ke gjë tjetër veç nderit! Më shumë se kaq s'e dua magjistarinë tënde!

Ik, shko! Për këtë çështje mos fol më! Mos rri duke folur përçart për mendjemadhësinë dhe madhështinë!

Gjer kur këto fjalë të bukura, të hijshme por pa bukë? Shih gjendjen tënde, shih punën tënde dhe turpërohu!

Mendjemadhësia është e shëmtuar, por tek dilenxhinjtë është më e shëmtuar. Dita është e ftohtë, vendin e ka mbuluar bora... T'i kesh edhe rrobat të lagura!...

O ti që e ke shtëpinë sa një fole merimange! Gjer kur do të vazhdojë ky pretendimi yt, mendjemadhësia, dëshira për t'u dukur, madhshtia jote?

Kur e ndriçove ti shpirtin me kënaqjen me pak? Kësaj gjëje ti vetëm emrin i mësove!

Pejgamberi tha se kënaqja është thesar. Por ti s'e ndan dot kënaqjen nga mundimi dhe vështirësia!

Kjo kënaqja s'është gjë tjetër veçse një thesar i pashtershëm. O ti që i jep zemrës ankth dhe dhimbje, mos u zhyt më në fjalë të kota!

Ec, mos më thuaj mua "ime shoqe", mos më trego afërsi! Unë jam e shoqja e maturisë, jo e dredhisë!

Pse flet vazhdimisht për mbret e për bej? Nga varfëria ti vret miza!

Përfytesh me qentë për një kockë, rënkon si fyelli bosh!

Mos më shih mua keq, ashtu si horr se s'dua të t'i them të fshehtat që të vërtiten brenda në damarë!

Të duket vetja më i mençur se unë; po unë, si të dukem? Shumë poshtë, apo jo!

Mos m'u hidh sipër si ujk i shëmtuar. Më mirë të mos jesh i mençur sesa të kesh mend, si ti, që të të turpërojnë!

Kur mendja të bëhet rreth i hekurt i lidhur rreth këmbëve, ajo s'është mendje, por gjarpër dhe akrep!

Allahu të qoftë hasmi i hileve dhe padrejtësisë tënde, dora jote e hiles mos t'u zgjattë gjer tek unë!

Sa e çuditshme që ti je edhe gjarpër, edhe magjistar! O arab, ti je gjarpër dhe gjarpër i shëmtuar!

Po qe se sorra do ta kuptonte shëmtinë e vet, do të tretej si bora nga dëshpërimi!

Magjistari, si armik, i këndon gjarprit magji; edhe gjarpri e magjeps atë!

Po qe se magjia e gjarprit nuk do të ishte kurth për njeriun që merret me gjarprinjtë, a do të gënjehej ai me magjinë e gjarprit, a do të merrej me të?

Kur magjistarin e zë ambicja e fitimit, nuk e kupton dot se gjarpri po e magjeps.

Atëherë, gjarpri i thotë: O magjistar, eja në vete! Mjeshtërinë tënde e pe, shihe edhe magjinë time!

Ti mua më magjepse me emrin e Zotit, në këtë mënyrë, deshe të më shfaqësh para popullit.

Mua më lidhi emri i Zotit, jo ato veprimet e tua. E bëre emrin e Zotit kurth; qofsh i turpëruar!

Hakun tim prej teje emri i Zotit ka për ta marrë! Zotit ia kam lënë në dorë edhe shpirtin, edhe trupin tim!

Ngaqë më plagose në nder, emri i Zotit ose ta këputtë damarin e qafës, ose të burgostë si unë!"

Në këtë rrugë, gruaja i lexoi me fjalë të ashpra burrit të saj të ri shumë shkrime.

Burri e këshillon gruan të mos i shohë të varfërit me përçmim, të mos i ngjisë mangësi punës së Zotit, të mos i qortojë të varfërit dhe varfërinë duke imagjinuar varfërinë e vet.

Beduini tha: "O grua, ti a je grua, apo ati i hidhërimit dhe dëshpërimit? Për mua, varfëria është një gjë për t'u krenuar; mos më sulmo!"

Malli dhe paratë janë si qylafi në kokë. Kush fshihet nën qylaf, është qeros!

Kurse, po t'i bjerë qylafi njeriut me flokë të bukura e kaçurrela, ai duket edhe më i bukur!

Njeriu i Zotit (njeriu i drejtë e i ndershëm) është si sy. Eshtë më mirë që syri të jetë i hapur se i mbyllur.

Duke e shitur skllavin, tregtari i skllevërve ia heq edhe të mbathurat.

A e zhvesh po të ketë skllavi ndonjë të metë? Përkundrazi, përdor çdo hile për ta treguar skllavin të veshur!

Dhe i thotë blerësit: Ky ka turp nga çdo gjë, nga e mira e nga e keqja, nga e qena e nga e paqena! Po ta zhvesh, do të turpërohet e do të druhet prej teje!

I pasuri është zhytur në turp gjer te veshët, mirëpo ka pasuri dhe pasuria ia mbulon turpet!

Për shkak të pangopësisë, i pangopuri nuk i sheh të metat dhe turpet e të pasurit. I pangopuri i pranon të gjitha zemrat!

Edhe sikur i varfëri të duhet si flori, për cohën e tij s'gjendet treg, fjalën askush s'ia dëgjon!

E papasja nuk është gjë që e kupton ti, prandaj papasjen mos e shih me sy përbuzës!

Sepse të varfërit kanë prej Zotit të Lartë dhunti shumë të mëdha përtej mallit e pasurisë materiale!

Zoti i Madh është i drejtë; si mund të ndodhë që të drejtët t'u bëjnë padrejtësi njerëzve të varfër e të pashpresë?

A mund të ndodhë që dikujt t'i japin të mira nga të gjitha llojet, kurse tjetrin ta hedhin në zjarr që të digjet?

A mund të pritet një punë e tillë nga Zoti që ka krijuar dy botët?

A mos është fjalë e kotë dhe e pabazë hadithi "elfakru fahri", "varfëria është krenaria ime"? A nuk fshihen në këtë fjalë mijëra gjëra të larta, mijëra dhunti?

Më vure llagape me zemërim; unë jam miku i njeriut të dashur, e bëj për vete atë, mirëpo ti je një gënjeshtare, magjistare!

Po ta zë gjarprin, ia shkul dhëmbin dhe, kështu, e shpëtoj nga shtypja e kokës,

Sepse ai dhëmb është armiku i jetës së tij. Në këtë mënyrë e bëj unë armikun mik!

Unë kurrë nuk bëj magji nga pangopësia; unë e kam vënë poshtë pangopësinë!

Zoti mos e thëntë! Unë s'kam pangopësi ndaj njerëzve. Ngaqë jam i ngopur e i kënaqur me atë që kam, në zemër kam një botë të tërë!

Ti sheh kështu nga maja e dardhës! Pa zbrit një herë poshtë që të mos mbetet më dyshim!

Po të rrotullohesh pak, fillojnë të të merren mendtë dhe, atëherë, të duket sikur shtëpia po të rrotullohet... Mirëpo je ti që po rrotullohesh!

Vështrimi dhe veprimi i çdokujt varen nga pozita ku ndodhet. Çdokush e sheh botën nga dritarja e vështrimit të vet. Xhami blu e tregon diellin blu; xhami i kuq, të kuq. Xhami pa ngjyrë është i bardhë, pa ngjyrë. Xhami pa ngjyrë tregon më drejt se të gjithë xhamat e tjerë. Xhami pa ngjyrë është koka, është prijësi i të gjithëve!

Ebuxhehli e pa Ahmedin dhe i tha: "Nga bijtë Hashim doli një fytyrë e shëmtuar!"

Ahmedi i tha: "Edhe pse e kalove masën, drejt fole!"

Ebu Bekri, Besniku, e pa Ahmedin dhe i tha: "O diell! S'je as nga lindja, as nga perëndimi! Shkëlqe me bukuri dhe zbukuroje gjithësinë me dritë!"

Ahmedi i tha: "O i vyer, o ti që ke shpëtuar nga kjo botë e pavlerë! Drejt fole!"

Ata që ndodheshin aty, e pyetën Pejgamberin: "O i madhi i njerëzve! këta të dy thanë fjalë të kundërta me njëra-tjetrën, kurse ti ua miratove fjalët që të dyve! Pse?"

Pejgamberi u tha: "Unë jam një pasqyrë e shkëlqyer e Zotit. Njerëzit shohin tek unë atë fytyrë që kanë!"

O grua! Po qe se mua më sheh si të pangopur, ngjitu më lart se ky hetim femëror!

Të flasësh për ngopjen dhe kënaqjen me atë që ke, i ngjet pangopësisë, por, në të vërtetë, është mëshirë! Ç'kërkon pangopësia në atë vend ku ndodhet kjo dhunti?

Edhe ti, provo nja dy ditë papasjen dhe shihe dyfish pasurinë në papasje!

Duroje papasjen dhe lëre këtë ankth. Sepse lartësia hyjnore e Zotit i cili është hyjnësisht i lartë, është papasja dhe varfëria!

Dhe shih mijëra shpirtra të mbytur në detin e mjaltit për shkak se janë të kënaqur e të ngopur që shesin uthull!

Shih qindramijëra shpirtra që vuajnë nga papasja... Ata shijojnë shijen e ëmbëlsirës së gatuar me trëndafila!

Eh, sa keq! Sikur tek ti të ndodhej aftësia për të kuptuar dhe nga shpirti im të shfaqej fitili i qiririt të zemrës!

Kjo fjalë është qumësht në gjirin e shpirtit. Po të mos ketë kush ta thithë, nuk rrjedh mirë!

Po qe se dëgjuesi është i etur dhe kërkues, predikuesi flet edhe në qoftë i vdekur!

Po qe se dëgjuesi është i ardhur i ri dhe i pamërzitur, edhe predikuesi memec flet si bilbil!

Kur nga porta më hyn brenda një i huaj, njerëzit e shtëpisë futen pas perdes, fshihen.

Por po të vijë një njeri i njohur, i afërt dhe i padëmshëm, njerëzit e shtëpisë që e mbulojnë dhe e fshehin veten, i hapin perçet.

Të gjitha gjërat e bukura, të këndshme e të hijshme bëhen për syrin që sheh.

Si ndodh që tingujt e hollë, të mesëm e të trashë të bien për veshin e shurdhër?

Zoti nuk e bëri kot më kot miskun erëmirë! Aromën e krijoi për atë që e ndjen jo për atë që s'ka nuhatje!

Zoti ka krijuar tokën dhe qiejt dhe midis tyre shumë dritëra dhe bukuri.

Tokën e ka bërë për banorët e tokës, kurse qiellin, vendbanimi për qiellorët.

Njeriu i ulët është armik i lartësisë. Kërkuesi i çdo gjëje del vetvetiu në shesh!

O femër e mbuluar, a mos u stolise ti ndonjëherë për qorrin?

Ç'të të bëj kur, edhe sikur të kesh margaritarë sa bota, s'ka se kush t'i merr?

O grua, Lëre zemërimin dhe grindjen! Dhe në mos i lënç këto, lërmë mua!

Unë nuk mund të grindem me të mirë e të këqij, unë s'kam punë me grindje dhe zënie. Jo nga lufta, por nga paqja, madje, zemra më dridhet!

Po heshte, sa mirë! Ndryshe, që këtë çast ngrihem, lë shtëpi e katandi e iki!

Gruaja e beduinit vjen në rrugë dhe bën pendesë për fjalët që ka thënë.

Me ta parë të shoqin të rreptë e të zemëruar, gruaja nisi të qajë. Fundja, të qarët është kurthi që përdorin gratë.

Ajo tha: "A këtë prisja unë prej teje? Unë shpresoja gjë tjetër!"

Duke hyrë në rrugën e mohimit të vetvetes, gruaja tha: "Unë nuk jam gruaja jote, por pluhuri i këmbëve të tua!"

Trupi e shpirti, ç'të kem, janë të tuat; urdhri i yti, vendimi i yti!

Nëse durimi m'u mbarua për shkak të papasjes, edhe kjo, jo për mua, por për ty!

Ti m'u bëre mua shërim në kohë vuajtjesh, pra nuk dua të jesh nevojtar!

Kjo s'është për mua, por për jetën tënde! Kjo e qarë dhe e rënkuar vetëm për ty!

Unë dua që, për hir të Zotit, në çdo frymëmarrje ta flijoj veten për ty!

Jeta t'u bëftë kurban! Eh, sikur shpirti yt ta kuptonte këtë?

Por kur ti re në pandehma të tilla për mua, u mërzita edhe nga shpirti, edhe nga trupi.

O qetësi e zemrës sime! Me të më dalë kështu, kundër meje, i hodha dhé edhe arit, edhe agjendit!

Ti më je edhe në shpirt, edhe në zemër! E ndërsa është kështu, për një gjë kaq të vogël kërkon të ndahesh prej meje!

Forca është në dorën tënde, mund të ndahesh; vetëm se, në përgjigje të këtij qëllimit tënd, po të kërkoj falje nga zemra!

Kujtoji ato kohë kur unë isha e bukur si një idhull kurse ti, para meje, i ngjaje një shamani që i falet idhullit.

Kjo skllave është e varur prej teje; zemra e saj është ndriçuar dhe djegur sipas dëshirës tënde. Po qe se më thua "piqe këtë gjë", unë menjëherë të them si u poq, madje, u dogj!

Unë jam spinaqi yt; po të duash më gatuaj me të thartë, po të duash, me të ëmbël...

Të fyeva, por ja, erdha në vete! Me shpirt dhe zemër, e jotja!

S'e vlerësova dot karakterin tënd të mrekullueshëm. Para teje u gomarisa paturpësisht!

Por pasi rregullova një qiri nga falja jote dhe e ndeza, bëra pendesë dhe e lashë kundërshtimin.

Po të vë para shpatën me qefinin, po të zgjas qafën dhe po të them: bjeri!

Po e thekson ndarjen e hidhur. Bëj ç'të duash, vetëm këtë mos e bëj!

Në zemrën tënde është një kërkues faljeje i fshehtë që flet në emër tim i cili, edhe po të mos jem unë, përpiqet për mua!

Ai kërkues i fshehtë faljeje në emër tim në zemrën tënde, është karakteri yt. Meqë i besoj atij, zemra kërkoi ta fajësojë atë!

O burrë i zemëruar me moralin më të bukur, më të ëmbël se njëqind koshere mjaltë! Edhe ti ki mëshirë për mua fshehtazi dhe nga zemra!

Duke folur kështu, hapur e bukur, gruas i erdhi për të qarë.

Dhe kur e qara me ngashërime e asaj bukurosheje e cila me bukurinë edhe të asaj fytyre të përlotur, i tërhiqte zemrat, e kaloi masën,

Nga ai shi lotësh shpërtheu një vetëtimë, në zemrën e atij burri të pashoq ra një shkëndijë.

Po qe se e dashuruara e cila është robëreshë e fytyrës së bukur të njeriut të dashur, fillon ta shprehë admirimin e saj të robëruar, ç'ndodh, në ç'gjendje vjen njeriu?

Po qe se e dashura e cila ta luan zemrën vendit me vendosmërinë e vet, e cila të bën të dridhesh ngaqë të mban për shumë të madh, fillon të qajë mu para syve të tu, në ç'gjendje bie ti?

Po qe se bukuroshja e cila i bën zemrat gjak me nazet dhe indiferentizmin e saj, fillon të të lutet, ç'ndodh?

Po qe se e dashuruara, vuajtjet e së cilës janë kurth për ne, fillon të na kërkojë falje, ç'justifikim mund të gjejmë ne, si mund të shpëtojmë?

Si mund të shpëtojnë njerëzit nga gjërat që Zoti u ka dhënë bukuri e stoli sipas argumentit "e zbukuroi njeriun"?

Zoti e krijoi femrën të afërt për mashkullin; atëherë, si mund të ndahej Ademi nga Havaja?

Sado trim të jetë burri, prapëseprapë, në marrjen e vendimit është rob i gruas!

Edhe Muhammedi, madje, ndaj të cilit bota ishte dehur me fjalët e Ademit, thoshte: "Bisedo me mua, Humejra!"

Në të vërtetë, uji është epror ndaj zjarrit, por kur uji të futet në një enë, zjarri e bën të valojë me vrull!

Po qe se mes zjarrit dhe ujit ndodhet një tenxhere ose poçe argjile, zjarri e bën ujin të zjejë, pastaj të avullojë duke u zhdukur krejtësisht si ujë!

Ashtu siç uji është epror në pamje ndaj zjarrit, edhe ti je epror ndaj gruas, por, në të vërtetë, je i dobët ndaj saj, je ti që e kërkon atë!

Një dobësi e tillë është vetëm te biri i njeriut. Sepse te njeriu ka afërsi dhe dashuri. Afërsia dhe dashuria te kafshët është e pakët dhe kjo është pasojë e mangësisë së kafshëve si qenie.

Femrat e mundin njeriun e mençur, kurse njeriu injorant del fitues mbi to!

Pejgamberi ka thënë: "Gratë dalin fituese me të tepërt ndaj njerëzve të mençur, ndaj njerëzve të ndjeshëm!"

Kurse injorantët dalin fitues mbi femrën, mbi gratë. Sepse ata sillen ashpër dhe në mënyrë trashanike me to!

Tek injorantët ka pak dhembshuri, falje, dashuri. Sepse në natyrën krijuese të tyre mbisundon ana kafshërore.

Dashuria dhe dhembshuria janë cilësi njerëzore, kurse egërsia dhe epshi, cilësi kafshërore.

Femra është dritë Zoti, jo e dashur... Sikur është krijues, jo e krijuar!

Beduini iu dorëzua gruas duke menduar se kundërshtimi dhe dëshira e gruas ishin urdhër i Zotit. Çdo njeri me arsye e di se është dikush apo diçka që e rrotullon gjënë që rrotullohet.

Siç një njeri injorant në çastin e fundit të vdekjes pendohet për injorancën e tij, ashtu dhe beduini u pendua për fjalët që kishte thënë.

Si ndodhi që iu bëra dushman shpirtit të shpirtit tim? Si ndodhi që t'i hidhja shkelma kokës zemrës sime?

Sapo të na vijë e shkruara, na i mbulon sytë që mendja të mos na i shohë ku e kemi kokën e ku, këmbët!

Kur kalon ajo që ka qenë e shkruar për të ngjarë, njeriu fillon ta hajë veten. Ai që i griset perdja, që i del e fshehta sheshit, gris jakën.

Beduini i tha të shoqes: "O grua, u pendova! Edhe nëse jam bërë qafir, tani po bëhem musliman!

Jam fajtor para teje, të të vijë keq për mua! Mos më shkul nga rrënjët, mos më hidh të tërin poshtë!"

Po qe se qafiri plak pendohet, fillon të justifikohet, të kërkojë falje, dhe bëhet musliman!

Prania hyjnore është e mbushur plot me mëshirë dhe bujari. Edhe qenia është e pasionuar pas saj, edhe mosqenia!

Edhe mohimi është ashik ndaj Zotit të Lartë, edhe besimi; edhe bakri është rob i atij eliksiri, edhe argjendi!

Ashtu siç janë të varur helmi me kundërhelmin dhe errësira me dritën ndaj dëshirës së Zotit, ashtu dhe Musai dhe Faraoni janë të varur ndaj dëshirës së Zotit. Faraoni i lutet Zotit në vetmi që t'ia ruajë nderin nga copëtimi!

Edhe Musai ka teorikisht një rrugëdalje, edhe Faraoni. Por në dukje, Musai ka rrugëdalje, kurse Faraoni, jo.

Musai qau dhe rënkoi ditën para Zotit, kurse Faraoni qau në mes të natës dhe tha:

"O Zot, ç'është ky zinxhir në qafën time? Po të mos e kisha pasur këtë zinxhir në qafë, kush do të mund të më dilte para me pretendimin se është dikush?

S'ka dyshim se me vullnetin tënd që e ndriçove Musain, më zhyte mua në errësirë!

Me dëshirën tënde që e bëre Musain fytyrëndritur si hënë, ma bëre shpirtin mua për faqe të zezë!

Ylli im s'është më i mirë, më me fat se hëna... Po u zu, ç'shpëtim kam unë?

Populli i bie daulles për mua duke më quajtur Zot, mbret, mirëpo, në të vërtetë, hëna u zu dhe ata u bien tasave për të!

Ata u bien tasave dhe bëjnë zhurmë, por me atë zhurmë e poshtërojnë hënën!

Unë që jam faraon, ankohem për popullaritetin. Edhe ajo që thonë për mua "ti je Zoti ynë" është goditja e tasave për mua që më poshtëron mua!

Edhe Musai, edhe unë jemi rojet e të njëjtës portë! Por në pyllin tënd punon sëpata jote, degët i pret sëpata jote!

Një degë e rrit, tjetrën e pret dhe e hedh!

A ka dorë dega kundër sëpatës? S'bëhet fjalë! A mund të shpëtojë dega nga dora e sëpatës?

Sëpata është e jotja; për hir të asaj fuqie, drejtoji këto shtrembëri me bujarinë tënde!"

Përsëri, Faraoni tha vetmevete: "Ç'gjë e çuditshme! A nuk po lutem unë tërë natën: "o Zoti ynë"?

Kur jam vetëm, bëhem modest, shtrohem. Pse bëhem kështu para Musait?

Si ndodh që, edhe sikur ngjyra e nënzemrës të jetë dhjetë gradë më e ndritshme se ari i kulluar, para zjarrit i nxihet fytyra e i bëhet zi!

A s'më janë edhe zemra, edhe kallëpi im nën urdhrin e tij? Dikur më bën tul, dikur, lëkurë!

Dikur më bën hënë të ndritshme, dikur më nxin. Punë e Zotit, tjetër ç'mund të jetë?

Më thotë bëhu e mbjellë, më jeshilon... Shëmtohu më thotë, më zverdhon!

Vrapojmë pa pushim edhe para shkopinjve të Zotit që e ka krijuar qenien me urdhrin e vet, edhe para botës së kufizuar në hapësirë, edhe para botës tej hapësirës!

Kur bota e mungesës së ngjyrave u bë rob i ngjyrës, njëri Musa ra në luftë me Musain tjetër!

Po të arrish në botën e mungesës së ngjyrave, arrin botën ku Musai me Faraonin janë përzjerë.

Po qe se për shkak të kësaj ideje të vijnë ndërmend pyetje të tilla si "Si ndodh që ngjyra shpëton nga thashethemet?"

"Gjë e çuditshme... Megjithëse kjo ngjyrë shfaqet nga bota e mungesës së ngjyrës, si hyn në luftë me mungesën e ngjyrës?"

* "Baza e vajit është nga uji dhe shtohet me ujë. Si ndodh që në fund bëhet e kundërt me ujin?"

"Meqë yndyrën e gatuan me ujë dhe yndyra doli nga uji, pse uji me yndyrën u bënë të kundërtat e njëra-tjetrës?"

"Trëndafili ka dalë nga gjembi, edhe gjembi, nga trëndafili! Megjithëkëtë, pse kanë rënë në luftë, në aventura kundër njëri-tjetrit?" Pra, në qoftë se të vijnë ndërmend pyetje të tilla,

Dije se, ose kjo luftë nuk është në të vërtetë luftë por një urtësi, një hile si zëniet e shitësve të gomerëve, një art,

Ose as luftë e as urtësi, por thjesht habi! Kjo është një gërmadhë brenda së cilës duhet kërkuar thesar!

Ndërkaq, për shkak të gjësë që ti e pandeh për thesar, për shkak të atij iluzioni, ti e humbet thesarin e vërtetë!

Ti njihi edhe iluzionin, edhe masat mbrojtëse, edhe mendimet, si ndërtesa të rregullta e të mirëmbajtura; në vendet e mirëmbajtura e të rregulluara s'mund të ketë thesar!

Në vendet e mirëmbajtura e të rregulluara ka qenie dhe luftë. E paqena turpërohet, fyhet nga qeniet.

Qenia nuk është qarë e ankuar nga mosqenia. Mosqenia e ka larguar e ka asgjësuar atë qenie nga vetja!

Mos thuaj "unë iki nga mosqenia"! Në të vërtetë, ajo ikën nga ti njëzet herë më shumë!

Në dukje, të thërret ty tek vetja, por në brendësi, të ndjek ty me shkopin e përzënies!

Këto punë janë potkonj të mbathur kalit ters për ta gënjyer ndjekësin. O njeri i patëkeq! Urrejtjen e Faraonit për Musain dije si të Musait!

Shkaku i privimit të njerëzve të këqinj nga të dy botët sipas konkluzionit "Pësuan disfatë në botë e në ahiret"!

Ata që i besojnë natyrës, janë të bindur se qielli është një vezë, kurse toka, e verdha e saj!

Dikush tha: "Si qëndron kjo tokë në mes të qiellit që e rrethon?

Si një kandil i varur në ajër, as poshtë zbret, as lart ngjitet!"

I urti u përgjigj: "Mbetet në mes të ajrit për shkak të tërheqjes së qiellit nga gjashtë anë.

Hekuri i derdhur si magnet sferik, mbetet në mes."

Kurse i urti tjetër tha: "Qielli i kulluar nuk e tërheq dheun e zi nga vetja.

Por e shtyn nga gjashtë anë. Prandaj toka ka mbetur e varur në mes të erërave të forcave.

Edhe zemrat e njerëzve të përkryer kështu i shtyjnë shpirtrat e faraonëve dhe ata mbeten pa orientim."

I përzënë ata edhe nga kjo botë, edhe nga bota tjetër. Prandaj ndodh që ata të paudhët mbeten të privuar edhe nga kjo botë, edhe nga tjetra!

Po qe se largohesh nga robtë dhe të urtët e Zotit të Madh, dije se ata nuk të pëlqejnë ty, nuk të duan ty!

Ata kanë shufra qelibari që po t'i nxjerrin në dukje, e kthejnë vërdallë qenien tënde si fije kashte, e tërheqin nga vetja.

Po t'i fshehin shufrat e qelibarit, menjëherë të lëshojnë ty në tërbim.

Kuptoje, o i varfër se, ashtu si shkalla shtazore është më poshtë se shkalla njerëzore dhe nën sundimin e saj,

Ashtu dhe shkalla njerëzore, në dorën e të urtëve të Zotit është e mundur si një kafshë!

Ndërsa Ahmedi po i orientonte njerëzit, Zoti i quajti "robtë e mi!" E urdhëroi: "Thuaj: "O robtë e mi!"

Mendja jote i përngjet devexhiut, kurse ti je deveja. Do a s'do, mendja të tërheq ty sipas urdhrit të vet!

Të urtët janë mendja e mendjeve! Edhe mendjet, gjer tek më e fundit, u ngjajnë deveve.

Vështroji ato duke nxjerrë mësim: një prijës, qindramijëra shpirtra!

As prijësin, as devexhiun! Ti gjeje syrin që sheh diellin dhe pastaj vështro!

E gjithë bota rri duke pritur diellin e mbetur në mes të natës, e mbuluar mes errësirave, dhe ditën.

Ja, pra, për ty, dielli i fshehur në molekulë, ja, pra, për ty, luani i fshehur nën lëkurën e qengjit!

Ja, pra, për ty, një det i fshehur nën kashtë! Eja në vete dhe mos vër këmbën me dyshim në atë kashtë!

Por dyshimi i formuar brenda për udhërrëfyesin është mëshira e Zotit.

Çdo pejgamber ka ardhur në botë i vetëm. I vetëm, por brenda tij të fshehura qindra botë!

Bota e madhe bëri magji dhe e fshehu veten brenda një trajte të vogël!

Kokëtrashët e panë atë të vetëm dhe të dobët. A mund të jetë i dobëti miku i mbretit?

Kokëtrashët thanë: "Ai është i vetëm! Mjerë për atë që nuk e mendon fundin!"

Syri i ndjenjës i sheh me përbuzje pejgamberin Salih dhe devenë e tij. Po qe se Zoti dëshiron ta shkatërrojë një ushtri, ia tregon armikun të pakët e të dobët edhe sikur të jetë më i madh në numër e më i fortë. Dhe thotë: "Për ta bërë atë që duhej bërë, ju tregoi juve në sytë e tyre të pakët e të dobët!"

Deveja e Salihut ishte në pamje deve dhe ai fis mizor, për shkak të paditurisë, e theri atë deve!

Për ujë, ngaqë ishin armiq të devesë, u bënë ujë dhe bukë për varrezat!

Deveja e Zotit pinte ujë nga lumi, nga reja. Ata e kursyen ujin e Zotit nga Zoti!

Deveja e Salihut është si trupi i personave të mirë; ata janë kurth për shkatërrimin e të këqinjve!

Më në fund, ç'mjerime i solli atij populli urdhri "hiquni prej devesë së Zotit dhe ujit që pi ajo" dhe si i shkatërroi ata!

Nëpunësi i ndëshkimit të Zotit kërkoi prej tyre një qytet të tërë si dëmshpërblim për gjakun e devesë.

Shpirti është si Salihu, kurse trupi i ngjet devesë. Shpirti është në bashkim, kurse trupi, në nevojë.

Shpirtit të pastër nuk mund t'i shkaktohet dëm. Zoti nuk plagoset.

Askush nuk mund të dalë epror ndaj atyre që kanë një shpirt të tillë. Edhe në qoftë se u vjen dëm, i vjen dëm guackës, jo margaritarit.

Shpirtit të pastër nuk mund t'i shkaktohet dëm. Shpirti i Zotit nuk mund të dalë i mundur ndaj mohuesve, qafirëve.

Shpirti u takua me trupin që i përket tokës dhe u bashkua me të me qëllim që personat e këqinj ta fyenin atë dhe ta shihnin provën e Zotit.

Personi që e fyen shpirtin, nuk di gjë se kjo është fyerje ndaj Zotit, nuk e di se uji i kësaj kupe është bashkuar me ujin e lumit.

Për t'u bërë strehim për të gjithë botën, Zoti krijoi lidhje me një trup fizik.

* Askush nuk mund të dalë fitues mbi zemrat e tyre. Dëmi i vjen guackës prej sedefi, jo margaritarit!

Bëhu rob i devesë-trup të të urtit të Zotit në mënyrë që të bëhesh shok porte i pejgamberit Salih.

Pejgamberi Salih tha: "Meqë u bëtë ziliqarë dhe e bëtë këtë punë, pas tri ditësh do të vijë ndëshkimi i Zotit. Dhe tri ditë pas tij do të vijë nga Zoti një fatkeqësi tjetër vrasëse, e cila ka tri shenja:

Të gjithëve do t'ju ndërrojë ngjyra e fytyrës dhe kur ta shihni njëri-tjetrin, fytyrat do t'ju duken me ngjyra të ndryshme.

Ditën e parë, fytyrat do t'ju zverdhen si shafran, kurse ditën e dytë do t'ju skuqen si jargavan.

Ditën e tretë, fytyrat do t'ju nxihen krejtësisht dhe, pastaj, do t'ju vijë ndëshkimi shkatërrues i Zotit.

Po deshët provë nga unë për këtë kërcënim, ndiqeni të voglin e devesë drejt malit.

Po ta kapni dot, do të gjendet shpëtim për hallin tuaj. Po të mos e kapni dot, zogu i shpresës ju ka ikur!"

* Sapo e dëgjuan këtë fjalë, të gjithë së bashku nisën të lehin si qentë pas tij.

Por askush s'e arriti dot të voglin e devesë i cili humbi mes malesh.

* Si shpirti i pastër nga turpi i trupit, ikte për tek Zoti dhurues e mirëbërës!

Salihu tha: "A e patë se si erdhi ky ndëshkim i Zotit? Tashmë jua goditi shpresën mu në zverk!"

Ç'është i vogli i devesë? Zemra e pejgamberit Salih. Respektojeni atë dhe çojini në vend ato që thotë ai!

Po t'ia fitoni zemrën, do të shpëtoni nga ndëshkimi, përndryshe, kjo do të jetë dita e pendimit dhe e humbjes së shpresës për ju!

Pasi e dëgjuan nga Salihu këtë premtim të turbullt, u vunë të vëzhgonin e të prisnin ndëshkimin.

Ditën e parë panë se iu zverdhën fytyrat dhe, duke mos patur shpresë më, filluan të ofshanin ftohtë.

Ditën e dytë, të gjithëve iu skuq fytyra. Atëherë, e humbën shpresën për pendesë.

Ditën e tretë, fytyrat e të gjithëve u bënë sterrë të zeza. Fjala e pejgamberit Salih doli e drejtë pa diskutim!

Pasi e humbën shpresën të gjithë, ranë në gjunjë me këmbët të mbledhura nën vete si zogjtë.

Këtë përgjunjje, Xhebraili Besnik ia tregoi Pejgamberit në Kur'an duke i sjellë ajetin "Xhasimin".

Përgjunju kur të të mësojnë ç'është përgjunjja si dhe kur të të frikësojnë me këtë lloj përgjunjje, domethënë, para se të të vijë belaja.

Populli i Salihut pritën ardhjen e ndëshkimit të Zotit; ndëshkimi dhe shkatërrimi i Zotit erdhi dhe e fshiu nga faqja e dheut atë qytet.

Salihu doli nga vetizolimi dhe shkoi drejt qytetit dhe pa se qyteti ishte përfshirë nga tymi dhe flakët.

Ai dëgjonte të qara dhe klithma edhe nga copat e tyre që ishin bërë një me tokën; dëgjonte të qara e klithma, por në shesh nuk dukej se kush i lëshonte!

Ai dëgjoi rënkime e ngashërime nga eshtrat; ato derdhnin lot si pika bryme.

Duke e dëgjuar këtë, Salihu nisi të qajë dhe u vu të vajtojë ata që vajtonin për vete:

O popull që ke jetuar në rrugë të shtrembër! Unë i qeshë ankuar Zotit për padrejtësinë tuaj dhe pata qarë.

Dhe Zoti më pati thënë: "Duroji mundimet e tyre dhe këshilloji. Fundja nuk u mbeti shumë kohë nga përmbysja!"

Kurse unë i pata thënë: "Për shkak të padrejtësive dhe mundimeve që më bëjnë, unë nuk mundem t'u jap këshilla. Qumështi i këshillës rrjedh nga dashuria dhe sinqeriteti."

Ju më munduat aq shumë sa qumështi i këshillës më ngriu në damarë!

Zoti më tha: "Unë të bëj të mira e të shpërblej ty dhe u vë melhem atyre plagëve."

Zoti ma kthjelloi zemrën si qielli i kulluar. M'i fshiu nga zemra mundimet tuaja!

Dhe fillova sërish t'ju jap këshilla, t'ju flas, t'ju sjell shembuj si sheqer!

Nxora qumësht taze nga sheqeri dhe u vura t'u shtoj fjalëve të mia mjaltë e sheqer, t'ju jap këshilla të ëmbla!

Ato fjalë vepruan mbi ju si të ishin helm, sepse ju ishit kryekëput burim helmi, minierë helmi, ishit vetë helm!

Si të mos ndjej dhimbje kur dhimbja më ka përfshirë të tërin! O popull inatçor! Ju ishit dhimbja vetë!

A mund të ketë njeri që të qajë për vdekjen e dhimbjes? A mund të gjendet njeri që të shkulë flokë e mjekër sepse i është shëruar plaga në kokë?

Salihu e ktheu shikimin nga vetja dhe tha: "O ti që këlthet! Ata nuk e meritojnë të qash e të klithësh për ta!"

O ti që e këndon Kur'anin drejt! Mos e këndo shtrembër! Si mund të mbaj zi për popullin mizor?

Por megjithatë, nga sytë e nga zemra nisën t'i rrjedhin lot. Tek ai u shfaq një mëshirë e pashkak!

Damarët e lotëve rridhnin si shi; edhe ai vetë po habitej! Ato pika ishin pikat e detit të bujarisë dhe shpirtmadhësisë që pikonin pa shkak.

Duke qarë, mendja i thoshte: "Pse kjo e qarë? A e vlen të qahet për ata lloj njerëzish që talleshin me ty?

Thuaj, përse po qan? A mos për ato që kanë bërë? A mos për ata ushtarë urrejtjeje me fund të keq?

A mos për zemrat e tyre të ndryshkura e të errëta, apo për gjuhët e tyre helmuese si të gjarprit?

A mos për frymën dhe dhëmbët e tyre që u ngjanin atyre të qenve, apo për gojën dhe sytë e tyre shtrat akrepësh?

A mos për kryeneçësinë e tyre, urrejtjen e tyre? Falendero dhe shih se si i burgosi Zoti, se si i shkatërroi!

Me duart të shtrembra, me këmbët të shtrembra, me sytë të shtrembër, me vështrimet të shtrembra, me luftën të shtrembër, me zemërimin të shtrembër...

Me imitime dhe prova logjike të sajuara, i vunë thembrën në kokë këtij plaku të mençur. Me frikën se mos shihen dhe dëgjohen nga njëri-tjetri, nuk u bënë dot të mençur e të gjykueshëm, por gomerë!

Zoti solli në tokë rob të tij nga xhenneti për t'ua treguar të dënuarit me xhehennem!.."

Shpjegimi i ajeteve "Zoti krijoi dy dete që, megjithëse takohen me njëri-tjetrin, nuk përzihen!"

Ata të xhehennemit me ata të xhennetit rrinë në një dyqan. Mes tyre ka një perde, prandaj nuk përzihen me njëri-tjetrin.

Lloji i zjarrit me llojin e dritës janë, në pamje, të përzjerë, por mes tyre është vënë një mal i tërë!

Kjo i përngjet përzjerjes së dheut me floririn. Dheu me floririn janë të përzjerë, por mes tyre ka qindra fusha, qindra konaqe!

Kjo i përngjet ndodhjes gjatë vetëm një nate të margaritarëve të vërtetë me margaritarë imitues në një varg!

Gjysma e detit e ëmbël, e shijshme si sheqer, me ngjyrën të shkëlqyer si hëna.

Gjysma tjetër, e hidhur si helm gjarpri, e pashijshme, me ngjyrën sterrë të zezë!

Edhe ata të xhennetit me ata të xhehennemit lëvizin të trazuar si dallgët e detit poshtë e lart.

Edhe shfaqja njëra pas tjetrës e dallgëve prej një trupi fizik të ngushtë e të vogël, i ngjan përzjerjes me njëri-tjetrin të shpirtrave në paqe e në luftë.

Dallgët e paqes lëshohen dhe i fshijnë urrejtjet nga zemrat. Ndryshe nga kjo, dallgët e luftës lëshohen dhe i përmbysin dashuritë!

Dashuria i tërheq hidhërimet drejt ëmbëlsisë, i ëmbëlson, sepse baza e dashurive është rruga e drejtë!

Kurse persekutimi e tërheq ëmbëlsinë drejt hidhësisë. Po a mund të pajtohen e të ndodhen bashkë e hidhura me të ëmblën?

Hidhësia me ëmbëlsinë nuk shihen me këta sy. Njerëzit tejpamës dinë se si t'i shohin ato nga dritarja e pasojës, përfundimit.

Syri që e sheh të pasmen, mund ta shohë të drejtën. Syri që e sheh të tashmen është krenari, verbëri.

Sa ëmbëlsira ka që janë si sheqer, por brenda atij sheqeri ndodhet i fshehur helmi.

Kush e ka mendjen më të lartë, kuptimin më të mprehtë, kupton nga nuhatja. Kurse tjetri dallon vetëm kur t'i prekë në buzë, në dhëmb!

Shejtani bërtet "hani", por buza e atij njeriu e kundërshton helmin pa i arritur në grykë!

Dikush tjetër e kupton kur t'i ketë arritur në grykë; dikush tjetër e ha dhe e kupton kur t'ia ketë prishur trupin.

Tek një tjetër, helmi bën gabim duke ia prishur abdestin; kohë më kohë formon një hidhësirë që ia shpon mëlçinë!

Tek dikush tjetër, shenja e helmit duket pasi të kalojnë ditë e muaj. Kurse te dikush tjetër, shfaqet pasi të ketë vdekur dhe pasi të ketë fryrë briri.

Po qe se atij personi i kanë dhënë afat në varr, patjetër do ta ndëshkojnë në ditën e ringjalljes.

Çdo bar e çdo sheqer ka një afat formimi në kohën e vet.

Që tulipani të fitojë ngjyrë, shkëlqim dhe hijeshi nën veprimin e diellit, duhet të kalojnë vite.

Barërat e thjeshta rriten në dy muaj, por trëndafilit të kuq i duhet një vit që të rritet e të japë gonxhe.

Prandaj, Zoti i Lartë e ka treguar exhelin, domethënë, afatin e fundit të çdo gjëje në suren En'am.

E dëgjove? Çdo qime të të bëhet vesh. Kjo që dëgjove është eliksir, të bëftë mirë!

Këtë fjalë mos e quaj fjalë, quaje eliksir. Dhe shihe këtë fjalë si një shpirt krejt të ri në trupin e shkronjave të vjetra.

O shok! Dëgjo edhe një fjalë tjetër! Kjo fjalë është, në të njëjtën kohë, edhe e hapur, në shesh, si shpirti, edhe e fshehur në një formë mjaft të hollë.

Vjen vendi që ky helm gjarpri, me anë të veprimeve të Zotit, bëhet mjaft i ëmbël e i shijshëm.

Në një vend është helm, në një vend, ilaç. Diku është mohim, herezi, diku plotësisht i denjë dhe me vend.

Atje i jep dëm shpirtit, por këtu kthehet në shërim!

Lëngu i rrushit aguridhe është i thartë, por kur piqet, ëmbëlsohet, zbukurohet.

Pastaj, kur hyn në koritën e tharmimit, hidhësohet, bëhet haram... Me t'u bërë uthull, vlen si ushqim!

Eshtë e papërshtatshme që myridi, duke vepruar me paturpësi, të bëjë të njëjtin veprim që bën edhe i urti. Sepse hallva nuk i bën dëm mjekut, por i bën dëm të sëmurit. Të ftohtit dhe bora nuk e dëmtojnë rrushin e pjekur, por aguridhen, sepse ajo është në rrugën e pjekjes... "Gjersa Allahu të t'i falë ty mëkatet e kaluara e të ardhshme!"

Po të hajë prijësi helm, i bëhet mjaltë, por po të hajë ndjekësi i tij, i errësohet dhe i dëmtohet mendja!

Sulejmani ka thënë: "O Zot, jepmë mua!" Domethënë, këtë mbretërim dhe forcë mos ia jep tjetërkujt veç meje.

Ose është lutur: "Mos e favorizo tjetërkënd veç meje!" Kjo i përngjet zilisë, por nuk është.

Këndoje nga zemra fjalën "Nuk është i denjë". Të fshehtën "Pas meje" mos e pandeh për koprraci të tij.

Për më tepër, ai pa qindra dëme dhe rreziqe nga mbretërimi. Mbretërimi botëror është kryekëput dyshim shpirti dhe frikë koke!

Me frikën për jetën, frikë shpirti dhe feje. Nuk mund të ketë provë tjetër si kjo për ne!

Duhet të jetë një njeri i vendosur si Sulejmani që të heqë dorë nga këto qindramijëra ngjyra dhe aroma!

Me gjithë fuqinë dhe forcën që kishte, vala e atij mbretërimi ia zinte frymën edhe Sulejmanit!

Kur i hodhën sipër pluhur e dhé për shkak të këtij dëshpërimi, atij i erdhi keq për të gjithë mbretërit e botës.

Dhe tha: "Ki mirësinë dhe këtë mbretërim që ma dhe mua, jepua edhe atyre që kanë arritur përkryerjen."

Kujtdo që t'ia japësh, t'ia dhurosh këtë mbretërim me mirësinë tënde, ai është Sulejmani dhe Sulejmani jam unë!

Ai nuk përfshihet në vendimin për të mos ia dhënë dikujt tjetër veç meje; ai është me mua. Por ç'domethënë "me mua"? Ai person është, pa diskutim, unë!

E kemi të detyruar ta shpjegojmë këtë, por ne prapë po kthehemi në historinë e atij beduinit me të shoqen.

Fundi i historisë së beduinit me të shoqen.

Fundin e historisë së bashkëshortëve e kërkon zemra e një njeriu të sinqertë e parimor.

Historia e beduinit me të shoqen është përrallë, por ti dije atë si alegorinë e nefsit (egos, frymës) me mendjen.

Kjo gruaja me burrin janë fryma me mendjen. I duhet patjetër edhe të mirit, edhe të keqit!

Të dy janë rob dhe të burgosur të këtij vatani prej dheu. Natë e ditë në luftë, në aventura!

Gruaja kërkon pa pushim nevojat e shtëpisë, nderin e shtëpisë, domethënë, bukën dhe dinjitetin që i duhen shtëpisë.

Si gruaja, edhe fryma ose egoja, për t'i gjetur një zgjidhje çdo gjëje, herë shtrihet përtokë duke treguar thjeshtësi, herë kërkon dinjitet e lartësim!

Kurse mendja nuk di gjë për këto dëshira. Në idenë e saj nuk ka gjë tjetër veç shqetësimit për Zotin.

Fytyra e brendshme e kësaj historie është ky kurth, është aventura mes egos dhe mendjes, por ti dëgjo të tërën e faqes së jashtme.

Po qe se tregimi vetëm i kuptimit do të ishte i mjaftueshëm, njerëzit e botës do të mbeteshin krejtësisht pa punë e pa gjë, rregulli dhe harmonia e botës do të prisheshin e shkonin.

Po qe se dashuria do të përbëhej vetëm prej mendimit dhe kuptimit, nuk do të mbeteshin as trajtat e jashtme të dukshme të agjërimit dhe namazit tënd, do të asgjësoheshin!

Dhuratat që i japin miqtë njëri-tjetrit janë vetëm gjëra formale në krahasim me vetë miqësinë.

Mirëpo këto dhurata dëshmojnë për dashurinë e cila ndodhet e fshehur në zemra!

Sepse, o i shtrenjtë, mirësitë formale e të dukshme janë dëshmitarë të dashurive të fshehta!

Edhe dëshmitarët bëhen disa herë vërtetues të drejtësisë së çështjes, disa herë gënjeshtarë, mohues të saj. I dehuri, disa herë bëhet i dehur nga vera, disa herë, nga dhallti!

Edhe ai që pi dhallë, mund ta tregojë veten të dehur. Bën zhurmë dhe duket i dehur.

Edhe hipokriti duket i agjëruar, fal namaz me qëllim që njerëzit ta pandehin për të dehur të dashurisë ndaj Zotit.

Gjëja që formohet nga veprimet që i përkasin trajtës, janë krejt tjetër, por janë shenjë e gjësë që ndodhet e fshehtë në zemër. Zoti ynë, na e prano lutjen dhe na pajis me aftësi dalluese që ta ndajmë atë shenjë të shtrembër e gënjeshtare nga e drejta!

Si mund të zotërohet kjo aftësi dalluese? Po qe se njeriu sheh me dritën e Zotit, atëherë e arrin këtë aftësi dalluese.

Edhe sikur të mos e arrijë, madje, e nxjerrin në shesh shkaqet. Si, p.sh., farefisnia... Farefisnia e bën të ditur dashurinë.

Por personi që ka për prijës besimin dhe dritën e Zotit, nuk u bëhet rob as shenjave, as shkaqeve.

Dashuria rritet në zemër duke u ndriçuar dhe, më në fund, njeriu që dashuron shpëton nga shenjat.

Ai s'ka nevojë ta bëjë të ditur dashurinë, sepse dashuria e ka përhapur dritën e vet në të gjithë botën!

Për ta plotësuar këtë fjalë, ka shumë e shumë hollësi; kërkoji!

Në të vërtetë, kuptimi shfaqet nga kjo trajtë, por, në një aspekt, është afër kuptimit, në një aspekt, larg kuptimit!

Në lidhje me provën, kuptimi dhe trajta janë si uji dhe pema. Po t'i shohësh nga natyra, janë krejtësisht të ndryshme nga njëra-tjetra.

Ti lëri natyrat dhe veçoritë dhe trego për hallin e bashkëshortëve që kërkonin rizk, pjesë nga të mirat e kësaj bote.

Beduini ia plotëson kërkesën gruas dhe i betohet se në këtë nënshtrim ai nuk ka hile dhe nuk po e bën këtë për ta vënë në provë.

Beduini i tha: "Hoqa dorë nga ndarja. Vendimi është yti! Hiqe shpatën nga milli dhe urdhëro!

Ç'të më thuash, do të ta plotësoj pa parë nëse urdhri yt është i mirë apo i keq!

Do të të bëhem fli, sepse të dua. Dashuria e verbon njeriun, e shurdhon."

Gruaja e pyeti: "A me të vërtetë më do, apo kërkon me dredhi të ma mësosh të fshehtën?"

Burri i tha: "Për Zotin që i di të fshehtat dhe që e ka krijuar Ademin e zgjedhur nga dheu (të dua)!"

Megjithëse i dha Ademit një shtat prej tre arshin, Zoti ia tregoi të gjitha ç'ka në shpirtra e në tabela!

Zoti ia mësoi atij çdo gjë nga pafillimi gjer në pambarim dhe ia tregoi të gjitha emrat e sendeve.

Kështu, engjëjt u mahnitën nga mësimi që Zoti i dha Ademit, dhe e humbën toruan!

Me miratimin e tij, arritën një shenjtëri tjetër.

Triumfit që merituan në sajë të Ademit, nuk ia kanë arritur dot as ata të qiellit.

Për hapësirën e atij shpirti të pastër të Ademit, edhe fusha e shtatë kat qiej, madje, vinte e ngushtë!

Pejgamberi tha: "Zoti ka thënë që nuk e nxënë tokë e qiej, madje as arshi,

Por sa e çuditshme është që e nxë zemra e besimtarit, prandaj, në e kërkojmë atë, duhet ta kërkojmë në zemrat besimtare!"

Zoti tha: O ti që ruhesh nga gjërat e ndaluara dhe të dyshimta! Hyr mes robve të mi që, në këtë mënyrë, të arrish lumturinë për të më parë mua!

Me gjithë bukurinë dhe gjerësinë e tij, edhe arshi, madje, kur e pa Ademin, lëvizi nga vendi!

Arshi ka një madhështi të pafundme por ç'është trajta para kuptimit?

Çdo engjëll thoshte: Më parë ne kishim marrëdhënie të afërta me tokën.

Mbillnim në tokë farën e shërbimit dhe adhurimit. Dhe habiteshim me lidhjen dhe interesimin që kishim për tokën.

Megjithëse ishim krijuar prej qielli, ç'ishte kjo prirja jonë për tokën?

Ne jemi dritë, pse kjo afërsi me errësirën? A mund të jetojnë drita me errësirën?

O Adem! Ajo afërsi qenkej nga kundërmimi yt. Sepse endja e trupit tënd ishte toka.

Trupin tënd prej dheu e endën në tokë; bukurinë tënde të pastër aty e gjetën.

Afërsia që shpirti ynë gjeti nga shpirti yt, më parë shndërriste nga dheu ku u gatua trupi yt.

Mbi tokë ishim, por nuk e dinim; nuk kishim njohuri për thesarin e groposur aty.

Dhe kur Zoti na urdhëroi të udhëtonim që aty për në qiej, ky ndërrim vendi na erdhi i hidhur.

Prandaj, duke bërë arsyetime, i thamë Zotit: "Zoti ynë, kush do të vijë aty në vend tonë?"

Dritën e dëshmisë për ty e të madhërimit tënd po ua shet thashethemeve.

Urdhri i Zotit na e shtroi para mëshirën e tij duke na thënë: "Thoni hapur, ç'kërkoni!"

Siç do të bënte fëmija i vetëm i përkëdhelur, thojeni pa u drojtur ç't'ju vijë nëpër gojë!

Sepse edhe sikur fjalët tuaja të jenë të pahijshme, mëshira ime e kalon ndëshkimin tim.

O engjëj, për ta nxjerrë në shesh këtë, po ju lëshoj në zemra dyshim.

Ju të flisni, kurse unë të mos zemërohem, të mos ndëshkoj. Në këtë mënyrë, edhe ai që e mohon butësinë time, të mos hapë gojë!

Në çdo frymëmarrje, nga butësia jonë lindin qindra baballarë e qindra nëna, zhyten në mosqenie e shkatërrohen.

Butësia dhe dhembshuria e atyre nënave dhe baballarëve janë shkumba e detit tonë të butësisë dhe dhembshurisë. Shkumba vjen e shkon, kurse deti mbetet, është i përjetshëm.

Jo, ç'thashë? Para atij margaritari, kjo guaskë prej sedefi nuk është shkumbë, por shkumba e shkumbës!

Ja, pra, për hir të asaj shkumbe, për hir të atij deti, kjo fjalë nuk është një provë, një fjalë e thënë për fjalë.

Kjo ka ardhur nga dashuria, besnikëria, nënshtrimi dhe dorëzimi. Për hir të Zotit para të cilit kam për të dalë!

Po qe se kjo dëshira ime është, sipas teje, provë, provoje provën time!

Mos e fshih të fshehtën tënde që e fshehta ime të dalë në shesh! Urdhëro me sa më vjen për dore, me sa kam fuqi!

Mos e fshih prej meje atë që ke në zemër, që edhe ajo që kam në zemër unë, të dalë në shesh dhe, në këtë mënyrë, ta pranoj atë që mund të bëj!

Por si t'ia bëj, ç'kam në dorë unë? Pa shih një herë, për ç'punë vlen shpirti im?

Gruaja i tregon të shoqit rrugën për të kërkuar të mira, dhe ai e pranon.

Gruaja i tha: "Ka lindur një diell dhe gjithë bota është ndriçuar prej tij!"

Ai është dorëzanësi i Zotit, zëvendësi i tij. Për shkak të tij qyteti i Bagdatit është si pranverë!

Po të arrish te ai mbret, bëhesh mbret. Gjer kur do të rrish duke shkuar pranë atyre që s'kanë mbarësi?

Miqësia e njerëzve që kanë mbarësi është si eliksir. Ku ka eliksir si vështrimi i tyre?

Kur syri i Ahmedit ra mbi Ebubekrin, ky u bë Besnik me një miratim!

Burri i tha gruas: "Si pranohem unë te mbreti? Si mund të shkoj pranë tij pa pasur ndonjë pretekst?

Për këtë duhet ndonjë shkak, ndonjë pretekst. A mund të ketë profesion pa mjete?"

Mexhnuni dëgjoi se Lejlaja ishte sëmurur.

Sa, keq, - tha, - si mund të shkoj pa pretekst? Po të mos shkoj, po të mos e pyes për hallin, ç'bëhet halli im?

Eh, sikur të isha një mjek i njohur! Atëherë shkoja me vrap te Lejlaja!

Zoti e urdhëroi Muhammedin të na ftonte ne dhe kjo ftesë u bë pretekst që të na ikte turpi.

Po qe se zogjtë e natës do të kishin aftësi për të parë në dritë, do të fluturonin dhe do të shihnin edhe ditën!

Gruaja iu përgjigj: "Po qe se mbreti bujar shfaqet në shesh dhe e tregon veten, mungesa e mjeteve kthehet në mjet."

Mjeti vetë është pretendim dhe qenie, kurse aftësia e vërtetë është mungesa e mjetit dhe thjeshtësia.

Beduini tha: "Si të bëj allishverish pa mjete për ta fituar mungesën e mjetit?

Edhe për sinqeritetin tim duhet një provë që mbretit t'i vijë keq për hallin tim.

Ti tregomë një dëshmitar tjetër veç fjalëve dhe dredhive, që ai mbret të ketë mëshirë!

Sepse kjo dëshmi prej llafesh dhe hilesh të këqija është faj para atij sunduesi të sunduesve!

Dëshmia e të sinqertit duhet të jetë drejtësi që drita t'i shkëlqejë pa folur (që t'i kuptohet halli pa folur)!"

Duke pandehur se atje ka mungesë uji, Beduini kapërcen shkretëtirën për t'i çuar dhuratë kalifit një shtambë me ujë shiu!

Gruaja i tha: "Drejtësi është të zhvishesh e të pastrohesh krejtësisht nga ç'ke e nuk ke, dhe ta braktisësh dëshirën."

Në shtambë kemi ujë shiu. Kjo është e gjithë kamja jote.

Merre këtë shtambë me ujë, shko te mbreti i mbretërve dhe çoja si dhuratë!

Dhe thuaji: "Ne s'ke asnjë lloj pasurie tjetër veç kësaj. Po kështu, në shkretëtirë nuk ka ujë më të mirë se ky!"

Edhe pse thesari i mbretit mund të jetë i mbushur plot gjëra të rënda, ujë si ky s'ka. Ky ujë gjendet pak.

Ç'është shtamba? Një gjë e llojit të varrit tonë, kurse brenda saj është uji i ndjenjave dhe dhimbjeve tona!

Zoti ynë! Pranoje këtë shtambën tonë nga bujaria e ajetit ku thuhet se Zoti bleu jetët dhe pasurinë e besimtarëve në shpërblim të xhennetit!

Dhe mbaje pastër nga të gjitha llojet e ndyrësive ujin e kësaj shtambe me pesë lëfyte të formuar nga pesë ndijimet tona!

Në këtë mënyrë, nga kjo shtambë të formohet një rrugë për në det dhe shtamba jonë të marrë natyrën e detit.

Dhe kur t'ia çosh dhuratën mbretit krejt të pastër, do ta shohë dhe do të kërkojë ta kuptojë.

Pastaj uji i shtambës arrin një gradë që bëhet i pambarueshëm dhe prej tij mbushen botë të tëra!

Mbylli lëfytet dhe mbushe shtambën nga gryka. Zoti urdhëroi: "Mbyllini sytë ndaj dëshirave dhe iluzioneve!"

Beduini thoshte: Kush ka një dhuratë si kjo? Dhe krenohej duke thënë: Me të vërtetë, kjo dhuratë është e denjë për një mbret të tillë!

As gruaja nuk e dinte se atje, mu pranë rrugës rridhte Tigri i ëmbël si sheqer!

Ai rridhte mespërmes qytetit i gjerë si det dhe i mbushur me gjemi dhe rrjeta peshkatarësh!

Shko te mbreti dhe shihe pasurinë dhe madhështinë e tij! Shihi ato vende të cilat lavdërohen si kopshte ku rrjedhin lumenj prej ari!

Në krahasim me atë det kthjelltësie, kuptimi ynë është sa një pikë!

Beduini e fut shtambën në një trastë lëkure, ia mbyll grykën shtambës dhe e qep.

Mirë, tha beduini. Mbyllja grykën shtambës! Me të vërtetë, kjo dhuratë është e dobishme për ne!

Mbështille me një trastë lëkure dhe qepe. Mbreti ta hapë agjërimin me ujin-dhuratë!

Sepse s'ka në botë ujë si ky. Ky ujë është verë e kulluar, burim kënaqësie dhe dëfrimi!

Sepse ata, duke pirë vazhdimisht ujëra të kripura, janë gjithmonë të sëmurë, janë bërë gjysmë të verbër!

Ku ta njohë ujin e ëmbël e të kulluar zogu që jeton në ujëra të kripura?

O ti që e ke vatanin në burimin e ujit të kripur, ku t'i dish ujërat e ëmbla?

O ti që s'ke shpëtuar dot nga ky konak i përkohshëm, ku t'i dish mosqenien, dehjen dhe harenë?

Edhe në i ditsh, i di me të rrëfyer nga yt atë, yt gjysh. Këto fjalë për ty janë si fjalëkryqe!

Po, fjalëkryqe, kriptograme! Këto janë sheshit për të gjithë fëmijët, por s'kanë kuptim!

Përfundimisht, beduini mori shtambën e u nis për udhë. Natë e ditë e barti me vete!

Dhe e çoi shtambën nga shkretëtira në qytet duke u dridhur nga frika se mos ia gjente gjë!

Kurse gruaja në shtëpi kishte shtruar sexhadenë dhe falej e lutej:

"Mbroje, o Zot, ujin tonë nga njerëzit e ulët! Zoti ynë, bëje që ky margaritar të arrijë në det!"

Sadoqë im shoq është i zgjuar e i aftë, margaritari ka mijëra armiq!

Ç'domethënë margaritar? Ky ujë është ujë parajsor, kurse margaritari i vërtetë është sa një pikë e këtij!

Në sajë të qarjes dhe lutjeve të gruas, në sajë të hallit të burrit dhe begatisë së barrës së rëndë që bartte,

Beduini e çoi shtambën gjer në Qytetin e Kalifatit pa ua lënë hajdutëve, pa e thyer në gurë dhe pa u ndaluar gjëkundi!

Atje pa një seli të mbushur plot të mira. Nevojtarët kishin ngritur pritë për të përfituar.

Për çdo çast një nevojtar merrte nga ajo portë ushqime dhe një kaftan.

Ajo portë ishte për muslimanin dhe qafirin, të bukurin dhe të shëmtuarin, si një diell, si shi..., madje, si xhennet!

Ai pa pastaj një grup njerëzish të stolisur në pritje dhe një grup tjetër që priste shërbim në këmbë.

Nga Sulejmani gjer te milingona, çdo njeri i gëzuar. Të gjithë si shpirtra të ringjallur e të mbledhur pas fryrjes së Bririt.

Ata që gënjeheshin nga dukja, ishin mbytur në perla, kurse ata që i jepnin rëndësi fytyrës së brendshme, kishin gjetur detin e kuptimit...

Njerëzit e pandihmë kishin gjetur ndihmë dhe ndihma u ishte kthyer në mirësi!

Ashtu siç i varfëri është i shtënë pas bujarisë dhe bujarit, ashtu dhe bujari është i shtënë pas të varfërit. Po qe se durimi i të varfërit është i madh, njeriu bujar i shkon në portë atij. Po qe se durimi i njeriut bujar është i madh, i varfëri i shkon në portë atij. Ndërkaq, durimi i të varfërit është pjekuri e tij, kurse durimi i të pasurit është e meta e tij.

Nga porta po vinte një zë: O nevojtar, eja! Bujaria, si një i varfër, është nevojtare për të varfërit!

Ashtu si bukuritë që kërkojnë pasqyrë të shkëlqyer e të pluhurosur, edhe bujaria kërkon njerëzit e varfër e të dobët.

Fytyra e të bukurve zbukurohet me anë të pasqyrës. Ata shihen në pasqyrë e stolisen. Edhe fytyra e mirësisë dhe bujarisë duket duke parë tek i varfëri.

Prandaj Zoti, në suren "Ve'd-Duha" e urdhëroi Profetin: "O Muhammed, mos i bërtit të varfërit!"

Meqë i varfëri është pasqyrë e bujarisë, dije mirë se çdo frymë e dalë nga goja e turbullon pasqyrën!

Një lloj bujari e Zotit i nxjerr në shesh të varfërit, kurse një lloj bujarie tjetër e tij u bën me shumicë mirësi atyre.

Në këto kushte, të varfërit janë pasqyra të bujarisë së Zotit. Kurse të varfërit e vërtetë që janë të tillë në sajë të Zotit dhe kanë hequr dorë plotësisht nga qenia, janë bërë dritë e vërtetë.

Të tjerët veç këtyre të varfërve (që s'kanë dhe që kanë hequr dorë nga kamja), janë, në fakt, të vdekur, të cilët nuk ndodhen në këtë portë, por përbëhen prej qëndismës në perde.

Ndryshimi mes personit të etur dhe nevojtar ndaj Zotit dhe personit i cili nuk zotëron diçka që i përket Zotit dhe është i etur ndaj dikujt tjetër veç Zotit.

Ai person është portreti i të varfërit që nuk ka jetë, nuk ha bukë. Mos i hidh kockë figurës së vizatuar të qenit.

Ai nuk është i varfër për Zot, por për kafshatë. Para vizatimit të vdekur mos vër tabakanë me ushqim.

I varfëri për bukë është peshk në tokë. Trajtën e ka trajtë peshku, por ka frikë nga deti, prandaj ikën prej detit.

Ai është zog që ushqehet në shtëpi, nuk është feniks që fluturon në ajër. Ai ha e pi gjëra lëndore; ushqimi i tij nuk është prej Zotit.

Ai është ashik i Zotit për të ngrënë e për të pirë, nuk është ashik i bukurisë shpirtërore.

Edhe nëse fantazon se është ashik i personit të Zotit, Zoti nuk është personi që do; fantazimi i tij është fantazimi i dhënë nga emri dhe atributi i personit të Zotit.

Fantazimi ose iluzioni lind nga atributet dhe kufizimet, kurse Zoti nuk ka lindur dhe nuk është i lindur.

Personi i cili është ashiku, i dashuri i gjësë së ideatuar ose përfytyruar prej tij vetë, i përfytyrimit të vet, si mund të jetë ndër ashikët e Zotit mirëbërës dhe shpërblyes?

Po qe se ashiku ose i pasionuari pas atij përfytyrimi është i sinqertë, i dashuri i tij i figurshëm e tërheq dhe e çon atë drejt së vërtetës përfundimtare.

Kjo fjalë duhet treguar, duhet shtjelluar mirë, por frikësohem nga njerëzit me mendime të vjetra, nga mendimet e tyre të vjetëruara.

Botëkuptimet e shkurtra e të vjetëruara i sjellin mendimit qindra lloje iluzionesh të këqija.

Jo ç'do njeri e ka mundësinë për të dëgjuar drejt. Jo çdo zog mund ta gëlltisë një fik të tërë menjëherë.

Sidomos po të jetë një zog i verbër i zhytur në iluzione të vdekura, të kalbura...

Për figurën e vizatuar të peshkut s'ka rëndësi nëse është tokë apo det. Për faqeziun, ç'bëri sapuni, ç'bëri karaboja!

Po qe se vizaton në letër portretin e një njeriu të mërzitur, ai portret s'ka të bëjë as me mërzitjen, as me harenë.

Në pamje, portreti i vizatuar është i mërzitur, por, në thelb, vizatimi në letër s'mund të jetë i mërzitur! Po kështu, as portreti i qeshur në letër s'mund të jetë i qeshur (letra dhe vizatimi mbi të s'mund të jenë vetë të mërzitur apo të qeshur)!

Mërzitja dhe gëzimi i kësaj bote që s'janë gjë tjetër veçse një gjendje e zemrës, në krahasim me mërzitjen dhe gëzimin e vërtetë, janë vizatim.

Pamja e mërzitur e portretit të vizatuar ka për qëllim pohimin e një kuptimi, kuptimin e mërzitjes së vërtetë.

Po qe se figurat e këtyre hamameve shihen jashtë kornizës së xhamtë, janë si rrobat e varura: të palëvizshme, të pajeta.

Nga jashtë, ti sheh vetëm rrobat. Hiqe rrobën, zhvishu dhe hyr një herë brenda, o shok!

Njerëzit e kalifit e takojnë beduinin për ta pritur me respekt dhe ia pranojnë dhuratën.

Sepse me rrobë nuk ka rrugë për brenda. Trupi nuk di gjë për rrobën, as rroba për trupin!

Beduini arab arriti nga shkretëtirat e largëta në portën e Qytetit të Kalifatit.

Portierët e pritën beduinin dhe e spërkatën, në shenjë respekti, me ujë trëndafili.

Ata ia kuptuan nevojën dhe dëshirën pa folur. Fundja, puna e tyre ishte të tregonin mirësi pa e kërkuar tjetri.

Ata e pyetën: "O më fisniku e më i larti i arabëve! Nga ç'anë je, a je i lodhur nga rruga?"

Beduini u tha: "Po qe se më respektoni, jam fisnik, jam i lartë. Por po të më lini pas dore e të mos më jepni rëndësi, s'kam as fisnikëri, as fytyrë!"

Dhe vazhdoi: "O ju që keni në fytyrë shenja madhështie, o persona me vlera më të këndshme se ari xhaferit!

T'ju shohësh ju vetëm një herë, të takohesh me ju vetëm një herë, e vlen sa për të parë qindra persona, për t'u takuar me qindra bukuri! Për t'ju parë ju, ju qofshin falë malli, pasuria, gjithçka!

O ju që shihni me dritën e Zotit, që keni arritur në këtë gradë, që jeni veshur me moralin e mbretit të mbretërve!

Me shikimin tuaj si eliksir, i shihni njerëzit që i ngjasin bakrit dhe i ktheni në flori.

Unë jam një i varfër që kam ardhur nga shkretëtira duke shpresuar mirësinë e sundimtarit!

Kundërmimi aromatik i mirësisë dhe bujarisë së tij kapi shkretëtirat, veshi thërrmijat e rërës dhe ato thërrmija, madje, u gjallëruan me mirësinë e tij.

Erdha gjer këtu për pará, por, kur arrita, u bëra sarhosh prej jush!"

Dikush vrapoi për te dyqani i bukëshitësit për të marrë bukë, por, me të parë bukurinë e bukëshitësit, dha jetën!

Dikush shkoi në lulishten me trëndafila për të shëtitur e për t'u dëfryer, por fytyra e lulishtarit iu bë vend për të shëtitur e për t'u dëfryer!

Si beduini që piu eliksir nga fytyra e Jusufit ndërsa po nxirrte ujë nga pusi...

Musai shkoi për të marrë zjarr, por pa një zjarr të tillë që hoqi dorë prej zjarrit.

Isai iku për të shpëtuar nga armiqtë. Ajo ikje e ngjiti atë gjer në shtresën e katërt qiellore!

Kalliri i misrit u bë kurthi i Ademit dhe, në këtë mënyrë, qenia e tij u bë kalli për njerëzit: të gjithë u bënë të qenë prej tij.

Zogu i Skifterit bie në kurth sepse kërkon të ushqehet, por, prandaj gjen fat dhe fuqi, bëhet krahu dhe ndalesa e sundimtarit.

Fëmija shkon në shkollë me shpresën se i ati do t'i bëjë dhuratë, do t'i blejë një zog, por, në të vërtetë, për t'u bërë i aftë!

Kur del prej shkolle, bëhet zotërues i shkallës më të lartë. Duke i dhënë rrogë mësuesit, shndërrohet në hënë pesëmbëdhjetë që ndriçon botën.

Abbasi kishte ardhur të luftonte duke ndjekur armiqësi, për të marrë shpagim për fenë e vjetër dhe për ta zhdukur Ahmedin.

Megjithëkëtë, ai dhe të bijtë, në postin e kalifatit, iu bënë mbështetje fesë gjer në kiamet, e nderuan atë pozitë!

Unë erdha në këtë portë për të kërkuar diçka; qysh në korridor u bëra i parë, u lartësova.

Solla ujë si dhuratë me shpresën për të marrë bukë; aroma e bukës më tërhoqi e më çoi gjer në qoshen e xhennetit.

Buka e largoi Ademin nga xhenneti, kurse mua më afroi me banorët e xhennetit.

Si engjëjt, hoqa dorë edhe nga uji, edhe nga buka. Në këtë portë po rrotullohem si qielli, pa patur tjetër zgjedhje.

Në këtë botë nuk ka rrotullim tjetër të pashqetësuar përveç rrotullimit të trupave të ashikëve, të shpirtrave të ashikëve. Çdo gjë lëviz me një synim të caktuar, çdo gjë rrotullohet e përsillet me një synim të caktuar!

Personi i dashuruar pas kësaj bote është i dashuruar pas një muri që i ka rënë dielli. Ai i përngjet personit që nuk e ka lodhur fare mendjen për ta kuptuar se shkëlqimi i murit nuk është i vetë murit por i vjen nga dielli dhe që, për këtë arsye, e ka dhënë veten plotësisht pas murit. Dhe, kur drita e diellit kthehet te dielli, ai mbetet pa të. "Mes tyre dhe gjësë që e dëshirojnë, ka hyrë një ndarje!"

Ata që janë dhënë pas të tërës, nuk e dëshirojnë pjesën. Kush e dëshiron pjesën, mbetet i privuar nga e tëra.

Po qe se pjesa e dëshiron pjesën, i dëshiruari i saj shkon shpejt e shpejt te e tëra e tij dhe atëherë pjesa mbetet e vetmuar.

I dëshiruari pas pjesës u poshtërua, iu bë rob të tjerëve. Ra në det dhe është duke u mbytur, prandaj kapet pas një fijeje bari.

Ai i dashuruar i dobët nuk është i plotfuqishëm që të bëhet shërim për hallin e të dashurit të vet. A të shohë punën e zotërisë, apo punën e vet!

Proverbi i arabëve: Në rënç në mëkat, të paktën bjer me një grua të lirë (jo me një skllave); Në vjedhsh, të paktën vidh margaritar!

Prandaj fjala "në rënç në mëkat, të paktën bjer me një grua të lirë" mbeti si proverb. Prandaj dhe thënia "në vjedhsh, të paktën vidh margaritar" mori kuptimin "kur të priresh ndaj diçkaje, priru ndaj më të mirës"!

Robi, domethënë i dashuruari, shkoi te zotëria, te Zoti i tij. Dashuruesi mbeti duke qarë e rënkuar. Aroma e trëndafilit shkoi te trëndafili, ai i ulëti e i pavleri mbeti i shtangur në vend.

Dhe u largua nga dëshira. Përpjekja iu humb, mundimi që hoqi shkoi kot, këmba iu plagos.

I përngjau gjahtarit që gjuan hije. A mund t'i bëhet hija kapital atij?

Dikush e kishte shtrënguar fort hijen e zogut, kurse zogu në degën e pemës habitej me të

Dhe thoshte: Për çfarë gëzohet ky njeri pa mend? Ja, pra, shkak i rremë, shkak i hedhur poshtë!

Po qe se ti thua se pjesa është e lidhur pas së tërës dhe s'ndahet prej saj, ha gjemb, mos kërko trëndafil se edhe gjembi nuk ndahet nga trëndafili.

Ndërkaq, pjesa është e lidhur pas së tërës vetëm në një drejtim, përndyshe, dërgimi i pejgamberëve nga Zoti bëhej një gjë e kotë e pa kuptim!

Sepse pejgamberët kanë ardhur për t'i afruar njerëzit te Zoti. Po qe se të gjithë do të përbëheshin nga një trup, Zoti me robin (njeriun) dhe e tëra me pjesën do të ishin një dhe, atëherë, kë do ta afronin dhe te kush?

O bir, kjo fjalë s'ka fund. Dita mbaroi, prandaj plotësoje historinë!

Beduini ua jep shtambën me ujë shërbyesve të kalifit.

E dorëzoi shtambën me ujë dhe e mbolli farën e shërbimit dhe respektimit të lartë ndaj selisë mbretërore.

Dhe u tha: "Çojani këtë dhuratë mbretit dhe shpëtojeni nga nevojtaria lypësin e tij.

Eshtë ujë i ëmbël e i shijshëm, i mbledhur nga liqeni i formuar nga ujërat e shiut. Edhe shtamba është e re dhe e bukur!"

Shërbëtorëve të kalifit u erdhi për të qeshur me këto fjalë. Megjithëkëtë, dhuratën e pranuan me gjithë zemër.

Sepse mirësia në natyrën e sundimtarit tejpamës kishte kaluar edhe në natyrën e të gjithë personelit të pallatit.

Shprehitë e sundimtarit ndikojnë edhe mbi popullin. Qielli i blertë e bleron edhe faqen e tokës.

Sundimtari i përngjet hauzit. Kurse personeli shërbyes janë tubat. Uji rrjedh nga tubat.

Meqë të gjitha ujërat që rrjedhin nga tubat vijnë nga një hauz i pastër, nga çdo tub rrjedh ujë i ëmbël e i këndshëm.

Po qe se uji në hauz është i kripur dhe i ndotur, nga çdo tub do të rrjedhë i njëjti ujë.

Sepse çdo tub është i lidhur me hauzin. Ti kridhu mirë në kuptimin e kësaj fjale, ki vëmendje të plotë dhe mendo!

Edhe shpirti që është mbreti i mbretërve i cili nuk ka një vend të caktuar, shih sesi ka ndikuar mbi të gjithë trupin.

Shih sesi edhe mirësia e mendjes me prejardhje të këndshme, e edukon tërë trupin.

Sesi edhe ashku i paqetë, i pavendosur e i brishtë e zvarris trupin në çmenduri!

Për shkak të tejdukshmërisë së ujit të detit si eliksir, copat e zjarrit në fund të tij janë që të gjitha diamante dhe margaritarë.

Për ç'mjeshtëri të jetë bërë i njohur ustai, me ç'mjeshtëri të ketë fituar popullaritet, edhe çiraku përparon në atë mjeshtëri, bëhet i njohur në atë mjeshtëri!

Mendja e shkathët, nxënësi i aftë pranë mësuesit që di shkencën e metodës, mëson metodë.

Kurse pranë mësuesit të drejtësisë, nuk mëson metodë, por drejtësi.

Nxënësi i mjeshtrit të sintaksës bëhet mjeshtër i sintaksës.

Kurse nxënësi i mjeshtrit të shkatërruar në rrugën e së vërtetës, në sajë të mjeshtrit të vet, shkatërrohet te sundimtari, arrin në humbje dhe asgjësim.

Ndërkaq është dituria mbi mosqenien e cila, ndër të gjitha dituritë, vlen në ditën e vdekjes dhe është ushqim rruge në atë rrugë!

Historia e dijetarit të sintaksës.

Një dijetar i sintaksës kishte hipur në një gjemi. Dijetari të cilit i pëlqente vetja, ktheu kryet nga gjemixhiu dhe i tha:

"A ke mësuar sintaksë ti?" Pasi gjemixhiu i tha se s'kishte mësuar, dijetari i tha: "Të paska shkuar gjysma e jetës kot!"

Gjemixhiu u nxeh nga kjo fjalë, iu thye zemra. Megjithëkëtë, nuk u nxitua për t'i dhënë përgjigje por heshti.

Ndërkaq, era e futi gjeminë në një vorbull. Gjemixhiu i thërriti dijetarit:

"Më thuaj, a di të notosh?" Dijetari iu përgjigj: "Nuk di! Mos kërko aftësi notimi tek unë!"

Atëherë, gjemixhiu i tha: "O dijetar i sintaksës! E gjithë jeta të paska shkuar kot! Sepse gjemia ka për t'u mbytur në këtë vorbull!"

Dije mirë se këtu duhet dituria e asgjësimit, jo e shkrimit! Po qe se e di diturinë e asgjësimit, zhytu pa frikë në det!

Uji i detit e mban të vdekurin sipër, por njeriu i gjallë që bie në det, si do të shpëtojë?

Pra, edhe ty, nëse ke vdekur për nga cilësitë njerëzore, deti i të fshehtave të së vërtetës ka për të të mbajtur sipër.

O dijetar, ti i thua popullit gomar, por tani je ti që ke mbetur si gomari mbi akull!

Edhe sikur të jesh më i dituri i botës, tani, për pak sekonda, do të të duhet të shohësh edhe mungesën e kësaj bote, edhe mungesën e kohës.

Mes historisë që kemi në gojë, treguam për dijetarin e sintaksës me qëllim për t'ju mësuar juve sintaksën e asgjësimit!

O i dashuri im i shtrenjtë, në asgjësim gjen edhe njohjen e të drejtës, edhe mësimin e sintaksës, edhe rregullat e matematikës!

Ajo shtamba e ujit ishte njohuria jonë, kurse kalifi, lumi Tigër i njohurisë mbi Zotin.

Ne po i çojmë shtambat e mbushura me ujë për t'i zbrazur në Tigër! Dhe, megjithëkëtë, po s'e ditëm se jemi gomerë, me të vërtetë që jemi gomerë!

Të paktën, beduini arab është i justifikuar, sepse ai ndodhej në një vend shumë të largët dhe s'dinte gjë për lumin Tigër.

Po të dinte, nuk do ta bartte shtambën nga konaku në konak gjer atje!

Madje, po të dinte, do ta thyente shtambën dhe nuk do t'ia hynte aspak kësaj pune!

Ndërsa nuk kishte nevojë aspak për ujë, kalifi e pranoi dhuratën dhe ia ktheu beduinit të mbushur plot flori. Beduini u gëzua së tepërmi!

Kur e mori vesh se si qëndronte puna, kalifi e mbushi shtambën me flori dhe i dha beduinit edhe dhurata të tjera!

I dha dhurata, veshje dhe e shpëtoi beduinin nga varfëria!

* Ai sundimtar i madh, ajo botë mirësie, ai det drejtësie i tha njërit prej njerëzve të tij:

"Jepja atij këtë shtambë të mbushur plot flori. Dhe ktheje me rrugën lumore!"

Se ai ka ardhur nga shkretëtira, kurse rruga nëpër lumë është më e afërt për në vendin e tij.

Kur beduini hipi në gjemi dhe pa lumin Tigër, nga turpi u përkul dhe ra në gjunjë duke thënë:

"Po habitem me mirësinë e këtij sundimtari bujar e shpërblyes! Por çudia më e madhe është se e mori ujin!

Si ndodhi që ai det bujarie e pranoi atë dhuratë të pavlefshme e kallpe?"

O bir! Dije se bota është një shtambë e mbushur gjer në grykë me dituri dhe bukuri!

Por meqë kjo dituri dhe bukuri është e mbushur në mënyrë të jashtëzakonshme, është vetëm një pikë nga Tigri i njeriut të cilin nuk e nxë lëkura e vet!

Ai ishte një thesar i fshehtë. Pse ishte i mbushur plot e përplot, e shfaqi veten. Tokën e bëri më të ndritshme se qiejt.

Duke qenë një thesar i fshehtë, mori vrull dhe tokën e bëri si një mbret që vishet me atllas.

Po ta shikonte beduini një pikë nga Tigri i Zotit, para asaj pike që në të vërtetë ishte një det, do ta hidhte shtambën.

Ata që e shohin atë, ndodhen vazhdimisht në gjendje ekstaze dhe, në këtë gjendje mosqenieje, i kanë thyer dhe hedhur shtambat.

O ti që tregon zell dhe e thyen shtambën! Bëre mirë që e theve shtambën!

Ena thyhet, por uji që ka brenda nuk derdhet. Në këtë thyerje ka qindra gjëra të mira.

Të gjitha copat e enës lëvizin, ndryshohen, por mendja e pjesshme (e shkurtër) e sheh këtë të pamundur.

Në këto kushte, në mes nuk duket as shtamba, as uji. Shihe mirë këtë, Zoti e di se ç'është më e drejtë!

Po t'i biesh derës së kuptimit, ta hapin. Braktise krahun e mendimit që të të bëjnë ty një skifter të madh.

Krahu i mendimit është ngjyer me baltëra, është i rëndë. Ti je mësuar të hash dhé, prandaj dheu të vjen i ëmbël si jeta.

Bukë, mish... Këto janë dhé. Ha më pak prej këtyre që të mos mbetesh mbi tokë si dhé.

Kur uritesh, ti bëhesh si një qen i zemëruar e i paafruar.

Kurse kur e mbush barkun, bëhesh i ndyrë, bëhesh si një mur që qëndron në këmbë duke mos pasur dijeni për asgjë.

Kështu, pra, herë bëhesh i ndyrë e i fëlliqur, herë bëhesh si qen. Si do të ecësh në rrugën e luanëve, si do të hidhesh e vraposh?

Vetëm qeni të vlen ty në gjah. Mbaje parasysh këtë dhe hidhi qenit më pak kocka.

Sepse, po ta ngopë barkun qeni, më keq prapësohet dhe me këtë prapësim a shkon për gjah siç do ti?

Beduinin për atje e tërhiqte varfëria. Më në fund, e pa atë portë, atë fuqi dhe lumturi!

E treguam mirësinë e mbretit për atë të varfër të pastrehë.

Çfarëdo që të thotë i dashuruari në vendin e dashurisë, nga goja i del kundërmim dashurie.

Po të flasë për drejtësinë, nga goja i dalin vetëm fjalë mbi mosqenien; nga ato fjalë vjen kundërmim mosqenieje.

Po të hapë diskutim mbi mohimin, në atë diskutim ka kundërmim feje. Po të thotë fjalë mbi dyshimin, ka treguar sigurinë.

Po të flasë shtrembër, duket i drejtë. Ç'e shtrembër e bukur që e stolis të drejtën!

Ajo shkumbë e shtrembër e shfaqur nga deti i drejtësisë, është dytësore. Parësorja e kulluar e ka stolisur edhe dytësoren me cilësinë e gjësë së kulluar.

Atë shkumbë dije për të kulluar dhe të pranueshme. Quaje qortim të dalë nga buza e të dashurës.

Ai qortim që i dashuruari nuk e pëlqen fort, shihet me sy të mirë për hir të fytyrës së të dashurës.

Sheqerit i jep formë buke; po ta pjekësh, prapë shije sheqeri ka, jo shije buke!

Po qe se një besimtar gjen një idhull të bërë prej ari, a e lë atë në kashtë?

Përkundrazi, e merr dhe e hedh në zjarr, e shkrin dhe ia ndryshon formën.

Kështu, te ari nuk mbetet më trajtë idhulli, sepse trajta është pengesë për adhurimin, është pirat.

E vërteta e atij idhulli, domethënë ari, është mirësi e Zotit. Pastaj i kanë dhënë formë idhulli. Mos e digj qilimin e ri për një plesht. Mos e humb ditën për shkak të dhimbjes së kokës prej një mize!

Po të mbetesh te forma, je idhujtar. Lëre formën e çdo gjëje dhe shihja kuptimin.

Po të shkosh në haxh, kërko shok haxhi; le të jetë indian, turk ose arab.

Mos e shih atë nga forma dhe ngjyra, por nga synimi dhe qëllimi.

Edhe sikur të jetë lëkurëzi, mjafton që ka të njëjtin synim me ty, prandaj ti quaje atë lëkurëbardhë.

Kjo histori u rrëfye copë-copë. Si puna e ashikëve, u përcoll pa kokë, pa këmbë.

Në të vërtetë, s'ka kokë, s'ka as fillim e as mbarim.

Madje është si ujë; çdo pikë e saj është edhe kokë, edhe këmbë: ikën e shkon pa kokë, pa këmbë!

Jo, jo, kjo nuk është ndonjë histori, ky nuk është tregim. Ki kujdes: është gjendja jonë e sotme!

Pranë sufive që zotërojnë forcë dhe fuqi, e kaluara nuk përmendet.

Edhe beduini jemi ne, edhe shtamba jemi ne, edhe mbreti jemi ne, gjithçka jemi ne. Ata që nuk e njohin fundin, nuk e kuptojnë dot këtë.

Mendja është burri, kurse gruaja është fryma dhe natyra. Këto të dyja i përkasin errësirës dhe janë mohues, kurse mendja është dritë.

Tani dëgjo: doli në shesh ai që me të vërtetë mohon, ngaqë e tëra përbëhet prej pjesësh të ndryshme.

Pjesa e kësaj të tëre nuk është si raporti i pjesëve ndaj të tërës; nuk është as si aroma e trëndafilit e cila është pjesë e trëndafilit!

Ashtu siç është hijeshia e blerimit pjesë e hijeshisë së trëndafilit, edhe zëri i kumrisë është pjesë e këngës së bilbilit.

Po qe se vihem t'i tregoj gjërat e vështira në lidhje me këtë çështje, t'u jap përgjigje atyre, kur do t'u jap ujë të eturve?

Po qe se ti ke rënë këtu në gjendje të vështirë, duro. Durimi është çelës për të shpëtuar nga ankthi.

Ruhu prej dyshimeve! Mendimi është luan dhe gomar i egër, kurse zemrat janë pyll.

Pehrizi (ruajtja) është kreu i ilaçeve, sepse kruajtja e shton zgjeben.

Nuk ka dyshim se pehrizi, (ruajtja, përkorësia) është baza e ilaçeve. Bëju i përkorë edhe në mendime dhe shih se sa i fortë do të bëhesh shpirtërisht.

Ti fito aftësi për t'i rrokur këto fjalë si aftësia e veshit për t'i dëgjuar, dhe të të vë ty vathë prej floriri!

Ç'janë vëthët? Bëhesh vetë flori dhe ngjitesh gjer në hënë, gjer në plejadë!

Më parë dëgjoje këtë që edhe shpirtrat e njerëzve të ndryshëm janë të ndryshëm si shkronjat e alfabetit!

Prandaj, edhe pse shkronjat e alfabetit përbëjnë një të tërë, prapëseprapë, asnjëra prej tyre nuk është identike e tjetrës.

Nga njëra anë, shkronjat janë të kundërta me njëra-tjetrën; nga një anë tjetër, të njëjta me njëra-tjetrën; nga njëra anë, të padobishme e tallëse; nga një anë tjetër, krejt të dobishme e serioze!

Dita e kiametit është një ditë e madhe kur Zotit do t'i paraqitet çdo gjë dhe kur do të hetohet dhe vlerësohet nga Zoti. Ajo ditë kërkon personin që do ta paraqesë veten të stolisur.

Ajo ditë dukjeje është dita kur do të vijë radha që fytyrëziu të poshtërohet.

Ai që s'e ka fytyrën si diell, kërkon vetëm natën e cila ia mbulon fytyrën si perçe.

Meqë tek gjembi nuk ndodhet as edhe një fletë trëndafili, pranverat janë bërë armike të fshehtësive të saj.

Por pranverat janë dy sy të ndriçuar për atë që është fund e krye trëndafil dhe stoli.

Gjembi i mangët nga kuptimi kërkon vjeshtën që të mund të ndodhet së bashku me trëndafilishten!

Sepse vjeshta mbulon edhe gjendjen lavdëruese të trëndafilit, edhe të metat e gjembit. Kështu, ti nuk mundesh t'i shohësh as ngjyrën e trëndafilit, as gjendjen e gjembit!

Prandaj vjeshta është jeta e gjembit, pranvera e tij. Sepse në vjeshtë që të dy duken njëlloj.

Por lulishtari e sheh trëndafilin edhe në vjeshtë. Kjo pikëpamje e një personi është më e mirë se pikëpamja e qindra botëve.

Fundja, bota është identitet i atij njeriu të vetëm. Të tjerët janë ndjekësit e tij, ata që përshkohen vetëm në sajë të tij.

Prandaj, të gjitha lulet e bukura thonë pa pushim: "Sihariq, sihariq, pranvera ja ku po vjen!"

Lulet e duan gjithmonë pranverën për të shkëlqyer si ujëvara, frutat, për të lidhur sythe.

Në pranverë, kur bien lulet, nxjerrin kryet frutat. Edhe kur trupi rrënohet, duket shpirti.

Fruti është kuptim, kurse lulja, trajta e tij. Lulja është sihariqi, kurse fruti, e mira.

Sapo të derdhen lulet, shfaqen frutat. Kur lulet të humbasin krejt, frutat duken me të tepërt.

A jep fuqi buka nëse nuk thyhet e hahet? A mund të bëhet verë po s'u shtrydhën veshulet?

Po s'u nxuar esenca e luleve dhe bimëve, si mund të shërbejnë ato si ilaç për shërim?

Kush është piri (plaku, prijësi)? Cilësitë e pirit.

O Husameddin, drita e Zotit! Merr nja dy fletë letre tepër që të të tregoj cilësitë e Pirit.

Ç'është e vërteta, trupi yt është i brishtë e shumë i dobët, por pa ty, punët e botës nuk hyjnë në rrugë.

Në të vërtetë, u bëre dritë dhe qelq. Por je kreu i njerëzve të zemrës dhe prijës i tyre.

Meqë kreu i fillit është në dorën tënde, varet nga dëshira jote. Edhe margaritarët e gjerdanit të zemrave janë mirësia jote.

Shkruaj për gjendjen e Pirit i cili e di rrugën, zgjidhe Pirin dhe njihe atë si vetë rrugën.

Piri është stina e verës, kurse populli, muaj vjeshte... Populli i ngjet natës, kurse Piri, hënës...

Fatit të ri e të njomë ia vura emrin Pir. Por ai është bërë Pir nga ana e Zotit, jo me kalimin e ditëve!

Eshtë një Pir i tillë që nuk ka fillim, është i përjetshëm. Nuk ka të ngjashëm të margaritarit të tillë të vetëm e të pashoq!

Vera e vjetër është parimisht e fortë, sidomos po të jetë verë hyjnore...

Gjeje Pirin se ky udhëtim është shumë i rrezikshëm pa Pirin, shumë i frikshëm, mbushur me fatkeqësi!

Edhe në rrugën që e njeh dhe ku ke shkuar herë të tëra, madje, e humb toruan pa udhërrëfyes.

Eja në vete! Mos shko i vetëm në atë rrugë që s'e ke parë kurrë, mos ia kthe shpinën udhërrëfyesit!

O nopran! Po të mos jetë hija e Pirit, zëri i lugatit të huton, të bën ta humbësh rrugën!

Lugati të dëmton, të pengon nga rruga. Në këtë rrugë humbën e shkuan sa e sa persona shumë më të zgjuar se ti!

Dëgjoje nga Kur'ani se si udhëtarët e humbën rrugën, se ç'u bëri atyre Iblisi me shpirt të keq!

I dërgoi ata në një rrugë qindramijëra vite larg rrugës kryesore, i çoi në fatkeqësi, i la lakuriq!

Shihi kockat e tyre, mbetjet e tyre dhe nxirr mësim; mos e nga gomarin në rrugën e tyre!

Tërhiqe gomarin prej kapistre, fute në rrugë dhe ngaje në rrugën e atyre që e njohin dhe e shohin rrugën e drejtë.

Mos e lër të lirë atë, mbaje për kapistre sepse ai ka dëshirë të shkojë ku ka gjelbërim.

Po qe se e humbe mendjen dhe e le të lirë për një çast, merr rrugë të gjatë drejt çaireve.

Gomari është armik i rrugës; me të parë gjelbërim, dehet. Për shkak të tij, shumë e shumë rob të tij janë lodhur e kanë ngordhur.

Po qe se nuk e di rrugën, ec në drejtim të kundërt me dëshirën e gomarit; rruga e drejtë është ajo, në drejtim të kundërt me dëshirën e gomarit!

Këshillohuni me gratë, por bëni të kundërtën e atyre që ju thonë. Nuk ka dyshim se ata që nuk kanë vepruar në kundërshtim me to, janë shkatërruar!

Bëhu pak mik me dëshirat dhe pasionet, me dëshirat e nefsit, egos tënde, sepse dëshirat dhe pasionet janë ato që të nxjerrin nga rruga e Zotit, që ta ngatërrojnë rrugën.

Asgjë në botë nuk mund t'i thyejë, nuk mund t'i asgjësojë dëshirat dhe pasionet si hija e shokut të rrugës!

Pejgamberi (s.a.s.) e ka porositur Aliun (r.a.) kështu: "Çdokush dëshiron t'i afrohet Zotit me një lloj adhurimi; ti përpiqu t'i afrohesh me anë të bisedës me robtë e mençur e të afërt të Zotit në mënyrë që të bëhesh i pari ndër të gjithë!"

Pejgamberi i tha Aliut: "O Ali! Je luani i Zotit, je i fuqishëm, trim e zemërfortë!"

Por mos u mbështet te fuqia prej luani, mos i beso asaj, por strehohu nën hijen e pemës së shpresës!

Hyr nën hijen e një personi të mençur të cilin nuk do të mund ta largonte askush me anë të rrëfimeve e përrallave!

Hija e tij mbi tokë është si e malit të përrallave dhe shpirti, si i Feniksit, fluturon e përsillet në lartësi të mëdha.

Sikur ta lavdëroj atë gjer në kiamet, nuk mbaroj dot. Mos kërko një prerje, një fund për këtë lavdërim!

Më në fund, kuptoje se dielli e ka mbuluar fytyrën me pamjen e njeriut, është fshehur në pamjen e njeriut. Zoti e di se ç'është më e drejtë!

O Ali, ti zgjidh atë që ndodhet në rrugën e Zotit, strehimin nën hijen e personit që i është afruar Zotit mes adhurimesh!

Çdo njeri u kap pas një lloj adhurimi, u mbajt për vete pas një lloj zgjidhjeje shpëtimi.

Ti ik nën hijen e një personi të mençur që të shpëtosh nga armiku i cili lufton fshehtazi.

Kjo është për ty më e mirë se të gjitha adhurimet. Në këtë mënyrë, i kalon të gjithë ata që kanë përparuar në rrugë, del para të gjithëve.

Sapo të fusësh në dorë një Pir, menjëherë dorëzoju; si Musai, hyr nën urdhrin e Hizrit dhe ec para.

O ti që nuk di se ç'është hipokriti! Bëj durim në punët e Hizrit që ai të mos të thotë "ik, erdhi koha për t'u ndarë!"

Po ta thyejë gjeminë, mos nxirr zë; po ta vrasë fëmijën, mos i shkul flokët.

Meqë Zoti tha se dora e Hizrit ishte dora e tij dhe tha se "dora e Allahut është mbi ta",

Po qe se dora e Zotit e vret atë, prapë e ngjall. Për më tepër, ç'do të thotë ringjallje? Do të thotë dhënie e jetës së përjetshme!

Edhe ai që rrallë e ka kaluar i vetëm këtë rrugë, prapë, me ndihmën e Pirëve e ka kaluar dhe në sajë të tyre ka arritur ku ka dashur të arrijë.

Dora e Pirit s'është e shkurtër, arrin edhe te ata që ndodhen në botën e fshehtë. Dora e tij nuk është gjë tjetër veç kapjes së Zotit.

Po qe se atyre që s'ndodhen pranë u japin një kaftan të tillë, ata që ndodhen në prani, janë, pa dyshim, më të mirë.

Po qe se i ushqejnë e u bëjnë të mira atyre që mungojnë, ç'dhunti nuk vënë para mikut?

Ku ai që lidh brezin e shërbimit në prani të tyre e ku ai që ndodhet jashtë porte!

Pasi ta kesh zgjedhur Pirin dhe t'i jesh dorëzuar atij, mos u bëj sjelljetrashë dhe i padurueshëm, por mos u bëj as i butë dhe i squlltë si balta!

Po qe se do të nxehesh për çdo vështirësi dhe mundim dhe do të urresh, si do të bëhesh pasqyrë pa u lustruar?

Historia e kazvinasit që ka dashur të bëjë tatuazhin e një luani në trup, por që është penduar nga dhimbja e gjilpërës.

Nga rrëfyesi dëgjoje edhe këtë histori: është zakon i banorëve të qytetit Kazvin në Azinë e Mesme.

Në trupat, krahët dhe supet bëjnë tatuazhe blu me gjilpërë pa i shkaktuar dëm vetes.

Një kazvinas shkoi te mjeshtri i tatuazhit dhe i tha: "Më bëj një tatuazh por pa më shkaktuar dhimbje."

Mjeshtri e pyeti: "Thuajmë trimi im, ç'figurë të të ngulis?" Kazvinasi iu përgjigj: "Figurën e një luani të zemëruar!

Fati im është luani, prandaj figurë luani të jetë. Përpiqu që ta bësh tatuazhin të përkryer!"

Mjeshtri e pyeti: "Në ç'pjesë të trupit ta bëj tatuazhin?" Kazvinasi i tha: "Mes dy supeve!"

Sapo mjeshtri nisi të ngulte gjilpërën dhe shpina e trimit të dhimbte, ky tha duke bërtitur:

"Aman, usta, më vdiqe! Ç'bën kështu!"

Ustai i tha: "A s'më the të të vizatoj një luan?" Kazvinasi e pyeti: "Nga ç'pjesë e fillove?"

Ustai: "Prej bishtit." Kazvinasi i tha: "Të puthsha të dy sytë, lëre bishtin!

Nga bishti i luanit më sëmboi kërbishti, m'u pre fryma, m'u zu gryka!

Le të jetë luani pa bisht! Nga plaga e gjilpërës do të më bjerë të fikët!"

Pa ia prishur qejfin kazvinasit, ustai filloi pa mëshirë tatuazhin e një pjese tjetër të luanit.

Por trimi nisi përsëri të bërtiste: "Ç'është aty?" Ustai i tha: "Veshi!"

Kazvinasi i tha: "Lëre, le të jetë pa veshë! Mos e bëj atë vend!"

Kur ustai filloi të bënte tatuazhin e një pjese tjetër të luanit, kazvinasi bërtiti përsëri:

"Kjo e treta gjilpërë, ç'pjesë të trupit të luanit shpon?" Ustai iu përgjigj: "I shtrenjti im, barkun!"

Kazvinasi i tha përsëri: "Po më dhemb shumë, bre, mos e ngul kaq shumë gjilpërën, lëre, le të jetë pa bark!"

Ustai u hutua dhe mbeti për një kohë të gjatë me gisht në gojë!

Pastaj e hodhi gjilpërën në tokë dhe tha: "A ra kush në botë në këtë gjendje si unë?"

Kush ka parë luan pa bisht, pa kokë, pa bark? As Zoti s'ka krijuar luan të tillë!

O vëlla, duroje plagën e gjilpërës që të shpëtosh nga gjilpëra e nefsit të ndyrë!

Atyre që kanë shpëtuar nga qenia e vet, edhe qielli u falet, edhe dielli, edhe hëna.

Vendimit të personit që i ka vdekur nefsi i trupit, edhe dielli i nënshtrohet, edhe reja.

Personin, zemra e të cilit ka mësuar të ndezë dritë, të lëshojë rreze, as dielli nuk e djeg dot!

Për diellin që lind dhe perëndon në mënyrë të pandërprerë, Zoti pati thënë: "Kur dielli lindte dhe perëndonte, nuk hynte në shpellën e tyre; ajo shpellë nuk shihte fare diell!"

Po qe se një pjesë e arrin të tërën, pranë asaj pjese gjembi, madje, hijeshohet si trëndafili! Si madhërohet, si lartësohet Zoti? Duke e nënçmuar veten, qenien tënde, duke e mbajtur veten në nivelin e dheut!

Ç'do të thotë ta pohosh njësinë e Zotit? Ta djegësh dhe ta asgjësosh veten para Zotit të vetëm!

Po qe se dëshiron të lëshosh rreze e të shkëlqesh si dita, digje qenien tënde që i ngjan natës!

Shkrije qenien tënde në qenien e atij që e ka bërë të qenë qenien tënde siç e tret eliksiri bakrin dhe e bën flori!

Ti je lidhur fort pas un-it. Të gjitha punët me rregull të prishur, të gjitha këto shkatërrime shkaktohen nga dyzimi!

Luani, ujku dhe dhelpra që shkojnë për gjah.

Një luan, një ujk dhe një dhelpër ishin lëshuar maleve për të gjuajtur.

Duke e ndihmuar njëri-tjetrin, kishin bërë mend t'ua zinin rrugën kafshëve të gjahut e t'i kapnin siç duhej!

Që të tre së bashku ishin të një mendjeje për të shtënë në dorë shumë gjah në atë fushë të gjerë!

Megjithëse i vinte turp të gjuante bashkë me ta, luani i mirëpriti dhe u bë bashkudhëtar i tyre.

Ushtarët në shoqërim të një mbreti të tillë janë vetëm mundim. Por, duke menduar se "bashkimi është mëshirë", bëri sipas tyre.

Një hënë e tillë turpërohet nga shëtitja bashkë me yjet. Ajo ndodhet mes yjeve vetëm për t'u dhënë shkëlqim atyre, për t'u bërë mirësi.

Megjithëse mendimi i Pejgamberit ishte më i drejti, atij i erdhi urdhri: "Këshillohu me ta!"

Në peshore, elbi është bërë shok me arin, por me këtë nuk do të thotë që elbi të ketë marrë të njëjtën vlerë!

Tani për tani, shpirti është bashkudhëtar i kallëpit (kallëpi e ruan shpirtin). Po kështu, edhe qeni e ruan portën për një farë kohe.

Kur ata shkuan drejt malit nën kryesinë e luanit të fuqishëm e të pushtetshëm,

Punët u erdhën mbarë dhe gjuajtën një antilopë, një dhi të egër dhe një lepur të majmë.

Qebapi i personit që shkon nën urdhrin e luanit luftëtar, nuk mungon as ditë, as natë.

Kur e sollën gjahun nga mali në pyll duke i hequr zvarrë,

Ujku dhe dhelpra lakmuan që gjahu të ndahej me drejtësi mbretërore.

Lakmia e të dyve u reflektua edhe te luani. Ai e kuptoi shkakun e lakmisë së tyre.

Luani dhe beu i të fshehtave e di se ç'ndjejnë zemrat.

Eja në vete, o zemër që e ke bërë shprehi të kridhesh në mendime! Para tij, ruhu nga mendimet e këqija!

Ai di, kupton dhe e nget gomarin në qetësi. Dhe, për të mos e treguar se e di të fshehtën, për të mos ia përplasur tjetrit në sy të metën, i buzëqesh.

Edhe pse e kuptoi shqetësimin e tyre, luani s'e shfaqi, s'tha gjë, i mbrojti ata.

Por vetmevete tha: "Ah, ju koprracë varfanjakë! Jua tregoj unë juve!"

A s'ju mjaftoi vendimi im? A kështu dyshoni ju në mirësinë time?

Edhe mendjen, edhe mendimet, prej meje i keni; ato janë nga mirësitë e mia që ndriçojnë botën!

Si mund ta turpërojë piktura piktorin? Është piktori që ia ka dhënë pikturës ato të meta, atë pamje të keqe!

A kështu do të dyshoni me lakmi ndaj meje? Në të vërtetë, ju jeni turpi dhe ndotja e kohës!

O ju që mendoni keq për Zotin, po s'jua fluturova kokën do të thotë se bëj gabim të madh!

Ta shpëtoj botën nga turpi juaj dhe kjo histori të rrëfehet sa të jetë bota!

Duke menduar kështu, luani qeshte haptas. Mos ji aq i sigurt ndaj të qeshurave të luanit.

Malli i kësaj bote janë të qeshurat e Zotit. Kjo pamje na ka bërë ne të dehur, krenarë dhe na ka shkatërruar!

O ti me fuqi të lartë! Ty të bën mirë varfëria dhe sëmundja, sepse ajo buzëqeshje, më në fund ta ngre kurthin dhe të bën të biesh në të!

Luani i tha ujkut për ta vënë në provë: "Eja pranë meje, o ujk dhe ndaje gjahun mes nesh!"

Luani i tha ujkut: "Ndaji këto! O ujk i madh, tregoje edhe një herë drejtësinë!

Zër vendin tim në ndarje dhe të dalë në shesh se kush je!"

Ujku i tha: "Sundimtari im! Antilopa është pjesa jote. Ajo është e madhe, edhe ti je i madh; i madh dhe i zhdërvjellët!

Dhia e egër është shtatmesatare, prandaj më takon mua. Kurse ti dhelpër merre lepurin se lepuri është krejt si për ty!"

Luani i tha: "O ujk, pa përsërite edhe një herë, çfarë the? Duke qenë unë këtu, ti kërkon pjesë, ë?"

Ç'qen është ky ujku që, para meje që s'kam shok e të barabartë, para këtij luani, kujton se diç është?

Dhe i bërtiti: "Eja këtu, ti, gomar që të pëlqen vetja!" Dhe kur ujku i shkoi afër, i ra me kthetër dhe e copëtoi!

Kur nuk pa te ai mendje dhe masë mbrojtëse, e ndëshkoi dhe ia ropi lëkurën!

Meqë pamja ime s'të turbulloi dhe ti s'e mohove veten para meje, një shpirt i këtillë duhet të vdesë!

Meqë nuk e mohoi veten para meje, u bë e detyrueshme t'i hiqej koka!

Çdo gjë tjetër veç Zotit është e vdekshme dhe e asgjësueshme. Meqë ti nuk shkrihesh në qenien e tij, mos kërko qenie, ekzistencë!

Për atë që shkrihet në të vërtetën tonë, "çdo gjë është e vdekshme, nuk ka ndëshkim."

Sepse ai është te "il'la" (vetëm), ka kaluar nëpër "la" (nuk). Dhe "il'la" nuk është i vdekshëm.

Kush troket në portë duke pretenduar se është "unë" dhe "ne", përzehet nga porta dhe mbetet të vijë vërdallë në "la" (nuk)!

Dikush i tha kështu dikujt që i trokiti në portë dhe, kur e pyeti se kush ishte, iu përgjigj "unë": "Meqë je "unë" për vete, pra "ti" për mua, nuk po ta hap portën, sepse nuk njoh asnjë nga miqtë e mi që të jetë "unë" për vete, pra "ti" për mua!

Dikush shkoi te porta e një miku dhe trokiti. Miku e pyeti nga brenda: "Kush troket?"

Ai iu përgjigj: "Unë!" Atëherë, miku nga brenda i tha: "Shko, nuk është koha! Një sofër si kjo nuk mund të jetë vendi i një personi të panjohur!"

Njeriun e panjohur apo gjënë e papjekur (a të pazjerë) kush mund ta zjejë apo ta pjekë, kush mund ta shpëtojë nga hipokrizia veç zjarrit të ndarjes?

Njeriu i shkretë shkoi dhe plot një vit u dogj nga ndarja prej mikut.

U dogj e u poq, u kthye dhe arriti te shtëpia e mikut. Pastaj filloi të përsillej rreth shtëpisë së tij.

Pastaj shkoi te porta dhe trokiti me frikë se mos i dilte nga goja ndonjë fjalë e paedukatë.

Miku pyeti nga brenda: "Kush troket?" Dhe ky iu përgjigj: "Ti je miku që ma ke marrë zemrën!"

Atëherë, miku i tha: "Meqë je unë, eja brenda, hyr! Shtëpia është e ngushtë, nuk i nxë dy vetë!"

Po qe se peri që duhet kaluar nëpër gjilpërë është dyfijesh, s'kalohet! Meqë je një, eja, kalo nëpër këtë gjilpërë!

Peri me gjilpërën kanë të bëjnë, prandaj peri kalon nëpër gjilpërë, kurse deveja nuk ka të bëjë fare me gjilpërën!

A mund të hollohet trupi i devesë me tjetër gjë përveç se synimit të përkorësisë dhe adhurimit?

Për këtë punë duhet dora e Zotit, fuqia e Zotit, sepse Zoti me vullnetin e tij e bën të qenë çdo iluzion.

Çdo gjë e parealizueshme bëhet e mundur me dorën e tij, çdo i prapë qetësohet me aromën e tij!

Ç'janë njerëzit e lindur të verbër dhe sybardhë? Lëri këta, por edhe i vdekuri, madje, ngjallet me magjinë e atij Zotit të shenjtë!

Edhe mosqenia që është më e vdekur se i vdekuri, vishet me qenie në dorën e tij!

Lexoje ajetin që thotë se "Ai në të gjitha ditët është në punë" dhe kurrsesi mos mendo se Zoti rri kot.

Puna më e pakët është të dërgojë çdo ditë në këtë botë tre njësi ushtarësh.

Një njësi ushtarësh kalojnë nga organet e baballarëve te nënat me qëllim për të rritur fëmijë.

Një njësi tjetër ushtarësh kalojnë nga mitrat në këtë botë për ta mbushur me meshkuj dhe femra.

Kurse një njësi tjetër ushtarësh ecin nga toka në drejtim të vdekjes me qëllim që çdo njeri të marrë përgjegjësen e punës së vet.

Por kjo fjalë s'ka fund. Eja në vete dhe kthehu te historia e dy miqve të mirë!

Personi që tha "jam unë" pendohet, kalon një vit me përkorësi, pastaj kthehet te shtëpia e mikut dhe pyetjes së tij "kush troket" i përgjigjet "je ti".

Miku i bëri zë nga brenda: O "ti" që je plotësisht "unë", hyr brenda! Ti nuk je "tjetërkushi" siç janë në jeshilishte gjembi dhe trëndafili ndaj njëri-tjetrit.

Peri u bë një; tashmë, o gabim, hiqu që këtej! Edhe nëse i sheh dy shkronjat Kaf dhe Nun, në të vërtetë janë një!

Kafi dhe Nuni janë tërheqëse për ta tërhequr mosqenien në punët e mëdha e të vështira!

Megjithëse litari duket në pamje prej dy pjesësh, punën e bën si një i vetëm.

N'daç të jetë dykëmbësh, n'daç katër, rruga ecën. I ngjet gërshërës që ka dy krahë por pret njëherësh.

Shih dy vëllezërit që lajnë bezen. Në pamje, bëjnë punë të ndryshme.

Njëri e fut bezen në ujë, tjetri e than!

Pastaj përsëri tjetri e lag. Sikur bëjnë të kundërtën e njëri-tjetrit.

Por, o djalë i ri! Edhe zemrat e këtyre dy shokëve që në dukje bëjnë punë të ndryshme, janë një, edhe puna që bëjnë!

Çdo pejgamber, çdo i urtë ka një profesion. Por, meqë të gjithë e afrojnë popullin te Zoti, janë një.

Po qe se dëgjuesit bien në gjumë nga fjalët e tyre, do të thotë se uji i mori me vete gurët e mullirit!

Rrjedha e këtij uji nuk është për mullirin; ai shkon në mulli për ju!

Por meqë nuk ju mbeti nevojë për mullirin, mullixhiu e lëshoi ujin në shtratin e vet dhe uji rrodhi për në lumë.

Aftësia për të thënë fjalë vjen në gojë për t'u dhënë mësim të tjerëve, ndryshe, ajo fjalë ka një shtrat tjetër.

E heshtur dhe pa u përsëritur, rrjedh e shkon gjer nën kopshtet e trëndafilave nën të cilët rrjedhin lumenj.

Zoti ynë! Na ua trego ti shpirtrave atë post të lartë që përcakton fjalë pa tinguj!

Që shpirti i pastër ta bëjë kokën këmbë dhe të vrapojë drejt fushës së largët e të gjerë të mosqenies.

Bota e mosqenies është një botë shumë e gjerë dhe e pakufishme. Ky iluzion dhe kjo qenie merr qindra ushqime nga ajo botë, përcaktohet dhe ushqehet nga ajo botë!

Në krahasim me botën e mosqenies, iluzionet janë të ngushta. Prandaj iluzioni bëhet shkak për ngushticë dhe shqetësim.

Edhe qenia është më e ngushtë se iluzioni. Prandaj muajt në këtë botë duken si hëna e re.

Kurse qenia e botës së ndjenjave dhe ngjyrave, domethënë e kësaj bote, është krejtësisht e ngushtë në krahasim me mosqenien, iluzionin dhe qenien, është, pothuaj, një qeli.

Përbërja dhe numrat në këtë botë janë shkak për ngushticë, por ndjenjat tona na tërheqin pa pushim drejt botës së përbërjes.

Me ato ndjenja njihe botën e njësisë dhe, në e dëshirofsh botën e njësisë, në atë anë ec!

Urdhri "Kun" (Bëhu) bën një punë të vetme, por në dukje është formuar nga shkronjat (tingujt) Kaf dhe Nun. Kuptimi është, gjithashtu, një dhe i thjeshtë.

Kjo fjalë s'ka fund. Kthehu dhe trego se ç'ndodhi me ujkun në atë luftë!

Luani e ndëshkoi ujkun sepse në përpjesëtimin e gjahut nuk respektoi etikën.

Ai luan i lartë ia këputi kokën ujkut që të mos mbeteshin dy kokë, dy epërsi.

O ujk i plakur! Meqë nuk e quajte veten të vdekur para mbretit, merre dënimin! Ja, pra, kjo është "Ne morëm shpagim prej tyre!"

Pastaj e ktheu fytyrën nga dhelpra dhe i tha: "Eja, ndaji këto mes nesh që t'i hamë!"

Dhelpra ra në gjunjë e tha: "O mbret besnik, kjo antilopë e majme është gjella jote e paradites.

Nga dhia, për mbretin fatbardhë bëhet një jahni që ta hajë në mesditë.

Kurse lepuri është gjella e mbrëmjes e mbretit mirëbërës e bujar!"

Luani tha: "O dhelpër, i dhe shkëlqim drejtësisë, e bëre tërë dritë. Nga kush e mësove këtë lloj përpjesëtimi?

Moj fisnike, nga kush e fiksove këtë lloj ndarjeje në pjesë?" Dhelpra i tha: "Imzot, nga pësimi i ujkut!"

Atëherë, luani i tha: "Meqë ti e le peng veten për dashurinë tonë, që të tria kafshët e gjuajtura qofshin të tuat, merri e shko!"

O dhelpër, ti u bëre krejt e jona, si mund të të fyej ty? Meqë ti u bëre "ne",

Edhe ne jemi të tutë, bashkë me kafshët e gjuajtura. Vëre këmbën mbi qiellin e shtatë, ngjitu lart!

Meqë more mësim prej ujkut të poshtër, tashmë ti s'je dhelpër, por luanesha ime!

I mençur është ai që në fatkeqësinë e kaluar merr mësim nga vdekja e miqve!

Atëherë, dhelpra falenderoi njëqind herë: Luani ma propozoi këtë mua pas ujkut!

Sikur të më kish propozuar mua të parës për ta përpjesëtuar gjahun, a do të kisha mundësi ta shpëtoja jetën prej tij?

Prandaj edhe ne ta falenderojmë Zotin që na solli ne në botë pas atyre që u shkatërruan!

Në këtë mënyrë, ne dëgjuam se si i shkatërroi Zoti popujt e kaluar në kohët e kaluara.

Më në fund, duke dëgjuar se ç'i gjeti ujqit para nesh, mundemi ta mbrojmë veten siç bëri dhelpra!

Ja, pra, për këtë shkak, ai Pejgamberi i vërtetë, ai Pejgamberi fjalëdrejtë, na e dha neve emrin "Ummeti i mëshiruar"!

O të shtrenjtë, shihini hapur kockat dhe qimet e atyre ujqve dhe merrni mësim nga pësimi i tyre!

I mençuri e braktis këtë kamje, mendjemadhësi dhe krenari, sepse sjell ndërmend hallin e Faraonit.

Po qe se nuk e lë të mbajturit më të madh dhe nuk merr mësim, nga azganllëku i tij marrin mësim të tjerët!

Nuhu e kërcënoi popullin e vet: "Mos u merrni me mua sepse unë jam mbulesë e Zotit! O të poshtëruar e të dëmtuar, në të vërtetë, ju merreni me Zotin!"

Nuhu u tha: "O të paudhë! Unë nuk jam unë. Me shpirt, unë jam i vdekur, e kam braktisur qenien time. Unë jam i gjallë me Zotin!

Meqë i ndërrova ndijimet e mia njerëzore, Zoti u bë për mua dëgjim, kuptim, shikim.

Sepse unë s'jam unë. Kjo frymë është prej tij. Kush thotë fjalë e kush mohon përballë kësaj fjale, është mohues, qafir!"

Në trajtën e kësaj dhelpre është fshehur luani. Aty ku ndodhet kjo dhelpër, nuk duhet shitur trimëri!

Po qe se e sheh nga trajta dhe prapë s'e beson që është luan, as bulërimën nuk ia dëgjon?

Po qe se te Nuhu nuk kishte ndonjë fuqi prej Zotit, si e përmbyti botën?

Në një trup kishte qindramijëra luanë. Ai ishte si zjarr, kurse bota, një mullar kashte.

Kur mullari nuk ia ruajti një të dhjetën e të drejtës, ai i dërgoi një rreze të tillë flake që e bëri hi.

Kush hap gojën si ujku dhe flet pa edukatë para këtij luani të fshehtë,

Ky e bën copë-copë siç e copëtoi luani ujkun dhe ia këndon ajetin "Dhe morëm shpagim prej tyre" siç ia këndoi luani ujkut.

Bie nën kthetrat e luanit. Ai që shet trimëri përballë luanit nuk ka mend!

Sikur ajo plagë t'i bëhej vetëm në trup, kurse zemra dhe besimi të shpëtonin!..

Me të ardhur fjala këtu, m'u prenë fuqitë. Si ta shtjelloj këtë të fshehtë?

Si dhelpra, edhe ju mendoni më pak për grykën tuaj dhe para tij rrëshqitni më pak në hile.

Para tij braktisini të gjitha "unë"-t dhe "ne"-të. Prona është e tij, pronën dorëzojani atij.

Po qe se në rrugën e drejtë vini si të varfër, edhe luani bëhet i juaji, edhe gjahu i tij.

Sepse ai është i pastër; madhështia është veti e tij. Ai është i pastër edhe nga gjërat e brendshme, edhe nga gjërat e jashtme.

Çdo lloj gjahu, çdo lloj dhurate dhe bamirësie tek ai janë për robtë e atij mbreti.

Mbreti nuk ka lakmi për asgjë. Gjithë këtë shtet ai e ka ngritur dhe rregulluar për njerëzit; lum për atë që e kupton!

Shtetet e kësaj bote e të botës tjetër ç'i duhen atij që ka krijuar shtetin, këtë botë dhe atë botë?

Prandaj, para të Madhit ruajeni zemrën që më pas të mos turpëroheni nga mendimet e këqija!

Sepse ai i kontrollon dhe i sheh të gjitha gjërat dhe mendimet e fshehta si qimja e zezë brenda qumështit të bardhë!

Personi që e lë trajtën dhe e pastron zemrën, bëhet pasqyrë për trajtat e padukshme.

Nuk ka dyshim se ai na e kupton të fshehtën, sepse besimtari është pasqyrë e besimtarit.

Pasi të na e ketë matur karatin e parasë sonë, menjëherë e ndan besimin e vendosur nga dyshimi.

Kur shpirti të jetë bërë mjeti matës i karatit të parave tona, sigurisht që e dallon edhe paranë e saktë, edhe kallpe!

Sundimtarët i ulin para vetes sufitë e pajisur me kulturën shpirtërore.

Në e mban mend, ke dëgjuar se sundimtarët kanë pasur një zakon të tillë:

Në anë të majtë të tyre rrinin trimat dhe heronjtë, sepse zemra ndodhet në anë të majtë të trupit.

Vendi i defterdarëve, nëpunësve të llogarisë dhe i njerëzve të kalemit ishte në anë të djathtë, sepse shkrimi dhe përcaktimi i një gjëje është punë e dorës së djathtë.

Kurse sufive u jepnin vend përballë, sepse ata janë pasqyrë e shpirtit, madje, më të mirë se pasqyra.

Ata u kanë dhënë shkëlqim zemrave me anë të zikreve dhe mendimeve, në mënyrë që pasqyra e zemrës t'i pranojë trajtat e bukura dhe që në të të duken trajtat e padukura.

Duhet vënë pasqyrë para personit të pastër e të bukur të lindur nga thelbi i krijimit. Fytyra e bukur e dashuron pasqyrën. Siç e dashuron pasqyrën, fytyra e bukur u jep edhe shpirtrave shkëlqim dhe zemrave, pastërti.

Te Jusufi shkon një mik dhe Jusufi kërkon prej tij një dhuratë.

Një mik i mëshirshëm nga vende të largëta shkoi si mik te Jusufi.

Ata e njihnin njëri-tjetrin qysh në fëmijëri. Qysh herët qenë bërë të afërt me njëri-tjetrin.

Ata biseduan për të keqen që i bënë vëllezërit Jusufit, për smirën e tyre. Jusufi tha: Smira dhe e keqja e tyre ishte zinxhir, kurse unë isha luan.

Lidhja e luanit me zinxhirë nuk është turp. Unë s'kam ndonjë ankesë për fatin që më ka caktuar Zoti.

Edhe po të jetë i lidhur me zinxhirë për qafe, luani është bej mbi të gjithë të tjerët.

Miku e pyeti Jusufin: "Në ç'gjendje ndodheshe në pus e në burg?"

Jusufi iu përgjigj: "Si hëna që hollohet dhe zhduket dhe pastaj del përsëri e re!"

Hëna e vjetër kërruset, humbet nga shikimi, pastaj del në qiell e re dhe e plotë.

Kokrrën e margaritarit e rrahin në havan, por vlera i mbetet përsëri e lartë; ose lyhen sytë me të si ilaç, ose bëhet brumë dhe hahet për qetësimin e zemrës.

Kokrrën e grurit e hedhin në tokë, por pastaj ajo del nga toka e bëhet kalli.

Pastaj shihet, bluhet në mulli, i shtohet vlera dhe bëhet ushqim që i jep jetës jetë.

Pastaj e shtypin edhe një herë nën dhëmbë si bukë dhe e hanë dhe buka bëhet mendje dhe arsye për ata që kanë mendje.

Pastaj jeta shkrihet në dashurinë për Zotin dhe, pasi mbillet në rrugën e Zotit, jep prodhim dhe i lë të mahnitur ata që e mbollën.

Por kjo fjalë s'ka fund. Ti fillo të tregosh se ç'i tha ai njeri i mirë Jusufit.

Jusufi i kërkon dhuratë mikut.

Pasi i tregoi se ç'i kishin rënë në kokë, Jusufi i tha mikut: "Eh, pa të shohim, ç'dhuratë na ke sjellë?"

O i shtrenjtë, të shkosh me duar bosh te miku është si të shkosh në mulli pa grurë!

Edhe Zoti i madh, madje, do t'i pyesë njerëzit ditën e ringjalljes: "Ku i keni dhuratat për këtë ditë?"

Keni ardhur këtu vetëm, pa ushqim me vete, pothuaj si atë ditë që ju krijuam!

Ejani në vete! Ç'dhuratë keni për ditën e kiametit, ç'keni sjellë?

Apo keni shpresuar se do të ktheheni e do të vini këtu prapë dhe premtimi i kësaj dite ju duk i gënjeshtërt?

Po qe se e mohon se do të shkojmë për të bujtë te ai, nga kjo vatër mund të marrësh vetëm dhé dhe hi.

Po qe se nuk e mohon, pse kështu, duarbosh? Si do të hedhësh hap kështu në portën e atij të dashuri?

Pakësoji pak ngrënien e fjetjen dhe ço një dhuratë për t'u takuar me të.

Dhe bëhu nga ata që netëve flenë pak, kurse kur zbardh drita bëjnë pendesë.

Si fëmija në mitër të nënës, edhe ti luaj pak që të të dhurojnë ndijime që i shohin dritërat dhe bukuritë.

Dhe kur të dalësh nga kjo botë që është si mitër, do të hysh në një hapësirë më të gjerë se toka.

A s'thonë se "vendi i Zotit është i gjerë"? Dije se ai vend i gjerë është hapësira ku kanë shkuar e kanë hyrë pejgamberët.

Në atë hapësirë të gjerë zemra s'ngushtohet, dega e njomë s'thahet.

Tani je plot ndjenja, por një ditë do të bëhesh i lodhur, i dërrmuar, kokëpërkulur.

Në gjumë nuk i merr ti ndjenjat me vete, por të marrin ndjenjat ty. Lodhja dhe mërzitja ikin dhe ti shpëton prej mundimit dhe shqetësimit.

Gjendjen e gjumit dije si një gjendje ku të urtët i bartin me vete edhe ndjenjat e gjendjes së zgjuar.

O kryeneç! Të urtët janë shokët e shpellës. Edhe në qofshin në këmbë, edhe në qofshin duke ecur dhe shëtitur, janë në gjumë.

Zoti i trajton ata edhe pa ditur gjë ata vetë: i kthen djathtas e majtas.

Ç'është kthimi nga e djathta? Punë e mirë. Po kthimi nga e majta? Edhe ajo, punë e trupit, e ekzistencës.

Edhe që të dyja këto gjendje shfaqen siç vjen zëri nga pejgamberët, nga mali. Ata s'dinë gjë as për këta të dy.

Mali ta kthen ty zërin tënd edhe sikur të jetë për të mirë, edhe sikur të jetë për të keq, por s'di gjë për to.

Miku i tha Jusufit: "Të kam prurë si dhuratë një pasqyrë.
Sa herë që të shihesh në të, do të vështrosh
fytyrën tënde të bukur dhe do të më kujtosh mua!"

Kur Jusufi i tha mikut ta nxirrte dhuratën që i kishte prurë, i turpëruar nga kjo kërkesë, miku i foli kështu pothuajse me të klithur nga dëshpërimi:

"Sado që kërkova, asgjë nuk pëlqeva dhe nuk gjeta dot një dhuratë të denjë për të ta sjellë ty!"

Si mund të marr një thërrime minerali e ta çoj në minierë, si mund të marr një pikë ujë e ta çoj në oqean?

Edhe sikur të të kisha sjellë zemër dhe shpirt, do të ishte njëlloj sikur të çoja majdanoz në Kirman!

Nuk ka farë tjetër nga bukuria jote e pashembullt që të mos ndodhet në këtë hambar.

Prandaj e pashë me vend të të sjell një pasqyrë si bukuria e zemrës.

O i bukur si dielli që është drita e faqes së qiellit! Kur të shihesh në të, do të vështrosh fytyrën tënde të bukur.

O dritë e syve të mi! Të solla një pasqyrë që, kur të shihesh në të e të vështrosh fytyrën tënde, të më kujtosh mua!

Dhe e nxori pasqyrën nga gjiri dhe ia dha. Bukuritë merren me pasqyrën.

Ç'është pasqyra e qenies? Mosqenie. Nëse s'je kokëtrashë, zgjidhe mosqenien.

Qenia mund të shihet te mosqenia. Pasanikët mund të tregojnë bujari ndaj varfanjakëve.

Pasqyra e qartë e bukës është i urituri. Unuri është pasqyra e gurit të çakmakut.

Aty ku të ketë mosqenie dhe mungesë, është pasqyrë e bukurive të të gjitha arteve.

Po qe se rroba do të jetë prerë dhe qepur, a mund të duket mjeshtëria e rrobaqepësit?

Druri duhet të jetë i palatuar që marangozi ta gdhendë e ta latojë dhe prej tij të bëjë diçka.

Mjeshtri i ngjitjes së kockave shkon ku ka ndonjë kockë të thyer.

Si do të duket bukuria e artit të mjekësisë po të mos ketë njerëz të sëmurë?

O i shtrenjtë! Si do të zbulohej alkimia po të mos ishte trashësia dhe ultësia e bakrit?

Të metat janë pasqyrë e cilësisë së përkryerjes. Ultësia është pasqyrë e lartësisë.

Sepse e kundërta e drejtpërdrejtë e diçkaje tregon të kundërtën e saj. Prandaj mjalti dallohet nëpërmjet uthullës.

Kush e sheh të metën e vet dhe e kupton, vrapon për në rrugën e përkryerjes sado larg të jetë.

Kurse kush e pandeh veten të përkryer, nuk mund të fluturojë në rrugën e Zotit të lartë!

O ti, krenar dhe i mbrapshtë! Nuk mund të ketë në shpirt sëmundje më të keqe se pandehja e vetes të përkryer!

Gjersa prej teje të jetë përzënë ky vetëpëlqim, edhe nga zemra do të të rrjedhë shumë gjak, edhe nga sytë!

E keqja e Iblisit ishte se tha "Unë jam më i dobishëm se Ademi!" Kjo sëmundje është te çdo krijesë.

Edhe sikur i sëmuri me këtë sëmundje ta shohë veten me përçmim, ti dije atë si ujë të kulluar që ka në fund ndyrësi.

Po qe se e përzjen për ta provuar, uji menjëherë turbullohet dhe merr ngjyrën e ndotësisë.

O trim! Lumi të duket i pastër e i kulluar, por në fund të tij ka ndotësi.

Piri i kuptueshëm që e njeh rrugën, është ai që hap ujësjellës për në kopshtet e Frymës së Përgjithshme.

Si do ta pastrojë veten lumi? Dija e njeriut jep dobi me anë të dijes së Zotit.

A mund ta presë sëpata bishtin e vet? Shko dhe tregoja këtë plagë një kirurgu.

Që askush të mos e shohë të keqen e plagës, mbi çdo plagë lëshon miza.

Ato miza janë mendimet dhe pasuria jote, kurse plaga, errësira e gjendjes ku ndodhesh.

Po qe se mbi atë plagë vë melhem Piri, atëherë dhimbja jote shërohet, rënkimet dhe ankimet të ndërpriten.

Njeriu që ka plagë, kur i vihet melhem, pandeh se u shërua. Kurse, në të vërtetë, aty ka vepruar drita e melhemit.

Eja në vete, o njeri me shpinën me plagë, mos e hiq mendjen nga melhemi. Dhe, kur të shërohesh, mos thuaj se je shëruar vetvetiu. Dije se shëndetin e ke nga melhemi!

Shkruesi i vahjit, zbulesës hyjnore, i cili, nën dritën e zbulesës, i thoshte ajetet para Pejgamberit (a.s.) prandaj filloi të pretendonte se edhe atij i zbulohej fjala hyjnore dhe, kështu, doli nga feja.

Para Osmanit ishte një shkrues i cili përpiqej ta shkruante vahjin ose fjalën hyjnore që i zbulohej Pejgamberit.

Sapo Pejgamberi t'ia thoshte ajetet që i zbuloheshin, ai i shkruante menjëherë në letër.

Kur drita e vahjit binte mbi shkruesin, në zemrën e tij lindnin disa urtësi.

Edhe Pejgamberi thoshte të njëjtat gjëra që i lindnin atij në zemër. Por kaq gjë e tërboi atë mendjeshkurtër i cili, duke dalë nga rruga, tha:

Çfarëdo që të thotë Pejgamberi që merr dritë nga Zoti, lind edhe në zemrën time, ajo e vërtetë lind edhe në zemrën time!

Drita e mendimit të tij i ra Pejgamberit, në shpirtin e shkruesit ra ndëshkimi i Zotit.

E humbi edhe punën e shkruesit, edhe fenë. Me urrejtjen që formoi, u bë armik i Mustafait dhe i fesë.

Mustafa i tha: O mohues kryeneç! Nëse drita është tek ti, pse tani u bëre sterrë i zi?

Po të ishe burimi i lumit të Zotit, nuk do ta hapje plagën e një uji të tillë të zi, nuk do të rridhje kështu, ujë të zi!

Dhe shkruesi e lidhi gojën me mendimin që të mos i cënohej nderi para të tjerëve.

Prandaj digjej nga brenda. Por ishte e çuditshme se as nuk bënte pendesë.

Ofshante, por ofshama s'i kishte dobi. Kishte ardhur shpata e ia kishte fluturuar kokën!

Zoti e ka bërë turpin dhe nderin një hekur të rëndë që sa e sa njerëz kanë mbetur të lidhur me lidhje të padukshme.

Mendjemadhësia dhe mohimi e kanë mbyllur atë rrugë aq shumë sa mendjemëdhenjtë dhe mohuesit as nuk ofshajnë dot hapur.

Zoti tha: "Atyre u vumë zinxhirë në qafa; e kanë ngritur kokën lart, por tani s'munden ta ulin". Këta zinxhirë nuk janë jashtë nesh.

Dhe tha: "U vumë pengesa para e prapa dhe ua mbuluam sytë me mbulesë". Por i dënuari i tillë nuk e sheh pengesën që ka para e pas.

Vështirësia e asaj pengese të ngulur nuk duket sepse ai njeri nuk e di se është kurdisur nga fati.

E dashura jote është mbulesë e fytyrës së të dashurit të vërtetë. Myrshidi yt bëhet pengesë për ta dëgjuar fjalën e murshidit të vërtetë.

Sa e sa mohues ka që janë të shtënë pas fesë, por nderi, mendjemadhësia, e të tjera si këto, u bëhen pengesë.

Kjo është një lidhje e fshehtë, por më e keqe se lidhja prej hekuri. Lidhjen prej hekuri e këput vetëm sëpata.

Sidoqoftë, këputja e lidhjes prej hekuri është e mundur. Por lidhjes së padukshme askush s'i bën dot gjë!

Po qe se njeriun e pickon bleta, natyra e tij fillon menjëherë të përpiqet për ta fshirë atë të keqe.

Edhe kjo është si pickimi i bletës, por e ardhur nga qenia jote, e krijuar prej teje. Prandaj ankthi është i fuqishëm dhe sëmundja s'kalon assesi.

Nga brenda më vjen ta shtjelloj këtë, ta shpjegoj mirë, por kam frikë se mos shkakton mungesë shprese.

Jo, mos e humb shpresën, por gëzohu dhe thirri Zotit i cili e kap atë thirrje.

Zoti ynë që e do faljen, falna ne! O ti që je mjeku edhe i kallos së vjetër, falna ne!

Reflektimi i urtësisë tënde në zemër e nxori nga rruga atë të keqin. Edhe ti mos e shih veten në mënyrë që ky shikim të mos ngrejë pluhur nga ti.

O vëlla, urtësia që pikon tek ti, është e përkohshme.

Ai ka gjetur tek vetja një dritë, por ajo dritë ka dalë nga pragu i mbretërve!

Falendero, mos u bëj krenar, mos u mbaj më të madh, vër veshin dhe mos e shih fare veten.

Qindramijëra ah-e dhe kjo gjendje e përkohshme i largoi bashkësitë nga të qenët bashkësi!

Ju bëfsha rob atij që nuk pandeh se në çdo konak do ta vënë në krye të sofrës!

Që njeriu të mundet të arrijë një ditë në shtëpi të vet, duhet të braktisë shumë konaqe.

Hekuri u bë i kuq flakë, por në të vërtetë nuk është i kuq. Kjo skuqje është një e kuqe e përkohshme që ia dha hekurit oxhaku.

Po qe se xhami i dritares ose shtëpia brenda shkëlqen, mos kujto se e ka nga vetja; ai shkëlqim është nga dielli.

Çdo derë e mur mund të thotë: Unë shkëlqej vetë, jo me dritën e dikujt tjetër. Unë jam që lëshoj dritë!

Por dielli i thotë: More i trashë! Pa të perëndoj unë dhe ta shohim atëherë se si është puna!

Bimësia e blertë mund të thotë: Ne jemi jeshiluar vetë, jemi plot gëzim, buzëqeshim pa pushim dhe kjo ndodh tek ne qysh në pafillim!

Por vera u thotë: O bimë të bleruara! Të kaloj unë dhe atëherë shiheni veten se kush jeni!

Trupi krenohet me bukurinë e vet dhe bën naze. Sepse shpirti i ka fshehur krahët dhe fuqinë.

Dhe i thotë trupit: O e fshirë fshese! Kush je ti? Ke jetuar nja dy ditë me dritën time!

A nuk t'i nxë bota tekat e nazet? Prit, atëherë, të dal prej teje dhe shih!

Ata që të duan ty me të tepërt, të fusin në varr dhe të bëjnë ushqim për milingona e gjarprinj!

A s'ka të tillë që shpesh herë kanë qenë gati të vdesin para teje? Ja, atëherë ata do t'i mbyllin hundët nga era jote e keqe!

Sytë, veshët, fjalët... Të gjitha janë drita e shpirtit. Ajo që vrapon e vezullon në ujë është vezullimi i zjarrit.

Ashtu siç drita e shpirtit arrin në trup, ashtu dhe drita e Abdallit arrin në shpirtin tim.

Sapo që drita e atij Abdallit që është shpirti i shpirtit, të heqë dorë nga shpirti, trupi i pajetë vjen në gjendje të tillë.

Dije mirë se unë po vë kryet në tokë që ditën e kiametit të dëshmojë për këtë fjalën time!

Ditën e kiametit kur toka të lëkundet me forcë, toka bëhet dëshmitare e gjendjes së njerëzve.

Dhe i thotë krejt hapur lajmet që i ka fshehur. Faqja e tokës dhe gjembat fillojnë të flasin.

Filozofi e mohon këtë sipas mendimit dhe pandehmës së vet. Thuaji atij: shko dhe bjeri murit me kokë!

Ndjenjat e njeriut të zemrës e dëgjojnë fjalën e ujit, dheut dhe baltës.

Filozofi e mohon rënkimin e trungut Hannane, sepse ai s'di gjë për ndjenjat e të urtëve, është i huaj për to.

Dhe thotë: Te populli, reflektimi i dashurisë krijon shumë iluzione dhe ua tregon atyre.

Mirëpo ky mendim është reflektim i intrigës dhe mohimit të tij. Ky iluzion heretik ka ardhur nga mendimi i tij, nga dëmtimi në besimin e tij.

Filozofi i mohon xhindët dhe shejtanët, por sapo ka mohuar, është bërë kllouni i një xhindi, i një shejtani.

O filozof, po s'e ke parë shejtanin, shihe veten! I ke rënë murit me kokë! Pa qenë i marrë, a mundet të të shtypet koka kështu?

Po qe se dikush ka dyshim e lëkundje në zemër, do të thotë se i ka besuar filozofisë dhe është mohues i fshehtë.

Disa herë i beson fesë, por herë-herë ai damari filozofik ia bën fytyrën sterrë të zezë.

Ruhuni, o besimtarë se ai besim në filozofi është edhe tek ju. Tek ju ka shumë dijetarë të pafund.

Tërë shtatëdhjetë e dy fe dhe sheriatë janë tek ti. Mjerë për ty atë ditë që të shfaqen tek ti!

Kushdo që të ketë një gjethe të vogël nga ai besim i mbrapshtë, dridhet si gjethe nga frika e asaj dite.

Ti qeshe pse iu duke burrë i mirë xhindit dhe shejtanit.

Por po qe se shpirti e vesh lëkurën përsëprapi dhe e nxjerr jashtë atë që ka brenda, sa e sa ofshaka dalin nga njerëzit fetarë!

Të gjitha metalet e dyqanit të cilat duken si flori, qeshin, sepse guri i provës është i fshehur.

Zoti ynë që i mbulon të metat! Mos na e ngri perden! Dhe kur të vijë koha e provës, na ndihmo e na shpëto ne!

Natën, ari kallp me arin e vërtetë janë pranë e pranë. Floriri i vërtetë pret mëngjesin.

Dhe thotë me gjuhën e gjendjes: Prit, o gënjeshtar ditën kur çdokush do të dalë sheshit!

Iblisi i mallkuar qindramijëra vjet ishte te Abdalli, ishte beu i besimtarëve.

Për shkak të tekave dhe indiferentizmit, hyri në luftë me Ademin dhe u poshtërua si ndytësira që fillon të mbajë erë para dite kur zë të ngrohë moti.

Historia alegorike e Baurit.

Njerëzit e botës qenë bërë vegël e Bel'amit të birit të Baurit, siç i qenë nënshtruar Isait të kohës së vet.

Askujt veç tij nuk i binin në gjunjë. Magjia e tij i shëronte të sëmurët.

Meqë i pëlqente vetja, meqë i dukej se ishte i madh, hyri në luftë me Musain. Pastaj e pësoi siç e ke dëgjuar.

Në botë ka qindramijëra Iblisë dhe Bel'amë që, hapur apo fshehur, kanë rënë po në këtë gjendje.

Zoti i bëri të famshëm këta me qëllim që të bëhen shembull për të tjerët.

Këta të dy hajdutë i tërhoqi në trekëmbësh e i lartësoi, kurse ka shumë e shumë hajdutë të goditur nga persekutimi i tij.

Këta të dy i persekutoi hapur dhe u dha famë, kurse të vdekurit nga persekutimi i tij janë aq shumë sa nuk numërohen!

Je i përkëdhelur, përkëdhelesh, por, për dashuri të Allahut, mos e kalo masën!

Po qe se has dikë më të përkëdhelur se ti, të fut shtatë pashë nën dhe!

Pse përsëriten vazhdimisht historitë e fiseve Ad dhe Themud? Për ta ditur ti që pejgamberët kanë qenë delikatë e të hijshëm.

Fundosja nën tokë, reshimi i gurëve mbi krye, marrja e shpirtrave me një zë, të gjitha këto ngjarje janë për të bërë të ditur lartësinë e egove folëse.

Të gjitha kafshët vriti për një njeri, por dhe të gjithë njerëzit vriti për një person të mençur! (S'ka asgjë të keqe!)

Ç'është ajo që ti i thua mendje? Mendja e Përgjithshme e atij që zotëron mendje. Edhe Mendja e Pjesshme është mendje, por shumë e dobët.

Të gjitha kafshët e egra që ikin nga njeriu, janë të ulëta në krahasim me kafshët e buta.

Derdhja e gjakut të kafshëve të egra është normal, sepse ikin nga mendja e lartë. Ato s'kanë mendje.

Egërsia ka rënë kaq poshtë sepse nuk i bindet urdhrit të njeriut.

Prandaj, o njeri i çuditshëm, pasi t'u ngjasësh gomerëve të egër që ikin nga luani, ç'nder të mbetet ty?

Gomari nuk vritet sepse vlen për punë. Por vrasja e gomarit të egër është normale.

Megjithëse gomari nuk di të mbrohet, nuk di të shkojë nga e mira, Zoti nuk e justifikon.

O i shtrenjtë! Po qe se njeriu (që është i mençur) ikën nga ajo frymë (nga fjalët e pejgamberëve dhe të të urtëve) dhe egërsohet, si mund të justifikohet?

Përfundimisht, përballë shigjetave dhe bajonetave, gjaku i qafirëve është normal, sepse ata s'vlejnë për gjë.

Edhe gratë dhe fëmijët e tyre quhen robër. Sepse nuk kanë mend dhe janë persona të ndyrë e të ulët.

Po qe se një mendje ikën nga mendja e mendjes, kalon nga grupi i të mençurve te trupi i kafshëve!

Historia e Harutit dhe Marutit.

Personi që ikën nga mendja e mendjes dhe nuk ua dëgjon fjalën pejgamberëve dhe të urtëve, i ngjan Harutit dhe Marutit. Edhe ata, për shkak të krenarisë, hëngrën shigjetë të helmuar.

Patën siguri në krijimin e tyre të shenjtë, në qenien e tyre engjëj. Por kjo siguri është si siguria e demit ndaj luanit. Sa mund të ketë siguri demi ndaj luanit?

Edhe sikur të ketë njëqind brirë dhe të përpiqet të mbrohet me to, luani ia copëton jo brirët, por brirët e brirëve!

Edhe pse iriqi është krejt gjemba, luani e mbyt pa shpëtim.

Ndërkaq, edhe pse i shkul drurët nga rrënjët, cikloni sillet mirë ndaj një fijeje bari.

Ajo erë e fortë ka dhembshuri për dobësinë e barit. O zemër, tashmë edhe ti mos mbaj anën e forcës.

A ka frikë sëpata nga dendësia e pemëve dhe e degëve? Që të gjitha i pret e i bën copë-copë.

Por barin nuk e sulmon. Bisturia nuk përdoret tjetërkund veçse në plagë.

Apo mërzitet flaka nga shumica e druve? A ikën kasapi nga tufa e dhenve?

Ç'është trajta në krahasim me kuptimin? Shumë e dobët, shumë e pafuqishme. Eshtë kuptimi tek ajo, i cili e mban kokulur të keqin.

Merr shembull nga qielli që rrotullohet si dollap. Pse rrotullohet qielli? Për shkak të mendjes së matur që është tek ajo.

O bir, edhe rrotullimi, edhe lëvizja e këtij kallëpi që është si mburojë, janë nga shpirti i fshehtë. Lëvizja e kësaj ere është nga kuptimi i tij (nga kuptimi i dukshëm në atë formë, nga fuqia e Zotit); i ngjan elikës së mullirit; elika është rob i ujit të lumit.

Edhe frymëdhënia, edhe frymëmarrja, nga është përveç se nga shpirti kërkues?

Fjalën e nxjerrë me këtë frymë, shpirti herë e bën fjalë paqeje, herë fjalë lufte.

* Shpirti e çon atë frymë herë djathtas, herë majtas. Disa herë e vë si trëndafilishte, disa herë, si gjembishte.

Po kështu, Zoti ynë, ndërsa e bëri erën kuçedër për popullin e Adit, për besimtarët e ka kthyer në mëshirë, jetë dhe siguri.

Shehu i fesë i cili është det i kuptimeve të Zotit të botëve, tha: "Kuptimi është Allahu!"

Të gjithë qiejt e dherat janë si fije kashte në atë det që ecën, në atë detin e shpirtit.

Lëvizja e fijes së kashtës në ujë është nga dallgëzimi i ujit.

Po qe se këmbëngul dhe kërkon ta lërë të palëvizshme, e hedh menjëherë në breg.

Ashtu siç zjarri i djeg e i fshin fijet e kashtës dhe plehrat, edhe deti i fshin dhe i merr me vete të gjitha plehrat që ndodhen në pjesën e bregut ku del.

Edhe kjo fjalë s'ka fund. O i ri, ti prapë kthehu në historinë e Harutit dhe Marutit.

Fundi i historisë së Harutit dhe Marutit dhe ndëshkimi i tyre në Pusin e Babilonit.

Kur këta dy engjëj panë mëkatet dhe të këqijat e popullit të botës, kafshonin gishtat nga zemërimi.

Por me sytë e tyre nuk shihnin të metat e veta.

Një i shëmtuar, me ta parë veten në pasqyrë, ishte nxehur dhe kishte kthyer kokën.

Ai që sheh nga vetja dhe e pëlqen veten, sapo të shohë një faj tek tjetri, brenda i flakëron një zjarr më i furishëm se i xhehennemit.

Këtë mendjemadhësi ai e quan zell fetar, nefsin e vet qafir nuk e sheh.

Zelli fetar ka shenja të tjera. Ai nga zjarri bën të blerojë një botë e tërë, gjen jetë.

Zoti u tha Harutit dhe Marutit: Po qe se ju jeni engjëj të pafajshëm të krijuar nga drita, mos i shihni fajtorët e gënjyer e dëmprurës.

O ushtarë të qiellit, o rob të mi! Falenderoni që keni shpëtuar nga epshi dhe prirja seksuale!

Po qe se edhe juve ju jap epsh, atëherë syri nuk ju pranon më ju.

Pafajësia tek ju është reflektim i pafajësisë dhe ruajtjes sime.

Dijeni se atë pafajësi e keni prej meje, jo prej vetes. Ejani në vete! Shejtani i mallkuar të mos dalë fitues mbi ju!

Po kështu, edhe shkruesi i vahjit të Pejgamberit e pa urtësinë tek vetja dhe pandehu se edhe tek ai vinte vahji.

Pandehu se zëri i zogjve të Zotit është edhe tek ai, ra në pandehmën se ajo vërshëllimë e keqe ishte e bukur si zëri i zogjve.

Ndërsa ti rri e e lavdëron zërin e zogjve, si do ta kuptosh qëllimin e zogut?

Edhe në e mësofsh, edhe në e njohsh zërin e bilbilit, si do ta dish se ç'bën me trëndafilin, se ç'punë ka me të?

Le ta supozojmë se e njohe me rrugën e analogjisë dhe dyshimit... Ajo njohje është sa njohja e shurdhve nga lëvizja e buzëve të të tjerëve.

Shurdhi shkon te komshiu i sëmurë për ta pyetur për shëndetin

Dikush që ishte i kuptueshëm dhe merrte vesh nga respekti, e lajmëroi shurdhin se e kishte komshiun të sëmurë.

Shurdhi tha me vete: Si do t'ia marr vesh fjalët unë atij me këta veshë të shurdhër?

Pa le sikur të jetë vërtetë i sëmurë e të mos i dalë zëri? Megjithatë, duhet të shkoj patjetër!

Shoh se si i lëviz buzët dhe e gjej se ç'thotë.

I them: O miku im që ke rënë në mundim, si je? Ai gjithsesi do të më thotë: Mirë jam!

Lavdi Zotit - i them unë. - Ç'supë ke ngrënë? Ai do të më përgjigjet, për shembull, se ka ngrënë supë bishtajash.

Unë do t'i them: Të pastë bërë mirë! Cili mjek të vjen, cili të mjekon?

Pasi të më thotë emrin e mjekut, do t'i them se ka këmbë të mbarë. Po të vu dorë ai, puna të ka hyrë në rrugë të mbarë.

Edhe ne e kemi provuar mjeshtërinë e tij. Ku të ketë shkuar, ka shëruar!

Pasi i vuri në radhë këto fjalë me mendjen e tij, shurdhi shkoi me vrap te komshiu për ta pyetur dhe respektuar.

- Si je? - E pyeti. I sëmuri i tha: - Po vdes! - Lavdi Zotit, shumë mirë! - Iu përgjigj shurdhi. I sëmuri u zemërua fort nga këto fjalë.

- More, po ky ma paska dashur të keqen! Tani e kuptova! - Mendoi i sëmuri. Rrjedha e bisedës nuk shkoi siç e kishte projektuar shurdhi.

Pastaj e pyeti: Ç'ke ngrënë? - Helm! - Iu përgjigj i sëmuri. - Të pastë bërë mirë! - I tha shurdhi, kurse i sëmuri u hidhërua e u zemërua më keq nga këto fjalë!

Pastaj shurdhi e pyeti të sëmurin: - Cili mjek të vjen për të të mjekuar?

I sëmuri iu përgjigj: - Këput qafën! Azraeli më vjen! - Kurse shurdhi ia ktheu: - Ka këmbë të mbarë, gëzohu!

Dhe, duke u gëzuar që, në një kohë të tillë të vështirë, ishte munduar e kishte vajtur për t'ia pyetur hallet komshiut, shurdhi doli jashtë.

*Nga gomarllëku i vet, shurdhi pandehu të kundërtën e asaj që ndodhi. Humbjen e pandehu për fitim!

Kurse i sëmuri mendonte me vete: Ky paska qenë dushmani i jetës sime! S'e paskam ditur kështu!

Në mendje i shkonin njëqind lloj gjërash të këqija dhe thurte njëqind lloj fjalësh për t'ia çuar.

Atij që ha një gjellë të keqe, i turbullohet stomaku dhe nuk i pastrohet e nuk i qetësohet gjersa ta vjellë.

Ja, kjo do të thotë ta mundësh zemërimin; mos e vill zemërimin që nga përballë të dëgjosh fjalë të ëmbla!

Ngaqë s'kishte durim, i sëmuri përpëlitej dhe thoshte me vete: Ku është ai qen i ndyrë

Që t'u përgjigjem të gjithave ç'më tha! Kur po më fliste, isha krejt i sëmurë, prandaj s'më erdhi gjë ndërmend për t'ia thënë!

Pyetja për shëndetin dhe hallet është për t'ia fituar zemrën tjetrit dhe për ta ngushëlluar, mirëpo kjo e tija s'është pyetje për shëndetin dhe hallet, por armiqësi!

Ai paska dashur të më shohë mua, armikun e tij, të dobët e të lëshuar e të kënaqet!

Sa e sa njerëz që e kanë lënë adhurimin, duan me gjithë zemër dhe shpresojnë të marrin pëlqimin e Zotit, të fitojnë mirësi!

Mirëpo, në fakt, ky është një mëkat i fshehur. Sa e sa gjëra të turbullta ka që ti i pandeh ato të kthjellta!

Si ai shurdhi! Shurdhi pandehu se bëri të mirë, por ndodhi e kundërta!

Ai ndenji i qetë me mendimin se i kish bërë të mirë një të sëmuri, se e kishte respektuar, se e kishte çuar në vend detyrën e fqinjit!

Mirëpo kishte ndezur një zjarr në zemrën e të sëmurit, ku kishte djegur edhe veten e vet.

Kini frikë nga zjarret që ndizni! Ju e ndizni zjarrin dhe e shtoni atë me mëkatet tuaja.

Megjithëse një hipokrit fali namaz, Pejgamberi i tha: "O trim, ngreu dhe fal namaz se namazi që fale ti s'është namaz!"

Për shkak të kësaj frike, në çdo namaz thuhet: "Ihdinassiratal mustakim, drejtona në udhë të drejtë!"

Ose: O Zot, mos e ngatërro këtë namazin tim me namazin e atyre që e kanë ndërruar rrugën, e atyre me dy fytyra!

Për shkak të supozimit të zgjedhur nga shurdhi, fqinjësia dhjetëvjeçare iku e shkoi!

O i shtrenjtë, pa le sikur të jetë supozimi i ndjenjës së inferioritetit, i cili është i papranuar në revelacion...

Edhe sikur veshi yt i ndijimit i kupton tingujt, dije se veshi yt që dëgjon të fshehtën, është i shurdhër!

Eshtë Iblisi i pari që, përballë fjalës së Zotit, pretendoi të bënte supozim.

Personi i parë që parashtroi pretendime me supozime përballë dritës së Zotit, ishte Iblisi, djalli.

Ai tha: "Nuk ka dyshim se zjarri është më i mirë se dheu! Unë jam krijuar prej zjarri, kurse Ademi, prej dheut të zi!

Atëherë, le t'i krahasojmë të dytin me të parin: Ai është prej errësire, unë, prej drite të ndritshme!"

Zoti tha: "Jo, s'ka soj e sorollop! Devocioni dhe ruajtja nga gjërat e dyshimta është virtyt!"

Kjo nuk është trashëgim i kësaj bote të vdekshme që ta shtish në dorë me anë të sojit e sorollopit! Kjo është trashëgim shpirti.

Madje, trashëgim profetik. Trashëgimtari i kësaj është shpirti i besimtarëve që ruhet prej gjërave të dyshimta.

Biri i Ebu Xhehlit u bë haptas musliman, njëri nga ata që e kanë ngatërruar rrugën e të birit të profetit Nuh.

I krijuari nga dheu u ndriçua si hëna, kurse ti, i krijuari nga zjarri, u bëre faqezi! Këput qafën!

Këto krahasime, këto kërkime janë për ta gjetur kiblen në ditën e vranët me re ose natën.

Por po të ketë lindur dielli dhe po ta kesh Qaben përballë, lëri këto krahasime e këto kërkime, mos kërko!

Për shkak të krahasimit, mos bëj sikur s'e sheh Qaben, mos i largo sytë prej saj. Zoti e di se ç'është më e drejtë!

Me të dëgjuar një këndim nga zogu i Zotit, ngulit në mendje vetëm të dukshmen siç ndodh kur bën mësimet dhe ngulit në mendje ato që lexon.

Pastaj bën krahasime sipas teje dhe e pandeh imagjinatën si të vërtetë.

Abdallët kanë zhargonin e tyre, për të cilin fjalët nuk dinë gjë.

Ti e mësove gjuhën e zogut vetëm si zë dhe u dhe zjarr qindra krahasimeve e fantazirave.

Por siç u prek ai i sëmuri, u prekën e u dëshpëruan edhe shumë zemra prej teje. Kurse shurdhi, i kapur nga pandehma e vet, kujtoi se kishte thënë fjalë të qëlluara dhe u deh nga gëzimi.

Edhe ai shkruesi i vahjit e dëgjoi zërin e atij zogut dhe e pandehu veten të barabartë me të.

Por zogu i rrahu krahët dhe e verboi atë dhe e çoi atë gjer në fundin e vdekjes dhe dhimbjes!

Ejani në vete dhe mos u rrëzoni edhe ju nga vendqëndrimet qiellore për shkak të pandehmës.

Edhe sikur të jeni Haruti me Marutin, edhe sikur të ndodheni para gjithë të tjerëve mbi platenë e "ne të falemi Ty radhë-radhë"!

T'ju dhimbsen të këqijat e të këqinjve. Mos ejani rrotull unit, rrotull vetëpëlqimit!

Ejani në vete! Zelli ndaj Zotit të përpiqet për të dalë nga pusia, ndryshe bini kokëposhtë në fund të dheut!

Që të dy thanë: O Zot, fermani është yti, mirësia është jotja! Po të mos jetë mbrojtja jote, kush na bën mirësi, kush na mbron ne?

Dhe u përpëlitej zemra duke e thënë këtë, për të zbritur e sunduar mbi tokë. Dhe thoshin: A vjen e keqe prej nesh? Ç'rob të mirë jemi ne!

Kjo krenari dhe këto kërkesa të tyre nuk i lanë të qetë ata; më në fund, i bënë ata që ta pëlqejnë veten.

O ju njerëz që i takoni dheut, ujit, tokës dhe zjarrit, o ju që s'dini gjë për pastërtinë e shpirtërorëve!

Ne lëshojmë perde mbi këtë faqe të qiellit, zbresim në tokë dhe ngremë shatërvane!

Bëjmë drejtësi, falemi dhe, pastaj, çdo natë fluturojmë e ikim qiejve.

Në këtë mënyrë, bëhemi të mëdhenjtë e çuditshëm të kësaj kohe dhe përhapim drejtësinë dhe sigurinë mbi tokë!

E krahasuan gjendjen e qiellit me të tokës, por ky krahasim s'është i drejtë... Mes tyre ka ndryshim të madh!

Halli, gëzimi dhe dehja duhen fshehur prej injorantëve.

Dëgjoje fjalën e Gjykatësit që ka hyrë nën perde: Aty ku të kesh pirë verë, mbështete kokën e fli.

I dehuri që del nga mejhanja dhe e ngatërron rrugën, bëhet loloja dhe lodra e fëmijëve.

Nga çdo anë që të shkojë e nga çdo rrugë që të kalojë, bie në baltë dhe çdo kokëtrashë qesh me të!

Në këtë gjendje, atij i vihen pas fëmijët që s'dinë se është i dehur, që s'dinë se ç'është gëzimi dhe kënaqësia e verës që ka pirë ai!

Të gjithë të tjerët veç atij që është i dehur pas Zotit, janë fëmijë. Nuk ka njeri të pjekur e të matur veç atij që ka shpëtuar nga dëshirat dhe fantazitë!

Zoti tha: Kjo botë është një dëshirë e kotë, një lodër pa dobi, kurse ju jeni fëmijë! Zoti thotë drejt.

Gjersa të mos i kesh lënë lodrat, je fëmijë! Si mund të jesh i pastër pa t'u pastruar shpirti?

Dije se ky epsh që kërkohet vazhdimisht në këtë botë, që kurrsesi nuk lihet, është si loja e fëmijëve me nusen dhe dhëndërrin.

Ç'është martesa tek fëmijët? Një lojë në krahasim me martesën e një trimi të ri!

Edhe lufta e njerëzve është si loja luftash e fëmijëve. Krejtësisht pa kuptim, pa bazë dhe e ulët!

Fëmijët luftojnë me shkopinj të bërë si shpata. Përpiqen e lodhen pa ndonjë dobi.

Të gjithë u hipin shkopinjve si të ishin kuaj dhe ashtu i quajnë.

Ata kanë barrë mbi shpinë, por, nga padija, e shohin veten lart, duke marrë udhë mbi kuaj.

Por prit, kalorësit e popullit t'i lëshojnë kuajt një ditë, të kalojnë nëpër nëntë kat qiell, dhe shih!

Atë ditë, shpirti dhe engjëlli ngjiten te Zoti dhe nga ngjitja lart e shpirtit, qielli dridhet!

Si fëmijët, edhe ju jeni kapur pas fundit të rrobës sikur t'ia kishit shaluar kalit... E keni kapur cepin e rrobës sikur të kishit hipur mbi kalë!

Nga Zoti ka ardhur vendimi se "pa dyshim, pandehma nuk jep dobi"! Si mund të vrapojë për në qiej gomari i pandehmës!

Po qenë dy pandehma të ndryshme, pëlqehet ajo që është më e fuqishme. Por kur të lindë dielli, qenia dhe shkëlqimi i tij nuk mund të kundërshtohen më!

Dhe ja, atë kohë ju i shihni gjërat që ua keni hipur dhe kuptoni se ua keni hipur vetëm këmbëve tuaja!..

Fantazinë, idenë, ndjenjën dhe kuptimin diji si shkopin që fëmija e quan kalë.

Dituria që i flet zemrës, që e bën njeriun njeri të zemrës, i sjell njeriut dobi. Kurse dituria që ndikon vetëm mbi trupin, që nuk bëhet pasuri për njeriun, është barrë për të.

Zoti tha se ata që e njohin Teuratin dhe nuk veprojnë sipas tij, i ngjajnë gomarit që bart libra. Dija që s'është e Zotit, është barrë.

Dituria që nuk jepet drejtpërdrejt nga Zoti pa ndërmjetës, ashtu si boja me të cilën e lyen nusen gruaja që e përgatit atë, e humb freskinë dhe avullohet.

Por po ta tërheqësh mirë këtë barrë, ta marrin e të lehtësojnë.

Mos e bart atë barrë dijesh në emër të dëshirave dhe pasioneve që të mund ta shohësh hambarin e diturisë brenda saj.

Pasi dituria jote të hipë mbi kalin revan, ta heqin barrën nga shpina.

Si mund të heqësh dorë nga dëshirat dhe pasionet pa pasur kupën e Zotit? O ti që kënaqesh vetëm me emrin "Hu" (Ai) të Zotit!

Ç'lind nga emri dhe atributi? Fantazi! Ajo fantazi bëhet për atë që e ka vetëm provë e bashkimit me Zotin!

A ke parë ndonjëherë ndonjë provë që të mos ketë objektin e saj? Po të mos ketë rrugë, kurrsesi s'mund të ketë as trëndafil!..

A pe ndonjë emër që të mos ketë të vërtetën e vet? Ose, a mblodhe trëndafila nga shkronjat Kaf dhe Lam?

Meqë e lexove emrin, shko dhe kërkoje emërtuesin. Hënën dije në qiell, jo në përrua! Po deshe të zhvishesh nga emri dhe shkronja, zhvishe plotësisht veten nga vetja jote (asgjësohu).

Shndritu ashtu si hekuri që fërkohet e shndrit dhe bëhu i pangjyrë. Dhe me përpjekje, bëhu një pasqyrë pa pluhur e pa ndryshk.

Pastroje veten nga cilësitë e tua që ta shohësh veten tënde të pastër e të kulluar.

Dhe atëherë, sheh në veten tënde dituritë e pejgamberëve në mungesë të librit, diskutantit dhe mësuesit.

Pejgamberi ka thënë: "Nga ummeti im ka të tillë që kanë të njëjtin krijim me mua, që zotërojnë të njëjtën influencë.

Me ç'dritë që t'i shoh unë ata, edhe shpirtrat e tyre patjetër më shohin me të njëjtën dritë."

Këta e shohin pejgamberin në burimin e eliksirit (në zemra) pa qenë librat e haditheve të vërteta dhe treguesit e tyre, pa mbetur nevojë për ta.

Njihe të fshehtën "ramë të flemë kurdë", lexoje të fshehtën "u gdhimë në mëngjes si arabë"!

Po deshe ndonjë shembull mbi diturinë e fshehtë, thuaje historinë e rumëve me kinezët:

Rumët me kinezët vënë bast për aftësi pikturimi.

Kinezët thanë: "Ne jemi piktorë më të aftë!" Edhe rumët thanë: "Mjeshtëria jonë është më e lartë!"

Padishahu u tha: "Do t'ju vë në provë! Ta shohim kush nga ju ka të drejtë në pretendimin e tij!"

Piktorët kinezë dhe rumë u përgatitën; piktorët rumë ishin më të aftë në diturinë e artit të pikturës.

Piktorët kinezë u thanë: "Neve na jepni një dhomë më vete, kurse një dhomë tjetër të jetë vetëm për ju!"

Ishin dy dhoma ballëpërballë. Njërën e morën piktorët kinezë, kurse tjetrën, piktorët rumë.

Kinezët kërkuan nga padishahu njëqind lloje bojërash. Atëherë, padishahu hapi thesarin.

Kinezëve u jepej bojëra nga thesari çdo mëngjes.

Piktorët rumë thanë: "Përveç pastrimit të ndryshkut, as boja vlen, as piktura!"

E mbyllën derën dhe nisën t'u japin shkëlqim mureve. Dhe i bënë të pastra, të kulluara e të kthjellta si qielli.

Mungesa e ngjyrave është më e mirë se ngjyrimi me dyqind ngjyra. Ngjyra është si reja, kurse bardhësia, si hëna.

Po qe se sheh dritë dhe shkëlqim te reja, dije se e ka prej yjeve, hënës dhe diellit.

Piktorët kinezë e mbaruan punën. Të gjithë i gëzoheshin bukurisë së pikturave që kishin bërë.

Padishahu hyri nga dera brenda dhe i pa pikturat në dhomë. Që të gjitha ishin përtej mendjes dhe përfytyrimit, gjëra mrekullisht të bukura!

Pastaj shkoi në dhomën e piktorëve rumë. Një piktor rum ngriti perden që pengonte shikimin e dhomës përballë.

Pikturat dhe ornamentet e bëra në dhomën tjetër nga piktorët kinezë ranë në murin e lustruar të kësaj dhome.

Gjithçka kishte atje, u duk këtu më mirë; reflektimi i pikturave pothuaj të merrte sytë!

O bir, piktorët rumë janë sofi. Ata s'kanë mësime e libra që duhen mësuar përmendësh.

Por zemrat i kanë lustruar si jo më mirë, i kanë pastruar prej dëshirës, ambicjes, pangopësisë dhe urrejtjes.

Pastërtia dhe kthjelltësia e asaj pasqyre është cilësi e zemrës. Në zemër mund të reflektohen trajta pa numër e pa kufi.

Trajta e patrajtë dhe e pakufi e botës së padukshme shkëlqeu në pasqyrën e zemrës së Musait, u duk në dorën që e futi dhe e nxori nga gjoksi.

Atë trajtë s'mund ta nxënë as qielli, as arshi, as toka dhe asgjë nga qielli më i lartë gjer te peshku në fund të detit.

Sepse të gjitha këto janë të kufizuara në hapësirë dhe në numër. Mirëpo pasqyra e zemrës nuk ka kufi!

Këtu mendja ose hesht, ose mbetet e habitur. Shkaku është ky: A zemra është Zot, a Zoti është zemër?

Përveç zemrës, reflektimi i çdo pikture edhe të numërueshme, edhe të panumërueshme (edhe përpjesëtohet, edhe është një e papërpjesëtueshme), është kalimtar, jo i përhershëm.

Por çdo pikturë e re e shfaqur nga pafillimi në pafundësi, reflektohet në zemër ku shfaqet pa perde në një trajtë krejtësisht të qartë.

Ata që u kanë dhënë shkëlqim zemrave, kanë shpëtuar nga ngjyra e nga era. Në çdo frymëmarrje ata shohin pa mundim një bukuri.

Ata e kanë lënë pikturën në lëkurën e diturisë dhe kanë ngritur flamurin e njohjes së drejtpërdrejtë të thelbit të saj.

E kanë lënë mendimin, kanë gjetur detin e afërsisë (konfidencës) dhe janë asgjësuar në të.

Çdo njeri dridhet, ka frikë nga vdekja, kurse ky fis i nënqesh asaj nën mustaqe.

Askush nuk del dot fitues mbi zemrën e tyre. Dëm pëson midhja, jo margaritari.

Ata kanë braktisur shkencën dhe gramatikën, por kanë zgjedhur prishjen dhe asgjësimin.

Kur pikturat e tetë xhenneteve përshndrisin, reflektohen në tabelën e zemrës së tyre dhe shfaqen atje.

Grada e atyre që rrinë ulur në postin e drejtësisë së Zotit, e atyre që e kanë bërë atë vendbanimin e vet, është më e lartë edhe se arshi, se kursia, se boshllëku!

Pejgamberi Alejhisselam e pyeti Zejdin: "Si u gdhive sot, si je?" Dhe ai iu përgjigj: "Si besimtar, o i dërguari i Zotit!"

Një mëngjes, Pejgamberi e pyeti Zejdin: "O shok i pastër e i thjeshtë, si e bëre këtë mëngjes?"

Zejdi iu përgjigj: "Si një rob besimtar!" Pejgamberi i tha: "Nëse kopshti i besimit është bleruar e ka çelur lule, ku është shenja e tij?"

Zejdi iu përgjigj: "Ditët i kalova pa ujë, netët nuk fjeta i djegur nga ashku!

Ashtu siç e shpon heshta mburojën dhe e kalon tejpërtej, ashtu dhe unë i kalova ditët dhe netët tejpërtej.

Prandaj, sipas meje, të gjitha sheriatet, të gjitha fetë janë një. Sipas meje, qindramijëra vjet dhe një orë janë e njëjta gjë.

Pafillimi dhe pafundësia u bënë një, por mendja, nga paaftësia e saj, nuk gjen dot rrugë këtu!"

Pejgamberi i tha: "Mirë, po ç'solle nga ajo rrugë diçka që të kuptohet në këtë vend, që ta gjejnë mendjet e këtushme?"

Zejdi iu përgjigj: "Ashtu siç e sheh populli faqen e qiellit, ashtu dhe unë e shoh arshin dhe ata që ndodhen në arsh!

Tetë xhennete dhe shtatë xhehenneme qëndrojnë para meje sheshit dhe të qarta si idhulli para shamanit.

I njoh ato një për një siç e dallon populli elbin nga gruri në mulli.

Kush është i xhennetit? Dhe kush është i huaj? Sipas meje, të qartë si gjarpri dhe peshku.

Prej tani ka dalë sheshit e fshehta "ditën e kiametit, disa fytyra bëhen të zeza, disa, të bardha...". Një pjesë e këtyre njerëzve e kanë fytyrën të bardhë, një pjesë, të zezë!"

Në të vërtetë, disa shpirtra qenë me të meta edhe më parë (para se të vinin në këtë botë). Por meqë ndodheshin në mitrën e nënës, ishin të fshehta për popullin.

I poshtri është i poshtër që në barkun e nënës (por nuk njihet). Kurse në botën materiale, nga gjendjet materiale kuptohen edhe gjendjet e shpirtit.

Si nëna, edhe trupi është shtatzënë në fëmijën shpirt. Vdekja është vuajtje lindjeje dhe kiamet.

Të gjithë shpirtrat që kanë kaluar në këtë botë, presin se "si do të lindë, vallë, ai shpirt i kënaqur?"

Zezakët thonë: "Ai është patjetër prej nesh!" Kurse të bardhët thonë: "Është e pamunudur! Ai do të bëhet shumë i bukur!"

Kur shpirti i trupit të lindë në botën tjetër, atëherë s'mbetet kundërshti bardhë apo zi!

Po qe i zi, e marrin zezakët, kurse po qe i bardhë, fëmijën e racës së tyre e marrin të bardhët.

Por ta kuptosh pa lindur është një nga punët e vështira të kësaj bote, sepse janë të pakët ata që e dinë se si është fëmija ende i palindur.

Personi që e kupton këtë, është personi që vështron dhe sheh vetëm me dritën e Zotit. Njeriu i tillë mund ta zotërojë edhe të brendshmen.

Origjina e embrionit është e bardhë dhe e këndshme, por reflektimi i shpirtit të njeriut të bardhë

i jep embrionit ngjyrë, e fut atë në formën më të bukur; edhe reflektimi i shpirtit të njeriut të zi e shtyn popullin në ngjyrën më të ulët, e fut në formën më të pavlerë.

Kjo fjalë s'ka fund. Prandaj ti vazhdo ta ngasësh kalin dhe ne të mos mbetemi pas karvanit.

Një ditë, para secilit grup del sheshit nëse je kashtë, mal, hindu, apo turk!

Hindui dhe turku nuk dallohen në barkun e nënës, por pasi lindin, gjithkush i sheh e i kupton nëse janë të dobët a të fortë.

Zejdi i përgjigjet Pejgamberit (s.a.s.): "Sipas meje, gjendja e popullit s'është e fshehtë, por krejt e qartë!"

Zejdi tha: "Unë e shoh popullin, burra e gra, krejt qartë, si të ndodheshin në ditën e kiametit.

A ta them menjëherë tani? Apo ta mbyll? Mustafai ia kafshoi gjuhën si për t'i thënë "hesht!"

Zejdi i tha: "O Pejgamberi i Zotit, a ta them të fshehtën e ringjalljes dhe ta bëj kiametin të shpërthejë sot në të gjithë botën?

Më lejo t'i gris perdet dhe esenca dhe përbërja ime të përshndrisë si diell?

Dhe dielli të zihet nga drita ime... dhe t'i tregoj drurin e hurmës (si dru frutor) dhe drurin e shelgut (si dru jofrutor)?

Ta zbuloj të fshehtën e kiametit, t'i ekspozoj paranë e vërtetë prej floriri dhe paranë kallpe?

Ata që ndodhen në të majtë, ngjyrën e mohimit dhe ngjyrën e kuqe?

Shtatë vrimat e intrigës në dritën e hënës që nuk zihet dhe nuk nxihet?

Rrobat e grisura të të ultëve t'i tregoj. T'i njoftoj daullet dhe ndërrimet e profetëve.

Xhehennemin, xhennetet, Arafin midis të dyve t'i sjell qartazi para syve të mohuesve, qafirëve.

Të tregoj se si hauzi Kevther dallgëzon, se uji i tij përplaset në fytyrat e banorëve të xhennetit duke u bërë zë: "Pini, pini!" Dhe se si ky zë u shkon atyre në veshë...

Të tregoj hapur se si të eturit vijnë rrotull pa pushim rreth hauzit.

Supet e tyre fërkohen me supet e mi, thirrjet e tyre vijnë në veshët e mi.

Ja, para syve të mi... Njerëzit e xhennetit e kanë përqafuar njëri-tjetrin me dëshirat e tyre.

Ia rrokin duart njëri-tjetrit, u urojnë mirëseardhjen, nga buzët sajojnë buzëqeshje.

Veshët m'u shurdhuan nga klithmat e mallit të personave të ulët, nga thirrjet e tyre "Ah, ah!"

Këto që po them janë vetëm shenja. Mund të them edhe më thellë, por kam frikë mos e lëndoj Pejgamberin."

Kështu po vazhdonte të fliste Zejdi si i dehur, në një trajtë të parregullt. Pejgamberi përkuli jakën.

Dhe i tha: "Eja në vete, kali po të ecën shumë shpejt, tërhiqja frerët. Ndodhi e kundërta e konkluzionit "Zoti nuk ndjen turp", ndjenja e turpit u hoq nga mesi.

Pasqyra të doli prej këllëfi. Pasqyra dhe peshorja a gënjejnë?

A e fshehin fjalën pasqyra me peshoren me qëllim që askush të mos preket, të mos turpërohet?

Edhe sikur qindra vjet t'u shërbesh pasqyrës dhe peshores, ata mbeten prapë gurë prove të drejtë e me vlerë të lartë.

Edhe nëse i lutesh pasqyrës "fshihe të fshehtën time, fshihe të drejtën", kurse peshores "mos trego mangët, por tepër",

Ata do të të thonë: "Mos e fëlliq veten! Ku pasqyra e peshorja e ku hileja e dredhia!

Zoti na e lartësoi vlerën me qëllim që të vërtetat të kuptohen nëpërmjet nesh.

Po qe se do të na mungonte kjo drejtësi dhe ndershmëri, s'do të kishim as vlerë; atëherë, si do t'ia zbardhnim fytyrën njeriut të mirë?"

Por ti mbaje në prehër pasqyrën edhe sikur në zemrën tënde të ketë rënë shfaqja e Zotit e malit Sina!

Zejdi tha: "Dielli i Zotit, diell i përjetshëm, a mund të mbahet nën sqetull?

I gris e i djeg edhe gjërat jo fisnike, edhe sqetullën. Para tij s'mbetet as marrëzi, as mençuri!"

Pejgamberi tha: "Po ta vësh njërin gisht mbi sy, e sheh botën pa diell."

Edhe një gisht i vetëm i bëhet hënës perde. Ja, pra, kjo është shenjë e mbulimit të turpit të padishahut.

Në këtë mënyrë, një pikë (që është gishti) e mbulon botën dhe një rrëshqitje e bën diellin të padukshëm.

Mbylli buzët dhe shih në fund të detit Zoti e ka bërë detin të burgosurin e njeriut.

Kështu, edhe lumenjtë Selsebil dhe Zenxhebil janë nën urdhër të robve që Zoti i ka vendosur në xhennet.

Katër lumenjtë e xhennetit janë nën urdhrin tonë.

Por kjo s'është prej forcës e prej fuqisë sonë. Eshtë kështu me urdhrin e Zotit.

Këta lumenj, si magjitë që u binden urdhrave të magjistarëve, janë nën urdhrin tonë; i bëjmë të drejtohen andej nga të dëshirojmë.

Si çezmat e këtyre dy syve që rrjedhin pa pushim, që janë nën urdhër të zemrës, nën dekretin e shpirtit...

Po deshi zemra, sytë shkojnë në atë anë ku është helmi, ku ndodhen gjarprinjtë; po dëshiroi zemra, nxjerrin mësim nga gjërat që shohin.

Po dëshiroi zemra, shohin nga gjërat që duken; po dëshiroi zemra, rrjedhin nga gjërat e mbuluara, të fshehta.

Po deshi zemra, i hedh sytë nga ana e së tërës; po deshi zemra, i mbyll te e pjesshmja.

Të pesë shqisat janë të lidhura me zemrën siç janë të lidhura rubinetat me depozitën e çezmës. Bëjnë punë sipas dëshirës dhe urdhrit të saj.

Në atë anë që të bëjë me shenjë zemra, në atë anë mblidhen e shkojnë pesë shqisat.

Ashtu si shkopi në dorën e Musait është i lidhur pas Musait, edhe këmba është e lidhur fare qartë pas zemrës.

Po deshi zemra, këmba hyn në valle ose, ndërsa po ecën ngadalë ngadalë, fillon të ecë me nxitim.

Po deshi zemra, dora nis të llogarisë me gishta ose shkruan libër.

Dora është nën urdhrin e një dore të fshehtë. Dora e fshehtë është brenda; nga jashtë i ka qepur vetes trupin, e ka bërë atë zëvendës.

Po deshi zemra, dora bëhet kuçedër për armikun. Po deshi zemra, i bëhet ndihmëse njeriut të dashur.

Po deshi zemra, dora është qepshe për gjellë; po deshi, top me dhjetë predha!

Ç'thotë, vallë, zemra për këto? Ç'bashkim i çuditshëm ky, ç'shkak i fshehtë ky!

A mos vallë zemra futi në dorë vulën e Sulejmanit që i tregon rrugët e pesë shqisave si të dojë?

Pesë shqisa të jashtme janë bërë jashtë lehtësisht të burgosurit e tij, kurse pesë shqisa të brendshme, brenda, nëpunësit e tij...

Dhjetë shqisa, veç këtyre, shtatë gjymtyrë, shumë fuqi që s'mund të përmenden me gojë... Të tjerat numëroji ti.

O zemër, meqë në madhëri edhe ti je një Sulejman, me unazën e mbretërimit në gisht urdhëroji perritë dhe djajtë!

Po qe se në këtë mbretërim nuk bën hile, ata tre djaj nuk mund të ta marrin unazën që ke në gisht.

Veç kësaj, emri dhe fama jote e mbajnë tërë botën. Siç të bindet trupi, të dy botët i binden urdhrit tënd.

Por po qe se djalli ta merr unazën që ke në gisht, do të thotë se mbretërimi të mbaroi, se fati yt vdiq!

O rob të Zotit, po qe se puna bëhet kështu, pas kësaj do të rrini vetëm duke thënë "ah, o mall" gjer në kiamet!

Le të themi se do ta mohosh hilen tënde; po shpirtin, si do ta shpëtosh nga pasqyra dhe peshorja?

Skllevërit dhe shërbëtorët e të zot e akuzojnë Llukmanin se ka ngrënë frutat e mbledhura.

Mes skllevërve dhe shërbëtorëve që ndodheshin nën shërbim të zotërisë së tij, Llukmani shihej me nënvleftësim dhe përbuzje.

Për të ngrënë i qetë e për t'u dëfryer, zotëria i dërgoi skllevërit dhe shërbëtorët në kopshtije që t'i sillnin fruta.

Mes skllevërve dhe shërbëtorëve, Llukmani ishte një shërbëtor që pothuaj varej prej tyre. Nga brenda, i mbushur plot ide, kurse nga jashtë, i zi si nata!

Skllevërit dhe shërbëtorët i hëngrën me lakmi frutat që mblodhën.

Dhe i thanë zotërisë se i hëngri Llukmani. Zotëria e thartoi fytyrën para Llukmanit dhe mbajti një qëndrim të rëndë.

Pasi e hetoi shkakun e kësaj dhe e kuptoi, Llukmani e hapi gojën tejet i zemëruar me zotërinë, të cilit i tha kështu:

"Or zotëri, robi tradhtar pranë Zotit nuk mund të jetë një rob që e ka fituar pëlqimin e tij!

O bujar! Provona të gjithëve! Na jep të pimë ujë të ngrohtë me të tepërt.

Pastaj na nxirr në fushë të hapur. Ti vrapo me kalë, kurse neve na vër të vrapojmë në këmbë.

Atëherë shihe se kush e ka bërë të keqen dhe vështro punët e Zotit se si i zbulon të fshehtat!

Zotëria u bë saki, ujëshërbyes i shërbëtorëve të vet dhe u dha ujë për të pirë. Dhe ata, nga frika, pinë.

Pastaj i vuri ata të vrapojnë në fushë të hapur. Skllevërit dhe shërbëtorët vraponin pa pushim poshtë e përpjetë fushës së gjerë.

Më në fund, u lodhën shumë dhe nisën të vjellin. Uji që pinë ua nxori jashtë tërë frutat që kishin ngrënë.

Edhe Llukmanit iu turbullua stomaku, edhe ai filloi të vjellë, por nxori vetëm ujë të papërzjerë.

Po qe se urtësia e Llukmanit diti ta tregonte këtë, për ç'gjëra është e paaftë urtësia e Zotit, krijuesit të ekzistencës?

Ditën e kiametit, të gjitha të fshehtat do të dalin, do të duken e do të kuptohen. Edhe juve ju doli sheshit e fshehta që s'deshët t'ju merrej vesh!

Siç e pinë ujin e ngrohtë, të fshehtat e tyre demaskuese dolën sheshit plotësisht.

Meqë guri do të provohet me zjarr (do të copëtohet, do të zbutet dhe do të tretet në zjarr), qafirët hidhen në zjarr dhe ndëshkimi i tyre kryhet me zjarr.

Disa herë i thamë ne fjalë të buta asaj zemre si gur, por nuk mori kështillë.

Edhe në damar, po të ketë plagë të keqe, vihet ilaç i keq; kokës së gomarit i shkon bushtra.

Thënia se gjërat e këqija janë për të këqinjtë, është një urtësi. E shëmtuara që i përshtatet të shëmtuarit, është bashkëshortja e tij.

Prandaj edhe ti, cilën bashkëshorte dëshiron, ec, atë merre! Humbe veten te Zoti, fito nga atributet e tij!

Po deshe dritë, fito aftësi për dritë; po deshe largësi nga Zoti, shihe veten dhe largohu!

Përndryshe, po deshe një rrugë për të shpëtuar nga kjo errësirë gërmadhë, mos e hiq kryet nga i dashuri, bjer në sexhde dhe afrohu!

Përgjigjja e Zejdit për Pejgamberin (s.a.s.) dhe fundi i kësaj historie.

Kjo fjalë s'ka fund. Zejd, ngrihu dhe lidhe kalin e fjalës!

Aftësia për të folur e zbulon të metën, i gris perdet e të fshehtës.

Zoti e kërkon të fshehtën në shumë vende. Shtyje këtë daullxhiun dhe mbylle rrugën.

Mos e nga kalin me nxitim, tërhiqja frerët. Eshtë më mirë që të fshehtat të mbeten fshehtë, që çdo njeri të jetë i gëzuar nga pandehma e vet.

Edhe për ata që e presin shpresën prej tij, Zoti kërkon që të mos largohen nga ky adhurim,

Që edhe ata të kapen pas një shprese dhe gjatë disa ditëve të vrapojnë me të.

Meqë mëshira e tij i përfshin të gjithë, Zoti dëshiron që mëshira e tij ta ndriçojë këdo.

Çdo zotëri e çdo rob të druhet nga Zoti me frikë dhe shpresë.

Kjo frikë dhe shpresë ka hyrë pas perdes në mënyrë që çdokush të ushqehet e rritet pas perdes.

Po e grise perden e frikës dhe shpresës, e fshehta del sheshit me të gjithë shkëlqimin e saj.

Një i ri pa dikë që po zinte peshk në breg të lumit dhe pandehu se "ai peshkatar duhet të ishte Sulejmani!"

"Pse të jetë i vetëm dhe i fshehur Sulejmani? Po s'qe ai vetë, si ndodh që t'i ngjajë kaq shumë Sulejmanit?"

Dhe këtë dyshim e pati në zemër gjersa Sulejmani u bë sërish një padishah më vete.

Divi u shemb e iku nga froni e nga vendi i tij; shpata e fatit derdhi gjakun e atij shejtani.

Prapë e vuri unazën në gisht dhe i mblodhi mbi krye ushtarët e divit dhe perrive.

Populli u mblodh në vend për të vështruar; edhe i riu që kishte ato mendime, i futur mes popullit, arriti gjer afër.

Dhe me ta parë unazën në gishtin e Sulejmanit, hamendja dhe dyshimi i kaluan plotësisht.

Hamendja ndodh kur puna është e fshehtë. Ky kërkim dhe hetim është për gjënë e padukshme.

Hamendja mbi gjënë që sndodhet në shesh rritet gjithnjë e më shumë. Por gjëja që ndodhet e fshehtë, po doli në shesh, hamendja zhduket.

* Në të vërtetë, ta shpjegosh të vërtetën e një gjëje është, në fakt, pjekuri, dhe i shpëton shpirtrat nga hamendja dhe iluzioni.

* Por besimi në të fshehtën është njëqind herë më i çmuar si besimi në gjënë e dukshme. Dije mirë këtë dhe shpëto nga dyshimi dhe lëkundja!

Faqja e ndritshme e qiellit s'rri e palagështirë, por edhe faqja e tokës e zezë nuk heq dorë nga rritja e bimësisë.

Mua më duhen ata që i besojnë të fshehtës. Prandaj mbylleni penxheren e këtij konaku të përkohshëm.

Si e shpjegoj dhe i çaj retë e i hap? Po qe se të vërtetat i vë në shesh, si mund të them: "A pe në këtë ndonjë mangësi, ndonjë të metë?

Çdokush, kur kërkon dhe heton në këtë errësirë, e kthen fytyrën në njërën anë;

Punët shkojnë një farë kohe në të kundërtën; hajduti e çon policin në trekëmbësh...

Kështu, shumë sulltanë, shumë bujarë të mëdhenj bëhen robër të robit të vet.

Po qe se shërbëtori e ruan pozitën e vet prej shërbëtori edhe kur s'është pranë të zot, dhe e ruan bindjen ndaj tij, kjo pozitë prej robi dhe shërbëtori është e mirë dhe e këndshme.

Ku ai i cili e lavdëron padishahun në sy, e ku ai që turpërohet dhe druhet prej padishahut edhe në mungesë të tij!

Një dizdar kalaje në skaj të vendit, larg nga padishahu dhe hija e mbretërimit të tij,

E mbron kalanë nga dushmanët dhe nuk e shet atë vend edhe sikur t'i japin mall dhe para pa numërim!

Po qe se dizdari tregohet besnik në mungesë të padishahut, përgjatë kufirit, sikur të ndodhej para padishahut,

Sigurisht që është më i çmuar se personat që flijohen kur ndodhen pranë padishahut dhe para tij!

Atëherë, zbatimi i një urdhri sa një grimcë, por të fshehtë, është qindramijëra herë më i lartë se shërbimi dhe zbatimi i urdhrit në prani të urdhëruesit.

Bindja, adhurimi dhe besimi janë të pëlqyeshme e të pranueshme tani, por të besosh pas vdekjes, kur çdo gjë të ketë dalë në shesh, s'vlen për gjë!

Nëse e vërteta është e mbyllur dhe e mbuluar dhe besimi në të fshehtën është më i mirë e më i pranueshëm, gjithsesi është më mirë që goja të mbahet e mbyllur dhe buzët, të shtrënguara.

Vëlla, hiq dorë nga fjala që Zoti vetë të nxjerrë në shesh prej teje diturinë hyjnore!

Dielli vetë është i mjaftueshëm si provë për ekzistencën e vet. Kush është dëshmitar më i lartë se Zoti?

Jo, do ta them, sepse në Kur'an, në çështjen e dëshmisë, janë përmendur gjithmonë bashkë edhe Zoti, edhe engjëjt, edhe dijetarët.

Edhe Zoti dëshmon, edhe engjëjt, edhe personat e ditur: nuk ka dyshim se Zoti është gjithmonë Zot!

Kur të dëshmojë Zoti, kush janë engjëjt që të mos marrin pjesë bashkë me Zotin në dëshmim?

Sepse sytë dhe zemrat e mjera që nuk e durojnë dot dritën, nuk kanë fuqi t'i qëndrojnë dritës së diellit dhe vetë diellit!

Këta lloj sysh dhe zemra të tilla u ngjajnë lakuriqëve të natës. Lakuriqi i natës nuk e duron dot dritën e diellit, nxehtësinë e diellit, prandaj e pret shpresën (mbetet i mangët nga dielli).

Dije se edhe engjëjt janë miqtë dhe bashkëshoqëruesit tanë në dëshmimin e diellit i cili bën lojra në faqen e qiellit!

Ata dëshmojnë: "Ne morëm dritë nga ai dielli i vetëm dhe, si zëvendës të diellit, i ndriçuam të dobëtit!"

Çdo engjëll është, si hëna e re ose si hëna triditëshe ose si hëna e plotë, zotërues i përkryerjes, dritës dhe fuqisë!

Ajo tufë drite bie, sipas gradës, në secilin prej engjëjve tre ose katërflatrash dhe i ndriçon ata.

Flatrat e engjëjve u ngjajnë flatrave të mendjes së njerëzve. Edhe mes mendjeve të njerëzve ka shumë ndryshime.

Si në të mirë, si në të keqe, çdo njeri ka për shok një engjëll që i ngjet.

Meqë s'e duron dot dritën, dritëshkurtit i jep dritë ylli dhe ai e gjen rrugën në këtë mënyrë.

Pejgamberi (s.a.s.) i thotë Zejdit: "Mos e zbulo këtë të fshehtë, por ruaje!"

Pejgamberi tha: "Sahabet e mi, si yjet, janë dritë për udhëtarët dhe gurë për shejtanët!"

Po qe se do të mund të shihte nga larg, çdokush do të ndriçohej me dritën e diellit.

Dhe o njeri i ulët, ç'nevojë do të mbetej për yllin që të dëshmonte për dritën e diellit?

Hëna i thotë resë, tokës dhe hijes: "Edhe unë jam njeri si ju, vetëm se mua më vjen vahji, fjala e Zotit tim!

Edhe unë, kur u krijova, isha në errësirë si ju, por dielli i vahjit më dha një dritë të tillë.

Jam pak më e errët se diejt, por jam më e ndriçuar se errësira e njerëzve!

E kam dritën të dobët që ta duroni ju, sepse ju s'jeni nga lloji i diellit të shkëlqyer!

Ashtu si përzjerja e mjaltit me uthull, edhe unë u formova nga errësira e ndriçuar dhe, në këtë mënyrë, gjeta rrugë për shërimin e sëmundjes së zemrës, u bëra e dobishme.

O njeri i sëmurë, pasi të shpëtosh nga sëmundja, lëre uthullën e shih të hash mjaltë!"

Froni i zemrës u pastrua nga dëshirat dhe iluzionet; në zemër u shfaq e fshehta "Mëshiruesi zotëroi mbi arsh!"

Pas kësaj, Zoti urdhëron mbi zemrën pa ndërmjetës, drejtpërdrejt. sepse zemra e gjeti këtë lidhje.

As kësaj fjale s'i gjindet fundi. Ku është Zejdi? Le t'i them se nuk është mirë të bëhet rezil!

Kthim në historinë e Zejdit.

Tashmë Zejdin s'e gjen dot se iku; fluturoi nga rradha e fundit pranë derës duke i lënë edhe papuçet!

E kush je ti? Zejdi, bile, si ylli që i ka rënë dielli, e humbi veten dhe s'e gjeti dot më!

Prej tij nuk mund të gjesh as gjurmë, as shenjë. Madje as një fije kashte për të ndjekur rrugën për te mullari i kashtës!

Ndjenjat dhe fjala jonë që s'i gjindet fundi, u zhdukën nën dritën e diturisë së mbretit tonë.

Ndjenjat dhe mendjet e atyre që ia kanë arritur kësaj, në botën e tyre të brendshme vrapojnë plot emocione si dallgë në detin e pranisë hyjnore.

Por kur bëhet natë, vjen përsëri koha e propozimit dhe vërtetimit; yjet e fshehur u vihen sërish punëve të veta.

Zoti ua kthen të pamençurve mendjet në formë rrathësh si vathët që u varen në vesh.

Që të gjithë, duke përplasur këmbët e duart, e lavdërojnë Zotin duke thënë: "Zoti ynë, na ringjalle, na dhe jetë!"

Ato lëkura të kalbura, eshtra të shkoqura bëhen si kalorës që ngrenë pluhurin përpjetë.

Ditën e kiametit, kalojnë nga mosqenia në qenie duke falenderuar ose si qafirë, mohues.

Pse e kthen kokën mënjanë duke bërë sikur nuk sheh? A nuk e pate kthyer kokën kështu edhe në mosqenie?

Kështu pate ngulur këmbë edhe në mosqenie duke menduar: "Si mund të më lëvizë mua prej këtu ku jam?"

A nuk e sheh se ç'bën Zoti i cili, më parë, duke të rrokur ty nga perçeja e ballit,

Të tërhoqi dhe të solli në këto gjendje që s'i kishe në kujtesë e imagjinatë?

Edhe ajo mosqenie është gjithmonë rob i Zotit. O div, nënshtrohu! Sulejmani është i gjallë!

Divi bën poçe si hauzë; s'ka fuqi që të heqë dorë nga kjo punë ose t'i japë një përgjigje atij që e urdhëron!

Pa shih nga vetja se si dridhesh pa pushim nga asgjësimi! Dije se edhe mosqenia dridhet kështu!

Sikur të fusësh në dorë të gjitha postet e botës, madje, heq shpirt nga frika e humbjes së tyre!

Çdo gjë tjetër veç Zotit që është më i bukuri, përbëhet prej agonisë, madje edhe të ngrënët sheqer!

Ç'është agonia, ç'do të thotë të heqësh shpirt? Do të thotë t'i afrohesh vdekjes, të mos e fusësh dot në dorë eliksirin, pijen e pavdekësisë!

Njerëzve të dy sytë u janë ngulur në dhé e në vdekje. A ka eliksir apo s'ka, kjo është mjaft e dyshimtë!

Ti bëj përpjekje që njëqind dyshime për këtë të të bien në nëntëdhjetë! Natën ec se, po fjete, ecën nata e të lë!

Ditën kërkoje te nata dhe bëje udhërrëfyes atë mendje që i djeg errësirat!

Në natën me ngjyrë të keqe ka shumë të mira. Eliksiri është bashkëshoqërues i errësirave, është në errësirë.

A mund ta ngresh kokën nga gjumi kështu, duke mbjellë qindra fara indiferentizmi?

Gjumi i vdekur u bë mik me kafshatën e vdekur; zotëria fjeti, kurse hajduti që punon natën, nisi përgatitjet!

Cilët janë armiqtë e tu? Nuk e di! Ata që janë krijuar prej zjarri, janë armiq të qenies së atyre që janë krijuar prej dheu.

Zjarri është armik i ujit dhe bijve të tu. Fundja, edhe uji është armik i jetës së zjarrit!

Ngaqë zjarri është armik i ujit dhe i fëmijëve, edhe uji e vret zjarrin, e shuan!

Pas të gjitha këtyre, dije se ky zjarr është zjarri i epshit, aty është origjina e mëkatit dhe fajit.

Zjarrin në botën e jashtme e shuan uji. Kurse zjarri i epshit vazhdon gjer në kiamet.

Zjarri i epshit nuk qetësohet me ujë, sepse për nga mundimi dhe dhimbja që shkakton, ka natyrë xhehennemi.

Ç'shërim ka për zjarrin e epshit? Drita e fesë. O besimtarë! Drita juaj e shuajti zjarrin e qafirëve, mohuesve.

Kush e shuan këtë zjarr? Drita e Zotit! Në këtë çështje, bëje usta për vete dritën e Ibrahimit

Me qëllim që trupi yt që digjet si pishë, të shpëtojë nga zjarri i nefsit, egos, që është si Nemrudi!

Zjarri i epshit nuk pakësohet e mbaron duke u djegur. Po të mos digjet, pakësohet mirë e mirë dhe, më në fund, asgjësohet!

Po t'i hedhësh vazhdimisht dru zjarrit, si ka për t'u shuar?

Por po s'i hodhe dru, shuhet. Sepse kjo tërheqje i spërkat zjarrit ujë.

A mund të nxihet nga zjarri fytyra e bukur e personit që i skuqet fytyra nga drojtja e zemrave prej haramit?

Në kohën e Omerit - Zoti qoftë i kënaqur me të - në qytet ra zjarr.

Në kohën e Omerit ra një zjarr. Zjarri i digjte gurët si të ishin dru të thata.

Zjarri nisi të djegë ndërtesat dhe shtëpitë, madje nisi t'ua ndezë zogjve pendët dhe foletë.

Flakët mbështollën gjysmën e qytetit. Edhe uji frikësohej dhe hutohej prej tij!

Njerëzit e mençur derdhnin mbi zjarr ujë dhe uthull me kova,

Kurse zjarri, si për inat, i shtonte flakët. Atë po e ndihmonte Zoti.

Populli u drejtua te Omeri; njerëzit vraponin te ai dhe i thoshin: "Zjarri nuk po na shuhet me ujë!"

Omeri u tha: "Ai zjarr është nga shenjat e Zotit. Eshtë një tufë flake nga zjarri i koprracisë suaj.

Lëreni zjarrin dhe ndajuni bukë të varfërve. Po qe se ma dëgjoni fjalën mua, lëreni koprracinë!"

Populli i tha Omerit: "Dyert tona janë të hapura. Ne jemi njerëz bujarë, kemi burrëri!"

Omeri u tha: "Ju u dhatë bukë të varfërve se ashtu e donte zakoni, nuk u bëtë dorëhapur për hir të Zotit!

Ju tregoni bujari për t'u lavdëruar, për t'u dukur, për t'u përkëdhelur, nga frika, pa u drojtur nga Zoti, jo për t'iu lutur atij!"

Malli është farë, mos e mbill në çdo vend të thatë! Shpatën mos e jep në dorë të çdo kusari!

Dalloji njerëzit fetarë nga njerëzit e urrejtjes! Kërko atë që është bashkë me Zotin, me të rri!

Kushdo tregon bujari ndaj fisit të vet, ndaj njerëzve që i përshtaten karakterit të vet, kurse njeriu i prapë kujton se ka bërë diçka!

Armiku e pështyn në fytyrë Aliun - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - Emiri i muslimanëve, Aliu, e hedh shpatën nga dora.

Sinqeritetin në adhurim mësoje nga Aliu dhe dije të pastruar nga hilet luanin e Zotit!

Në luftë shtriu përtokë një trim, nxori menjëherë shpatën dhe iu hodh sipër.

Dhe trimi e pështyu në fytyrë Aliun me të cilin lavdërohej çdo profet e çdo i shenjtë!

Pështyu në një fytyrë që hëna, në vend të vendit të sexhdes, bën sexhde në fytyrën e tij.

Aliu e hodhi menjëherë shpatën nga dora dhe hoqi dorë nga luftimi me të.

Luftëtari mbeti i habitur nga kjo punë, nga kjo mëshirë dhe falje e pavend.

Dhe i tha: "Pate ngritur kundër meje shpatën tënde të mprehtë, pse e ule dhe më le?

Çfarë pe që, ndërsa ishe i nxehur shumë, u qetësove; çfarë ndodhi që shpërtheu një rrufe dhe u shua menjëherë?

Çfarë pe? Reflektimi i asaj që pe, më goditi edhe mua; në zemër, në shpirt më ndriçoi një tufë drite!

Ç'ishte ajo gjë më e lartë se koha dhe hapësira, më e mirë se shpirti, që na fali jetë?

Në trimëri je luani i Zotit, po në bujari, kush je, kush e di këtë?

Në bujari je reja e Musait në shkretëtirën Tih. nga ajo re bien bukë e të mira që s'u është parë shoqja!"

Këto re punojnë e përpiqen dhe bëjnë të mbijnë grunjërat. Dhe populli e pjek grurin duke e bërë të ëmbël si mjaltin.

Mirëpo reja e Musait e hap krahun e saj të mëshirës dhe i jep popullit pa mundim të mira të gatshme të pjekura e të ëmbla!

Mëshira e asaj reje ka hapur flamur në botë për ata që hanë ushqim të gatuar në sofrën e bujarisë.

Dyzet vjet me radhë, ajo dhunti dhe mirësi nuk u bë mangët as edhe një ditë për njerëzit e lutjes.

Më në fund, ata, me sjelljen e trashë të tyre, u ngritën dhe kërkuan presh, lëpjeta dhe sallatë; atëherë u pre.

Për ummetin, bashkësinë e lartë të Ahmedit, ajo gjellë do të ekzistojë gjer në kiamet.

Kur thënia e Pejgamberit "po shkoj mik te Zoti im" u përhap gjithandej, thënia "Ai më ushqen e më jep ujë" u bë aluzion për këtë ushqim shpirtëror.

Pranoje këtë pa e interpretuar fare që të të vijë në fyt e shijshme si mjaltë dhe qumësht.

Sepse interpretimi është kthimi prapë i gjësë së dhuruar. Sepse interpretuesi e sheh të vërtetën gabim.

Mirëpo kjo e parë gabim vjen nga dobësia e arsyes. Arsyeja e Përgjithshme është mishi, kurse Arsyeja e Pjesshme është lëkura.

Veten interpretoje, jo ngjarjet; kokës tënde thuaji e keqe, jo trëndafilishtes!

"O Ali që je i tëri mendje dhe sy! Thuaj një copëz nga ajo që sheh!

Shpata jote e butësisë na e bëri shpirtin copë-copë; uji yt i diturisë na e pastroi tokën.

Hape; e di se kjo është nga të fshehtat e Zotit. Sepse vrasja e njeriut pa shpatë është vetëm punë e Tij!

Zoti është bërës pa vegla, pa gjymtyrë. Ai është dhënësi i këtyre dhuratave që shtohen pa pushim.

Ai e bën mendjen të shijojë qindra mijëra lloje verërash, për të cilat s'dinë gjë as sytë e as veshët e tu!

O skifter i gjuajtur kënaqësisht që qëndron në Arsh! Thuaje hapur, çfarë sheh në këtë çast nga Zoti?

Syri yt ka mësuar ta shohë të padukshmen. Kurse sytë e të tjerëve që ndodhen aty, janë të mbyllur.

Njëri e sheh hënën krejtësisht qartë, kurse tjetri e sheh botën sterrë të zezë.

Kurse një tjetër sheh tri hëna në një vend. Po, këta tre vetë janë ulur në një vend.

Që të tre i kanë sytë hapur, veshët u dëgjojnë... Mirëpo këta janë lidhur pas teje, janë njerëzit e tu (ti ua di gjendjen), ikin prej meje (unë nuk mund t'i di).

Kjo gjendje a mos është një magji që i përket të padukshmes, apo një favor i fshehtë? A mos tek ti ka një trajtë ujku, kurse tek unë, një trajtë Jusufi?

Edhe sikur bota të jetë tetëmbëdhjetë mijë ose edhe më shumë, as tetëmbëdhjetë prej tyre nuk duken për çdo sy!

O Ali Myrteza, o kaza dhe kader i mirë pas kazasë dhe kaderit të keq, hape të fshehtën!

Ose thuaj ti ç'të vjen në mendje, ose të them unë ç'më lind në zemër!

Kjo e fshehtë shkëlqeu prej teje dhe u duk tek unë; si ta fsheh? Si hëna, shpërndan dritë pa folur!

Por po qe se sfera hënore do të fliste, do t'i vinte udhëtarët menjëherë në rrugë.

Dhe ata do të ishin të sigurtë se nuk po shkonin në udhë të gabuar e se nuk po dilnin nga udha. Zëri i hënës është më i lartë se zëri i fantazmës.

Po qe se hëna tregon rrugën pa folur, ç'do të bënte po të fliste? Do ta mbyste botën në dritë!

Meqë ti je portë për qytetin e diturisë, meqë ti je tufë drite për diellin e butësisë,

O portë, hapu për ata që kërkojnë portë që lëkurët të mbushen (ata që shohin anën e jashtme, ta kuptojnë të vërtetën)!

O portë e mëshirës, o seli e Zotit që s'ke të ngjarë, qëndro e hapur gjer në përjetësi!"

Çdo dëshirë, çdo thërrime është një dritare, por si ndodh që zemra e verbër thotë "atje ka një portë"?

Gjersa vëzhguesi të mos i hapë një portë zemrës, atje nuk ekziston as mundësia që të ketë portë!

Por sapo të hapet një portë, habitet. Zogu i shpresës së pangopësisë fluturon e ikën.

Një njeri i mençur gjeti papritmas një thesar në një gërmadhë, prandaj vrapon në çdo gërmadhë.

Po qe se ti s'ke gjetur dot një margaritar në mosqenie, pse kërkon margaritar tjetërkund?

Edhe sikur për vite të tëra të vrapojë me këmbët e veta, pandehma nuk shkon dot më tej se hunda e vet!

Gjersa në hundë të mos të vijë një aromë nga bota e padukshme, thuaj: a mund të shohësh gjë tjetër veç majës së hundës sate?

Qafiri e pyeti Aliun - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - "Pse e hodhe shpatën prej dore kur më kishe vënë poshtë mua?"

* Atëherë, ai shenjtor musliman i ri, me ndjenjën e dehjes dhe kënaqësisë, i tha Aliut:

"O emiri i muslimanëve! Urdhëro që shpirti në trup të gjallërohet e të lëvizë si fëmija në mitër!

O shpirt, shtatë yje e edukojnë me radhë dhe në periudha të caktuara çdo fëmijë që formohet në barkun e nënës.

Kur fëmijës i vjen koha të gjallërohet, është dielli që i jep ndihmë.

Fëmija nis të lëvizë nën ndikimin e diellit dhe dielli i dhuron menjëherë shpirt.

Fëmija nuk gjallërohet me ndikimin e yjeve të tjerë pa lindur dielli për të, pa i arritur drita e diellit. Yjet e tjerë i shërbejnë vetëm trajtës së tij.

Nga ç'rrugë e fitoi fëmija në mitër këtë lidhje me diellin fytyrëbukur?

Nga një rrugë e fshehtë për ndijimet tona, në qiell ka shumë rrugë për në diell!

Eshtë një rrugë; smeraldi ushqehet nga dielli me atë rrugë.

Eshtë një rrugë; me atë rrugë dhe nën ndikimin e diellit, bëhet smerald.

Eshtë një rrugë me të cilën dielli e skuq rubinin; është një rrugë me të cilën dielli i bën potkonjtë të lëshojnë shkëndija.

Eshtë një rrugë me të cilën dielli pjek frutat; është një rrugë me të cilën u jep guxim frikacakëve.

O skifter me flatra të ndriçuara, i miqësuar me padishahun dhe krahun e padishahut, thuaje hapur!

O skifteri i padishahut që gjuan edhe feniksin, o ti që thyen ushtri jo me pak ushtarë, por i vetëm,

Ti je bashkësi në vetvete, por numërohesh sa për qindramijëra ushtarë. O ti që e gjuan këtë rob për skifterin e mirësisë!

Pse kjo mëshirë në kohën e vrasjes? Lëshimi i kuçedrës, rruga e kujt është?"

Emiri i besimtarëve, Aliu - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - jep përgjigje dhe tregon se cili ishte shkaku që e hodhi shpatën.

Aliu tha: "Unë godas me shpatë për hir të Zotit. Unë jam rob i Zotit, jo nëpunës i ngarkuar me punë i trupit.

Jam luan i Zotit, jo luan i dëshirave dhe iluzioneve... Puna ime dëshmon për fenë time.

Unë jam i merituari i të fshehtës "kur qëllove, nuk qëllove ti, por Zoti qëlloi". Unë jam si shpatë, goditësi është ai diell.

Unë i hoqa nga rruga ç'kisha e ç'nuk kisha; unë e mohova çdo gjë tjetër veç Zotit.

Unë jam hije, zotëria im është dielli. Unë jam treguesi i tij, jo fshehësi i tij.

Jam shpatë e stolisur me margaritarët e bashkimit me Zotin. Në luftë ringjall, nuk vras.

Gjaku nuk e mbulon margaritarin e shpatës sime. Si mundet era të ma marrë renë e ta çojë tutje?

Unë s'jam mullar kashte, por mal butësie, durimi dhe drejtësie. A mundet ta lëvizë cikloni malin?

Kush lëviz e këputet nga vendi me një erë, është një fije kashte, sepse ka shumë erëra që fryjnë në të kundërt!

Era e zemërimit, epshit dhe ambicjes e fshin dhe e hedh tutje personin që s'është i namazit.

Unë jam mali; qenia ime është ndërtesa e tij. Edhe era që më bën t'i përngjaj një mullari kashte, është era e tij.

Lëvizja ime bëhet vetëm me anë të erës së tij. Kryekomandanti i ushtrisë sime është vetëm dashuria për Zotin e vetëm.

Furia sundon edhe mbi padishahët, madje, por për ne është skllav. Unë e kam sunduar furinë, i kam hipur sipër.

Shpata ime e butësisë ia ka këputur qafën zemërimit tim. Kurse zemërimi i Zotit, sipas meje, është mëshirë.

Tavani e çatia m'u shembën, por u mbyta në dritë! Edhe nëse u bëra atë i tokës (Ebu Turab), u shndërrova në kopësht.

Duke luftuar, përbrenda më erdhi një lëkundje, një egoizëm dhe e pashë me vend ta fshihja shpatën.

Në këtë mënyrë, dëshirova të thuhej "dashuria e tij është për hir të Zotit", vetëm se gjithashtu duhet edhe të urrej dikë për hir të Zotit.

Desha që bujaria ime të jetë në rrugë të Zotit, gjithashtu që kursimin ta bëj për hir të Zotit.

Edhe ruajtja, edhe dhënia ime janë vetëm për hir të Zotit; vetëm për të e për askënd tjetër!

Çfarëdo që të bëj për Zotin, nuk është imitim, nuk është duke fantazuar, nuk është duke rënë në dyshim. Atë që bëj, atë që kryej, e bëj dhe e kryej vetëm me vetëdije.

Shpëtova pa nxjerrë urdhra, pa bërë kërkime e hetime. Me dorën time u kapa pas Zotit.

Po të fluturoj, e shoh vendin ku fluturoj; po u ktheva, vendin ku kthehem.

Po të bart një ngarkesë, e di se ku do ta çoj. Unë jam hënë; para meje prijësi është dielli.

Eshtë e pamundur që popullit t'i thuhet më tepër se kaq; është e pamundur që lumi ta nxëjë detin.

Po flas nga shkalla e poshtme aq sa ç'mund të nxënë mendjet. Kjo nuk është turp, por punë e Pejgamberit!

Unë jam i lirë nga marazi; dëgjoje dëshminë e njeriut të lirë. Dëshmitë e atyre që janë skllevër e robër s'vlejnë as sa dy kokrra elbi!

Në sheriat, dëshmia e robit në gjykim dhe vendim nuk ka vlerë.

Edhe sikur mijëra skllevër të dëshmojnë kundër teje, sheriati s'e vlerëson dëshminë e tyre as sa për një fije kashte!

Kush i bëhet rob epshit, para Zotit është më i keq se skllavi, se robtë e tij të rënë rob.

Sepse skllavi fiton lirinë me një fjalë dhe çlirohet nga pronësia e të zot, kurse skllavi i epshit ringjallet i ëmbël dhe vdes i hidhur.

Skllavi i epshit nuk mund të shpëtojë nga robëria dhe skllavëria pa qenë mëshira e Zotit, favori dhe mirësia e posaçme e tij!

Ai ka rënë në një gropë të tillë që ajo gropë është faji i tij. Nuk është shtrëngesë dhe dhunë.

Ai e ka hedhur veten në një gropë të tillë që unë nuk mund të gjej litar që të arrijë në fund të saj!

Mjaft me kaq!.. Po ta zgjas këtë fjalë, ç'bëhet me mëlçinë? Edhe mermeri, madje, kthehet në gjak!

Këto mëlçitë nuk bëhen gjak nga ashpërsia, hutimi, preokupimi me këtë botë dhe pafatësia.

Një ditë kthehen në gjak, mirëpo kjo gjë s'ka dobi atë ditë. Bëhu gjak kur vlen për t'u bërë gjak!

Meqë dëshmia e robërve dhe e skllevërve nuk është e pranueshme, person me të vërtetë i drejtë i thonë atij që nuk i bëhet skllav fantazmës dhe hijes!

Në Kur'an për Pejgamberin thuhet: "Ne të dërguam ty si dëshmitar!" Sepse qysh në krijim ai ishte i lirë i biri i të lirit.

Meqë unë jam i lirë, si më sundon zemërimi mua, si më bën rob të vet? Këtu s'ka atribut tjetër veç atributeve të Zotit, kthehu mbrapsht!

Kthehu prapë që mirësia e Zotit të të çlirojë. Sepse mëshira e tij është më e lartë e më e madhe se ndëshkimi i tij!

Kthehu prapë se tani shpëtove nga rreziku, ike; alkimia të ktheu në gjendje margaritari.

Shpëtove nga mohimi dhe gjembat e tij; tani hapu si trëndafil në lulishten e Zotit!

O njeri i lartë, ti je unë dhe unë jam ti.Ti ishe Aliu, si e vrave Aliun?

Bëre një faj të tillë që, më mirë se një adhurim, në një çast i kapërceve qiejt skaj më skaj!

Ç'faj i bekuar faji i kryer prej atij njeriu! A nuk mbin trëndafil nga gjembi?

Faji i paramenduar i Omerit ndaj Pejgamberit a nuk e tërhoqi dhe çoi atë gjer në portën e pranimit të besimit?

A nuk i thirri faraoni magjistarët sepse ishin magjistarë?

A nuk kërkoi prej tyre për këtë shkak ndihmë, a nuk arritën ata pozitë për këtë shkak?

Po të mos ishte magjia e tyre, mohimi i tyre, a do t'i pranonte faraoni në pritje?

As ata nuk do ta kishin parë dot shkopin e Musait dhe magjinë e tij. O fis kundërshtues! Faji u bë adhurim!

Zoti i ka rënë në zverk pesimizmit. Sepse mëkati dhe faji janë bërë adhurim.

Sepse Zoti, në mitrën e shejtanëve, fajet i shndërron në adhurim, në mirësi.

Si rrjedhojë e kësaj shejtani goditet me gurë, çahet nga smira, bëhet dy copë.

Shejtani dëshiron të nxjerrë në shesh një mëkat dhe me të të na rrëzojë neve në gropë.

"A e pe se ai mëkat është adhurim?" Ja, pra, ai çast është për shejtanin një çast i pafat!

Kthehu pas se të kam hapur një portë; ti më pështyve në fytyrë, kurse unë të ofrova një dhuratë.

Po qe se edhe atë që më mundon e trajtoj kështu, po qe se edhe atyre që më gjuajnë me shkelm, u bie ndër këmbë,

Ç'i dhuroj atij që më rri besnik? Kupto! Në xhennete u dhuroj pasuri të patundshme të përjetshme!

Pejgamberi (a.s.) i thotë në vesh kujdestarit të kalit të emirit të muslimanëve, Aliut - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - "Po të lajmëroj se vrasja e Aliut do të jetë në dorën tënde!"

Jam një trim i tillë, që sherbeti i favorit tim nuk iu bë helm vdekjeje as gjakësit e as vrasësit tim!

Pejgamberi i tha në vesh shërbëtorit tim se ai kishte për të ma ndarë kokën nga zverku!

Ai më thotë vazhdimisht: "Vramë që kjo punë e gabuar dhe e keqe të mos dalë prej meje!"

Edhe unë i them: "Meqë vdekja do të më ndodhë prej teje, si mund të bëj dredhi ndaj kazasë dhe kaderit?"

Ai vazhdimisht duke më rënë ndër këmbë, duke e vënë ballin në tokë, më thotë: "O bujar i madh, për hir të Zotit çamë më dysh

Që të mos pësoj një fund të tillë dhe të mos më digjet shpirti!"

Edhe unë vazhdimisht i them: "Ec tutje! Kalemi i kaderit këtë shkroi dhe boja e këtij shkrimi u tha. Ç'qe për t'u thënë, u tha! Sa e sa flamurë bien përtokë nga kalemi i kaderit!

Në zemër nuk kam asnjë armiqësi ndaj teje, sepse e di që këtë s'e kam prej teje!

Ti je vegël e Zotit; bërësi është dora e Zotit. Si ta dënoj veglën e Zotit, si ta kundërshtoj veglën e Zotit?"

Ai tha: "Atëherë, ndëshkimi kokë për kokë pse është?" Aliu iu përgjigj: "Edhe ai është prej Zotit, edhe ai, një sekret i fshehtë.

Po qe se Zoti e kundërshton punën që e ka bërë vetë, për shkak të këtij kundërshtimi bën që të blerojnë kopshte e vreshta.

Kundërshtimi për punën e vet ka vlerë vetëm për të, sepse ai është i vetëm edhe në favor, edhe në ndëshkim!

Në qytetin e këtyre ngjarjeve ai është zotëri, masat parandaluese nëpër vendet janë të tij.

Po e theu veglën, veglën e thyer e përmirëson vetë!"

O i shtrenjtë, dije alegorinë që thotë se "Asnjë ajet nuk e ndërruam që pas tij të mos sjellim një më të dobishmin!"

Fuqinë e cilit sheriat të ketë ngritur Zoti, do të thotë se iu shkul bari dhe në vend të tij mbiu trëndafili.

Nata i jep fund preokupacionit të ditës. Shihe këtë gjumë që s'ta merr mendja!

Pastaj përsëri, me dritën e ditës, nata zhduket dhe, në këtë mënyrë, për shkak të atij zjarri me breshëri, ngrirja dhe gjumi digjen e mbarojnë.

Ai gjumë, ajo pandjeshmëri është errësirë, mirëpo a s'është uji i jetës në errësirë?

Mendjet, a nuk rinohen me atë errësirë? Pushimi në pjesën e kompozuar a nuk i jep forcë zërit?

Të kundërtat shfaqen nga të kundërtat... Zoti krijoi një dritë të vazhdueshme në pikën e errët të zemrës.

Lufta e Pejgamberit u bë shkak për paqe. Paqja në këtë kohë të mbrame është si pasojë e asaj lufte.

Ai i dashuri që rrëmben zemra (Pejgamberi) preu qindramijëra koka që kokat e atyre që janë në këtë botë të gjejnë shpëtim.

Kopshtari krasit degët në mënyrë që fidanët të hedhin shtat dhe të japin fruta.

Kopshtari që e di zanatin, herr barërat e këqija e të tepërta që kopshti dhe perimet të zhvillohen e të zbukurohen.

Mjeku ia heq dhëmbin e kalbur të dashurit me qëllim që të shpëtojë nga dhimbja dhe sëmundja.

Në gjërat e mangëta ka sa e sa teprica. Jeta për dëshmorët është te mungesa e tyre.

Po u pre fyti që ha rizk, përvetësohet dhuntia "Ata furnizohen, ushqehen dhe qetësohen nga Zoti i tyre!"

Kur pritet gryka e kafshës, zhvillohet gryka e njeriut. Kafsha hyn në trupin e njeriut, bëhet njeri, i rritet vlera.

Ç'ndodh po t'i pritet gryka njeriut? Gjer ku i shkon vlera? Më në fund, bëhu i kuptueshëm dhe krahasoje me këtë.

Lind një grykë e tretë e tillë që ushqehet dhe zhvillohet me sherbetin e Zotit, me dritën e Zotit!

Gryka e prerë e pi këtë sherbet, por gryka që ka shpëtuar nga "La"-ja (mohimi) dhe ka vdekur në "Bela" (pohim)!

O ti njeri me gishta të shkurtër e me mirësinë të prerë! Gjer kur jeta e shpirtit tënd do të jetë bukë?

Meqë e fëlliq fytyrën për bukë të bardhë, je pa fruta si shelgu lotues!

Po qe se shpirti i ndjenjave të tua nuk duron dot pa këtë bukë, gjeje alkiminë dhe bëje bakrin flori!

Po deshe ta lash rrobën, mos ik nga mëhalla e rrobalarësve!

Po qe se buka ta ka thyer agjërimin, zëre mjeshtrin e kockave të thyera, ngjitiu pas dhe lartësohu!

Meqë dora e tij i lidh thyerjet dhe i shëron, nuk ka dyshim që thyerja që bën ai është bërje, rregullim.

Por po të thyesh ti, të thotë: "Eja, bëje, të të shohim!" Mirëpo s'e bën dot sepse të mungojnë duar e këmbë!

Atëherë, thyerja është e drejta e njeriut që e ngjit, e lidh dhe e shëron thyerjen!

Ai që di të qepë, di edhe të grisë. Çfarëdo që të shesë, në vend të saj merr më të mirën.

E shemb shtëpinë, e bën rrafsh me tokën, por veç kur brenda një çasti e sjell në gjendje më të rregulluar.

Po të presë një kokë prej një trupi, në vend të saj, menjëherë nxjerr qindramijëra kokë!

Po të mos urdhëronte shpagim një për një për kriminelët ose po të mos thoshte se "në shpagimin një për një ka jetë",

Kush do të merrte guximin që t'i hiqte shpatë një personi të bërë rob urdhrit të Zotit?

Sepse kujt t'ia ketë hapur syrin Zoti, e di se vrasësi është rob i vendimit të Zotit.

Kështu ka ndodhur që, sipas vendimit të Zotit, njeriu ia ka prerë kokën të birit!

Ec, ki frikë dhe dënoji pak të këqinjtë; njihe dobësinë tënde përballë kurthit të vendimit të Zotit!

Ademi (a.s.) habitet me mbrapshtinë dhe mendjemadhësinë e Iblisit.

Pejgamberi Adem, befas e pa me përbuzje Iblisin i cili, në fakt, ishte i ulët.

Dhe qeshi me punën e shejtanit të mallkuar që e pëlqente veten dhe e mbante për të madh!

Zelli i Zotit bëri zë: "O njeri krejt i pastër! Ti nuk i di sekretet e fshehta!"

Po qe se Zoti e vesh qyrkun ters, edhe malin e shkul nga rrënjët, nga themelet!

Atëherë, ua gris perdet qindra Ademëve dhe krijon qindra Iblisë të pamëkat, të pafaj, që porsa janë bërë muslimanë!

Ademi tha: "Bëra pendesë për këtë mendim të ulët. S'kam për të rënë edhe një herë tjetër në një mendim të tillë të paturpshëm!"

O ti, ndihmëtari i atyre që lypin ndihmë, na udhëzo! Eshtë e pamundur të lavdërohemi me dituri dhe pasuri!

Mos e tërbo zemrën që pate mirësinë ta udhëzosh, largoji prej nesh të këqijat që ke miratuar!

Kurseji nga ne ngjarjet e këqija dhe mos na ndaj nga vëllezërit që e duan Zotin!

Nuk ka gjë më të hidhur se ndarja prej teje! Po s'u mbështetëm tek Ti, po s'na ruajte Ti, puna jonë është vetëm grindje e rrëmujë!

Zaten malli e pasuria jonë ua presin rrugën mallit dhe pasurisë sonë... Zaten trupi ynë e grabit, e zhvesh dhe e lë lakuriq trupin tonë!

Pasi që dora të na i bjerë këmbës, kush mund ta shpëtojë jetën pa qenë favori yt?

Edhe sikur ta shpëtojë jetën prej rreziqeve shumë të mëdha, gjëja e shpëtuar shndërrohet veçse në kapital rreziqesh dhe frike!

Sepse gjersa shpirti të mos e ketë arritur të dashurin, është përjetësisht i verbër e në zi!

Në thelb, po të mos jetë mirësia jote, shpirti është pothuaj një i zënë rob; shpirtin që s'është i gjallë me ty, zëre të vdekur!

Po qe se ti, o Zot, zemërohesh me robtë e tu, i dënon ata, kjo është e drejta jote!

Po qe se hënës dhe diellit u thua se janë të metë, pa dritë e bukuri, të përulen gjer në tokë;

Po qe se qiellit dhe arshit u thua të ulët e pa vlerë, minierës dhe detit, të varfër,

Në krahasim me përsosmërinë tënde, të ka hije! Sepse vetëm ti e ke fuqinë për t'i plotësuar mangësitë e për t'u dhënë përsosje gjërave!

Sepse tek ti nuk ka mungesë dhe nevojë; vetëm ti je që i krijon mungesat dhe që i shpëton ato nga nevojtaria!

Kush bën, di dhe të çbëjë; kush shqep, di dhe të qepë!

Çdo vjeshtë i zverdh e i rrënon kopshtet e vreshtat. Pastaj sërish rrit trëndafilat e kuq që i riveshin kopshtet në ngjyra.

Dhe i krijon të gjitha nga e para duke u thënë: "O ti që je djegur, shfaqu, rinohu, zbukurohu sërish!"

Syri i narcizit verbohet dhe ai prapë e bën të çelë... Ia pret fytin kallamit, pastaj vetë e përkëdhel dhe nxjerr tinguj prej tij.

Meqë ne s'jemi krijues, por të krijuar, jemi vetëm robër, vetëm të kënaqur.

Të gjithë ne thërresim vazhdimisht: "Unë, unë!" Vetëm veten tonë mendojmë! Po s'na favorizove ti, jemi shejtanë!

Ne shpëtuam nga shejtani sepse ti na e shpëtove shpirtin nga verbëria, sepse ti na i hape sytë!

Për këdo që është në jetë, ti je ai që i jep shkopin për ta gjetur rrugën, ti ia tregon rrugën. Po të mos e ketë shkopin dhe shoqëruesin që e udhëzon, ç'mund të bëjë i verbëri?

Çdo gjë tjetër veç teje, qoftë e mirë ose jo e mirë, e djeg njeriun, është zjarri vetë!

Kush mbështetet te zjarri dhe i vë shpinën zjarrit, është edhe idhujtar, edhe zjarradhurues!

Çdo gjë tjetër veç Zotit është e shtrembër, është e kotë. Mirësia e Zotit është një re që nuk i pritet shiu.

Kthim në historinë e Aliut - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - Aliu e sheh me sy të mirë vrasësin e vet.

Kthehu përsëri në historinë e Aliut dhe vrasësit të tij dhe trego për bujarinë e tepërt që tregoi për vrasësin e vet!

Aliu tha: "Unë e shoh me sy armikun tim, natë e ditë atë rri dhe e shoh. Megjithëkëtë, nuk zemërohem aspak me të!"

Sepse vdekja më vjen e këndshme si jeta, pothuaj njëlloj me ringjalljen.

Vdekja si pavdekësi është bërë e bekuar për ne; ushqimi si mungesë ushqimi është ushqim dhe dhunti për ne.

Pamja e vdekjes është vdekje, kurse përmbajtja, fytyra e brendshme e saj, është ringjallje; në pamje, vdekja s'ka fund, kurse në të vërtetë, është përjetësi.

Lindja, dalja e fëmijës nga mitra është shtegtim në një botë ku për të ka një jetë të re nga fillimi.

Meqë prirja jonë drejt vdekjes është pasioni ynë për çastin e fundit, urdhri ndalues "mos e hidhni në rrezik veten me dorën tuaj" është për ne!

Sepse ndalimi bëhet për gjënë e ëmbël, pasi për gjënë e hidhur s'ka nevojë të vihet ndalim!

Po qe se një gjë është e hidhur edhe nga brenda, edhe nga jashtë, do të thotë se hidhësia e saj është ndalim për të keqen e saj.

Edhe për mua, vdekja është e ëmbël. Ajeti "ata s'kanë vdekur, por janë të gjallë pranë Zotit të tyre" është për mua.

O njerëz që ju kam besuar dhe ju jam bindur! Dënoméni dhe vraméni! Nuk ka dyshim se jeta ime e amshuar është te vdekja ime!

O trim! Pa diskutim, jeta ime është te vdekja ime! Gjer kur do të mbetem larg vendit tim?

Po qe se qëndrimi im në këtë botë nuk do të ishte ndarje, nuk do të thuhej se "pa dyshim, ne do të kthehemi te Zoti ynë!"

Personi që kthehet është personi që vjen përsëri në qytetin prej nga është larguar; është ai që, duke shpëtuar nga ndarja në kohë, arrin njësimin!

Vrasësi i bie ndër këmbë Aliut - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - duke i thënë: "O emiri i besimtarëve, vramë dhe shpëtomë nga kjo ngjarje!

Duke ardhur prapë, vrasësi tha: "O Ali, vramë menjëherë që të mos e shoh atë kohë të keqe, atë çast të keq!

Po ta bëj hallall, derdhma gjakun që syri të mos ma shohë atë kiamet!"

I thashë: "Edhe sikur çdo thërrime të jetë një gjakatar, një katil dhe me hanxhar në dorë të të sulmojë për të të vrarë,

Nuk do të ta prekte as qimen ty, sepse kalemi i kaderit kështu ka shkruar: ti ke për të më vrarë mua!

Por mos u shqetëso, ndëmjetësuesi yt për falje jam unë! Unë jam burrë dhe mbret i shpirtit, jo skllav dhe shërbëtor i trupit!

Ky trup s'ka vlerë për mua; unë jam trim bir trimi që s'varet nga trupi!

Hanxhari dhe shpata ime janë lulja ime; vdekja është kuvendi im, është kopshti dhe vreshta ime!"

Si mund të ndodhë që njeriu i cili e merr nëpër këmbë dhe e vret në këtë mënyrë trupin, të bjerë në ambicjen për zotërillëk dhe pushtet?

Ai merret në dukje me punët e postit vetëm për të udhëzuar, për të fiksuar detyrën e emirit.

Ai merret me këtë punë për të dhënë një jetë të re për postin e emirit, për ta bërë të japë fruta fidanin e kalifatit.

Dëshira e Mustafait (s.a.s.) për ta pushtuar Mekën dhe vende të tjera nuk ishte nga dashuria për pasurinë e kësaj bote, por me urdhër të Zotit, sepse ai pati thënë se "kjo botë është kufomë".

A mund të akuzohet Pejgamberi për dashuri ndaj kësaj bote për shkak se u përpoq ta pushtonte Mekën?

Ai ishte një njeri i tillë që ditën e provës (miraxhit), përballë thesareve të shtatë qiejve, edhe sytë i mbylli, edhe zemrën.

Për ta parë atë, shtatë kat qiej ishin mbushur skaj më skaj me hyrí dhe engjëj.

Të gjithë e kishin stolisur veten për të, mirëpo te ai s'kishte dëshirë dhe pasion tjetër veç prirjes dhe dashurisë për të dashurin, Zotin e gjithësisë!

Ai ishte mbushur në atë mënyrë me madhështinë dhe madhërinë e Zotit, saqë as njeriu i Zotit, madje, nuk do të mund të gjente rrugë gjer në atë gradë, gjer në atë post!

Ai tha: "Në postin tonë nuk mund të arrijë as ndonjë pejgamber me sheriat, as engjëll, madje, as shpirt!" Mendoni, pra, dhe kuptoni!

Ai tha: "Ne jemi të njohur me të fshehtën "syri nuk u shmang, nuk u prir për ndonjë vend tjetër veç Zotit", jemi sarhoshë të Zotit që e ngjyen botën ngjyra-ngjyra, jo sarhoshë të kopshtit e vreshtës!"

Po qe se edhe thesaret e qiejve e të mendjeve, madje, duken të parëndësishme si fije kashte para syve të Pejgamberit,

Ç'janë Meka, Damasku dhe Iraku që të luftojë për to, t'i dëshirojë ato?

Vetëm personi me zemër të keqe, i cili punët e tij i krahason me paditurinë e vet, me ambicjen e vet, mund të bjerë në një dyshim të tillë mbi të!

Po pe nga qelqi i verdhë, dritën e diellit do ta shohësh të verdhë.

Thyeji atë qelq dhe atë pandehmë dhe shih atëherë se kush është burrë e kush, pluhur!

Kalorësi ngre pluhur pas dhe ti e pandeh pluhurin për trimin e Zotit!

Edhe Iblisi pa pluhurin dhe tha: "Është nga lloji i kësaj toke. si mund të jetë më i lartë se dikush me ballin të zjarrtë si unë?"

Kur t'i shohësh shenjtorët si njerëz, dije se kjo pikëpamje është trashëgim prej Iblisit.

O inatçi, po të mos jesh i biri i Iblisit, si ndodh që trashëgimi i atij qeni të bie ty?

Unë nuk jam qen, por luan i Zotit. Luani i Zotit është ai që ka shpëtuar prej trajtës.

Luani i kësaj bote kërkon gjah dhe ushqim, kurse luani i Zotit, liri dhe vdekje.

Sepse në vdekje sheh qindra jetë dhe qenien e vet e djeg si flutura rreth qiririt.

Dëshira për vdekje është hallkë në qafë të personave të drejtë, sepse kjo dëshirë u bë provë për çifutët.

Zoti tha në Kur'an: "Çifutët thonë se vdekja për të drejtët është pushtim, kapital dhe tregti.

Dëshira për vdekjen është më e mirë se dëshira për kapital dhe tregti.

O çifutë! Po deshët ta ruani nderin mes popullit, flisni për këtë dëshirë, për dëshirën për vdekjen!"

Me ta ngritur Muhammedi këtë flamur, as një çifut i vetëm, madje, nuk pati guxim për të shprehur një dëshirë të tillë!

Pejgamberi tha: "Po qe se do të bënin fjalë për këtë, në botë s'do të mbetej asnjë çifut!"

Atëherë, çifutët thanë: "O drita e fesë, mos na demasko ne!" Dhe dhanë mall dhe haraç.

Fundi i kësaj fjale nuk duket. Meqë syri ta pa të dashurin, nëma dorën mua!

Emiri i besimtarëve, Aliu - Allahu ia shenjtëroftë fytyrën - i tha armikut: "Kur më pështyve në fytyrë, egoja m'u fry dhe në luftën time s'më mbeti më sinqeritet. Kjo ishte që më pengoi të të vrisja!

Emiri i besimtarëve i tha atij djalit të ri: "O trim, ndërsa po luftonim

Dhe ti më pështyve në fytyrë, egoja m'u fry, u tërbova, karakteri m'u prish e m'u shkatërrua.

Erdha në një gjendje të tillë që në atë çast, lufta ime ishte gjysma për Zotin dhe gjysma tjetër, për veten time! Mirëpo ortakllëku në punën e Zotit s'është me vend.

Ti je pikturë e Zotit: Ty ai të krijoi me dorën e fuqisë dhe të stolisi. Ti je i tij, jo imi.

Pikturën e Zotit prapë me dorën e Zotit thyeje, xhamin e të dashurit me gurin e të dashurit qëlloje!"

Qafiri e dëgjoi këtë fjalë dhe në zemër iu shfaq një dritë e tillë që e preu brezin e priftërisë.

Dhe i tha: "Unë kisha mbjellur farën e së keqes dhe ty të pandehja ndryshe.

Mirëpo ti paske qenë një peshore me karakter hyjnor, madje ti paske qenë shigjeta e të gjitha peshoreve!

Ti paske qenë soji e sorrollopi im, paske qenë ndriçimi i kandilit dhe i fesë sime!

Unë jam robi, skllavi i kandilit që kërkon syrin që sheh, që edhe kandili yt prej atij ka marrë dritë, është ndriçuar...

Unë jam robi i atij deti drite, jam kurbani i tij, që shfaq një margaritar të tillë!

Thuajmë Fjalën e Dëshmisë, ta them edhe unë, se të pashë ty më të lartin e kohës!"

Bashkë me të, edhe afro pesëdhjetë vetë nga fisi dhe të afërmit e tij iu drejtuan haptazi fesë dhe u bënë muslimanë.

Me shpatën e tij të butësisë, Aliu i shpëtoi nga shpata kaq grykë, kaq njerëz!

Shpata e butësisë është më e mprehtë se shpata prej hekuri, madje më fitimtare, më e epërt se qindra ushtri!

Sa keq që u hëngrën dy kafshata dhe, prandaj, entuziazmi i mendimit ngriu, u tulat.

Një kokërr grurë u bë shkak për zënien e diellit të Pejgamberit Ademi. Duke hyrë mes tokës dhe diellit, u bë shkak për nxirjen e hënës së plotë!

Ja, pra, ndjeshmëria e zemrës! Nga një grusht argjilë! Nga nja dy kafshata bukë, hëna bëhet copë-copë!

Po qe se është bukë shpirtërore, në ngrënien e saj ka dobi. Por buka që njohim ne, s'ka dobi; ajo e ngushton zemrën!

Buka shpirtërore, si gjemb i blertë... Kur e ha, deveja gjen qindra lloj dobish, qindra shije.

Por pasi t'i ikë blertësia e të thahet e pastaj ta hajë deveja në shkretëtirë,

Ia copëton qiellzën dhe grykën. Sa keq që një trëndafil i rritur ashtu, kthehet në shpatë!

Edhe kur buka bëhet shpirtërore, ai gjemb i blertë është. Por tani, meqë është bukë materiale, e dukshme, është e thatë dhe e fortë.

O ti qenie e përkëdhelur, Husameddin! më parë ishe mësuar të hash atë.

Me këtë shprehi kërkon ta marrësh edhe këtë bukë të thatë e ta hash, por kuptimi u përzje me dheun;

Dhe, i përzjerë me dheun, i fortë, u bë që ta grisë gjuhën dhe qiellzën. O deve, mos e ha tani atë bar, largohu prej tij!

Fjala u përzje me dheun, uji u turbullua... Mbyllja grykën pusit.

Që Zoti ta sjellë atë përsëri në gjendje të kulluar e të këndshme. Edhe atë që e ka turbulluar, e kullon.

Qëllimi arrihet me durim, jo me ngutje. Duro se Zoti e di ç'është e drejtë!